

**Fadil
paçrami**



EDHE TRI DRAMA

NGJARJE NË FABRIKË
NJËZET DITË
LAGJJA E VARFËR

891.983-2

5

P 13

FADIL PAÇRAMI

R

Edhe tri drama

1 – Ngjarje në fabrikë

2 – Njëzet ditë

3 – Lagjja e varfër

SHTF 71

31-914

SHTEPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»
LIBRARI I KULTURËS

H Y R J E

Pas 6 shkurtit 1967 kudo shpërthyen fletërrufetë. Unë i ndiqja ato me vëmendje, i lexoja, mora pjesë në shumë mbledhje të puntorëve, edhe në debatet që bëhen. Me këtë dua të them se shumë ngjarje, dialloge, batuta, deri në tekste të plota të fletërrufeve, që lexojmë në dramën «Ngjarje në fabrikë», janë marrë drejtë përdrejtë ngajeta.

Klasa puntore ngrihej në luftë, në luftën për revolucionarizim, dhe në procesin e kësaj lufte, duke hapur zjarr kundër çdo gjëje të huaj, formonte edhe vetveten, forconte edhe kontrollin e saj. Drama mbaron me këtë thënje të gazetarit; «Këta njerëz, me thirrjen e partisë u ngritën në luftë, në luftën për revolucionarizim. Ata nuk i ndal më asgjë. Ja kështu, në kudhrën e revolucionit kaliten ata... Në këtë kudhër dërmohet edhe çdo gjë e huaj... Sepse kjo është një kudhër e atillë që, o të shëron, o të pëlcet... Dhe kjo vazhdon... Dhe kjo do të vazhdojë... Letra e hapur dhe 6 shkurti ndezi tek ne një zjarr të ri të pashuar...» Kjo është edhe idea e dramës.

Dhe si hero të saj të vërtetë, në qëndër të saj, vura masën, punëtorët. Ata janë e reja, ata veprojnë, ata fitojnë. E vjetra, e përfaqësuar nga Jashar Driza, që në fillim deri në fund, nuk bën tjetër veçse mbrohet. Kongresi i 5-të i partisë vuri para nesh detyrën për ta trajtuar më gjérë dhe më thellë klasën punëtore. Dikush e mori atë në komandë, të qëndrueshme, të patundur. Të tjerë e morën në luftë me vështirësitë e natyrës. Unë e mora në luftë me konceptet dhe ideologjinë e huaj,

burokratizmin, intrigën, meskinitetin. Shokë të tjerë, edhe unë vetë, do ta marrim atë edhe në shumë aspektë të tjera. Kjo temë është për letërsinë e artet tonë e pa-fund, porsa kemi hedhur hapat e para. Sigurisht, nuk është e thjeshtë: duhet të rrosh dhe të shkrihesh me punëtorët, që të hyjsh thellë në botën e tyre, të zbulosh dhe të kuptosh atë të veçantë e të madhe që kanë ata.

Që në fillim më dolli edhe çështja e formës. Vetë idea e dramës kish lindur në mbledhjet e punëtorëve dhe nuk më qe e mundur të shkëputesh nga mbledhja edhe si formë. Mirëpo nguroja, i trembesha mbledhjes. Vetë skena, më vonë, hodhi poshtë frikën se kështu si u shkrojt ajo nuk do të ishte skenike. Nga gjithë kjo edhe një herë forcova bindjen se forma lind nga përmajtja dhe duhet t'i shërbejë asaj, prandaj nuk mund të ketë kufij e pengesa kur përmajtja dhe forma janë në unitet. Me këtë dua të them se mbledhja u bë kësh-tu një mjet, edhe një konveksion, për të shprehur përmajtjen dhe luftën e ideve të veprës, siç është edhe kafeneja në dramën «20 ditë».

Personat veprues:

MIRA	20 vjeçë
LUMTUA	25 vjeçë
MARA	40 vjeçë
LANDA	drejtoreshë e fabrikës, 32 vjeçë
JASHARI	shef i repartit, 37 vjeç
LEKA	31 vjeç } .
GJINI	35 vjeç } punëtorë.
PIRRUA	27 vjeç
PETRUA	54 vjeç
LONI	inxhinier, 34 vjeç
KRISTAQI	furnitor, 41 vjeç
NËNË SANIA	pastruese, 53 vjeçë
DRITANI	19 vjeç } grupi i
BENI	18 vjeç } të rindjëve
VITA	18 vjeçë }
OBJEKTIVISTI	
INDIFERENTI	
FRIKAMANI	
NJË GAZETAR	
NJË I PFTUAR	
NJË I PANJOHUR	
PUNËTORË DHE PUNËTORE	

PJESA E PARË

Në paraskenë, nga e majta, janë vendosur shumë fletërrufe, të cilat mbulojnë të gjithë faqen e murit. Nga drejtime të ndryshme hynë punëtorë, duke biseduar me gjallëri. Jemi në një ndërmarrje çfarëdo të Tirana, në shkurt të vitit 1967. Grupegrupe punëtorët ndalin përpara fletërrufeve, që tërheqin vemendjen e tyre.

GAZETARI: (*Hyn nga e majta, shikon punëtorët duke lexuar fletërrufetë, bën disa hapa dhe drejtohet nga spektatorët*) Unë pata shkrojtur dikur një artikull përkëtë ndërmarrje. Cilat ishin shkaqet e prapamjetjes së saj? Çfarë e mbante në vend atë? Përse nuk shkëputej nga format artizanale dhe nga se pingohej progresi teknik? Ishte e qartë. Diçka dhe di-kush e pengonte. Dhe kjo diçka nuk ishte abstrakte. E reja me të vjetërën përllesheshin edhe në këtë ndërmarrje, herë hapur dhe herë jo hapur. Lufta sa ndizej, shuhej. Këto ditë filloj thjesht më një fletërrufe. Pastaj u vunë fletërrufe të tjera. U vunë shumë fletërrufe. Plasën diskutimet. Kështu filloj...

PIRRA — (*U drejtohet shokëve të tij*) Sot është mbushur plot, nuk ka mbetur vend fare.

VITA — Sot bëhet mbledhja, prandaj...

PETRUA — U bënë 10 ditë, nuk janë pak më duket...

KRISTAQI — Këtë shko e ja thuaj shokut Leka.

Ai nguli këmbë të vazhdonte diskutimi me anë të fletë-rrufeve një herë, pastaj të bëhej mbledhja.

BENI — Dhe mirë bëri.

KRISTAQI — Se mos thashë unë keq!..

VITA — Përgjegjja e Jasharit e ngriti shumë tensionin...

MARA — Pse, sa i vajti, moj bijë, se ka qenë i së-murë.

VITA — 25, më duket.

MARA — Mua më arrin deri në 18 dhe më merren mendtë.

PETRUA — (*Marës*) Bën shaka ajo, moj Marë, bën shaka... Nuk e ka fjalën për tensionin e gjakut...

PIRRUA — Sot nuk ecën më me të hedhura, pikë, mbaroi.

PETRUA — Mos u ngut. Është ngjalë ai... Di të rrëshqasë si bolla, më dëgjo mua.

DRITANI — Nuk do t'i ecë. Nuk shkojnë më ato.

OBJEKTIVISTI — Pse, ore, thoni kështu? E do punën ai, këtë e dinë të gjithë, nuk mund t'ja mohojë njeri. Si mjeshtër s'e ka shokun.

PIRRUA — Mjeshtër edhe për dredhira. Mirë thotë xha Petrua.

INDIFERENTI — Ama, për këto do të bisedojmë?!
Ika unë...

PIRRUA — Dale, prit! Ku shkon?

INDIFERENTI — Ku më do qejfi, pse?!

PIRRUA — Si flet kështu?

INDIFERENTI — Kështu di të flas unë. Shko dhe më var një fletërrufe, po deshe...

DRITANI — Pse, nuk e meriton?

INDIFERENTI — Dëgjo ti, lum vëllai: do fillojnë përsëri nga kritika dhe autokritika. Apo nuk i kanë qejf disa... Mira thotë kështu, Jashari thotë ashtu... E ç'më duhen mua punët e tyre?..

DRITANI — (*Prerë*) Nuk janë vetëm të tyre!

INDIFERENTI — E di ç'ke ti, lum vëllai? Shiko punën tënde. Të shkon tymi drejt ty, kjo është gjith-shka...

BENI — Ky është egoizëm!

INDIFERENTI — (*Dritanit*) Më dëgjo mua: larg, larg, sa më larg...

DRITANI — ... telasheve.

INDIFERENTI — (*Mendohet pak, nga që nuk e priste*) Pse jo, edhe telasheve...

DRITANI — Unë them ndryshe: u hap kjo çesh-tje, tani i duhet shkuar deri në fund. Mira hoqi petën e parë, tani duhen hapur edhe të tjerat.

OBJEKTIVISTI — E kush do t'i hapë të tjerat?

DRITANI — Mbledhja.

OBJEKTIVISTI — Rrini, more djema, mos flisni marrëzira. E kush është në mbledhje? Ne. Pse nuk e kemi bërë këtë deri tani?

FRIKAMANI — Sepse nuk është e lehtë. Të heq nga puna, këtë të bën. Sikur nuk e dimë! Sa e kanë pë-suuar prej tij, e di sa e kanë pësuuar?

BENI — Pse, ore, ç'u bë ai këtu, padron?

FRIKAMANI — Padron mbase jo, por këtë ta bën.

DRITANI — S'e bën dot.

FRIKAMANI — Të shohim si do të flasësh atje në mbledhje, këtu është ndryshe. Atje, atje... (*Duke shikuar djathtas*) Po vjen.

JASHARI — (*Duke hyrë*) Oho!. . Vazhdon diskutimi... dhe me zjarr...

KRISTAQI — Edhe në orarin e punës...

JASHARI — S'ka gjë, s'ka gjë... Ja vlen. U ça akulli, kjo është kryesorja. U ndez edhe tek ne kritika. Kjo është një shenjë e mirë.

KRISTAQI — Dakord, plotësisht dakord... Por jo edhe ashtu kot, kritikë për kritikë...

JASHARI — Nuk duhet të kemi frikë nga kritika, përkundrazi. Në fillim mund të ketë edhe teprime, kjo s'prish asgjë. More, sikur të jetë edhe e padrejtë, tendencioze, qoftë edhe thjesht shpifje, në fillim ajo duhet inkurajuar, me të gjithë e keni lexuar kritikën e shoqes Mira... Ajo mirë bëri, më kritikoi me fletërrufe... Unë mund të kem kundërshtime, mund edhe të mos jem dakord, por kjo, tani për tani,

ka pak rëndësi. Kryesorja është t'i hapet rruga kritikës... (*Papritur*) Më falni, se ç'harrova, më falni. (*Del*)

PETRUA — (*Pirros*) Hë, more, e pe?

PIRRUA — Ngjalë, mirë thua ti, xha Petro, ngjalë.

DRITANI — Ngjalë!.. Është pak, dhelpër...

JASHARI — (*E dëgjon dhe qëndron*) Si thatë?

DRITANI — Thashë... Do ta përsërit?

JASHARI — Nuk e dëgjova mirë kush foli. Me ty nuk dua ta zgjat...

DRITANI — Ja ku po ta them: njerëzit nuk janë budallenj, si i kujton ti.

JASHARI — Atë them edhe unë, prandaj edhe kam besim të plotë se ata...

DRITANI — Cilët ata?

JASHARI — Të gjithë!.. Kam parasysh kolektivin tonë të mrekullueshëm.

DRITANI — Të cilit ti ja ke frikën.

JASHARI — Unë kam besim në njerëzit... Kam pasur dhe kam...

DRITANI — E pra unë po të flas hapur; nuk besoj asnjë në ato që thua.

JASHARI — Megjithatë, unë besoj edhe tek ti.

LONI — (*Duke hyrë*) Shoku Jashar!

JASHARI — Ah, inxhinieri! Nga ishit sot gjithë ditën? Ju kërkova disa herë...

LONI — Mbarova edhe skicat e fundit, prandaj... Tani çdo gjë është gati.

JASHARI — Kalojmë në një anë. (*E tërheq pak*) Për këtë të kërkova: ta lemë një herë këtë punë, nuk kemi asnjë arësyte të ngutemi. Më vonë, më vonë...

LONI — Pse?

JASHARI — Kështu është më mirë...

LONI — Unë ju kam thënë dhe ja ku po e përsërit: projekti juaj është i mrekullueshëm. Më falni në flas hapur, por jam shumë entuziast... Nuk di si t'jua shpreh, prandaj...

JASHARI — Më vonë. Flasim më vonë...

LONI — Ju them të drejtën, jo që nuk duhet pri-

tur më, por nuk e kuptoj pse keni ngurruar deri tani.

JASHARI — S'na shtyn gjë të ngutemi. Pastaj, ndërmarrja jonë nuk ka nge të merret tani me çeshjtje të prodhimit. Si e shikon, merremi me fletërrufe-të...

LONI — (*Duke shikuar nga fletërrufetë*) Vërtet, pse i jepet kaq rëndësi një fletërrufeje?

JASHARI — Si të them: çështje mode. Pastaj, është një merimangë e madhe këtu në ndërmarrjen tonë, e cila s'rri asnë minutë pa punë. Njerëzit e pazotë në profesion po gjejnë mbështetjen e drejtore-shës, që është gjithashtu esëll në çështjet profesionale. Injoranca ndeshi në rrugë injorancën dhe tokën duart. Por ti mos u shqetëso, nuk do t'u ecë gjatë. Ja, sa të mbarojë kjo valë dhe fillojmë...

LONI — Ku ndodhi pikërisht tani!..

JASHARI — Tani kam edhe një lutje: ti je i pari që u njohe me projektin tim pér rikonstruksionin e ndërmarrjes, dëshëroj që hëpërhi, veç teje, të mos e dijë njeri tjetër. (*Loni bën të flasë*) Pse, thua ti? Ke të drejtë. Por ja që ka keqdashës, dhe ata, me gjendjen që është krijuar në ndërmarrjen tonë tani, do ta sulmojnë atë akoma pa e paraqitur mirë.

LONI — Projekti është yti dhe, si autor, ke të drejtën tënde... Mirë, unë s'mund të them asgjë.

JASHARI — Hajde, pra, toke këtu. (*I shtrën-gon dorën*) Dhe kokën lart. E shikon? Unë po goditem dhe as qepallat nuk më lëvizin. Në të tilla raste njeriu duhet të jetë i fortë. (*Del*)

DRITANI — (*Lonit*) Shoku inxhinier!

LONI — Urdhëroni.

DRITANI — Po ju pse nuk merrni pjesë në diskutimin e hapur me fletërrufetë?... Si gjithë të tjerët?...

LONI — Për mua shumë gjëra janë të panjohura këtu akoma, shumë gjëra nuk i di...

DRITANI — Me aq sa dini, inxhinier. Secili shpreh atë që di dhe që ndjen...

LONI — Sikur të shprehja atë që di dhe që ndjej

tani, do tē thosha: «talenti őshtë talent, ai do tē çajë pérpara, me siguri do tē çajë. E keqja őshtë se ndér-marrja do tē vonohet pak...» Por nejse... (Del)

VITA — Ky o őshtë naiv, o s'di ç'të them.

DRITANI — Pér mua őshtë i ndershëm...

BENI — Kush e di me çfarë profkash ja ka marrë mendtë Jashari, prandaj edhe flet kështu!... Mirë e ka xha Petrua, őshtë ngjalë ai.

DRITANI — Jo ngjalë, por dhelpër... Dhelpër i shkon më shumë.

OBJEKTIVISTI — Të dëgjova edhe më parë. Të them tē drejtën, nuk e kuptoj këtë, me tē vërtetë nuk e kuptoj: tjetri flet më zemër në dorë, dhe ju (*Petros dhe Benit*) thoni ngjalë! Ky (*tregon Dritanin*) shkon edhe më tutje: dhelpër.

PETRUA — Nuk e njeh, pa flet kështu.

OBJEKTIVISTI — Më thuaj, tē lutem: ka njeri pa tē mëta? S'ka. Atëhere? Mua më duket se diçka nuk shkon në gjithë këtë zhurmë që po bëhet. Po sikur tē jetë një intrigë? Duhet parë më mirë. Ç'kanë njerëzit me tē?

DRITANI — Mos folë kot.

OBJEKTIVISTI — Hë, more, se edhe ne qorra s'jemi. Kemi dëgjuar se e ka inat drejtoresha, prandaj ... Ku e di ti si e kanë punën?

DRITANI — Kjo nuk őshtë fletërrufeja e drejtoreshës, po e asaj që po vjen.

PETRO — Kanë marrë zjarr këto vajzat tonë. Nuk e ke vënë re ti?

PIRRUA — More, Mirës i lumtë. Por ne tē tjerët ku jemi.

OBJEKTIVISTI — Rrini, more djema, janë punë tē thella këto.

MIRA — (*Duke hyrë me disa tē tjerë*) Më thanë se janë vënë fletërrufe tē tjera, prandaj erdha t'i lexoj. (*Fillon tē lexojë fletërrufetë; pas pak i drejtohet Lumtos*) Si duket, ti ke vendosur tē heshtësh...

LUMTUA — Të hesht, pérse?

MIRA — Ashtu kot. Se ç'm'u kujtua këto ditë....

LUMTUA — Pse pikërisht këto ditë?

MIRA — Si të them... (*Duke iu afruar*) Vërtet ke vendosur të heshtësh?

LUMTUA — Folë ti, ç'ke me mua?

MIRA — Ato që di unë do t'i themi të gjitha. (*Lumtua del. Mira vazhdon të lexojë fletërrufetë*)

LEKA — (*Mirës*) Ç'ka ndonjë të re?

MIRA — Ka disa gjëra që të revoltojnë, shoku Leka. E lexove? (*Tregon një fletërrufe*) Edhe i thotë vetes komunist.

GJINI — (*Lekës*) E ka fjalën për Vebiun.

LEKA — (*Mirës*) Dole në shesh të luftës? Tani lufto!..

MIRA — Por ka njerëz që luftojnë skutave.

LEKA — Detyroji të dalin hapur.

MIRA — (*Pasi mendohet pakë*) Mirë thua...

NJË PUNËTOR — (*Duke hyrë*) Shokë, po fillojmë. Do të vini?

(*Ngrihet sipari. Është salla e një reparti çfarëdo në ndërmarrje. Brenda në repart, duken maqineri. Përballe një dritare e gjatë, nga poshtë deri lart. Nga e djathta lexojmë një pjesë të parullës së shkrojtur me gërma të mëdha: «Të djegim me zjarr e t'i këputim kokën cilitdo që merrr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave e të vajzave». Nga e majta lexojmë parullën po me gërma të mëdha: «Cilido, pa frikë dhe me shkronja të mëdha, të shkruajë çfarë mendon ai për punën dhe për njerëzit». Pak më poshtë, po nga e majta, lexojmë parullën tjetër: «T'i hapi m rrugë progresit teknik». Në parullën e dytë duket firma e shokut Enver. Djathtas ka një tavolinë, ku zenë vend Gjini, Mara dhe Pirrua. Përballe është nji si podium dhe aty pranë bien në sy Mira, Lumtua, Landa dhe Le-ka, si dhe grupi i të rinjve: Dritani, Vita dhe Beni. Majtas janë Kristaqi, Vebiu dhe të tjerë. Duket sikur masa e njerëzve vazhdon deri jashtë skenës, deri poshtë në sa-llë)*

GINI — Shokë, të shuhen cigaret. (*Pas pak*) Ju atje, afrohuni pak, pse keni shkuar në fund fare?

OBJEKTIVISTI — (*Jasharit, i cili hyn më atë çast*) Shoku Jashar, ejani këtu.

KRISTAQI — Këtu, këtu... (*I tregon një vend*).

JASHARI — E po dale, se nuk ndahem dot dhjetë copash. (*Shikon nga Mira*) Jo, do të ulem këtu pranë Mirës. (*I drejtohet Mirës*) Më pranon?

MIRA — Nuk është imja karriga.

JASHARI — (*Mirës*) Mira, pse më qëndron ftohet gjithë këto ditë? Mua më duket se nuk ke asnje arësy. Kritikove dhe bëre shumë mirë. Për ndër, nuk jam prekur hiç fare, as nuk të mbaj mëri. Përkundrazi... Ti e di, mua gjithmonë më ka pëlqyer sinqueriteti...

GJINI — Atëhere fillojmë. (*Bëhet qetësi*) Rendin e ditës e dinë të gjithë, do të diskutojmë mbi fletërrufenë e shoqes Mira, kritikën e saj për shokun Jashar...

JASHARI — Me leje!..

GJINI — Pak durim, ju lutem. Mos u bëni merrak, do tua japim fjalën të gjithëve, veç me radhë. Për këtë jemi mbledhur, të flasim dhe të dëgjojmë...

PIRRUA — Dhe të gjykojmë...

GJINI — (*Pas pak*) Unë thashë të dëgjojmë...

KRISTAQI — Mirë thotë. Nuk jemi në gjyq këtu.

GJINI — Kisha për të thënë vetëm dy fjalë: ne me qëllim e shtymë mbledhjen, nga fletërrufeja e shoqes Mira, deri më sot, që të shpreheshin njerëzit, të diskutohej më parë me anë të fletërrufeve; thamë të rrihen mendimet dhe të dalin çështjet, pastaj të mblidhemi. Organizata bazë e partisë nguli këmbë për këtë dhe më duket me të drejtë. Njerëzit filluan të flasin hapur dhe kjo është kryesorja. Unë kaq kisha. (*Ulet*) Shoku Jashar, më duket kërkuat fjalën? (*I tregon vendin si podium*)

JASHARI — (*Duke u ngritur*) Po flas prej këtej.

GJINI — Për të vendosur një farë rregulli, jo për tjetër, mendoj se është më mirë të flisni që këtu. (*Tregon vendin si podium*)

JASHARI — S'është keq t'i lëmë këto formalizma, shoku Gjini, sikur nuk shkojnë tanë.

GJINI — Shkojnë, s'shkojnë, i lëmë shakatë.

JASHARI — Keni të drejtë, bëra shaka. Mos ma merrni pér të keq. (*Del te vendi si podium*) S'kisha ndonjë gjë kushedi se çfarë... Desha vetëm të theksoj diçka: shoku Gjini tha se mbledhja e sotme është thirrur të diskutojë mbi kritikën që më bëri shoqja Mira, këtu e dhjetë ditë të shkuara. Kjo është e drejtë, pa fjalë e drejtë, por... (*Hesht pér të parë c'efekt bëjnë fjalët e tija*)

GJINI — Vazhdoni, vazhdoni... Po ju dëgjojmë.

JASHARI — E kisha fjalën këtu: diskutimi që u bë me fletërrufe, pér mua mjaft interesant, një formë e re kjo, nxori në shesh një tok problemesh, të cilat i kalojnë kufitë e një mosmarrëveshjeje, unë do të thosha më saktë, të një keqkuptimi, midis shoqes Mira dhe meje.

KRISTAQI — E drejtë, shumë e drejtë...

JASHARI — Prandaj, shoku Gjini, mos e ngush-tojmë kështu temën e asaj pér të cilën duhet të diskutojmë më të vërtetë sot. Nuk është e para herë që po e them: punët kanë filluar të mos shkojnë mirë në ndërmarrjen tonë dhe pér këtë dikush duhet të përgjigjet. Pse të druhemi t'i hapim rrugën kritikës dhe autokritikës?

LANDA — Kush, sipas teje, duhet të përgjigjet?

JASHARI — Ju drejtoni këtu, shoqja Landa, ju duhet ta dini më mirë se kushdo. (*Shkon në vendin e tij. Heshtje e gjatë, siç ndodh disa herë në mbledhjet*)

VEBIU — S'thotë keq: e filluam që e filluam këtë punë, t'i shkojmë deri në fund tanë...

KRISTAQI — Dhe ta zëmë nga koka, jo nga bishti.

GJINI — Shoqja Landa, mos ju prenë fjalën?

LANDA — Jo, bëra vetëm një pyetje.

INDIFERENTI — Shokë, më falni, por unë nuk marr vesh gjë në gjithë këtë sherr, që ka plasur tek ne kohët e fundit: pse të zihemi dhe të grindemi, ore, kot së koti, si kemi filluar?.. Ishim mirë më parë: planet

i realizonim, normat i tejkalonim dhe merrnim ndonjë lek më shumë, me njëri-tjetrin shkonim mirë, kishte një shoqëri dhe miqësi për bukuri në mes tonë... Unë them se shoqja Mira bëri gabim që e vuri atë fletërrufe me kokë të vet, pa pyetur njeri...

PETRUA — (*Papritur*) Bëri shumë mirë.

KRISTAQI — Bëri gabim, unë kështu mendoj.

DRITANI — Unë mendoj ndryshe.

MARA — Edhe mua kështu më duket: Mira u ngut.

JASHARI — E lëmë këtë çështje, shokë: bëri mire apo bëri keq, u ngut apo nuk u ngut. Kjo nuk është kryesorja tani, më duket. Të fillojmë atje ku na dhëmb më shumë: pse punët kanë nisur të mos shkojnë mirë në ndërmarjen tonë? (*Heshtje e gjatë. Mendohen*)

GJINI — Kush e do fjälën?

LEKA — Unë them t'i marrim gjérat me radhë, të fillojmë nga ajo që tha Gjini: nga kritika e shoqes Mira.

MIRA — Këtu u fol për keqkuptim, për mosmarrëveshje dhe për kush e di çfarë... Unë ngul këmbë në ato që kam thënë, për të cilat nuk kam marrë përgjegje. (*Del në vendin si podium*) Përbledhtas, në fletërrufenë që vura më 15 shkurt kam ngritur këto çështje për Jasharin dhe pres përgjegje:

E para, përsë hiqeni sikur ju, dhe vetëm ju, dini gjithshka këtu në ndërmarjen tonë, kurse të tjerët si pas jush, nuk dinë asgjë? Përsë e mbivlerësoni kaq shumë veten dhe përsë nuk i lini të tjerët t'ju çmojnë? Përsë i nënveftësoni të tjerët?

E dyta, si përgjegjës reparti, pse jeni munduar vite me radhë dhe vazhdoni të mbillni përçarje midis punëtorëve, duke nxitur thashethemet, deri edhe grindjet?

E treta, ju përshpëritni poshtë e lart se në ndërmarjen tonë ka njerëz që e hanë bukën kot, bile edhe që pengojnë. Për çarësyte nuk i thoni hapur emrat e tyre, por na i thoni ne punëtorëve me rast dhe pa rast.

Dhe si konkluzion: a nuk janë të gjitha këto qëndrime mikroborgjeze e borgjeze, të dënueshme nga shqëria jonë? Përse merreni me këto çështje, të cilat, në vend që t'i zhdukni në kushtet e sotme revolucionare dhe të bëni kthesë, po i thelloni më keq, duke e futur veten në një rrugë pa krye? (*Heshtje*)

Për të gjitha këto unë kam kërkuar sqarime përparrë kolektivit të ndërmarrjes dhe, si e thashë, nuk kam marr përgjegje akoma. (*Ulet në vendin e saj*)

JASHARI — (*Papritur*) Unë bëra një propozim. Nuk e di pse s'merret parasysh nga presidiumi ajo që thashë unë.

GJINI — (*Jasharit*) Më duket e sqarova një herë, do t'i përbahemi rendit të ditës. Ju, po të keni gjëra të tjera, i ngrini... (*Duke hapur një dosje, merr një letër dhe ja zgjat Jasharit*) Është përgjegjja juaj. Doni ta lexoni, apo e mbani mend, si Mira?

ZËRA — E dimë, e kemi lexuar.

— Të lexohet, të lexohet!

— Pse të humbim kohë?

— Lexoje, lexoje!

JASHARI — Nuk e di përsë ngulni këmbë, shoku Gjini... Nuk e di. (*Merr letrën që i dha Gjini dhe del te vendi si podium. Duket nervoz. Fillon të lexojë*)

«Përgjegje shoqes Mira Gjoka.

Më 6 shkurt, shoku Enver, ndërmjet të tjerash, tha: «Cilido pa frikë dhe me shkronja të mëdha të shkruajë çfarë mendon ai për punën dhe për njerëzit». (*Shikon po këtë parullë të shkrojtur në mur*) Ja, tek është shkrojtur edhe këtu. (*Vazhdon të lexojë letrën*) «Këto fjalë u dhanë guxim njerëzve dhe kudo, në të gjithë vendin, valuan fletërrufetë, që u bënë një mjet i madh edukativ revolucionar. Të gjithëve, sigurisht këtë ma kishin thënë edhe disa vizitorë të jashtëm, u vinte keq që në ndërmarrjen tonë kaluan 10 ditë dhe nuk po du keshin akoma fletërrufetë. Tabela «Zëri i masës» u rregullua një herë, dy herë, dhe më mirë për të treti, por

asnjë dobi. E pra, si kudo, gabime kishte dhe tek ne. Të them të drejtën, u gëzova një mëngjez kur pashë një vërejtje që bëhej për disa shokë, në mes të të cilëve edhe pér mua, pér mungesat në gjimnastikën e mëngjetit. Filloi, thashë me vete, dhe do ta kisha humbur shpjet gjëzimin, në qoftë se do të mbetesh puna me kaq. Por ti, nxënësja ime, nuk e le që ky gjëzim të shuhej tek unë, sigurisht edhe te të tjerët. More guximin, sepse kështu të mësoi partia dhe vare fletërrufënë...»

MIRA — (*Duke ndërhyrë*) Kaluat një frazë.

JASHARI — Ashtu?! (*Duke i zgjatur letrën Gjinit*) Ta vazhdojë ndonjë tjetër. (*Mirës*) E paske mësuar pér mendsh! (*Ulet në vendin e tij*)

MIRA — Unë e kam marrë shumë seriozisht këtë çështje, prandaj... (*Gjini ja jep letrën Piros që ta lexojë*)

PIRRUA — Ku mbetëm? Hë: «More guximin, sepse kështu të mësoi partia...»

MIRA — ... kështu të mësova edhe unë».

PIRRUA — Pikërisht ashtu: «... kështu të mëscva edhe unë dhe vare fletërrufënë e parë kritike. Gjithmonë kam thënë se reparti im, ku bën pjesë edhe ti, është revolucionar. Ja, pikërisht ky repart përqafoi i pari, si gjithnjë, fjalën e partisë.

Ju kërkonî disa sqarime dhe mendoni të rrëmbeni flamin. Më vjen keq, nxënësja ime, por kolektivi është i sqaruar, ai më njeh prej kohësh. Sidoqoftë, ju përgëzoj pér inisiativën dhe guximin.

Jashar Driza

Tiranë, 17 shkurt 1967.»

(*Dëgjohen pëshpëritje, ka reagim*)

DRITANI — (*Papritur*) Pse, përgjegje është kjo?!. Jo, Mira, por edhe ne të tjerët nuk kuptojmë asgjë nga kjo përgjigje... Përgjigje i thënçin...

KRISTAQI — Rri, mor djalë, mos i fryj zjarrit...
Ç'do ti që ngatërrrohesh kot së koti?

DRITANI — Jo kot, por plot. Po ti ç'je këtu, zjarrfikës?!

MIRA — (*Duke dalë në vendin si podium*) Si e pätë, shokë, jemi përpara një loje fjälësh. Në «përgjigjen» e dhënë nuk jepet asnë sqarim për çështjet kryesore. Përse? A nuk tregon edhe kjo një mospërfillje? Me disa fraza mundohet ta heqë veten si revolucionar, por s'bën tjetër veçse zbulon të kundërtën, pikërisht atë se nuk është aspak në pozita revolucionare...

JASHARI — (*Me shaka*) E në çfarë pozitash jam, atëhere, kundërrrevolucionare? (*Disa qeshin*) Nejse, shket goja nganjëherë...

MIRA — (*Prerë*) Unë them se, jo vetëm keni frikë të prekni thelbin e çështjes dhe silleni me mospërfillje, por kërkoni të bëni edhe presion ndaj meje. Ç'kuptim kanë fjalët: «por ti, nxënësja ime» si dhe «kështu të mësoi partia, kështu të mësova edhe unë»? Ç'doni të thoni me këtë, mos vallë pse kam qenë nxënësja juaj duhet të jem edhe nën urdhërat tuaja, të qëndroj me frikë e servilizëm ndaj jush? Aq më keq e vini partinë në një plan me veten tuaj, në një kohë kur duket fare qartë se mësimet e partisë dhe ato që thoni ju janë dy gjëra krejt të kundërtta, ndryshojnë si dita me natën. Sa për repartin tonë, atë them edhe unë: punëtorët dhe punëtoret tona janë revolucionare, megjithëse ju nuk keni lejuar që ato të shprehen lirisht, për arësyte se jujeni një shtypës arrogant i kritikës, intrigant dhe hak-marrës.

JASHARI — Edhe kjo kish mbetur...

MIRA — Është e hidhur, nuk më vjen mirë që ka ndodhur kështu, por më duhet ta pranoj hapur: edhe për mua nuk ka qenë aspak e lehtë të ngrihem dhe t'ju kritikoj. Sikur të mos kisha lexuar dhe rilexuar disa héré fjalimin e 6 shkurtit të shokut Enver, nuk do ta kisha bërë këtë hap, me siguri nuk do ta kisha bërë....

VEBIU — (*Papritur*) Kam një pyetje: a i dinte Mira më parë këto gjëra, pér të cilat flet tani?

MIRA — Po, i dija, në mos të gjitha, një pjesë.

PETRUA — Unë kam një pyetje tjetër: pse ka heshtur?! Pse nuk i ka ngritur më parë?! Kjo, më duket, është kryesorja. Unë flas pér këtu tek ne, në ndërmarrjen tonë.

LEKA — Këtu është gjithë puna, xha Petro: pse? Këtë pyetje e bëjmë të gjithë: pse?

KRISTAQI — Ehu!.. Ku rreh xha Petrua... Vret larg ai...

LEKA — Ashtu është, vret larg, xha Petro, dhe me të drejtë. Edhe këtë duhet ta gjejmë ne: pse?

OBJEKTIVISTI — Na futët në të thella tani. Pse-ve nuk u gjendet fundi.

GJINI — (*Petros*) E drejtë, xha Petro, e drejtë. Do të përpinqemi t'i japim përgjegje edhe kësaj pyetjes sate. Me doemos... (*Mirës*) Vazhdo ti, vazhdo...

MIRA — (*Duke u drejtuar nga Jashari*) Prandaj ju bëj thirrje të përgjigjeni hapur dhe me zemër në dorë. Zhvishuni nga ato të këqia që ju mundojnë dhe ju kanë futur në një rrugë pa krye. Përndryshe do të humbisni çdo gjë. (*Shkon në vendin e saj. Heshtje*)

KRISTAQI — Këto nuk janë as fletërrufe... as kritika shoqërore. Akuza dhe shpifje, ja çfarë janë, pér mua.

BENI — Kritika është kritikë. O bëje si është pér të bërë, o hiq dorë...

FRIKAMANI — Mirë thotë...

GJINI — Kishe gjë pér të thënë ti?

FRIKAMANI — (*Ngrihet*) Jo... Unë kam gjashtë kalamaj në shtëpi, prandaj s'kam gjë... (*Bën të ulet*)

PIRRUA — Ç'do të thotë kjo: kam gjashtë kalamaj në shtëpi, prandaj s'flas?... Unë s'e kuptoj.

FRIKAMANI — Ata duan bukë... Tani e kupton? (*Ulet*)

PIRRUA — Jo.

OBJEKTIVISTI — (E kthen në shaka) Pirrua ësh-të beqar akoma, nuk i di këto punë...

GJINI — (Rreptë) Nuk ka asgjë për të qeshur këtu! Përkunderazi, duhet të shqetësohem... Ai (tregon frikamanin) ka frikë. Nuk e shikon?

LONI — Më falni, kisha për të thënë dy fjalë edhe unë.

GJINI — Flisni, inxhinier, flisni. (Të gjithë dë-gjojnë me vëmendje)

LONI — Desha të pyes: mos ka ndonjë ngatërrresë apo keqkuptim në këtë çështje?

GJINI — Çfarë ngatërrrese?

LONI — U thanë gjithë këto gjëra për shokun Jashar... Dhe po thuhen akoma... Po a është i tillë ai?... Nuk po flas këtu për qëndrimin shoqëror dhe dashamirës që mban me të gjithë. Edhe me mua ka mbajtur këtë qëndrim, që në ditën e parë kur vura këmbë në ndërmarrje... Po mua më entuziazmojnë kryesisht mendimet, planet dhe aspiratat e tij për të ardhmen e ndërmarrjes. Fatkeqësisht nuk jam i autorizuar të flas për një punë të tij, por jam i sigurt se, po të njiheshit edhe ju me këtë punë të tij, do të bindeshit, ashtu si jam bindur unë, për një punë të talentuar, të menduar dhe të hartuar nga një njeri me talent, i cili edhe atje në shtëpi, duke punuar edhe natën, në një kohë kur ndoshta ne të tjerët flemë, punon, për të ardhmen e ndërmarrjes. Atëherë, shokë, a nuk do të ishte më mirë ta lemë të qetë në këtë punë të madhe krijuese, jo vetëm kaq, por edhe ta ndihmojmë, që të dalë faberdadhë? T'i lemë thashethemet dhe të shikojmë punën. Kriteri kryesor për vlerësimin e njeriut është puna. Le ta shohim, pra, Jasharin në punë dhe këtu të bëjmë vlerësimin e tij.

LEKA — Jo vetëm në punë.

KRISTAQI — Të lumtë, inxhinier! Vërtet i ri këtu tek ne, po na mësove dhe ne të tjerëve si duhet të flamsim.

VEBIU — Flet pa pasione, prandaj...

OBJEKTIVISTI — Për mua ky është një qëndrim objektiv. Të lumtë, mor vëlla, kështu duhet.

GJINI — Keni tjetër, shoku inxhinier?

LONI — Jo.

PIRRUA — Më fal, inxhinier, por nuk mund të rri pa ju thënë se na i bëtë të gjithë njerëzit ëngjëj këtu në ndërmarrjen tonë. Por nuk është kështu...

LEKA — Kam një pyetje për shokun Loni.

LONI — Po?

LEKA — Ju folët për një punë të Jasharit. A ka mundësi të na thoni çfarë lloj pune është kjo?

LONI — Nuk jam i autorizuar të flas, por mund t'ju them vetëm kaq: është një punë me vlerë të madhe për të ardhmen e ndërmarrjes.

LANDA — Unë nuk ju pengoj, flisni!..

LONI — Jo, shoqja Landa, nuk ka lidhje me ju, është një punë e Jasharit...

JASHARI — (*Ndërhyn shpejt*) Më falni. Në qoftë se shoku Loni mbaroi, desha të them dy fjalë edhe unë.

LONI — Unë mbarova.

JASHARI — Unë e falnderoj shokun Loni për fjalët e mira që tha në adresë time. Jo vetëm unë, por të gjithë këtu në ndërmarrjen tonë mendojmë e punojmë natë e ditë për të ardhmen e saj... Megjithatë, unë nuk kam në mend aspak të zvogëloj kritikat që më janë bërrë atje jashtë në fletërrufetë që m'u bënë edhe këtu. (*Pasi vëren pak përshtypjen që bëjnë në të tjerët fjalët e tij*) Të dal më mirë këtu. (*Del në vendin si podium. Duket i vrarë dhe tërheq vëmendjen e të gjithëve. Heshtje*) Shokë, unë i kam lexuar me vëmendje fletërrufetë që janë vënë atje përjashta nga disa shokë, pas përgjegjes sime shoqes Mira, dëgjova me vëmendje edhe ato që foli ajo pak përpara. Të them të drejtën, për mua nuk ka qenë aspak e lehtë t'i kupto gjérat që më ngrihen... Prandaj dua ta nis me autokritikë: në fillim më erdhi rëndë dhe u preka, sedër e sëmurë mikroborgjeze, tani e kupto fare mirë, por më vonë reflektova thellë, sigurisht edhe me ndihmën e shokëve. Ndoshta përtë parën herë nisa të analizojet veten me një sy kritik. Tani,

jo vetäm e kuptoj se është një gabim, por e dënoj veten dhe e quaj një faj të rëndë atë përgjegje që dhashë, pa kokë dhe pa bisht, si më tha një shok këto ditë. Ju kërkoj ndjesë shokëve dhe shoqeve, në radhë të parë shoqes Mira, të cilën e falnderoj pér ndihmën që më dha. Nga analiza kritike që i bëra vetes, më del se është e vërtetë që jam gjaknxehtë, mbasë edhe pak arrogant, si thotë shoqja Mira. Është e vërtetë se më pëlqen puna ime, ndofta pse edhe të tjerët, që nga dikasteri, më kanë mburrur dhe e kanë lavdëruar punën time shumë herë, mbasë me vend dhe pa vend. Është e vërtetë, gjithashtu, se influencohem nga thashethemet, mbasë nga që i dua njerëzit dhe më vjen keq pér ta, prandaj edhe u qaj hallin...

MARA — (*Papritur*) Kjo është e vërtetë. E kam provuar unë vetë...

GJINI — Mirë, moj Marë, po prit të mbarojë një herë...

JASHARI — Ja, mbarova. Edhe një herë ju falem nderit të gjithëve. Çdo ditë unë po e shoh veten si në pasqyrë dhe do të luftoj kundër çdo të keqeje deri në fund. Ju siguroj pér këtë, veç më lini pak kohë. Kërkoj ndihmën tuaj, që me siguri nuk do të më mungojë. (*Shkon në vendin e tij*)

VEBIU — (*Fort*) Autokritikë tamam bolshevike.

DRITANI — Gënjeshtër, krejt gënjeshtër...

KRISTAQI — (*Atyre që ka pranë*) Ka të drejtë Vebiu. Unë nuk e kuptoj c'kërkohet tjetër.

PETRUA — Ngreu e thuaje, që ta dëgjojnë të gjithë.

KRISTAQI — (*Duke u ngritur*) Këtë desha të them, shokë: Vebiu tha autokritikë bolshevike. Unë nuk di ta them është bolshevike apo jo, por që është një autokritikë e thellë, kjo duket. Në fund të fundit, kush ka bërë një autokritikë si kjo deri tanë në ndërmarrjen tonë? Për veten time them se ky është një hap i madh pér kolektivin tonë, një shembull i mirë. Nuk e di tanë c'kërkohet tjetër...

MARA — Këtë them edhe unë. Kemi nja dhjetë

ditë që po e mundojmë burrin e botës. E pse? Kot së koti...
JASHARI — Jo, Marë, mos u ngut. Kështu nuk ndihmohem... Shokët duhet të jenë të bindur dhe kanë të drejtë. Shoku Gjini e mori pak si me rrëmbim atë që thashë në fillim, nuk më la të shpjegohem. Nejse, një keqkuptim, gjëra që ndodhin...

OBJEKTIVISTI — (*Duke u bërë me dorë të tjerë-ve që të heshtin*) Me leje, me leje!.. Një minutë!..

GJINI — Ke pyetje?

OBJEKTIVISTI — Po... (*Jasharit*) Ti je dakord me gjithë ato që tha Mira, që ka ngritur edhe në fletë-rrufënë e saj?.. Me gjithë ato akuza?..

JASHARI — Me kritikat...

OBJEKTIVISTI — Ore, akuzat, akuzat thashë.

JASHARI — Për hir të zhvillimit të kritikës.

OBJEKTIVISTI — Ti qofsh, paske stomak të fortë. (*Disa qeshin*)

KRISTAQI — (*Papritur*) I lëmë shakatë tani, mjaft de, mjaft... Nuk e di çfarë thonë edhe shokët, por përmua tani s'mbetet tjetër veçse...

GJINI — Ti thuaj mendimin tënd, ç'ke me të tjerët?

KRISTAQI — (*Duke u përmbajtur*) Atë po them, mendimin tim, ku e kisha fjalën... (*Kujtohet*) Po, përsa i përket Jasharit, s'mbetet tjetër tani veçse t'i lëmë kohë të realizojë autokritikën që bëri. Kurse, përsa i përket gështjeve të tjera...

PIRRUA — (*Papritur*) Ky është mendimi yt... Unë nuk jam dakord. Nuk jam akoma i qartë. Pikë, mbaroi.

FRIKAMANI — Mirë thotë.

BENI — Na plase edhe ti me këtë «mirë thotë».. Thuaj ç'ke për të thënë vetë, pse ke frikë?

FRIKAMANI — Unë nuk flas.

LEKA — Përse nuk flet?.. Ti ke krahët e tua dhe kokën tënde... Këtu nuk bën as punën e Jasharit, as të Landës, as të ndokujt tjetër, prandaj folë...

FRIKAMANI — Ah, shoku Leka, sa mirë flet ti... Më pëlqen kur të dëgjoj, por nuk është aqë e thjeshtë... Kam parë unë, pa flas kështu...

LEKA — Folë atëhere, ç'ke parë?

FRIKAMANI — (*Mbyll gojën me dorë, pas pak flet*) Jo, s'kam gjë për të thënë. S'kam gjë...

GJINI — Kush e do fjalën? (*Heshtje e gjatë. Mendohen*)

VEBIU — E ç'të themi akoma, shoku Gjini? Më duket se u thanë të gjitha. Jashari bëri autokritikë...

PIRRUA — (*Me të hedhur*) Bolshevikë...

VEBIU — (*Pas pak*) Po, bolshevikë... Do ta përsërit edhe një herë: bolshevikë.

DRITANI — Gënjeshtër, fund e krye gënjeshtër.

VEBIU — S'e di ç'autokritikë do të bëje ti po të ishe në vend të Jasharit. (*Pirros*) Edhe ti. E, pra, në repartin mekanik, atje ku punon ti, nuk ka më pak të metta, në mos më shumë.

LANDA — Sot nuk jemi mbledhur për repartin mekanik, as për repartin e Jasharit, po për Jasharin. Më duket janë dy gjëra.

KRISTAQI — (*Shpejt*) E pse të mos flasim, shoqja Landa? Bile edhe për repartet e tjera. Pse, pak ju duken disa gjëra që janë thënë këto ditë në fletërrufetë? Mirë e tha dikush këtu...

BENI — Jashari e tha.

KRISTAQI — (*Nervozi*) E po s'të lënë të flasësh... Sa hap gojën, të hidhen në grykë... Atëhere të mos flasim, më mirë të mos flasim...

GJINI — Shoku Kristaq, mos i ngatërroni gjérat, ju lutem mos i ngatërroni.

KRISTAQI — Unë nuk po ngatërroj asgjë, më duket, të tjerët po më ngatërrojnë...

OBJEKTIVISTI — Me ç'po shoh unë, or vëlla, këtu qenkan krijuar dy grupe.

VEBIU — (*Nervozi*) Ulu, more ti, po na nxjerr edhe konkluzione...

MIRA — Me leje! (*Ngrihet dhe shkon te vendi si podium*) E shoh se po bëhen shumë përpjekje për t'u larguar nga thelbi i çështjes, për ta devijuar mbledhjen tonë të sotme... Atëhere më lejoni ta bëj pyetjen copë:

pse ti, Jashar Driza, ke folur poshtë e lart për shoqen Landa dhe çfarë ke thënë? (*Shkon në vendin e saj*)

PETRUA — Kështu de, hapur, mushka i do drutë të gjata. Kështu thonë...

DRITANI — E drejtë, shumë e drejtë... (*Heshtje*)

GJINI — Shoku Jashar, do të përgjigjeni?

JASHARI — (*Duke u përmbarjtur*) Nuk e di të kem folur ndonjë gjë... Në punë ne kemi patur dhe kemi disa kontradikta, por kjo nuk do të thotë se unë kam ndonjë gjë për shoqen Landa... Unë, të paktën, nuk kam...

LANDA — Shoku Jashar, pse i bini rrrotull e rrrotull? I bini drejt, kështu do të jetë më mirë edhe për ju.

JASHARI — (*Me zor përbahet*) Po, shoqja Landa, do t'i bie drejt e drejt. Pse jo?... T'i themi gjérat ashtu si janë, jam dakord, t'i themi. (*Shkon te vendi si podium*) E shoh se jeni shumë e interesuar të mos preken çështjet e punës në ndërmarrje, ku duhet të dalë edhe përgjegjësia juaj, por mendoj se pikërisht këtej duhet nisur: nga punët e ndërmarrjes. (*Të tjerëve*) Po, shokë, unë me shoqen Landa, siç janë në dijeni edhe mjaft shokë, kemi disa kontradikta, të thella bile, që kur ajo erdhi këtu si drejtoreshë; kontradikta për çështje të punës, të cilat kanë ardhur duke u shtuar, kuptohet, jo për fajin tim. E drejtë, pse t'i biem rrrotull e rrrotull, kjo është, pra, e vërteta dhe ashtu si na mëson partia, (*Landës*) ju mëson juve, por më mëson edhe mua, kontradiktat duhet t'i zbulojmë, t'i njobhim, sepse vetëm kështu do të mund t'i kapërcejjmë. (*Lonit*) Shoku inxhiner, thoni, ju lutem, nuk ka nisur të çalojë puna prej disa kohësh?

LANDA — Dhe fajet bien mbi mua. Këtë doni të thoni?

JASHARI — Bëtë mirë që e thatë vetë. Që ta dinë shokët si qëndron puna, do të përmend vetëm disa gjëra për të vërtetuar atë që thashë më lart: shoqja drejtoreshë nuk do të më shohë me sy, përsë? Atë nuk e di, le ta thotë vetë. Unë i them gjérat troç. Ndoshta kjo është e

keqje, dhe mua më ka sjellë jo pak të këqia, por kështu jam, nuk do të ndryshoj pse kështu do shoqja Landa. Ünë, shokë, i ofrova gjithë ndihmën time, që ditën e parë, por ajo nuk e deshi. Pse? Le ta thotë vetë. Më thirri disa herë e seç më thoshte për repartin tim, por t'ju them të drejtën, asgjë s'merrja vesh. Pse? Por ja, siç e dini, nga ana teknike ajo... Më falni, nuk është se nuk do, por nuk mund t'i dijë të gjitha gjërat megjithëse pretendon se i di... Më ka prerë pothuaj të gjitha kontaktet me repartet e tjera dhe me jashtë. Pse edhe kjo? Nuk e di, le ta thotë vetë. Mund të thotë ndokush: ajo drejton këtu, do të dijë dhe duhet të dijë për çdo gjë që ka lidhje me ndërmarrjen. Mbase unë nuk e kuptoj mirë këtë çështje, por po them atë që ndjej, që kam në zemër dhe në kokë. Erdhi rasti dhe po i them këtu, hapur, të gjitha këto. Nuk i kam bërë fjalë deri më sot dhe ky mbase është gabimi im...

LUMTUA — (*Shpërthen*) S'është e vërtetë! (*Heshtje*)

GJINI — Çfarë s'është e vërtetë?

LUMTUA — Ajo që tha se nuk i ka bërë fjalë deri më sot.

DRITANI — Folë, Lumto, folë, mos ki frikë!

LUMTUA — Ta thotë vetë, pa frikë s'kam unë...

JASHARI — (*I zënë keq*) Po, më kujtohet, se si ra fjalë një ditë, nuk e di kush ishte tjetër veç Lumtos...

MARA — Kam qenë edhe unë, por nuk tha ndonjë gjë kaq sa e bën Lumtua.

LUMTUA — (*Rreptë*) Le ta thotë vetë! Ka gojën e tij ai. Dhe për të folur është bilbil:

PIRRUA — Ja gjeti: bilbil. E bukur fort.

DRITANI — (*Pasi u konsultua pak me Vitën dhe Benin*) Edhe ne kemi dëgjuar, jo një, por disa herë.

VITA — «Vunë në krye një grua, ke thënë, tani e mori lumi ndërmarrjen tonë». Ishin ditët e para, porsa kishte ardhur shoqja Landa. E mban mend?

JASHARI — Veç me ju nuk kam biseduar ndonjëherë, për asgjë, aq më pak për një çështje të tillë.

LEKA — (*Jasharit*) Po me inxhinier Ilirin ke patur kontradikta?

JASHARI — Ti, shoku Leka, duhet ta dish fort mire punën e tij. Vërtet s'ka shumë që u zgjodhe sekretar, po ti këtu ke qenë, nuk e kuptoj pse pyet!

LEKA — Do ta përsërit edhe një herë: me inxhinier Ilirin ç'ke patur?

JASHARI — Mirë. E hapim edhe një herë këtë histori: inxhinier Iliri ishte vagabond dhe imoral, këtë e dinë të gjithë. Ai bëri skandal këtu në ndërmarrje dhe për këtë u hoq.

VEBIU — Ashtu është: ai bëri skandal dhe u hqën të dy, edhe ai edhe Filja. Për vagabondët dhe imoralët nuk ka e nuk mund të ketë vend tek ne.

JASHARI — (*Papritur*) Kisha një pyetje për shokun Leka: bëri apo nuk bëri skandal inxhinier Iliri?..

MIRA — Jo! (*Heshtje*)

JASHARI — Unë ju pyes juve, shoku Leka: ishte apo nuk ishte vagabond dhe imoral inxhinier Iliri?

MIRA — Jo! (*Pëshpëritje*)

JASHARI — (*Bërtet*) Duhej apo nuk duhej hequr pas asaj që bëri?

MIRA — Jo! (*Heshtje*)

JASHARI — (*Mirës*) Nuk po flas me ty.

LEKA — (*Jasharit*) Mbarove?

JASHARI — Po.

LEKA — Atëhere përgjegju: ç'ke patur me inxhinier Ilirin?

MIRA — Ta them unë. (*Del në vendin si podium*)

JASHARI — (*Bërtet*) Kjo vajzë është kurdisur keq, nuk di çfarë flet!..

MIRA — Shokë, ju të gjithë e mbani mend sherrin që u hap, një vit e ca më parë, në lidhje me Filen dhe inxhinier Ilirin...

MARA — E di unë atë histori, moj Mira. Jashari nuk hyn fare në atë çështje.

VITA — (*Marës*) E di ti, po e dimë edhe ne. Më lerë ta tregoj unë, ashtu si e di (*Del te vendi si podium, ku është edhe Mira*) Një ditë ai (*tregon Jasharin*)

më thirri në zyrën e tij. Aty gjeta edhe Filen. «Të thirra, më tha, se kjo vajzë e shkretë filloi të më thotë disa gjëra për një të keqe që i ka ndodhur. Ti je e komitetit të rinisë, prandaj të thirra, ta dëgjojmë bashkë». Filja, sipas atyre që tha ai, (*tregon Jasharin*) akuzonte inxhinier Ilirin për qëllime të këqia, se ishte përpjekur ta mashtronnte, se... Më falni, por nuk mund t'i përsërith fjalë për fjalë të gjitha sa tha ai...

PIRRUA — Po Filja, ç'bënte ajo?

VITA — Ajo heshtte.

PIRRUA — Ishte dakord?

VITA — Deri sa heshtte...

PETRUA — Pastaj?

VITA — «Të shkosh t'i thuash atje ku duhet, më tha ai, (*tregon Jasharin*) do të vete t'i them edhe unë...»

GJINI — Dhe ti erdhe dhe na the për të gjitha, kështu? Të tjerat i dimë, nuk ka nevojë të përsëriten.

MIRA — Por Vita nuk tha një gjë dhe s'kish si ta thoshte: që gjithë kjo qe një intrigë e kurdisur nga shefi i repartit tim dhe të saj, Jashar Driza, nuk tha se ky ishte një kurth për të diskredituar inxhinier Ilirin dhe për ta hequr qafe, ashtu si dhe e hoqi.

KRISTAQI — E kam thënë edhe një herë tjetër, më duket këtu, në një mbledhje si kjo: «bluan shumë në kokë kjo çupë». Kam frikë se, në gjithë këto gjëra që thotë, ka shumë trillime...

MIRA — Nuk kam mbaruar akoma. (*Kristaqit*) Dhe ti ç'ke që hidhesh ashtu?!. (Të tjerëve) Vërtet në gjithë këtë histori ka shumë trillime, por jo nga unë. Filja ishte nga fshatrat e Burrelit. Të gjithë i dimë zakonet e ashpra të atyre anëve. Jashar Driza i dinte gjithashtu. Ai i dërgoi një letër babait të Files, të cilën e kishte qëndisur në atë mënyrë sa i futi xixat plakut dhe ai, si i marrë, erdhë drejt e këtu. Për pak inxhinier Iliri e pagoi shtrenjtë. Kurse Filen e mori në fshat. Ju e dini, nuk patëm as kohë, as mundësi për të verifikuar asgjë nga akuzat gjoja të Files. Me ndërhyrjen e Ministrisë, unë do të thosha me intrigat e Jashar Drizës, që vajti dhe

informoi si deshi vetë, inxhinier Iliri u largua nga ndërmarrja, edhe nga Tirana. Çdo gjë u zhvillua sipas planit të parapërgatitur: inxhinier Iliri mori rrugët, por edhe Filja u largua nga ndërmarrja, kështu edhe qëllimi u arrit, edhe gjurmët u zhdukën. E pse gjithë kjo? Për shefin e repartit tim, Jashar Drizën, dhe dëshirën e tij që një ditë të bëhej drejtë, kishte dalë një pengesë: inxhinier Iliri. Veç kësaj, ai e ndjente se një rrezik akoma më i madh po i vinte: inxhinieri se ç'punneronte një projekt për rikonstruksionin e ndërmarrjes, si dhe kish filluar ta kritikonte e të ankohej për punën e tij...

JASHARI — S'është e vërtetë. Unë e thashë si qëndron puna. Ju të gjithë e dini atë që ndodhi dhe si ndodhi. Por nga ato që u thanë, tani së fundi del edhe më qartë një gjë: këtu po merren në mbrojtje ato që nuk duhen marrë. Pse?.. Dikush ka interes. Më falni, por kjo është një çështje parimore, prandaj nuk do të lëshoj asnjë grimë. Do ngul këmbë, qoftë edhe i vetëm... Për mua ky është kulmi: hapur merren në mbrojtje imoralët.

LUMTUA — (Papritur) Kjo është e paturpshme.

GJINI — Çfarë është e paturpshme?

LUMTUA — Ky njeri ndryshe flet, ndryshe mendon...

MIRA — Folë. Lumto, thuaja edhe ti, thuaja!

LUMTUA — (Bërtet) Mira, hesht ti! Mos më nga-tërrë! E more vesh? Lëre të flasë. Tha se do të bënte autokritikë, prandaj...

JASHARI — S'kam tjetër. (Ulet. Heshqje e gjatë)

GJINI — Ti, shoqja Lumto, kishe tjetër?

LUMTUA — (Prerë) Jo.

GJINI — Po ti, shoqja Mira?

LUMTUA — (Reptë) Jo.

GJINI — Tani pyeta shoqen Mira?..

LUMTUA — (Reptë) Dhe unë thashë jo! (Gjini dhe të tjerët habiten)

GJINI — Ti je Lumtua, unë pyeta Mirën.

MIRA — (*Duke u ngritur*) Jo, nuk kam. (*Ulët*)

LANDA — (*Papritur*) Vajza, mbasse është më mirë të flisni. Unë kështu them... Pse ngulni këmbë, edhe njëra edhe tjetra? Ju vetë erdhët një ditë tek unë...

MIRA — Shoqja Landa, ju lutem...

LUMTUA — (*Prerë*) Erdhëm, e pastaj?...

LANDA — Atë po them: erdhët të dyja dhe mirë bëtë...

LUMTUA — Më mirë të mos kisha ardhur.

LANDA — (*Preket*) Më fal, në qoftë se ti mendon kështu, kot që fola...

MIRA — Unë ju thashë, shoqja Landa... Lereni Lumton, mos e ngacmoni...

LUMTUA — Jo, jo... Flitni tani, flitni!... Shokët u bënë kureshtarë, ndryshe kushedi çfarë do të mendojnë... Në fund të fundit aqë më bën, nuk ju kam thënë asgjë...

LANDA — (*Të tjerve*) Kjo është e vërtetë: as unë nuk e mora vesh pse erdhën. Ishin ditët e para të janarit, më duket... Isha në zyrë...

LUMTUA — Mira më solli, unë nuk desha të vija.

MIRA — Po, unë e sella.

LANDA — U deshën disa minuta sa të fillonin. «Flitni, moj vajza, Ç'keni, pse keni ardhur?»

LUMTUA — (*Rreptë*) Thashë, më mirë të mos kisha ardhur.

LANDA — Lumto, ti nuk arësyeton drejt... Ne po diskutojmë për shumë gjëra sot... Mendoj se duhet thënë edhe kjo... Po deshe ti e lë dhe nuk vazhdoj...

ZËRA — Vazhdoni, vazhdoni...

LUMTUA — Derisa e hapët, vazhdoni tani, vazhdoni...

MIRA — Po ja, do ta them unë: Lumtua deshi të largohej nga reparti ku punonte, dhe të shkonte në një repart tjetër...

PIRRUA — Të largohej nga reparti ku drejton Jashari, thuaje kështu.

LANDA — Dhe unë e pyeta: «përse, moj vajzë, ç'të ka ndodhur?»

LUMTUA — Dhe unë ju thashë: «dua të largo-hem», kështu?

LANDA — Kështu... Po nuk më the pse.

LUMTUA — Ju thashë: «kot».

LANDA — (*Të tjerëve*) Ja, kështu, shokë: ndenjëm afro një orë dhe deri në fund këto dy fjalë përsëriti: «kot», «asgjë».

KRISTAQI — Mbase nuk i pëlqente; kjo ndodh shpesh...

LUMTUA — (*Prerë*) Ti pusho!

KRISTAQI — Nuk e kuptoj!.. Ç'është kjo mënyrë të foluri?

LUMTUA — Ti ç'do? Le të flasë ai, (*tregon Jasharin*) po deshi...

JASHARI — Jo, unë s'kam gjë pér të thënë...

LANDA — Atëhere iu drejtova Mirës: «edhe ti do të largohesh?»

MIRA — Dhe unë ju thashë: «jo, unë kërkoij të mos largohem nga reparti».

LANDA — Po, kështu the... (*Të tjerëve*) Unë atëhere iu drejtova të dyjave: «Vajza, flisni hapur me mua, si e keni hallin? Me mua mund të flisni hapur...»

JASHARI — (*Papritur*) Shoku Gjin! Nuk ju duket se po denegjeron kjo mbledhja jonë sot? Nuk e shikoni me se po merremi?...

GJINI — Jo, nuk më duket. (*Landës*) Vazhdoni, shoqja Landa.

LANDA — Ishte e qartë, këto ishin diçka pér të thënë, së bashku ose veç e veç, por nuk po e thoshin.

VEBIU — E qartë...

LUMTUA — Desha të largohesha nga reparti, këtë jua thashë. Tjetër ç'doni?

MIRA — Kurse unë nuk desha të largohesha nga reparti. Pse nuk desha? Nuk doja të shkonte në vend fjala e tij, e shefit të repartit, që deshi të më degdiste andej... E kish thënë vetë... Pse? Unë nuk e di...

JASHARI — Kjo nuk éshtë e vërtetë, unë nuk desha ta largoj nga reparti me doemos. Ajo nuk punonte mirë dhe mendova se ishte edhe në të mirën e saj të ndërronte vend.

LEKA — (*Jasharit*) Po Lumtua pse deshi të largohet?

JASHARI — (*I zënë keq*) Atë s'e di unë...

LEKA — Po çfarë di atëhere?

JASHARI — (*Nervoz*) Thashë një herë, nuk e di...

VEBIU — (*Papritur*) Propozoj të bëjmë dhjetë minuta pushim!

ZËRA — S'hotë keq, bëjmë pushim.

— Të lumtë goja, se vdiqëm për një cigare.

— E drejtë, shumë e drejtë.

KRISTAQI — (*Ngrihet*) Me leje? Unë propozova ta mbyllim për fare, pse nuk merret parasysh kjo?...

GJINI — (*Prerë*) Dakord, bëjmë pushim. Por vetëm dhjetë minuta. (*Fiken dritat. Në paraskenë dalin Lumtua dhe Mira*)

MIRA — Lumto, pse nuk flet?

LUMTUA — Nuk dua. Pres.

MIRA — Çfarë pret?

LUMTUA — Që të flasin të tjerët.

MIRA — Të tjerët po flasin...

LUMTUA — Akoma nuk kanë folur.

MIRA — Kush?

LUMTUA — E di unë.

MIRA — Po folë ti, atëhere.

LUMTUA — Jo, do pres.

MIRA — Nuk të marr vesh...

LUMTUA — Do të më marrësh vesh.

MIRA — U zemërove me mua?

LUMTUA — Jo. Ti s'më ke faj. Askush s'më ka faj. (*Pas pak*) Ikë tani, më lërë vetëm!

MIRA — Këto dit, se si më dukesh...

LUMTUA — (*Prerë*) Ik, po të them! (*Mira e shikon pak dhe del. Lumtua bën të dalë, por qëndron dhe flet me vete*) Po ajo Landa ç'pat që e hapi atë çështje,

ç'i duhet asaj?.. (*Mendohet pak, bën tē dalë. Afrohet Jashari*)

JASHARI — Të lutem qëndro!

LUMTUA — (Qëndron) Ç'do?

JASHARI — Të provokojnë hapur, nuk e sheh?

LUMTUA — Ke frikë?

JASHARI — Nuk është çështje frike...

LUMTUA — (Reptë) Gënjen! (*Bën tē dalë*)

JASHARI — Mendo pér veten tënde!..

LUMTUA — (Qëndron pak) Po më kërcenon?!

JASHARI — Jo, përkundrazi...

LUMTUA — Kujtova...

JASHARI — Desha vetëm tē kujtoj se njerëzit kanë folur dikur pér marrëdhënjet tonë...

LUMTUA — E di që kanë folur.

JASHARI — Ti u ndave atëhere nga unë. Pse-në nuk e di akoma. Shkaqet pse nuk deshe tē fejoheshe me mua akoma i kam tē errëta.

LUMTUA — Ti e di mirë pse-në. Janë mendimet e tua tē kalbura, që i ndanë rrugët tonë. Për mua tanë kjo është një çështje e mbyllur. Por tek ti nuk ka ndryshuar asgjë.

JASHARI — E çfarë tē ndryshojë?!. Ha-ha-ha!.. Gjithmonë nga pozitat parimore ti...

LUMTUA — Hapju kolektivit, dil para tyre me zemër në dorë... Sa nuk është vonë... Ndryshe do tē jetë më keq...

JASHARI — Ti ke lojtur mendsh?!

LUMTUA — Bën si tē duash. (*Bën tē dalë*)

JASHARI — Qëndro! (*Ajo qëndron*) Mund tē kërkoj një gjë: mos bëj ndonjë budallallëk, ti e shikon, ata duan tē më përpjijnë...

LUMTUA — Bën si tē thashë: dil hapur para kolektivit! (*Del*)

LONI — (*Duke hyrë*) Shoku Jashar! Që t'ju them tē drejtë, nuk ju kuptova pak më parë...

JASHARI — Për autokritikën time e ke fjalën? S'ka gjë, s'ka gjë... Duhet. Nuk janë tē gjithë njerëzit

si ti në këtë botë. Po të ishte kështu, jeta mbi këtë planet do të ishte më e lehtë.

LONI — Nuk ju kuptoj.

JASHARI — Do të më kuptosh, do të më kuptosh... Hë, desha të të them për diçka.

LONI — Po ju dëgjoj.

JASHARI — Do të të provokojnë në lidhje me projektin... Të lutem asnje fjalë, me asnje njeri...

LONI — Pse druheni kaq shumë? Është një punë e mirë dhe mbaroi.

JASHARI — Eh, mor shpirt i vëllait, nuk i njeh njerëzit ti. Pra do të më premtosh se në çdo situatë dhe për asnje arësyen nuk do të nxjerrësh asnje fjalë për projektin...

LONI — Meqë e kërkon!..

JASHARI — Të jem i qetë?

LONI — Sigurisht.

JASHARI — Edhe diçka: do të ketë ndoshta edhe provokime, edhe shpifje monstruoze, por mos u beso... nuk dua në asnje mënyrë të humbas zemrën tënde të pastër...

LONI — Më ofandoni.

JASHARI — Për mua ishte me rëndësi vendimtare mbështetja dhe ndihma që më dhe për projektin tim... Oh, ç'them edhe unë: ku ka më timin dhe tëndin aty? Ja ç'desha të them: projekti për rikonstruksionin e ndërmarrjes, që në këtë minutë, ka dy autorë: unë dhe ti.

LONI — Ju lutem...

JASHARI — Asnjë fjalë, shoku Loni, nuk lejoj asnjë fjalë. Përndryshe do të më ofandoni. Dhe çdo gjë që do të vijë si frut i këtij projekti, do të jetë e të dyve: gëzimi, lavdia edhe shpërblimi material.

LONI — Shoku Jashar!.. (*Hynë Leka dhe Mira. Jashari bën të dalë*) Shoku Jashar, unë nuk e pranoj... (*Jashari del, pas tij edhe Loni*)

MIRA — Thashë nuk di asgjë... Nuk dua të bëj as supozime.

DRITANI — (*Duke hyrë bashkë me të tjerë*) Mira ka të drejtë, për mua ka të drejtë.

OBJEKTIVISTI — Unë nuk shoh qartë akoma.

VEBIU — Kurse mua më duket se disa gjëra fryhen dhe disa të tjera lihen pas dore, jo pa qëllim.

DRITANI — Atëhere mund të na thuash edhe çfarë fryhet dhe çfarë lihet pas dore.

VEBIU — Shumë.

DRITANI — Kam qejf të dëgjoj një, vetëm një...

MARA — Po ja: ajo çështja e Files nuk është ash tu.

MIRA — (*Prerë*) Është.

MARA — Nuk është. Unë e di mirë. Po do të flas edhe unë, do të flas.

PIRRUA — (*Duke hyrë*) Shokë, vajtën dhjetë minutë. Do fillojmë. (*Të gjithë hyjnë në skenë, ku janë edhe të tjerët dhe zënë vendet e tyre*)

GJINI — Vazhdojmë, shokë. Kush e do fjalën?

MARA — (*Ngrihet papritur*) Unë. (*Heshtje*) Dhe desha të them se të gjitha sa tha Mira, në lidhje me Filen, nuk janë ashtu. Filja gaboi dhe inxhinier Iliri ka faj, kjo është e vërteta. Ju e dini të gjithë, unë Filen e kam timen. Atë e pata sjellë këtu unë... (*Zhurmë, ka reagim. Mara shkon te vendi si podium*) Nuk e di si të them, por në qoftë se gjithë ato që ka ngritur Mira në fletërrufenë e saj dhe që foli këtu janë si kjo që tha për Filen, atëhere kam të drejtë të dyshoj për të gjitha. Më falni, unë do të flas hapur, do të flas se nuk mund të rri pa folur. Dëgjuam shumë gjëra... E çfarë nuk u tha sonte këtu? Prandaj do të them edhe unë mendimin tim. A nuk ju duket, shokë, se shumë gjynahe iu hodhën në shpinë dhe shumë baltë u hodh mbi shokun Jashar? Mua më duket se po. E, pra, për mua ai është edhe i zoti edhe njeri i mirë, i sjellshëm dhe i dashur me ne të gjithë, e do punën dhe nuk kursehet për as gjë. Mua më ka ndihmuar jo një herë, por shumë herë. I kam qarë hallin e normës, sepse ishte e lartë, dhe e rregulloi menjëherë, jo vetëm mua, por të gjithave, tani marrim më shumë... (*Ka përshpëritje dhe bëhet*

zhurmë) Pa hapur gojën unë, gjithnjë më thotë «mirë mëngjez». Cilitdo fjalën e mirë, këtë e thonë të gjithë. Nuk e di si mund të jetë njeriu i mirë ndryshe. E them hapur, unë i jam mirënjohnëse deri në fund. Por kryesorja është ajo që thashë në fillim: punën e Files unë e di mirë dhe nuk është ashtu si tha Mira...

LUMTUA — (*Papritur*) Mara, nuk të ka hije!..

MARA — Çfarë?

LUMTUA — Të mos thuash të vërtetën.

VITA — Ka të drejtë Lumtua: Mara nuk na tha këtu të vërtetën për çështjen e Files.

OBJEKTIVISTI — Tani u bë lëmsh fare, asgjë s'po marrim vesh.

PIRRUA — Nuk tha të vërtetën. Pikë, mbaroi.

VEBIU — Kam një pyetje për shoqen Mira: mos ka ndonjë arësy personale midis shoqes Mira e shokut Jashar dhe kjo e shtyn të bëjë të gjitha ato që bëri, të thotë edhe të gjitha ato që tha?..

LEKA — Flisni më qartë, ç'është kjo diçka personale? C'doni të thoni me këtë?

VEBIU — E thashë këtë, shoku Leka, sepse pak përpara doli se kish vajtur te shoqja Landa dhe i kish-te kërkuar të mos largohej nga reparti ku drejton shoku Jashar, prandaj...

LUMTUA — (*Ngrihet papritur*) Jo, nuk ka. (*Hesh-tje*)

GJINI — Çfarë nuk ka?

LUMTUA — Nuk ka asgjë aty ku e hedh fjalën Vebiu.

VEBIU — Nga e di ti?

LUMTUA — (*Tregon Jasharin*) Pyeten, ja tek e keni. (*Ulet*)

JASHARI — (*Prerë*) Shoku Vebi, nuk hyjnë këtu çështjet personale, nuk hyjnë... Njerëzit atë punë kanë: të flasin... (*Papritur*) Por, më falni, ne po zgjatemi këtu me gjëra që... (*Hutohet*) Ku e kisha fjalën? (*Papritur*) Hë, desha të them për nënë Sanijen, e shikoj që me shumë zor qëndron... Ta lëmë të shkojë, është e lodhur, ka qenë edhe e sëmurë, prandaj...

ZERA — Le tē shkojë.

— Shko, nënë Sanije, shko!

— Dakord, tē shkojë.

GJINI — Po tē duash, mund tē shkosh, nënë Sani-
je...

SANIJA — Jo, po rri nëna, nuk jam lodhur, falem-
nderit, falemnderit...

GJINI — Si tē duash... Ku mbetëm?

VEBIU — E kisha fjalën unë... (*Del në vendin si
podium*) Po tē drejtohem përsëri ty, shoqja Mira: atë-
here ç'duhen tē gjitha këto akuza kundër shokut Ja-
shar? (*Të tjerëve*) A nuk është koha, shokë, që shoqja
Mira tē na thotë pse i ngre këto gjëra?

GJINI — Ti si mendon, përse?

VEBIU — Unë kërkoj tē përgjigjet shoqja Mira.
Këtu mund tē fshihen shumë gjëra...

GJINI — Çfarë gjërash?... Flisni hapur, jo me tē
hedhura.

VEBIU — Hapur po flas, më duket. Pas asaj që
tha, tani së fundi, shoqja Mara, duke sqaruar atë çësh-
tjen e Files, ajo sqaroi shumë gjëra... Kaq kisha. Tjetër
s'kam. (*Ulet në vendin e tij*)

PIRRAU — E qartë. I vuri kapakun. Pikë, mbaroi.

VEBIU — (*I drejtohet Pirros, i papërbajtur*) Nuk
e marr vesh ç'je ti këtu, që bën ç'bën dhe i vë pikat at-
je ku do vetë. Kush tē ka vënë tē nxjerrësh konkluzio-
net si tē duash?

LEKA — Po ti që kur ke vendosur tē bëhesh avokat
i tē tierëve?

KRISTAQI — Për mua Vebiu foli drejt, shumë drejt
... Atë them edhe unë: pse i ngre tē gjitha këto shoqja
Mira? Kam edhe një pyetje tjetër: a lejohet që tē shpi-
fet dhe tē thuhen gjëra tē paqëna?

DRITANI — Varet çfarë quajmë tē qëna dhe tē pa-
qëna!..

KRISTAQI — (*Bëhet nervoz*) Të lutem mos ma pre
fjalën! Interesant, deri tani veç këtë punë ke bërë. Në
qoftë se ke për tē folur, dil atje dhe folë; në qoftë se nuk
të pëlqen ajo që them, mos dëgjo. Këtu jemi tē gjithë

njëlloj. Të kam dëgjuar shpeshherë kur thua «masa, masa...» Mësohu atëhere të dëgjosh zërin e masës...

JASHARI — (*Duke shkuar në vendin si podium*) Jo, shokë, nuk është as e bukur, as e drejtë t'i kthehem i tani shoqes Mira pse bëri kritikë. Vërtet i dramatizoi dhe i fryu gjërat, por kjo nuk është kryesorja. Unë nuk jam hakmarrës, mengjithëse më akuzuan edhe për këtë, prandaj nuk do ta lejoj një gjë të tillë. Është e re, mbas kjo është arësyja që edhe nxitohet. Në asnje mënyrë nuk i duhet prerë hovi rinisë. Unë kështu them. (*Ulet në vendin e tij. Heshtje e gjatë, mendohen*)

INDIFERENTI — (*Papritur*) Propozoj të mbyllen diskutimet.

ZËRA — Dakord.

— Të vihet në votë.

— Si, ore, të mbyllen, e ç'morëm vesh? Unë përvete s'kam marrë vesh asgjë akoma.

— Në votë.

GJINI — Një minutë, shokë...

KRISTAQI — Nuk e kuptoj, shoku Gjin, me të vërtetë nuk e kuptoj pse kërkon me kaq këmbëngulje të flasin njerëzit, kur nuk kanë çfarë të thonë.

LEKA — Po ti ç'ke që bërtet kaq shumë? Pse? Ç'të ka gjetur?

KRISTAQI — Sepse nuk më duket e drejtë kjo që po bëhet, shoku Leka. Pastaj, më falni, por më duket se bëhet presion dhe kërkohet të influencojet në njerëzit. Si sekretar i organizatës-bazë të partisë edhe ju nuk vepronи drejt. Kjo nuk ju lejohet.

LEKA — (*Prerë*) Po ti, Jashari dhe Vebiu, mund të futim këtu edhe Marën, përsë u përpinqët deri tani? Unë nuk di si ndodhi kjo, që gjetët një gjuhë: rastësisht, apo jo rastësisht, por për këtë s'latë gur pa lëvizur.

JASHARI — Më falni, por kjo është njëlloj sikur të them edhe unë: cila qe ajo dorë që e kurdisi kaq me mjeshtëri këtë vajzë (*tregon Mirën*) të ngrejë gjithë atoakuza që ngriti?

LEKA — Folët pérakuza! Atëhere i hapni kartat, kjo do të jetë më mirë, pér ju, në radhë tē parë.

PIRRUA — E drejtë: tē hapen kartat.

JASHARI — Unë s'kam karta pér tē hapur. Por nuk bëj keq t'ju kujtoj se do të mbani gjithë përgjegjësinë pér këtë që po ndodh, jo si sekretar i partisë, por si Leka. Unë i ndaj këto dy gjëra.

LEKA — Ato nuk ndahen dhe pikërisht pse e ndjej tē gjithë përgjegjësinë, them se duhet t'i shkojmë deri në fund kësaj çështjeje...

KRISTAQI — Përse nuk hidhet në votë propozimi im? Të hidhet në votë.

MIRA — Nuk është e drejtë tē mbyllen diskutimet. Unë e di se ka edhe tē tjerë që kanë pér tē folur, që dinë shumë gjëra edhe me gjithatë heshtin.

PETRUA — Mundet që edhe dinë, moj Mira, por me tē dëgjuar. E keq tē vështirë tē flasësh me tē dëgjuar, unë i pari...

MIRA — Por ka njerëz këtu që kanë edhe fakte.

OBJEKTIVISTI — Cilët janë ata?

KRISTAQI — Thuaj emrat!

VEBIU — Mjaft më në përgjithësi, tē flitet konkretisht.

KRISTAQI — Ky është presion...

DRITANI — Ajo nuk flet kot. Mos u ngut!

VEBIU — Po pse nuk hapet atëhere?

MIRA — Ka njerëz që thonë: pse ta gjejë nga unë.

LUMTUA — Mira!

MIRA — Që kanë frikë, ose turp...

LUMTUA — Mira, pusho!

MIRA — Mirëpo ky njeri (*tregon Jasharin*) vazhdon punën e tij, intrigat e tij, poshtërsitë e tij.

KRISTAQI — Fakte, fakte, jo në përgjithësi.

MIRA — Ka dhe fakte. (*Nxjerr një letér. Shtangen tē gjithë*) Kam këtu një letér që kam marrë këto ditë nga Filja. (*Reagim nga tē gjithë*)

JASHARI — (Bërtet) Të vërtetohet në është me tē vërtetë e File!

GJINI — Nuk kemi pse vëmë në dyshim gjëra tē

tilla dhe shoku Jashar nuk bën mirë që dyshon për çdo gjë.

JASHARI — Sepse kam plot arësyte të dyshoj. Ku e gjeti Filen ajo ? Përralla...

MIRA — Do ta them edhe këtë: e pyeta një ditë Marën dhe ajo më tregoi se Filja qe martuar, më tregoi edhe fshatin se ku. Kështu i shkrojta për ta uruar lidhur me martesën e saj. Kemi punuar bashkë kaqe kohë, dhe ajo më dërgoi këtë përgjigje: (*Lexon letrën*)

«E dashur Mira!

Të falem nderit që më kujtove. Unë i kujtoj shumë herë shoqet e mia të ndërmarrjes, por nuk kam patur guxim tu shkruaj. E ndjej veten fajtore ndaj jush të gjithëve, megjithëse jam pa faj, prandaj nuk ju kam shkrojtur. Edhe një herë të falemnderit. Por dije, lum shoqja ime, se unë, pa mbushur akoma njëzet vjetët, jam martuar me një burrë të ve mbi 50 vjeç». (Në të gjithë ka reagim)

GJINI — Qetesi, shokë, qetesi! (*Mirës*) Vazhdo ti, shoqja Mira, vazhdo!..

MIRA — (*Vazhdon të lexojë*) «Për mua u hapën fjalë, prandaj nuk mund të kisha fat tjetër vec këtij. Pastaj, këtej nga anët tona martesat, si kjo imja, janë diçka e zakonshme. Pse nuk kundërshtova? Unë isha bërë një herë me turp, megjithëse pa të drejtë, atje në ndërmarrje; herën e dytë këta të shtëpisë do të më vrisnin. Janë të tmerrshme zakonet tona. Ti as mund t'i marrësh me mend. Kur e kujtoj sa mirë isha atje tek ju, sa mirë do të isha sikur ai njeri i lig të mos kish bërë atë që bëri... Dhe ky njeri i lig nuk është inxhinieri, siç u hapën fjalët, por shefi i repartit tonë, Jashar Driza. Ai më thirri në zyrë, gjoja për të më këshilluar, më kërcënoi se do të më largonte nga ndërmarrja, më tha se kish vënë re se inxhinieri më binte në qafë, se ai ishte vagabond, se po të hapeshin fjalët për këtë, do të ishte një turp për mua. U frikësova...»

FRIKAMANI — Përsërите, përsërите edhe një herë.

MIRA — «U frikësova, i thashë disa herë se nuk ishte e vërtetë ajo që tha ai pér inxhinierin, por ai ngulte këmbë, më kërcënoi dhe unë, e turpëruar, kur erdhi Vita, isha krejt e hutuar... Ai fliste dhe unë hesh-tja: veshët më qenë vulosur, goja më që kyçur, nuk mora vesh asgjë nga gjithë sa po ndodhë... Oh, kur e kuj-toj!... Por ai i poshtër lajmëroi edhe babanë tim. Pastaj ndodhën të gjitha ato që ndodhën... Të tjerat i di, s'kam pse t'i përsërit». (*Reagim nga të gjithë. Bëhet zhurmë*)

OBJEKTIVISTI — Dale, dale... Se qenka interesante...

GJINI — Qetësi, shokë, të dëgjojmë deri në fund. (*Mirës*) Vazhdo ti, shoqja Mirë.

MIRA — (*Vazhdon të lexojë*) «Tani, më thuaj ti: ç'është ky njeri? Ç'i kisha bëre unë? Pse më bëri me turp? Pse më nxiu jetën në këtë mënyrë?...»

PIRRUA — Sepse, sepse... (*Përbahet*)

MIRA — (*Vazhdon të lexojë*) «Kërkoi nga ti dy gjëra: E para, t'i thuash të gjitha këto në një mbledhje të punëtorëve të ndërmarrjes, të lexosh edhe letrën ti-me, po të duash, dhe t'i hiqet maska Jashar Drizës, që ta dinë të gjithë cili është. Të lutem bëje këtë. Unë e di, ti je e guximshme dhe do ta bësh. E dyta kam marrë vesh se pér shkakun tim e ka pësuar edhe inxhini-eri. Ai nuk ka asnjë faj, ai ra viktimi e një intrige. Prandaj u thuaj shokëve që ta shfajjësojnë atë. Bëje këtë pér mua. Të puth më mall.

Shoqja jote

Filja»

(*Nga të gjithë ka reagim*)

JASHARI — (*Bërtet*) S'është e vërtetë, e gjithë kjo s'është e vërtetë. Është e trilluar, edhe letra, edhe gjithë sa shkruhen atje.

LANDA — (*Papritur*) Është krejt e vërtetë: inxhini-er Iliri është krejt pa faj.

JASHARI — (*Hutohet pak*) Si pa faj?!.. Nga e dini këtë, ju shoqja Landa? E thoni me kaq siguri!..

LANDA — S'ka pak ditë që ai kërkoi të takohet me mua, dhe e takova. Më foli për të gjitha: edhe për Filen, edhe për projektin e tij. Dhe unë i besoj atij.

JASHARI — Pse nuk thua se është një plan i tërë: Kjo (*tregon Mirën*) ka kurdisë atë letër, gjoja nga Filja. Ju bisedoni me Ilirin. Sa është e vërtetë edhe kjo dreqi e di... E shikoni, shokë, si thuren intrigat? Një intrigë e tërë...

MIRA — (*Duke i treguar letrën Marës*) Është shkrimi i Files ky?

MARA — (*Pasi e shikon me vëmendje*) Po. (*Zhurmë*)

KRISTAQI — Shikoje, shikoje, mirë!

MARA — E njoh mirë, është shkrimi i saj.

PETRUA — Po ku ishe, moj Mira, këtë të na kishe thënë që në fillim, të nxirrije këtë letër dhe mjaft.

MIRA — Jo, xha Petro, ju me të drejtë bëtë pyetjen: pse është heshtur deri tani, pse?

PETRUA — Edhe ju, shoqja Landa, pse nuk na thatë më parë?...

JASHARI — (*Papritur*) Një minutë! Një minutë! (*Mirës*) Ma jepni pak letrën. (*Mira i jep letrën*) Edhe zarfin. (*Mira i jep zarfin*) Gënjeshtë! Letra mban vu-lën e Burrelit, kurse Filja është martuar në një fshat që i takon Rrëshenit. Ky është falsifikim, shokë, falsifi-kim.... (*Ja jep letrën Gjinit*)

LEKA — Po ti nga e di se është martuar në Rrë-shen?

JASHARI — Mara, ajo më ka treguar. Ja tek ësh-të, pyeteni.

LEKA — (*Marës*) Kështu është?

MARA — Është e vërtetë që më ka pyetur dhe i kam treguar se ku është martuar Filja. Është e vërtetë që fshati ku është martuar Filja i takon Rrëshenit, por është e vërtetë që edhe kjo letër është e Files, e njoh mirë shkrimin e saj.

PETRUA — Mara, folë, mos ki frikë!.. Folë!..

LUMTUA — (*Papritur*) Kërkoj që mbledhja të shtyhet për nesër.

KRISTAQI — (*Shpërthen*) Edhe kjo na duhet! Kemi më se dhjetë ditë me këtë histori. Sa do ta zgjatim akoma?

LUMTUA — (*Prerë*) Edhe dhjetë ditë të tjera, po qe nevoja. Ato poshtërsitë tuaja kanë zgjatur me vite të tëra.

KRISTAQI — (*Rreptë*) Poshtërsitë tonë!?. (*Duke u drejtuar nga Gjini*) Është në vete kjo?.. E di çfarë flet?

LUMTUA — (*Gjinit*) Kërkova që mbledhja të shtyhet për nesër.

GJINI — Po pse të shtyhet dhe pse për nesër?

LUMTUA — (*Prerë*) Kam për të folur edhe unë.

JASHARI — (*I trondit, por duke e mbajtur vreten*) Ti fole disa herë, s'ta preu njeri fjalën.

LUMTUA — S'ma preu, por nuk desha të flas. Tani dua...

JASHARI — Unë shikoj që këto vajzat sonte janë xhindosur, nuk e di ç'ka ndodhur me to.

MIRA — (*Duke treguar citatin që është në mur*) Lexo atje dhe do ta marrësh vesh. Si thotë: (*Lexon*) «përmbrojtjen e të drejtave të grave e të vajzave» (*Jasharit*) E lexon? Edhe të vajzave...

KRISTAQI — (*Bën ta kthejë në shaka*) Aty flitet për zakonet atje në fshat, ama q'e paske kuptuar ti, shoqja Mira! Ha-ha-ha!.. (*Mbetet vetëm dhe pushon*)

MIRA — Edhe unë, edhe të gjithë ne e kemi kuptuar ashtu si është thënë dhe si është në të vërtetë. Ti do dhe e shtrembëron.

KRISTAQI — Unë nuk po marr vesh asgjë!

DRITANI — E, pra, është e qartë. Unë do të thosha shumë e qartë.

GJINI — (*Pasi konsultohet me Pirron dhe Marën*) Dakord, vajti edhe vonë. Mbledhja për sonte mbyllët. Vazhdojmë nesër në të njëjtën orë, në pesë pasdreke. (*Të gjithë ngrihen dhe fillojnë të dalin*)

LONI — (*Në paraskenë*) Shoqja Landa!

LANDA — Urdhëroni.

LONI — Më falni... Këtu u fol për një projekt të in-
xhinier Ilirit. Ku ndodhet ai tani?

LANDA — Projekti?

LONI — Po.

LANDA — Duhet të jetë në ministri.

LONI — Mund të njihem më të?

LANDA — Përse?

LONI — Një kureshtje profesionale.

LANDA — Shkonë nesër në mëngjez atje në degën
përkatëse dhe kërkojeni!

LONI — Mund ta kërkoj zyrtarisht, i autorizuar nga
ju?

LANDA — Pse jo?

LONI — Po të më nxjerrin pengesa?

LANDA — Më merrni në telefon.

LONI — Po mundet që nesër të vonohem pak? Be-
soj nuk keni ndonjë punë me mua.

LANDA — (*Mendohet*) Jo, nesër nuk kam ndonjë
punë të veçantë me ju. Prandaj, s'ka gjë, mund të vo-
noheni.

LONI — Falemnderit.

LANDA — Më bëtë kureshtare: pse ju duhet me
kaq ngut ky projekt?

LONI — Dua të sqaroj diçka.

LANDA — Vetëm kaq?

LONI — Hëpërhë, vetëm kaq. (*Dalin*)

JASHARI — (*Duke hyrë pas Lumtos*) Unë të them:
mendohu mirë. Deri tani me ty jam sjellë korrekt. Ke
parë ndonjë të keqe nga unë?

LUMTUA — Jo.

JASHARI — E, pra, po të bësh ndonjë budallallëk,
ja ku po ta them: do ta pësosh keq.

LUMTUA — Nuk më tremb.

JASHARI — Ti më njeh dhe e di mirë sa fatkeqë
bëhen ata që urrej unë.

LUMTUA — Unë për ty kërkova të shtyhet mble-
dhja. Të kisha folur që sonte, do të ishte shumë keq
për ty. Mendohu. Po të le 24 orë të mendohesh. Në qof-

të se aq të bën pér të tjerët, të paktën mendo pér veten
tënde.

JASHARI — E, pra, mbahu atëhere Jashar Driza!
(*Lumtua del. Hyn Leka*) Shoku Leka, unë nesër nuk
vij në mbledhje.

LEKA — (*Prerë*) Nesër ti do të vish.

JASHARI — Me doemos?

LEKA — Me doemos.

(Bie perdja)

PJESA E DYTE

Në paraskenë janë vënë fletërrufe të tjera edhe nga ana e djathtë, e cila është mbushur deri lart, ashtu si ana e majtë. Në fillim hyn Vebiu, i cili ndalet e lexon një prej tyre. Pas pak hyn edhe Leka, i cili afrohet dhe lexon fletërrufetë e tjera.

VEBIU — Ti ma vure këtë fletërrufe?

LEKA — Ka emrin tim poshtë?

VEBIU — Jo.

LEKA — Pse mendon që të gjitha fletërrufetë i vë unë?

VEBIU — Nuk desha të them këtë.

LEKA — Megjithatë do të kisha bërë mirë të vija një fletërrufe për ty.

VEBIU — Por do të kishe bërë më mirë të më thërrisje për të biseduar më parë, si sekretar partie që je dhe si komunist që jam.

LEKA — Ti the gjithë ato mbrëmë, pse s'bisedove më parë me muat?

VEBIU — Nuk e dija se për çdo mendim, që mund të shpreh në mbledhjet tona, duhet të marr me doemos aprovin e sekretarit. Që kur është vënë ky rregull këtu tek ne?

LEKA — (*Duke u përbajtur*) Ti e di fort mirë se nuk ka një rregull të tillë, por...

VEBIU — Por komunistit nuk i thuhet avokat, si bëre ti mbrëmë.

LEKA — Po kur ai me të vërtetë luan rolin e avokatit?

VEBIU — Po ti ç'rol luaje, atë të prokurorit?

LEKA — (Papritur) Nuk e di si e ke punën, po ç'të lidh ty me ata?

VEBIU — Me ata?... Cilët ata?

LEKA — Të flasim drejt, nuk je dakord me vendimin e organizatës bazë që të shkosh në prodhim, prandaj hedh shqelme.

VEBIU — Jo, nuk është puna aty, unë në prodhim kam qenë edhe më parë.

LEKA — Nuk thua të vërtetën. E pe me cilët u bashkove mbrëmë?

VEBIU — Unë thashë mendimin tim, nuk u bashkova me njeri! Kurse ju po shkoni pas një çupke si Mira.

LEKA — Si është e mundur të mos e marrësh vesh këtë që po të them? Ajo çupkë, Mira, ka marrë vesh më shumë se ti dhe se shumë të tjerë për atë që duhet bërë.

VEBIU — Ti më qëllove rëndë dje, jo një, por disa herë, ç'ke me mua? Ç'të kam bërë...

LEKA — Përkundrazi, duheshe kritikuar më fort, që të vije në vete.

VEBIU — Nuk m'u përgjegje: ç'ke me mua? Ç'të kam bërë?

LEKA — Asgjë. Por ka disa kohë që nuk më dukesh në rregull.

VEBIU — Ja që paske diçka pra. Thuaje, pse nuk e thua?

LEKA — (I afrohet miqësisht) Ty se ç'të mundon!

VEBIU — Asgjë!

LEKA — Nuk më duket të jetë kështu.

VEBIU — Shumë beson në ato që thua, kjo të bën të mos besosh në fjalën e të tjerëve dhe të mos i dëgjosh ata.

LEKA — Kurse ti shumë i trembesh kritikës. (Duke

u afruar te fletërrufeja që po lexonte Vebiu) Përse të kritikojnë shokët? Ç'kërkojnë nga ti?

VEBIU — Ja që e ditke...

LEKA — E marr me mend.

VEBIU — Lexoje atëhere, unë e lexova. (*Largohet pak dhe del. Leka lexon fletërrufënë e vënë për Vebiun dhe, duke kujtar se është aty, flet*)

LEKA — Po të më dëgjosh mua, bën autokritikë. (*Shikon nga ai dhe habitet kur nuk e sheh*)

GJINI — (*Duke hyrë*) Shoku Leka, Lumtua nuk ka ardhur akoma. (*Shikon orën*) Ora po shkon pesë.

LEKA — Unë them do të vijë. Pyete gjë Mirën?

GJINI — Jo. Di gjë pse kërkoi të shtyhet mbledhja?...

LEKA — Jo. Sot në mëngjes nuk erdhi në punë. E kërkova disa herë.

GJINI — Si të bëjmë?

LEKA — Të fillojmë mbledhjen. Fletërrufetë e sotme kanë ngritur shumë probleme të reja. (*Dalin të dy. Pas pik hyn Jashari me Kristaqin*)

KRISTAQI — Fletërrufetë, që u vunë sot, ngrënë me forcë çështjen e rikonstruksionit të ndërmarrjes.

JASHARI — I lexova.

KRISTAQI — Disa i lëshohen edhe Vebiut. Ti ç'thua, do të qëndrojë në pozitat e mbrëmshme?

JASHARI — E ka të vështirë të tërhiqet...

KRISTAQI — Është i pakënaqur.

JASHARI — Sigurisht.

KRISTAQI — Me gjithë ato që po ndodhin...

JASHARI — Fryjnë erëra të tjera, nuk i ndjen?

KRISTAQI — I ndjej që ç'ke me të, por nuk më pëlqen ta them. Ç'mendon: kush qëndron pas Mirës? Nuk më duket t'i ketë të sajat të gjitha ato që tha!...

JASHARI — Si i ke punët në sektor?

KRISTAQI — Ti i di si janë punët. Revizioni vazhdon, ka plot një muaj. Të shohim.

JASHARI — Merr masa. E shikon ç'po bëhet?

KRISTAQI — Si do të vejë kjo punë?

JASHARI — Ti si thua?

KRISTAQI — E ngatërruar...

JASHARI — E ngatërruar...

KRISTAQI — Ajo budallaqja, Mara, në fillim e ndreqi për bukuri, kurse më vonë...

JASHARI — Ku t'i merrnim ca budallaqe e buda-llenj si ajo!

KRISTAQI — Po ajo, Lumtua?

JASHARI — (*Mendohet*) Ajo dhe Mira s'janë budallaqe.

KRISTAQI — C'do të thotë sot? Di gjë?

JASHARI — Për atë kam vrarë mendjen tërë ditën. (*Jashtë dëgjohet zhurmë, vijnë njerëz dhe Jashari e Kristaqi dalin*)

BENI — (*Duke hyrë bashkë me të tjerë*) Sot, si e shikoni, u detyruam t'i vendosim edhe nga kjo ana tjetër. (*Tregon fletërrufetë*)

DRITANI — Më thanë se sot kanë ardhur në mble-dhje edhe të tjerë, edhe gazetarë. Mbledhja e djeshme ka pasur jehonë. (*Pas pak*) Lumtua ç'bëhet, ka ardhur?

BENI — Nuk e pashë.

VITA — Jo, nuk ka ardhur akoma.

BENI — Po ajo kish për të folur.

DRITANI — (*Shikon orën që ka në dorë*) Shkojmë, se tani fillon. (*Dalin. Hapet përdja. Çdo gjë është si në pjesën e parë. Vetëm disa kanë ndryshuar vendet. E merr fjalën Gjini*)

GJINI — Atëhere fillojmë, shokë, ose më mirë, vazhdojmë. Siç e patë, atje përjashta janë vënë shumë fletërrufe të tjera. Janë ngritur edhe probleme të reja. Kjo vërteton se çështjet nuk janë sqaruar akoma. Prandaj bëmë mirë që e shtymë mbledhjen për sot...

VEBIU — Me leje! Ku është shoqja Lumto? Nuk po e shoh këtu sot. Ajo kërkoi që të shtyhet mbledhja, tha se kishte për të folur.

GJINI — Nuk ka ardhur, nuk e di pse. Kam dërguar njeri në shtëpit të saj për të pyetur. Besoj se nuk vonohet... atëhere do të mund të themi diçka më të sak-të.

KRISTAQI — Të paktën për respekt të të gjithëve

duhej të vinte, e të thoshte: «Shokë, kot ngula këmbë mbrëmë, nuk e mbaj mend edhe unë çfarë thashë... Më falni, ju mundova... Ashtu e kam unë nganjëherë: më hipën në kokë ndonjë gjë dhe nuk di çfarë them». Kjo, të paktën, do të ishte e ndershme. Kështu mbledhja jonë e sotme do të ishte më e shkurtëra që kemi bërë deri më sot.

Mira — (*Duke u ngritur e vendosur*) Ajo do të vijë.

KRISTAQI — Atëhere ti e di, pse nuk e thua? Më bën përshtypje nga dhe si e di shoqja Mira, se ajo do të vijë.

GJINI — Kjo s'ka rëndësi.

KRISTAQI — Jo, për mua ka. Nga kjo njeriu mund të nxjerrë konkluzionin se këtu ka diçka të parapërgatitur. Mua kështu më duket.

PIRRUA — Mua jo.

KRISTAQI — (*Objektivistit*) Po ty?

OBJEKTIVISTI — Dakord, duhej të vinte.

MIRA — Thashë: do të vijë.

GJINI — Unë them të vazhdojmë punën për çësh-tjet që mbetën pa u sqaruar mbrëmë dhe për ato që ngrihen në fletërrufetë e reja. Lexojmë më parë disa pyetje që i kanë ardhur presidiumit.

JASHARI — (*Duke u ngritur, shkon në vendin si podium*) Unë paralajmëroj shokët se nuk kam tjetër gjë për të thënë, prandaj nuk do t'u përgjigjem pyetjeve, në qoftë se do të ketë për mua. (*Heshtje. Vëren me vëmendje të tjerët*) Pse, thoni ju? E shoh se disa shokëve kjo nuk u pëlqen, mund ta quajnë edhe të padrejtë, prandaj po e shpjegoj. U lodha, shokë, u lodha nga kjo histori, e dini ç'do të thotë u lodha? Nuk mundem më. Merrni çdo vendim që të doni, bëni ç'të doni, unë s'kam ç'të them tjetër. Mbrëmë nuk kam fjetur deri vonë, i solla të gjitha edhe një herë nëpër mend, të gjithë jetën time, dhe nuk munda të bëj tjetër veçse arri-ta në konkluzion se shpifja, nganjëherë, them nganjë-

herë dhe jo gjithnjë, paska fuqi më shumë se fjala e singertë, me zemër në dorë. Më vjen keq të ndodhë kështu, më vjen keq të kem arritur në këtë konkluzion, më vjen keq ta them atë këtu përpëra jush, por më mirë ta them. S'jam as i pari as i fundit që bie viktimi e një intrige. Siç dihet, intrigat kanë përmbysur mbretëri e shtete të tëra. Kështu po ndodh edhe me mua. (Ulet në vendin e tij)

DRITANI — (Gjinit) Unë them të lexohen pyetjet, të jepen me doemos edhe përgjigjet.

GJINI — E drejtë, lexojmë pyetjet. (*Lexon pyetjet*)

1) Pse, sipas mendimit të shokut Jashar, kanë filluar të shkojnë keq punët e ndërmarrjes?

2) Si qëndron puna me konstruksionin e ndërmarrjes, pse është penguar dhe nga kush?

3) Kush e ka përkrahur shokun Jashar, aq sa na është bërë si zot këtu në ndërmarrje, qoftë edhe atje në ministri?

4) A ka thënë shoku Jashar për shoqen Landa se ajo nuk është teknologe dhe nuk do të mundë të drejtøjë, se është e zonja vetëm për të mbajtur leksione dhe se i pëlqen të rrrijë qosheve, duke shitur mend?

Këto janë kryesoret. Shoku Jashar, do të përgjigjeni tani, apo më vonë?

JASHARI — (Duke u ngritur) Të gjitha pyetjet nuk janë për mua, prandaj pse më drejtoheni vetëm mua?

NJË PUNËTOR — (Duke hyrë, mezi flet) Vajta në shtëpi të Lumtos. Nuk ishte. E éma tha se kishte dalë që në mëngjez, si zakonisht, dhe nuk qe kthyer. Bile ishte bërë merak. U trondit shumë kur vajta unë. Nuk e qetësova dot. «E pashë unë mbrëmë atë, tha ajo, nuk ishte në vete fare». Pastaj u vesh shpejt e shpejt dhe doli. Nuk dija ç'të bëja. «Ku po shkon, moj nënë?» i thashë unë. «Do të vete ta kërkoj», më tha dhe iku. Dësha të shkoja edhe unë me të, por erdha të lajmëroj një herë...

VITA — Kam frikë.

GJINI — Përse ke frikë?

VITA — Unë e takova në mëngjez, dhe...

KRISTAQI — Ti në mëngjez, nuk ishe në punë?

VITA — E takova rrugës, banojmë në një lagje, prandaj...

GJINI — S'të tha gjë ku po shkonte?

VITA — As nuk e pyeta.

MARA — Po si t'u duk, nga ftyra them, ç'vure re?

VITA — Asgjë! Po pse m'i bëni këto pyetje?!

JASHARI — Ashtu e ka ajo, i pëlqen të térheqë vëmendjen e të tjerëve, të krijojë shqetësimë pér të. Ka gjithfarë manirash në këtë botë.

LEKA — Ashtu?.. E njihke mirë.

JASHARI — Sikur të mos njihja njerëzit që kam në repart, ç'bëj unë atëhere?

PETRUA — More, duhet të vejë njeri, që të interesohet ku ka vajtur...

MIRA — Mos u bëni merak, do të vijë.

KRISTAQI — Nga e di ti se do të vijë?

MIRA — Kështu them: do të vijë.

JASHARI — (*Provokonjës*) Nuk e shikon, ky është një plan i tërë, një gjë e kurdisur.

MIRA — Ne nuk jemi mësuar të kurdisim plane prapa shpine. Sa kemi mësuar të shkurdisim plane të tilla dhe shorti na ra të fillojmë me një plan intrigash të thurur nga një dorë mjeshtri.

JASHARI — (*Duke u përbajtur me zor*) Duhet të hesht, s'bëj dot ndryshe, derisa edhe shoku Gjin nuk ndërhyn kur bëhen fyerje të tilla. (*Papritur*) Nuk do të flas më... Po, nuk do të flas... është e kotë... Këtu po thuhen gjëra që mund të të çmendin... të humbasësh duri-min është pak. Do të hesht. Mbase kështu është më mirë. Thuajni çfarë të doni... Bëni çfarë të doni.

DRITANI — Unë nuk e quaj aspak të drejtë këtë

qëndrim. Kërkojmë sqarime, bile edhe llogari. Duhet të japë llogari. U bënë gjithë këto pyetje, të përgjigjet...

JASHARI — Ju mund të kërkonи edhe kushedi çfarë...

DRITANI — Atë do ta shohim...

JASHARI — (*Duke mos u përbajtur*) Thuajeni, pse nuk e thoni hapur, ka ardhur koha ta thoni...

DRITANI — (*Rreptë*) Përgjigju më parë pse i ke bërë të gjitha këto, pse?

JASHARI — Pse-të tuaja janë pa fund. Nuk jam i detyruar t'u përgjigjemi edhe pyetjeve provokonjëse, si kjo. (*Ulet*)

DRITANI — Se mos i je përgjegjur deri tani ndonjërs nga pyetjet që të janë bërë? (*Heshtje e gjatë, mendohen*).

LANDA — (*Del në vendin si podium*) Dua të shpjegoj cilat kanë qenë marrëdhënjet e mia me këtë njeri, pasi u bë një pyetje për këtë dhe ai mbrëmë u përpoq të hidhte shumë faje mbi mua, sikur unë e paskam penguar, e paskam izoluar e kushedi se çfarë. E vërteta qëndron ndryshe. Në fillim më bëri mjaft lajka, shau drejtoren që ishte më parë, foli edhe për inxhinier Lonin, për shokun Leka tha se është i ngurtë. Njeri i zoti, sipas tij, ishte vetëm Kristaqi. Për çdo gjë që unë konsultoheshë me të, sepse të them të drejtën nga disa shokë atje në ministri kisha rekomandimet më të mira, ai, me një menjemadhësi që të revoltonte, më thoshte: «merrni dhe studjoni dosjen time për këtë çështje» ose «kam paraqitur njëherë një projekt për këtë çështje, studjojeni me vëmendje... nuk ju mbetet tjetër veçse ta vini në jetë». Një ditë s'durova më dhe iu ktheva: «S'jam unë që do të vë në jetë projektet e tua, por je ti ai që do të zbatosh urdhërat e mia». Kërkova, gjithashtu, që, pas një javë, të raportonte para këshillit teknik të ndërmarrjes për progresin teknik në repartin e tij, ku punët nuk shkonin mirë.

BENI — Hë, ç'ja bëre mirë!

LANDA — Që atë ditë, ai u kthye hapur kundër meje. Nuk i pëlqeu aspak që u thirr në raport, sepse assnëherë nuk kishte dhënë llogari më parë, përpara askujt dhe, pa kaluar dy ditë, më tha: «Dëgjoni, ju, shoqja Landa, si duket, nuk më njihni, ose ndokush ju ka fryrë kundër meje, por unë nuk jam një nga ata që mund të merrin nëpër këmbë». Dhe shtoi se do të ankohej. Kur e pyeta se ku, me shumë kryelartësi më tha: «Në ministri ata më njohin mua, të dinë edhe ty».

LEKA — Te kush atje në ministri? Nuk tha se te kush? Burokratët dhe njerëzit si ky kanë, zakonisht, edhe mbrojtësit e tyre.

LANDA — Këtu desha të dal. Të nesërmendajt vajta në ministri, në degën përkatëse, por, për habinë time, atje në degën përkatëse, disa shokë ma ngritën në qiell. «Ësh-të i zoti», «është teknik i mirë» më thoshte njëri, «ta kesh krah të djathtë», «të dish ta përdorësh, vërtet ka ca huqe, por i pjell mendja», ja priste një tjetër. «Edhe si njeri është i mirë, i ndershëm».

PETRUA — Vazhdo ti, shoqja Landa, vazhdo. Po do të them edhe unë diçka për këtë çështje.

LANDA — Erdha në ndërmarrje, nisa të verifikoj çdo mendim timin dhe të atyre që më folën veç mirë për të. Mirëpo mua më dilte ndryshe.

MIRA — Nuk është e para herë që ndodh kështu. Shoku Leka e tha mirë: e kanë mbrojtur disa njerëz, bille me këmbëngulje. E mbaj mend, para dy vjetësh, u shkrua një artikull në gazeten e murit me rastin e 1 Majit, në të cilin, midis shumë të tjerëve, që lavdërohen në përpunë të mirë, nuk përmendej emri i Jasharit. Nuk përmendej, e pse duhej përmendur me doemos? Do ti? U ngritën në këmbë, jo një e dy, por disa, erdhë edhe një nga ministria dhe e detyruan redaksinë e gazetës së murit ta hiqte artikullin, të shtonte edhe emrin e Jasharit dhe pastaj ta vinte përsëri. Dhe kështu u bë. (Vebiut) E mban mend, shoku Vebi? Ti ishe një ndër ata që bëre shumë zhurmë atëhere. (Të tjerëve) Ja, kështu ndodhi.

PETRUA — Këtë desha të them: kështu ka ndodhur...

PIRRUA — E pastaj, si të mos i rritej mendja Jashar Drizës!.. Jo t'i rritej, por t'i fluturonte fare. Nuk prekej me pupël. Pikë, mbaroi. Erdhi e na u bë si zot i ndërmarrjes. I paprekshëm. Pa pyetur atë s'bëhej gjë. Drejtor e mbi drejtor... Ku ja varte ai drejtorit që kishim?

BENI — Mirëpo një ditë i ngeci sharra në gozhdë...

GJINI — (*Landës, që është akoma te vendi si podium*) Shoqja Landa, kishit gjë tjetër, se ju ndërprenë?

NJË I PAFTUAR — (*Papritur*) Me leje? Desha të them edhe unë dy fjalë. Mbase e ndihmoj shoqen Landa.

LANDA — (*Gjinit*) Kisha edhe një gjë, por mund ta them pastaj. (*Ulet në vendin e saj*)

I PAFTUARI — (*Del te vendi si podium*) Nuk dua të ndërhyj... As të mbroj njeri... Sa për atë: është apo nuk është në kompetencën tuaj të zini në gojë ministri-në...

MIRA — Ndonjë atje në ministri, jo ministrinë: janë dy gjëra, nuk duhen ngatërruar.

I PAFTUARI — (*Duke u përbajtur*) E pra, është apo nuk është në kompetencën tua, edhe këtë nuk më takon mua ta them. Ata që folën, duhet ta kenë menduar...

DRITANI — (*Gjinit*) Më falni, po kush është shoku që flet?

GJINI — Tani sapo bëhesha gati ta them: është një shok që punon në ministri.

DRITANI — Edhe më shkoi në mend, pas asaj që foli shoqja Landa.

I PAFTUARI — (*Përbahet dhe nuk i përgjigjet Dritanit*) E kisha në fillim më ju, shoqja Landa. Singarisht, më vjen keq që nuk qenkemi marrë vesh, kur erdhët tek ne... E pra, do kishi bërë mirë të dëgjoni me kujdes. Jo kështu: neve nuk na thatë asgjë, kurse këtu hapët luftë... Po, po, luftë...

LANDA — S'është e vërtetë, unë ju thashë që nuk

jam dakord. Sa pér atë që hapa luftë, unë kam pér të bërë autokritikë pse nuk bëra atë që bëri kjo këtu. (*Tregon Mirën*)

I PAFTUARI — Unë e them këtë me përgjegjësi dhe shokët është mirë ta dinë: shoqja Landa, që në ditët e para, sa erdhi në ndërmarrje, e mori pak me vrull. Ne e pamë këtë dhe e diskutuam, por thamë se mos ishte vetëm fillimi...

LANDA — Me mua nuk keni folur pér asgjë nga këto...

I PAFTUARI — Tani edhe dy fjalë pér disa gjëra që u thanë këtu, mbasë do t'i ndihmojnë shokët: ne u vumë në dijeni menjëherë pér fletërrufetë dhe pér mbledhjen që do të bëhej.

DRITANI — Kush, ne?

I PAFTUARI — Ti, djalosh, dukesh shumë i papërmajtur. Prit pak. (*Vazhdon*) Të themi të drejtën, u entuziazmuam të gjithë pér frymën revolucionare, na pëlqeu. Sigurisht, na ranë në sy edhe disa deviacione, disa akuza pa bazë pér shokun Jashar, por kjo nuk ishte kryesorja. U njoftuam edhe pér mbledhjen e mbrëmëshme... (*Shpejt*) Këtu u fol se shoku Jashar ka patur mbështetjen tonë pér disa gjëra...

DRITANI — Që të jemi të saktë, këtu u fol pér mbrojtjen dhe pér përkrahjen e Jasharit nga disa shokë atje në ministri. T'i vëmë mirë pikat mbi i-të.

I PAFTUARI — (*Nuk përbahet më*) Të them të drejtën, nuk më ka ndodhur ndonjëherë si këtu tek ju... Dhe kjo më shqetëson, mënyra e të folurit, në radhë të parë... Por kjo është një çështje tjetër... (*Prerë*) Po, e kemi përkrahur, nuk e fshehim. Pse? Detyrohem të them disa gjëra që i dimë vetëm ne. Unë do t'i them. Shoku Jashar është bërë copë pér ndërmarrjen tuaj, në përgjithësi, dhe pér shumë nga ju... Është folur se është karrierist dhe se donte të bëhej drejtor. Ne me të vërtetë kemi dashur ta bëjmë drejtor, por ai ka ardhur disa herë dhe na është lutur të mos e largojmë nga reparti, sepse kishte nëpër duar disa projekte dhe donte

t'i realizonte. E ç'karrierizëm është ky, shokë? Shoku Jashar na ka mbirë në ministri pér nevojat e ndërmarrjes, jo vetëm, por edhe të personave të veçantë. Të marrim edhe çështjen e inxhinier Ilirit. Që ta dini, shoku Jashar na mbeti në zyrë, duke na u latur të mos e transferonim aq sa e akuzuam se merrte në mbrojtje një njeri imoral. (*Bëhet zhurmë, ka reagim*)

PIRRUA — Jashari ju mbeti në zyrë pér këtë?!...

I PAFTUARI — Po, po, Jashari... Do të sjell edhe një shembull tjetër, që m'u kujtua, duke parë këtu në-në Sanijen. Prej shumë vjetësh ajo punon këtu bashkë me ju, por kush u interesua të dinte se në ç'kushte të vështira jetonte ajo? S'ka një vit që Jashari e bëri problem çështjen e saj, e ku nuk u interesua: në Komitetin Ekzekutiv, deri atje tek ne, i ngriti në këmbë të gjithë dhe, siç jeni në dijeni, ajo mori apartament. Është kështu, nënë Sanije?

NËNË SANIJA — Po, more bir, ashtu është... (*Qan. Bëhet zhurmë, ka reagim*)

OBJEKTIVISTI — E po të rrimë shtrembër dhe të flasim drejt. (*Duke u drejtuar nga Mira, Dritani, etj.*) Ju aty qepeni gojën tanë, qepeni dhe mos u ndieni më. E muartë vesh? Qepeni... Keni ç'keni në mes tuaj, na lini rehat ne të tjerëve... Kemi dy ditë këtu, e përse?

I PAFTUARI — Edhe pér mbledhjen e mbrëmshme e pyeta shokun Jashar mos kish ndonjë intrigë kundër tij, si mendonte ai. Por ai m'u përgjegj drejt: «nuk besoj», asgjë më shumë. Një hakmarrës nuk flet kështu, më duket... Unë kaq kisha pér të thënë... Desha vetëm të sqaroja disa gjëra... Ju dini vetë më mirë se kushdo. (*Ulet në vendin e tij. Heshtje*)

PETRUA — (*Dritanit*) Të thashë se është ngjalë ai. E pe? I ka rrënjet të thella ai, më dëgjo mua ti.

GJINI — Kush e do fjalën?

FRIKAMANI — E thashë unë...

GJINI — Ke gjë pér të thënë, folë!

FRIKAMANI — Jo. Ç'më duhet mua ajo punë: pa pasur pula të bëj ish, jo nuk kam. (*Heshtje*)

GAZETARI — Me leje.

GJINI — Urdhëro.

GAZETARI — (*Del në vendin si podium*) Mbështetje nuk është vendi që unë të flas këtu, por (*duke u drejtuar nga i paftuari*) fjala juaj më ngjau me një kovë ujë që hidhet mbi zjarr, prandaj nuk munda të bëj ndryshe. (*Drejtohet nga Gjini*) Shokët e kishin filluar mbarë, përmua. (*Të tjerëve*) Mendoj të vazhdoni. Çështjet duhen quan deri në fund, s'ka rrugë tjetër.

OBJEKTIVISTI — Po ky kush është?

GJINI — Një gazetar, pse?

OBJEKTIVISTI — Kot, kot... Më bëri përshtypje: u ngatërruam dhe u bëmë lëmsh tanë.

GAZETARI — Kaq kisha përmë të thënë, më falni... (*Ulet në vendin e tij*)

I PAFTUARI — (*Duke u ngritur*) Unë thashë ato që dimë ne në ministri. Këto janë fakte. Këto kemi ne. Në fund të fundit, nuk fola thjesht në emrin tim...

LEKA — (*Reptë*) Ti fole në emrin tënd dhe vetëm në emrin tënd. Përmë kjo është e qartë. Ne pamë me këtë rast deri ku shtrihen fijet e atij lëmshi që quhet burokratizëm...

GAZETARI — Kjo është e vërtetë: ky është një lëmsh i madh.

LEKA — Unë isha në ministri sot dhe fola me shokët atje. (*Prerë*) Ata nuk mendojnë si ti.

I PAFTUARI — (*I zënë keq*) Ju lutem, unë nuk gënjej këtu.

LEKA — (*Prerë*) Unë thashë se atje në ministri nuk mendojnë si ti. Nuk e di pse e zgjatni akoma...

MIRA — (*Del në vendin si podium dhe mban në dorë një libër*) Shumë e drejtë, shoku Leka, shumë e drejtë. Është një lëmsh ky që i ka fijet të gjata. Xha Petrua më se një herë pyeti në se i dinim ne këto gjëra, pse nuk i thoshim, pse kemi heshtur. (*Duke hapur librin*) Më duket se një përgjigje të saktë përmë këtë e gjejmë këtu: (*lexon*) «Përse masa nuk i përlan këta njerëz të këqinj dhe pa skrupull? Kush i mbron këta, përmë zbulohen me

vonesë dhe kundër tyre merren masa me vonesë, kurse të këqijat që bëjnë njihen me kohë nga masat e shumë herë këto të këqia janë vënë në dukje e megjithatë ata lejohen të vazhdojnë?» (*I drejtohet Petros*) Thuhet këtu në fjalimin e 6 shkurtit. (*Vazhdon të lexojë*) «S'ka asnë dyshim, këta i mbron burokratizmi, rutina, formalizmi dhe disa njerëz të aparateve.» (*Heshtje. Ka reagim*)

PIRRUA — Tamam, tamam, s'e lot as topi.

PETRJA — (*Mirës*) Shejtane, po ku ja gjete...

PIRRUA — He more shokë, ju që heshtni, do të thoni apo jo fjalën tuaj? (*Indiferentit*) Ja, ti atje!

INDIFERENTI — Unë as nuk marr vesh, as nuk më duhet gjë kjo punë.

OBJEKTIVISTI — U ngatërrua keq tanë. (*Frikamanit*) Ti ç'thua?

FRIKAMANI — Unë... Asgjë!..

LEKA — (*Shpërthen*) Kjo është e palejueshme.

FRIKAMANI — Çfarë?....

LEKA — (*Reptë*) Ti hesht, se ke frikë, ky (*tregon Indiferentin*) thotë «nuk më duhet gjë kjo punë», (*objektivistit*) kurse ti...

OBJEKTIVISTI — Unë jam me të drejtën, vetëm me të drejtën.

LEKA — Me cilën të drejtë?

OBJEKTIVISTI — Nuk të kuptoj, e drejta është një.

LEKA — Jo, është dy.

OBJEKTIVISTI — Sigurisht bëni shaka, shoku Le-ka...

LEKA — (*Indiferentit*) Ti si thua? (*Frikamanit*) Po ti?

FRIKAMANI — Unë, ja... (*Mbyll gojën me dorën e veti*) Kështu është më mirë.

LEKA — (*Shpërthen*) Ja, këto qëndrime e kanë ndihmuar dhe e ndihmojnë akoma këtë. (*Tregon Jasharin*) Këto qëndrime ka shfrytëzuar dhe shfrytëzon ai.

Këtë bëri gjatë diskutimit me anë të fletërrufeve, këtë bëri edhe këtu në mbledhje. Me një fjalë, me dashje ose pa dashje, ju bëni lojën e tij.

OBJEKTIVISTI — Këtë unë nuk e pranoj. Në asnjë mënyrë nuk e pranoj.

INDIFERENTI — As unë.

FRIKAMANI — As unë.

LEKA — Atëhere duhet të përcakttoni pozitën tuaj.

FRIKAMANI — (Papritur) E ç'të përcaktojmë?

Pse flitni kështu, shoku Leka? A nuk e patë ç'bëri ai (*tregon të pastuarin*) këtu, pak përpara? Dhe ju thoni flitni! E pse të flasim? Përse?...

DRITANI — Pikërisht për gjashtë kalamanët...

FRIKAMANI — Nuk është puna e kalamanëve, nuk është puna aty, jo. Pse, ore, budalla jam unë? Nuk e di unë se kjo parti dhe ky pushtet janë të mitë, po aq sa janë edhe tuajtë. As më pak, as më shumë. Por ka ndodhur këtu tek ne, këtu, ore, këtu tek ne, për këtu flas unë: kam kritikuar unë një herë Jasharin.... Nuk tha gjë aty për aty. Por më vonë... Është i zgjuar ai... Më vonë nuk ma harroi... Le ta thonë shokët, si jam unë në profesion.

ZËRA — Nga më të mirët.

— Më mirë nga shumë të tjerrë.

FRIKAMANI — Mirëpo kam mbetur nja dy kategorë më poshtë se shokët.

PETRUA — Ashtu është, ashtu...

LEKA — Dhe ti ngrite duart, u dorëzove, i the këtij (*tregon Jasharin*) vazhdo, ti vëllaçko, bëj kështu edhe me të tjerët!... Kam një pyetje: po të ishe në luf të, ç'do të bëje? Do të hidhje armët, do të dorëzoheshe?

FRIKAMANI — Ajo është luftë, është ndryshe në luftë...

LEKA — Edhe sot jemi në revolucion. Në luftë mund të vriteshe. Ndërsa këtu mund ta pësosh, si në rastin tënd. E çfarë? Duhet t'u themi njerëzve: shkoni në luftë, por mos u bëni merak, nuk do t'ju zerë

plumbi! Kështu? Luftë është edhe kjo. Edhe këtu do të ketë njerëz që mund ta pësojnë, dhe do të ketë patjetër, por jo të gjithë, sepse një herë, dy, e shumta tri herë do t'i ecë Jashar Drizës, një ditë do të dalë e drejtë në shesh.

DRITANI — E drejtë, shoku Leka, e drejtë...

ZËRA — Shumë e drejtë, ashtu është...

— Mirë thotë, si në luftë...

— Me vend, krejt me vend. (*Jashtë, në paraskenë, djathtas, duket Lumtua; ndërsa nga e majta ka qëndruar dhe pret një i panjohur. Nga lart bie sipari*)

NJË I PANJOHUR — (*Lumtos*) Mirë mbrëma!

LUMTUA — (*Pa i dhënë rëndësi*) Mirë mbrëma. (*Bën të kalojë*)

I PANJOHURI — Nga shkoni kështu? Po bëhet natë...

LUMTUA — Unë nuk ju njoh. Shkoni në punën tuaj. (*Bën të largojet*)

I PANJOHURI — Ç'po ndodh atje në ndërmarrjen tuaj, ç'bëni kështu?

LUMTUA — (*Qëndron*) Nga e dini ju ç'bëhet në ndërmarrjen tonë?

I PANJOHURI — Ja që e di... Mbrëmë ndenjët deri vonë dhe nuk mbaruat.

LUMTUA — E ditke mirë, po ty ç'të duhen punët e ndërmarrjes sonë?

I PANJOHURI — Hap sytë, mos bën budallallëqe. Mos shko në mbledhje, më dëgjo mua.

LUMTUA — Ç'budallallëqe, nuk të kuptoja?

I PANJOHURI — I lini historitë e shkuara, ç'ju duhen ato? Mos shko.

LUMTUA — Pse të mos shkoj?

I PANJOHURI — Ose shko, por mos folë...

LUMTUA — Të mos flas!..

I PANJOHURI — Nuk do të flisje ti sonte? Nuk kërkove që të shtyhet mbledhja se kishe për të folur?..

LUMTUA — Ditke shumë gjëra ti nga punët e ndërmarrjes sonë... Nuk më the cili je.

I PANJOHURI — Një... S'ka rëndësi se cili.

LUMTUA — E njeh Jasharin ti? Tjetër cilin njeh nё ndërmarrjen tonё?

I PANJOHURI — Nuk qenke vajzë budallaqe ti, jo. Meqë më pyete, po tё them: edhe e njoh, edhe s'e njoh, pёr mua nuk ka rëndësi Jashari ose cilido tjetër. Unё, dhe jo vetëm unё, nuk dua tё bёhen ato që po bёhen, ajo që filloj edhe nё ndërmarrjen tuaj... Më kup-toni?..

LUMTUA — Jo...

I PANJOHURI — Po e pёrsёris: nuk qenke vajzë budallaqe ti, pёrkundrazi. Kjo krijon mundësitë tё merremi vesh.

LUMTUA — Pёrse tё merremi vesh?

I PANJOHURI — Që tё mos flasёsh...

LUMTUA — E njeh ti Jasharin, i di historitë e tij?

I PANJOHURI — Jo, nuk i di... Dhe që ta dish ti, nuk më interesojnё shumë historitë e Jasharit ose cilido tjetër... Nuk po më kuption më duket...

LUMTUA — Po çfarë tё intereson atёhere, folë më qartë.

I PANJOHURI — Mirё, do tё flas më qartë: nuk dua që nё ndërmarrjet tё bёhen mbledhje tё tilla, tё ketë fletёrrufera, kritika, demaskime... më kuption tan?

LUMTUA — Po filloj tё tё kuptoj...

I PANJOHURI — Bën ashtu si tё thashё, ёshtë nё tё mirёn tёnde.

LUMTUA — Thuaj: nё tё mirёn tёnde, jo nё timen.

I PANJOHURI — Edhe nё tёnden. Një ditë mund tё pendohesh....

LUMTUA — Po më kёrcёnon tan, s'ёshtë kёshku?

I PANJOHURI — Deri tan, vetëm po tё kёshilloj. (*Jashtë dëgjohen zёra njerёzish*)

LUMTUA — (Rreptë) Nё djall tё vesh me gjithë kёshillat dhe kёrcёnimet e tua. E more vesh?

I PANJOHURI — (Shpejt) Mirё. Tё paralajmё-rova! Bën si tё thashё. (*Ikёn nga e djathta*. Lumtua

del nga e majta. Ngrihet sipari. Jemi gjithnjë në mbledhje. Në vendin si podium ka dalë përsëri Landa. Ajo po flet)

LANDA — U bë edhe një pyetje: «Pse, kohët e fundit, kanë filluar të shkojnë keq punët në ndërmarrje?» Pyetja i drejtohet Jasharit. Ai të thotë mendimin e tij, por unë do të përgjigjë si drejtori: nuk është e vërtetë që tani punët shkojnë më keq, ose kanë filluar të shkojnë keq, siç ka pëshpëritur Jashari ose ndonjë tjetër poshtë e lart, përkundrazi, ato tani shkojnë më mirë; ka më shumë iniciativë dhe mobilizim. Mbasse Jasharit kanë nisur t'i shkojnë punët jo mirë, këtë e besoj. Reparti i tij shkon keq, ka mbetur në vend. Edhe në sektorin e furnizimit e të magazinës punët nuk shkojnë mirë. Për më tepër, revizioni, që përfundoi këto dit, nxori se ka pasur vjedhje. (*Ka reagim në të gjithë. Sytë përqëndrohen te Kristaqi*)

KRISTAQI — Shoqja Landa, unë nuk di gjë përkëtë. Revizorët nuk më kanë thënë gjë, megjithëse i kam pyetur. Edhe ju mund të ma kishit thënë më përpara... E dini ç'do të thotë kjo përmua?

LANDA — E di, prandaj edhe e thashë.

KRISTAQI — Mua nuk më besohet, do të jetë ndonjë ngatërrresë. Ndodh kështu nganjëherë me revizionin.

LANDA — Jo, nuk është nga ato ndodhiet kjo. Dhe ti mos u bën i paditur.

KRISTAQI — Shoqja Landa... (*I merret goja*) Shoqja Landa, si juva nxë goja atë që thatë? Unë kam dhjetë vjet këtu në ndërmarrje... Kam kaluar kaq kontrollë e revizione...

PIRRUA — Sikur po të merret goja, ç'vate? Mbrëmë e kiske bilbil... C'të gjeti? Shtama shkon shumë herë në çezmë, por një herë thyhet. Thyhet pra. Pëkë. Mbaroi. (*Hyn Lumtua, është e trondititur. Të gjithë shqetësohen*)

LUMTUA — Më falni, shokë, u vonova. (*Ulet*)

LANDA — Ku ishe? C'të ka ndodhur?

LUMTUA — Këtu pranë ndërmarrjes më dolën në rrugë...

GJINI — Kush?

LUMTUA — Një i panjohur. Donte që unë të mos vija sonte këtu, ose të mos flitja për atë që kam në mend.

DRITANI — Si ndodhi? Cili qe ai?

LUMTUA — Nuk e pashë në fytyrë, por me siguri... (*Shikon nga Jashari, pastaj nga Kristaqi*)

MIRA — Çfarë me siguri?

LUMTUA — Me siguri ndonjë nga miqtë e tyre... (*Tregon Jasharin dhe Kristaqin*)

JASHARI — (*Duke protestuar*) Ti nuk di çfarë flet. (*Të tjerëve*) Ju thashë unë, shokë, kjo vajzë ka shumë fantazi, sheh èndrra me sy hapur. Miqtë tanë?! Një herë pse tanët? Pastaj, ç'janë këta miq, që kërcënojnë natën? (*Lumtos*) E mendon, ti, moj vajzë, kuptimin që marrin këto fjalë? Lëri lodrat dhe eja në vete!

LUMTUA — (*Reptë*) Unë nuk luaj ndonjë lodër këtu dhe nuk i kam qejf lodrat. E njihni ose nuk e njihni ju atë, e keni dërguar ose nuk e keni dërguar ju, kjo s'ndryshon asgjë. Ai, ose, ata, që ju qajnë hallin, janë miqtë tuaj të drejtpërdrejtë ose shpirtërorë. «Unë, dhe jo vetëm unë, — tha ai, — nuk dua të bëhen ato që po bëhen, që filluan edhe në ndërmarrjen tuaj, më kupton? Nuk duam që në ndërmarrje të bëhen mbledhje të tillë, të ketë fletërrufera, kritika, demaskime, më kupton, tani?» E ç'janë të gjitha këto?... (*Mira afrohet pranë Lumtos dhe qëndron pranë saj*)

JASHARI — Fantazira të një mëndjeje të sëmurë, s'kanë ç'të jenë tjetër.

LUMTUA — Dhe kjo mendje e sëmurë jam unë?

JASHARI — Se mos ke faj ti, është çështje sëmundjeje kjo.

LEKA — (*Prerë*) Lumtua ka të drejtë: disa njerëz shqetësohen, sepse nuk iu pëlqen ky proces revolucionarizimi që ndodh sot tek ne. Dhe s'ka si t'u pëlqejë.

MIRA — (*Jasharit*) Ata janë miqtë tuaj! Unë përkëtë jam e sigurt...

JASHARI — Këto vajza (*tregon Lumton dhe Mirën*) janë të sëmura, më dëgjoni mua.

LUMTUA — Prit, se kam akoma për të thënë! (*Del në vendin si podium*) Mbrëmë unë kërkova të shtyhet mbledhja... Thashë se kam për të folur edhe unë... E kuptoni, nuk është e lehtë për mua të dal këtu e të them ato që do të them... Unë kam qenë... Si t'jua them.... E kam fjalën për ato që u thanë edhe këtu: për atë që është folur për mua dhe këtë (*tregon Jasharin*) dikur...

JASHARI — Protestoj. Nuk lejoj në asnje mënyrë që çështjet e mia personale të bëhen objekt i diskutimeve në mbledhje të hapura si kjo. Këtë edhe gjyqi e merr parasysh: në të tilla raste zhvillohet me dyer të myllura. Nuk e lejoj...

LUMTUA — Unë nuk do të flas për asgjë personale, do të flas vetëm...

JASHARI — E kush u bë shkak që ne u prishëm, që nuk u fejuam bashkë?

LUMTUA — Unë. (*Mira afrohet pranë Lumtos te podiumi dhe qëndron pranë saj*)

JASHARI — Thuaje troç: sepse dashurove ndonjë tjetër, apo disa të tjerë, është punë për ty... Nuk deshë, rruga e mbarë të qoftë. Atëhere ç'do me mua, përderisa kam qenë korrekt dhe nuk të kam asnje faj?

LUMTUA — Jò se dashurova ndonjë tjetër... Jo sepse ke ndonjë detyrim ndaj meje... Por sepse zbulova tek ti një tok mendimesh të kalbura, të errëta, të huaja për shoqërinë tonë, do të thoshja të fëlliçura... Ja pse vendosa të largohem nga ti, të largohem edhe nga reparti, siç tregoi këtu shoqja Landa. Pse heshta?

MIRA — (*Lumtos*) Prit, ta them unë këtë...

LUMTUA — (*Mirës*) Jo, do ta them edhe këtë... (Të tjerëve) Ka një opinion të tillë tek ne, që për çështje të kësaj natyre, fajet dhe njollat vihen mbi ne vajzat, kurse ata, që disa herë bëhen shkak edhe për lloj-lloj fatkeqësish tona justifikohen, sikur merren në mbrojtje. Unë nuk flas këtu thjesht për një çështje barazie.

Por shoqëria jonë, mendoj, duhet t'i japë fund një spekullimi të tillë. Kjo më shtyu mua të hesht. Ndoshata kjo më shtyu përsëri këto ditë që të mos flas... Por unë do të flas.

JASHARI — Kjo vajzë nuk di çfarë thotë!

LUMTUA — Mira ngriti këto ditë çështjen e këtij njeriut dhe në ndërmarrje filluan diskutimet për të. U diskutua me fletërrufetë. Po diskutohet edhe këtu, në mbledhje. (*Rreptë*) Por po diskutohet për veprimet e tij dhe nuk është prekur akoma rrënja, që ushqen dhe u jep jetë këtyre veprimeve të ulëta... E pra, rrënja janë mendimet e tij të kalbura, të huaja për ne, mendimet e tij për jetën dhe për njerëzit. Ju, natyrisht, nuk i dini, sepse ai nuk i shpreh ato hapur, djathtas e majtas. Sisurisht i manifeston, por nuk i shpreh. Ato i di vetëm ai dhe... unë. Po, unë pata fatin e keq t'i njoh ato më nga afër... Me mua, ai, në një farë mënyre, i shprehu më 'hapur...

JASHARI — Kjo është e pandershme dhe me qëllim të keq.

LUMTUA — Heshtja jote para kolektivit mbrëmë dhe sonte, fshehja që u bën ti mendimeve të tua është e pandershme dhe me qëllim të keq, Jashar Driza.

JASHARI — Ti mund të thuash çdo gjë, mund të trillosh, por nuk ke dëshmitar për këtë.

GJINI — Thatë se nuk ka dëshmitar?

JASHARI — As edhe një.

GJINI — Jeni i sigurt për këtë, se këto bisedat dhe mendimet tuaja nuk i di askush tjetër?

JASHARI — (*Pa u menduar*) I sigurt si vdekja.

GJINI — Pra bisedat janë bërë dhe mendimet ti i ke shprehur, por çështja qëndron se ato nuk i di njeri tjetër veç jush, kështu?

OBJEKTIVISTI — Të lumtë, shoku Gjini, se bukur ja punove. (*Jasharit*) Re brenda me këmbët e tua, Jashar vllai, me këmbët e tua...

GJINI — Tani të dëgjojmë shoqen Lumto dhe ju lutem mos e ndërprisni.

LUMTUA — Po, ai i ka shprehur dhe unë i kam dëgjuar. Kolektivi të peshojë kush nga ne thotë të vërtetën dhe kush jo... Jashar Driza nuk do asnjeri tjetër veç vetes, ai nuk beson në asnjë. Pse? Këtë pyetje ja bëra vetes edhe unë në fillim... (*Rreptë*) Sepsejeta përtë eshtë një pyll me bisha dhe njerëzit janë bishat e këtij pylli. Kush eshtë i fortë, dinak, i zoti përtua hedhur të tjerëve, del në sipërfaqe, sipas tij. Kush nuk eshtë i tillë, vete në fund. Dhe ai do të mbetet në sipërfaqe... Fraza e tij më e preferuar eshtë: «Çaj përpara, nuk ka rëndësi si dhe me q'mjete, por çaj, në qoftë se nuk do që të të shtypin...»

JASHARI — Shoku Gjini, i jepni fund, ju lutem, kësaj historie, kësaj psikopatie të një njeriu jo normal.

GJINI — Unë nuk shoh asgjë jo normale në atë që flet, kurse këto që po dëgjoj janë me të vërtetë jo normale, do të thoshja, tronditëse.

LUMTUA — Unë u përpoqa, bëra luftë në fillim t'ja hiqja këto mendime nga koka. Mirë po ai, jo vetëm që nuk bëri asgjë, por sa herë që i thosha, bëhej nervoz, zemërohej pse nuk i nënështrohesha këtyre mendimeve. Përtë nuk ka as shokë, as kolektiv, as miqësi, as gjë... Më falni, gabova, kishte diçka përtë cilën ai mendonte ditë e natë: mendonte të ngrinte një familje mbi bazën e këtyre mendimeve, të ngrinte dhe një shtëpi të tijën, ku të jetonte ai... dhe unë... ose ndonjë tjetër, kjo nuk ka asnë rëndësi përtë atë, ashtu si në një kësh-tjellë mesjetare, duke u myllur në mosbesimin e pa-fund ndaj çdo gjë që e rrëthon, duke u ruajtur vazh-dimisht «të mos ja hedhë njeri» dhe ai «t'ua hedhë të gjithëve». Më thoni tani cili do të pranonte të groposej gjallë në këtë varr. Ja, ky eshtë Jashar Driza, ja, këtu eshtë edhe rrënja e gjithë atyre që u thanë nga shokët... Ai eshtë një individualist me mendime të kalbura, mikroborgjeze, prandaj dhe veprimet e tij janë të shëmtuara. Dhe nuk ka nevojë këtu të merremi me gjyqe, dëshmitarë, etj. etj. I ka bërë Jashar Driza të gjitha ato që thanë shokët dhe do të bënte më shumë akoma po t'i

lilihesh dorë e lirë, po të mos ishte vija e partisë sonë, njerëzit tonë të edukuar nga ajo, kolektivi ynë... Në qoftë se kolektivi ynë nuk do të ngrivej, ashtu si u ngrit këto dit, që t'i thoshte një herë e mirë ndal, ai do të bënte dhe të tjera gjëra, edhe më të shëmtuara.

JASHARI — (*Duke u ngritur*) Unë nuk mund të dëgjoj më shpifje të tillë! (*Bën të dalë*)

GJINI — Ulu aty dhe dëgjo deri në fund. (*Jashari ulet*)

LUMTUA — Por ka një gjë që e ndihmon atë dhe e ka ndihmuar: heshtja. Oh, sa e pëlqente ai heshtjen e njerëzve! Ai dinte dhe ta kultivonte atë... Dinte dhe ta siguronte me njëmijë mënyra dhe mjete, me çdo kusht. Këtu rashë edhe unë dhe për këtë e dënoj veten fort... Ai thoshte kështu: «sikur të heşte e gjithë Shqipëria si heshtin disa njerëz, e di unë q'do të bëhesha...» Ai i ndante ata që heshtin në tri kategori: disa, thoshte ai, heshtin nga frika, disa të tjerë nga fisnikëria, të tjetër pse nuk kuptojnë. Dhe i kish rënë pikës, shokë. Heshti Filja, e pësoi inxhinier Iliri, dhe vetë Filja. Filloj të fliste Filja, shkrojti letrën që lexoi këtu Mira, dhe iu lidhën këmbët këtij njeriu... Kaq kisha... (*Ulet në vendin e saj. Mira i qëndron pranë. Ka reagim, përshtypëritje*)

JASHARI — (*Shpërthen*) Këto vajza janë çmendur, më dëgjoni mua! Unë thashë më parë se u punon shumë fantazia, por duhet thënë u punon vetëm për këq dhe arrin deri në çmenduri. Ju lutem, i jepni fund një herë e mirë kësaj historie, që është **kthyer tanimë** në histeri. Unë paralajmërova disa herë për rrëziqet që mund të kishte nxitja dhe përpunimi i këtyre vajzave.

LEKA — (*Rreptë*) Ti shpesh ke folur, edhe mbrëmë, edhe sonte, për nxitje dhe përpunim të njërit dhe të tjetrit. Thuaje hapur, nga kush dhe përsë.

JASHARI — Po, do ta them: nga ti, në radhë të parë, dhe nga shoqja Landa. Vetëm një dorë mjeshtri mund t'i radhisë njërin pas tjetrës dhe kaq hollë gjithë ato që u ngritën për mua këtu.

LEKA — Sigurisht një dorë mjeshtri i radhiti dhe i nxori ato në dritë, aq sa ta bëri të vështirë të manovrosh edhe ty, që e quaje veten mjeshtër përsa i përket intrigave, kjo dorë mjeshtri është kolektivi ynë që ti nuk e ke llogaritur dhe nuk e ke çmuar asnjëherë, është klasa punëtore me grushtin e saj të fuqishëm.

JASHARI — Duhen prova, fakte, prova dhe faktë... Me shpifje nuk kalohet...

LONI — (*Papritur*) Fakte kam unë.

JASHARI — (*Duke u përbajtur*) Inxhinier, unë ju paralajmërova disa herë: ruhuni nga provokacionet.

GJINI — Flisni inxhinier, flisni....

LONI — Po, do të flas, do të flas...

JASHARI — Atëhere shpifni edhe ju, shpifni...

LONI — Unë nuk shpif dhe nuk kam nevojë të shpif... As frikë nuk kam unë...

JASHARI — Atë nuk e di. Por si të tjerët edhe ti: nga të fryjë era, në fund të fundit inxhinier...

LEKA — Si, si e the këtë, përsërite edhe një herë...

JASHARI — Inxhinier thashë, intelektual...

LEKA — Veç të tjerave je dhe një provokator i lig...

LONI — (*Duke ndërhyrë*) Shoku Leka, për një gjë ai ka të drejtë: për atë që nuk pashë qartë, që në fillim, atë që patë shumë nga ju te ky njeri intrigant, i poshtër, provokator dhe vjedhës...

PIRRUA — Vjedhës, thatë?!

LONI — Po, vjedhës: ai kundërshtoi dhe hodhi poshtë, në fillim, projektin e inxhinier Ilirit për rikonstrukcionin e ndërmarrjes, më vonë intrigoi kundër tij, doli këtu me atë historinë e Files... E mirë, ai ja vodhi projektin inxhinier Ilirit dhe pa pikë turpi e paraqiti atë si të tijin, me disa modifikime pa asnjë rëndësi... (*Shpërthen*) Po, kjo është e poshtër, shumë e poshtër... Kjo është vjedhje, e hapur!...

JASHARI — S'është e vërtetë. Është shpifje, triplim!... Shokët e dinë të gjithë. Ideja e rikonstrukzionit

të ndërmarrjes ka qenë që në fillim imja... Inxhinier Iliri e mori atë nga unë... Unë kërkova ndihmën e tij, kërkova të bashkëpunoja me të, por ç'bëri ai, mori idenë time dhe e paraqiti projektin si të tjin... ashtu si desha të bashkëpunoja edhe me ty...

LEKA — (*Duke ndërhyrë*) Pra ti pranon se shku i grindjeve me inxhinier Ilirin ishte projekti për rikonstruksionin e ndërmarrjes.

JASHARI — Ai u bë shkaktar.

LEKA — Dhe se çështja e Files qe një intrigë...

JASHARI — Jo, këtë nuk e pranoj!...

LEKA — Dhe se i vodhe projektin inxhinier Ilirit?...

JASHARI — Jo, kjo nuk është e vërtetë, nuk është e vërtetë...

LONI — (*Del në vendin si podium*) Unë, shokë, nuk i di të gjitha ato që u thanë këtu për Filen dhe inxhinier Ilirin, kur kanë ndodhur ato unë nuk kam qenë këtu. Por, që në ditët e para, sa erdha këtu, ky njeri m'u afroa shumë... Më foli për ndërmarrjen, më foli edhe për njerëzit... Për inxhinier Ilirin, të them të drejtë, nuk më tha asgjë... Bile shprehu një farë keqardhje për të... Unë nuk e zgjata dhe ai nuk e përmendi më punën e tij.

DRITANI — Mirë thua ti, xha Petro: dhelpër.

PETRUA — (*Lonit*) Si mendon, mor bir, pse e bëri ai këtë?

LONI — Atë desha të them: me shumë kujdes ai punoi me mua. Unë fillova të mendoj se, si shef reparti, ai ishte një nga më të mirët... më të zotët këtu në ndërmarrje, tek i cili mund të mbështetesh... Ja pse nuk e kuptova fletërrufenë e Mirës në fillim, nuk kuptova kritikat e saj... Ja edhe pse mbrëmë thashë ato që thashë...

PIRRUA — Po ajo çështja e vjedhjes... si qëndron puna e vjedhjes?

LONI — Unë nuk kam ditur gjë për projektin e inxhinier Ilirit, deri mbrëmë nuk kam ditur gjë... Mbrëmë dëgjova këtu për të parën herë. Pyeta shoqen Landa dhe ajo më tregoi se projekti origjinal ishte atje në ministri, në degën përkatëse... Sot vajta në ministri me autorizi-

min e shoqes Landa dhe aty u njoha me projektin e inxhinier Ilirit.

LEKA — Loni nuk shton dhe nuk heq asgjë. Çështja qëndron pikërisht kështu, inxhinier Loni nuk ka qenë në dijeni të këtyre dokumentave dhe ky është një gabim i rëndë, i drejtorisë në radhë të parë...

LANDA — Kjo është e vërtetë: ka një çrregullim në mbajtjen dhe përdorimin e dokumentacionit teknik tek ne... Mbrëmë ai më pyeti për projektin e inxhinier Ilirit dhe unë e drejtova në ministri, në degën përkatëse...

PIRRUA — Po vjedhja, ku qëndron vjedhja?..

LONI — Ja ku del vjedhja: disa dit përpara se Mira të vinte fletërrufënë e saj, Jashari më solli në shtëpi, po e përsëris, në shtëpi, projektin e tij për rikonstruktionin e ndërmarrjes dhe kërkoi ndihmën, ose, si tha ai më vonë, bashkëpunimin tim...

PIRRUA — Ti the projektin e tij, domethënë të Jashtarit?

LONI — Jo, shokë, ai më solli në fakt projektin e inxhinier Ilirit. Sot, kur i krahasova ato, unë pashë se ai qe projekti i inxhinier Ilirit...

JASHARI — (*Papritur*) Shoku Gjin, do të anko-hem.

GJINI — E përse?

JASHARI — Për të gjitha, edhe për presionin që u bëhet njerëzve, edhe për komplotin që porsa nxori kokë me inxhinier Lonin.

LONI — (*Jasharit*) Kam një pyetje, pse nuk më the asgjë për projektin e inxhinier Ilirit?

JASHARI — Sepse ai ishte projekti im dhe jo i inxhinier Ilirit, e thashë këtë një herë.

LONI — (*Vebiut*) Shoku Vebi, sic doli këtu mbrëmë, ju jeni marrë atëhere me çështjet e inxhinier Ilirit, mund të më thoni: si u hodh poshtë atëhere projekti i tij?

VEBIU — (*Ngrihet*) U tha se ishte shumë i kushtueshmë.

LONI — Kush e tha këtë?

VEBIU — Jashari

LONI — Kush tjetër?

VEBIU — (*Duke shikuar nga i paftuari*) Edhe ai, që kish ardhur nga ministria. (*Vebiu qëndron në këmbë*)

GJINI — Pse nuk uleni, shoku Vebi? (*Heshtje*) Shoku Loni, keni gjë tjetër me Vebiun?

LONI — Jo

GJINI — Uluni, shoku Vebi, mos rrini në këmbë, uluni. (*Vebiu ulet*)

LONI — E kisha fjalën te Jashari. Një ditë erdhi dhe më mori në shtëpi e më dërgoi në ministri te ky... (*Tregon të paftuarin*)

I PAFTUARI — Është e vërtetë...

GJINI — Çfarë është e vërtetë?

I PAFTUARI — Që erdhën tek unë... Dhe unë i përgëzova për iniciativën që kishin marrë.

LEKA — I the ti, se ky ishte po ai projekt i paraqitur nga inxhinier Iliri?

I PAFTUARI — Nuk e shikova më vëmendje.

LEKA — Nuk e shikove, apo nuk deshe t'i thuash? (*I paftuari hesht, pas pak ul kokën*)

LONI — Nuk deshi, prandaj edhe heshti. Jashari kishte biseduar më parë me të, prandaj...

I PAFTUARI — Jo, nuk kishte biseduar... Nuk kishte biseduar....

LONI — Nuk thoni të vërtetën dhe për këtë duhet t'ju vijë rëndë... (*Jasharit*) E mban mend q'më the kur dolëm nga zyra e tij? (*Tregon të paftuarin*)

JASHARI — Asgjë nuk ju thashë, asgjë...

LONI — Më the se e ke të njojur dhe ta dëgjon fjalën.

JASHARI — Gënjeshtër.

LONI — Më the edhe këtë: se ke folur më parë me të dhe se ai do të na ndihmojë...

JASHARI — Shpifje! Trillim!

LONI — Më the dhe këtë: «ky është një rast i mirë për të dalë me një racionalizim të madh, për të marrë edhe një shpërblim të mirë, veç të tjerave...»

JASHARI — (*Papritur*) Ha-ha-ha dhe kujton se

me këto përralla do të gënjesht njeri? Po njerëzit më njohin mua, të njohin edhe ty... Ata nuk u besojnë përrallave...

MIRA — Po, ne të njohim mirë, të njohëm tani edhe si vjedhës.

JASHARI — Rri, moj ti, fillove përsëri ti... E di unë sa të vlen lëkura... Por nuk je ti që flet kështu, jo, nuk je ti. Veç mos kujto se do të mbetet puna me kaq...

LEKA — Pse, ç'ke në mend të bësh?

JASHARI — Në gjyq, do t'i drejtohem gjyqit, ja ç'do të bëj. (*Si i xhindosur*) Po, po, do të vete në gjyq. (*Mirës*) Dhe ti, moj vajzë, e para ti, do të më përgjigjesh... (*Lumtos*) Edhe ti (*Lonit*) Ti gjithashtu. Republika Popullore e Shqipërisë ka ligje. Ka edhe të tillë ligje që e dënojnë shpifjen. Kodi penal, neni 166 dhe 167 parashikojnë dënimë deri në një vit... Me ju e kam të lehtë... Tani me ju të tjerët. (*U drejtohet të gjithëve*) Kush bashkohet me ta? Hë, pra, t'i japimi fund. Keni dy ditë që më torturoni, jo kështu, jo ashtu... (*Nuk e kontrollon më veten*) Hajde, cilit ja mban? Keni frikë? Po, sigurisht. Sepse duhen fakte, jo përralla. Ligji do fakte... Dhe fakte ju nuk keni. Kush, pra, kush? Po pres... Ka apo nuk ka? E po më lini rehat atëhere, e morët vesh! Për të fundit herë po ju pyes: ka apo nuk ka njeri që do t'i shoqërojë këta në bankën e të akuzuarve?

PETRUA — Unë!

JASHARI — (*Shpejt*) Nuk e kam me ty, xha Petro. Qëndro në një anë ti. E kam me ata që kurdisin prapa shpine.

PETRUA — E kam unë me ty.

JASHARI — Rri, more ti, ke rrjedhur, më duket...

PETRUA — (*Duke iu afruar*) Mbaje gojën, se nuk di llafe unë.

LEKA — Mos i bjerë, xha Petro, se atë do ai.

JASHARI — A ke fakte?

PETRUA — Po.

JASHARI — Qiti!

PETRUA — Të njoh ty unë... Të njoh mirë...

JASHARI — Ky nuk është fakt.

PETRUA — Jashar Driza, mua nuk më hedh hi syve. I kam mbajtur këtu (*tregon shpatullat*) zotérinjtë dikur unë dhe ua njoh mirë huqet.

JASHARI — Unë nuk jam zotëri.

PETRUA — Fjalët i ke si tonat ti, por në kokë dhe në zemër me shembëllen me zotérinjtë e dikurshëm. Këtë unë e ndjej. E çfarë nuk bëmë ne për të hequr qafe zotérinjtë, as gjakun nuk e kursyem... Mos kujto se do të lemë të ngallen zotérinj të rinq, jo nuk do të lëmë...

JASHARI — Mirë, paç veten në qafë... Tjetër, ka tjetër?

PIRRUA — Unë!

DRITANI — Ne! (*Ngrihet në këmbë bashkë me Benin dhe Vitën*)

FRIKAMANI — Edhe unë!

JASHARI — (Qesh me zor) Ha-ha-ha!... Edhe ti?!

Po kush pyet për ty, more i humbur?

ZËRA NGA THELLËSIA — Edhe ne!

JASHARI — (Bërtet) Servilë! E di unë, keni frikë, prandaj ngriheni... Hë, ç'do të pendoheni!.. (*Nënë Sanija shpërthen në të qarë. Të gjithë kthejnë kokën nga ajo*) Ja, po qan nënë Sanija! (*I afrohet nënë Sanijes, dhe, duke e zënë me të dy duart, e shtrëngon fort*) Mos u bën merak, nënë Sanije, nuk kanë ç'të më bëjnë, jam i fortë unë, nuk kanë fakte, dhe pa fakte...

PIRRUA — (*Thërret fort*) Hiqjani, more duart, se po e mbyt plakën! (*Disa e mbërthejnë Jasharin dhe e largojnë*)

GJINI — Si është puna?

NËNË SANIJA — Më vraftë zoti mua, more bijtë e mi, mallékuar qoftë kjo zemra ime e butë.

GJINI — Pse, si është puna? Folë!

NËNË SANIJA — E mjera vajzë! Ky e mori në qafë Filen. Unë e dëgjova Jasharin atë ditë kur i fliste Files për inxhinier Ilirin...

JASHARI — Gënjen, gënjen matufja e dreqit.

NËNË SANIJA — I thashë pas disa ditësh Jasharit, por më erdhi keq për të, m'u lut: «mos më merr në qafë, nënë Sanije» më tha. Më vonë m'u kërcënuat dhe unë heshtat...

JASHARI — Shtrigë, gënjen! Qepe gojën, shtrigë!

MARA — Je djall! Ke bërë të gjitha këto...

MIRA — I ka bërë, lum Mara, i ka bërë të gjitha. Këto dhe të tjera...

MARA — E kam të vështirë, moj Mira, e kam të vështirë të beso...

MIRA — Atëhere ti nuk u beson të gjithë shokëve këtu, nuk i beson Files? Ti e solle atë.

MARA — Do të thuash se unë u bëra shkak përfatim e saj të zi?

MIRA — Unë nuk e them këtë... Po të flasim përgjegjësitë, të gjithë ne kemi dha duhet të ndjejë më përgjegjësi për atë që ndodhi.

JASHARI — Ha-ha-ha, kërkon të të hedh në gracë edhe ty! E dëgjon? E dëgjon?.. (*I afrohet*)

MARA — (*Shpërthen*) Hiqmu këtej! Hiqmu, po të them! (*Mirës*) Jo, jo të gjithë, por unë. Unë e para. Ju të tjerët nuk keni faj, unë, unë... Unë dhe ky njeri. (*Tregon Jasharin*) Prandaj filloj të më merrte me të mirë mua, pasi iku Filja, se kishte frikë mos dija gjë... dhe unë budallaqja i dola zot. (*Në drejtim të Jasharit*) Djall! Je djall!...

JASHARI — E marrë! Budallaqja e dreqit!... Nuk e di çfarë flet... Hajde, ka tjetër, tjetër... ka tjetër?

ZËRA — Jemi të gjithë ne!

— Edhe ne! (*Jashari bën të flasë*)

LEKA (*Rreptë*) Mjaft, tan! Mjaft! Të marrë fund kjo histori. (*Bërtet*) Shporreni këtej! Shporreni!... (*Hesh-tje. Gazetari lëviz nga vendi dhe del në paraskenë, ndërsa të tjerët kanë ngrirë*)

GAZETARI — Këta njerëz, me thirrjen e partisë, u ngritën në luftë, në luftën për revolucionarizm...

Ata nuk i ndal më asgjë. Ja, kështu, në kudhrën e revolucionit kaliten ata... Në këtë kudhër dërmohet edhe çdo gjë e huaj... Sepse kjo është një kudhër e atillë që o të shëron, o të pëlqet... Dhe kjo vazhdon... Dhe kjo do të vazhdojë... Letra e hapur dhe 6 shkurti ndezën tek ne një zjarr të ri, të pashuar...

F u n d

Pogradec, 30 Korrik 1967

H Y R J E

Shumë është folur, flitet edhe sot, për humanizmin. Për atë kanë folur mbretër dhe xhelatë, deri te fashistët e Hitlerit; për atë flasin vrasësit e popullit vietnamez, deri te Niksoni; për humanizmin flasin sot edhe revzionistët. Është folur për një humanizëm kristian, flitet shpesh për një humanizëm në përgjithësi, abstrakt, për këtë të fundit flasin edhe revizionistët sot, sado që zënë në gojë humanizmin socialist. Por ka me të vërtetë një humanizëm revolucionar socialist, me të cilin merret drama «20 ditë».

Jemi në ditët e fundit të pushtimit gjerman në Shqipëri. Armiku, i egër si gjithënjë, bën terror, ka minuar qytetin dhe kërkon ta hedhë në erë, artileria është vendosur në kodrat përreth dhe kërcënën qytetin, një kollonë e madhe gjermane po i afrohet qytetit. Ka një urdhër të Hitlerit: «Vetëm gërmadha të lini nga pas», këtë duan të bëjnë gjermanët edhe në Shqipëri.

Mirpo plani i tyre dështon, aksioni i vendosur partizan e shpëton qytetin. Vjen koha që armiqt, ata që i shërbyen pushtuesit të huaj, të japid llogari. Pikerisht në këtë kohë dalin njerëz dhe këshilltarë hipokritë, të cilët thërasin «jo kaq të ashpër... më të përbajtur... më njerëzorë... më paqësorë...». Kjo ka lidhje me akuzën që u është bërë dhe vazhdon t'u bëhet komunistëve dhe revolucionit të tyre socialist se janë të ashpër në përgjithësi. Oportunistët e të gjitha

kohërave, edhe revizionistët e sotëm, janë përpjekur e përpjigen ta justifikojnë tradhëtinë e tyre, duke shpallur «socializmin me fytyrë njeriu», duke bërë thirrje për të hequr dorë nga lufta e klasave, duke ngatërruar kështu gjithë përbajtjen e humanizmit të vërtetë socialist. Por heroi thotë në fund «le të na quajnë të ashpër... le të çiren sa të duan. Ky është dhe do të jetë revolucioni ynë deri në fund. Ne e themi këtë me zë të lartë: revolucioni ynë është dhe do të jetë i ashpër me armiqtë e revolucionit». Kjo është edhe ideja e dramës. Ky është edhe tingullimi i saj aktual, që flet për vazhdimësinë e revolucionit, demaskon edhe çdo zë që u ngrit dhe ngrihet, jashtë e brenda, kundër revolucionarizimit të gjithë jetës së vendit tek ne tanë.

Çdo përpjekje për të kërkuar histori dhe për të gjetur emocione «të embla» në dramën «20 ditë» ka lidhje ose me një moskuptim të historizmit në art, ose u ngjet thirrjeve «jo kaq të ashpër», kundër të cilave ngrihet drama. Heroi i dramës thotë «humanizmi ynë qëndron pikërisht edhe në ashpërsinë tonë me armiqtë». Edhe unë dua të përsëris bashkë me të se «humanizmi në artin tonë gjen shprehjen e tij pikërisht në luftën e ashpër që duhet të bëjë ai me armiqtë e revolucionit dhe ideologjinë e tyre». Siç dihet, disa herë, e kanë quajtur «të ashpër» artin tonë. Po, ne e themi hapur, është ca i ashpër ky arti ynë, sepse edhe ai bën luftë klase.

Personat veprues:

AGIMI	partizan, 26 vjeç
MEDIU	kafexhi, 50 vjeç
VJOLLCA	bija e Mediut, 20 vjeç
LECI	llustraxhi, 13 vjeç
QYTETARI I PARË,	
QYTETARI I DYTE,	
QYTETARI I TRETE,	
VASILI	i papunë, 40 vjeç
ZAIMI	komandant ballist, 30 vjeç
ZENULLAI	pronar tokash, 55 vjeç
RREMA	tregëtar, 55 vjeç
KAPITENI	oficer gjerman
TOGERI	SS gjerman.
PARTIZANË, BURRA DHE GRA, BALLISTË DHE USHTARË GJERMANË	

Ngjarjet zhvillohen në njëzet ditë, në një kafene, në një nga rrugët e qytetit. Skena është e ndarë në dy pjesë: brenda, nga e majta duken një banak, tri tavolina, karriga dhe, në ballë, një portë; jashtë, nga e djathita, të ndarë me xhame, duken tavolina dhe karriga të tjera të vendosura në trotuar.

Gjatë gjithë shfaqjes, në një formë ose në një tjetër, dëgjohet luftë. Nga tabloja në tablo skenës i shtohet ose i hiqet diçka, nga kafene ajo kthehet me radhë: në shtab, në kamp, në bunker, në barrikadë, etj. Në fillim të çdo tabloje zbret nga lart një tabelë që shënon ditët: «Dita e parë», «Dita e pestë», e këshiu me radhë.

DITA E PARE

(Mëngjez)

*Pa u hapur perdja, në paraskenë duken me radhë
Qytetari i parë (nga e majta), Qytetari i dytë (nga e
djathta) dhe Qytetari i tretë (në mes).*

QYTETARI I PARË — (*Drejtohet nga spektatorët*) Flitet se ky është fundi... Fundi i luftës, fundi i qytetit, fundi i gjermanëve, apo fundi i të gjithë neve, këtë s'di ta them akoma... Por, me sa duket, është me të vërtetë...

QYTETARI I DYTË — (*Nga spektatorët*) Fundi i qytetit, fundi edhe i të gjithë neve.

QYTETARI I TRETË — (*Nga spektatorët*) Jo!.. Është fundi i tyre: i gjermanëve dhe i tradhëtarëve...

QYTETARI I PARË — (*Qytetarit të dytë dhe të tretë*) Unë fola qartë: nuk di ta them akoma.

QYTETARI I TRETË — (*Qytetarit të parë*) E pra, duhet ta dini!

QYTETARI I DYTË — (*Nga spektatorët*) Kohë të turbullta.

QYTETARI I TRETË — (*Nga spektatorët*) Kohë heroike.

QYTETARI I PARË — (*Nga spektatorët*) Unë nuk di si të them.

QYTETARI I DYTË — (*Qytetarit të tretë*) Si thatë?

QYTETARI I TRETË — (*Qytetarit të dytë*) Heroike. Pse?...

QYTETARI I DYTË — (*Duke bërë disa hapa, u*

drejtohet spektatorëve) Heroike thotë!... Çudi me këta njerëz... E dinë çfarë thonë?... Tërë jetën jam marrë me këto punë dhe nga politika diçka marr vesh, por kështu nuk më ka ndodhur...

QYTETARI I PARË — (*Bën disa hapa edhe ai dhe u drejtohet spektatorëve*) «E, pra, duhet ta dini!...» — tha ai. (*Shikon nga qytetari i tretë, përsëri nga spektatorët*) E çfarë të di?! Unë kam qëndruar në një anë, jashtë politikës... Mirë ose keq... (*I duket se foli njëri nga spektatorët*) Keq?.. Dikush nga ju tha keq... Unë po them se kështu ka ndodhur...

QYTETARI I TRETË — (*Bën edhe ai disa hapa përvesh këta njerëz: njëri nuk di si të thotë, tjetri sheh turbullt...* Sa janë këta unë nuk e di... (*Qytetarit të parë*) C'bën ti për të parë më qartë? Në qoftë se nuk bën asgjë, nuk ke për të parë kurrë... .

QYTETARI I PARË — (*Qytetarit të tretë*) C'duhet të bëj?

QYTETARI I TRETË — (*Qytetarit të parë*) Shko të njerëzit, qëndro dhe jeto me ta.

QYTETARI I DYTË — (*Qytetarit të parë*) Lufto, vraj edhe ti!... (*Qytetarit të tretë*) Pse nuk ja thua edhe këtë?

QYTETARI I TRETË — (*Rreptë*) Po, vraj edhe ti armiq e tradhëtarë. Lufta i ka këto.

QYTETARI I DYTË — (*Qytetarit të parë*) E dëgjon?

QYTETARI I TRETË — (*Qytetarit të dytë*) C'do të thuash me këtë?

QYTETARI I DYTË — Fola një herë...

QYTETARI I TRETË — Pak më parë the se sheh turbull.

QYTETARI I DYTË — Unë nuk thashë asgjë. (*Del*)

QYTETARI I PARË — (*Pas pak, Qytetarit të tretë*) E njeh?

QYTETARI I TRETË — (*Qytetarit të parë*) Nga fytyra jo, kurse nga ato që tha e njoh mirë... (*Shikon në drejtimin nga doli Qytetari i dytë dhe i vete pas, Del edhe Qytetari i parë. Errësohet. Hapet perdja. Ako-*

ma nuk ka zbardhur mirë. Brenda, Mediu rregullon tavolinat. Në parashkenë, duket Agimi dhe Leci, të cilët shikojnë me kujdes vendin: përpara, prapa dhe nga kafenejá)

LECI — (Duke treguar me kokë) Atje në mes, te kryqëzimi i rrugëve, është bunker. Prej disa ditësh gjermanët punojnë edhe ditën, edhe natën.

AGIMI — (Duke shikuar në atë drejtim) E qartë... Kanë vendosur të rezistojnë... Dhe si vend nuk e kanë zgjedhur keq. (Shikon me vëmendje nga kafeneja dhe rrëth e rrotull)

LECI — Kurse në godinat përballë dhe në shumë të tjera kanë vendosur mina...

AGIMI — E di... Në momentin e fundit duan të hedhin në erë qytetin. Në kodrat përreth kanë vendosur artileri dhe këtu në qytet kanë vënë minat nga të katër anët. E kuption ç'bëhet?...

LECI — Atëhere?

AGIMI — Të shohim... (Lëviz pak në parashkenë)

LECI — Kur fillon sulmi?

AGIMI — Sot.

LECI — Po qytetin do ta hedhin në erë?

AGIMI — (Pas pak) Qyteti duhet të shpëtohet, ky është urdhëri. Për atë kam ardhur... (Duke shikuar nga kafeneja) Ky si i ka punët?

LECI — S'ka pak ditë që mori lajm për djalin...
E ke njohur?

AGIMI — Kemi qenë shokë... Bashkë kemi lufuar. (Shikon me vëmendje rrëth e rrotull) Shko tani, kaq desha...

LECI — Po ti?

AGIMI — Unë do të qëndroj këtej rrotull.

LECI — Në kafene?!...

AGIMI — Mbështet edhe në kafene, s'është ide e keqe... Lajmëro shokët se unë jam këtu.

LECI — Nuk e di sa do të jenë dakord me këtë:
ka plot rreziqe...

AGIMI — Tani shko... Dhe duku herë pas here...
LECI — Shokët do të më flasin.

AGIMI — Ata e dinë si është puna... (*Dëgjohen hapat e një patrulle gjermane*) Shko tani, shko!... (Agimi dhe Leci dalin. Hyn patrulla, e cila kalon. Hështje. Brenda, Mediu ka rregullur tavolinat. Pas pak hapan dritat dhe bëhet ditë. Jashtë ka njerëz. Në një anë Leci po i bën këpucët me bojë Ballistikit të parë, ndërsa Ballisti i dytë pret. Në një tavolinë janë Rremë me Dolfin dhe Zenullai, kurse në një tavolinë tjeter është Vasili, vetëm. Dëgjohet ndonjë krismë pushke e largët. Nga rruga vijnë zëra njerëzish dhe zhurma maqinash. Hyn Ballisti i tretë)

BALLISTI I TRETË — Hajdeni, se po mblidhen.

BALLISTI I DYTË — Ja, erdhëm.

LECI — Lustra, zotëri, lustra!.. (*Ballistikit të tretë*) Do t'i bësh këpucët me bojë edhe ti?..

BALLISTI I TRETË — Jo, jo... mirë i kam. (*Të tjerëve*) Tunduni de, tunduni!.. Kanë ardhur edhe maqinat. Nuk i shikoni?

BALLISTI I DYTË — (*Lecit*) Shpejt, more ti, mjaft ja lustrove, nuk do të shkojë në dasmë.

BALLISTI I PARË — Hë se ka kohë, akoma s'janë grumbulluar të gjithë... Pastaj, ti e di, komandanti ynë ka qenë oficer dhe nuk është si disa, ai kërkon që të gjithë të paraqiten në rregull. «Në luftë, thotë ai, duhet vajtur si në dasmë».

LECI — Shumë mirë e paska ky komandanti juaj... Po i keni parë si kthehen?..

BALLISTI I PARË — Nga lufta?

LECI — Unë thashë nga dasma, por njëlloj është, edhe nga lufta.

BALLISTI I DYTË — Léri llafet ti dhe luaj duart!

LECI — Ja, edhe pak.

DOLFI — (*Nga ana tjetër e kafenesë*) Baba, hajde të shkojmë në shtëpi.

ZENULLAI — Doli edhe tetori, zoti Rremë... Erdhi dimri...

RREMA — Erdhi, Zenulla, erdhi... Sa kemi sot? E kam humbur fare, as datat nuk i mbaj mend... Po edhe mirë, në këtë rrëmujë mund të harrosh edhe veten... S'po marrim vesh asgjë.

ZENULLAI — Mbrëmë kishin pushkatuar 10 veta.

DOLFI — Baba, hajde të shkojmë në shtëpi.

RREMA — (*Dolfit*) Fillove ti... (*Zenullait*) Luftë, Zenulla vëllai, luftë... (*Hyn Mediu, i cili u sjell nga një kafe Rremës dhe Zenullait*)

VASILI — (*Nga tavolina e tij*) Usta, më bjerë edhe një teke, tani për tani...

BALLISTI I DYTË — (*Ballistikë parë*) Më duket se do të nisemi bashkë me gjermanët... Kështu dëgjova mbrëmë, ma tha një...

BALLISTI I PARË — Aq më mirë. Se ç'kanë një hije të rëndë këta qerratenj. (*Dëgjohet një bilbil*)

BALLISTI I DYTË — Po na thërresin. (*Lecit*) Hajde shpejt!

LECI — Ja, mbarova. (*Ballistët paguajnë dhe din. Nga pas*) Kokën lënshi!...

RREMA — Nuk e di si do të vejë ky hall.

ZENULLAI — Zoti éshtë i madh.

VASILI — (*Mediut, që i sjell pijen*) Kujtova se nuk do të gjeja kafe të hapur sot.

MEDIU — Kot e hapa edhe unë, krejt kot...

VASILI — Po unë?! Ç'do të bëja unë atëhere?!. I zoti i shtëpisë më qiti jashtë: «nuk ke paguar qiranë, më tha, dil përjashta».

DOLFI — Baba, hajde të shkojmë në shtëpi.

RREMA — Ja, edhe pak. (*Larg dëgjohen pushkë*)

DOLFI — Baba, e di, një çun aty te rruga jonë më tha dje se partizanët do të vijnë edhe këtu. Më tha edhe këtë: «do t'i grijnë të gjithë gjermanët, do të të varin edhe ty».

RREMA — (*Reptë*) Sa herë të kam thënë të mos rrish me ata rrugaçë? Pse rri me ta?

ZENULLAI — E, more Rremë, nuk të lënë rehat disa horra, apo nuk i kanë ngritur veshët...

RREMA — Mirë thua, nuk të lënë rehat.

ZENULLAI — Veç mos na lëntë Zoti në dorë të tyre.

RREMA — Mirë thua, mos na lëntë...

LECI — (*Bërtet*) Hajde, lustra, lustra, zotëri!...

(*Zenullait*) T'ju bëj këpucët me bojë, zotëri?

ZENULLAI — Nuk ka nevojë.

LECI — (*Rremës*) Të t'i bëj ty, zoti Rremë?

RREMA — Ik, more, na lërë rehat!

LECI — Dolfi i paska për ibret! (*Dolfit*) Shiko si i ke bërë!

RREMA — Ik, tani, se na mërzite, hajde, zhduku!

DOLFI — (*Lecit*) Hë, pse më quan Dolfi tani dhe nuk më quan ashtu... apo pse jam këtu me babin tim?

RREMA — Pse, si të quan ky ty?

DOLFI — (*Lecit*) Hë, thuaje, thuaje, apo s'ta mban tani?

LECI — Llapush. (*Heshtje*)

RREMA — Si the? Llapush?! Po pse llapush?!

LECI — I ka veshët të mëdhenj, veshllapushi... Sa herë ja kam shkulur ata veshë, apo nuk i ka si parafango...

RREMA — Ik, more kopuk, shporru këtej... (*Nxehet*) Dhe dëgjo këtu: po e shave edhe një herë, ta këpus kokën. E more vesh!... Ik tani... (*Bërtet*) Ikë po të them!...

LECI — Po si ta quaj?

RREMA — Oj ky, si ta quaj! Me emër, ore, si të gjithë...

LECI — Po yt bir nuk ka vetëm një emër, zoti Rremë...

RREMA — Shih, shih, kopili... Po sa ka?

LECI — Po ja... (*Numëron me gishta*) Tre. Në kohën e merhumit, mamaja e tij e thërriste gjithnjë nga dritarja: «Dalip, hajde të pish qumështin me ka-

kao!» Kur erdhën italianët, ajo e thërriste: «Dino, hajde të pish qumështin me kakao!» Pasi erdhën gjermanët, filloj ta thërriste: «Dolfi, hajde të pish qumështin me kakao!»

RREMA — Shiko, shiko, kopili... E dëgjon, more Zenulla? (*Ngrihet dhe bën t'i bjerë*) Ik, more edepsëz, shporru këtej...

LECI — (*Duke u larguar*) Lustra, lustra, hajde lustra!..

RREMA — (*Duke u kthyer, i drejtohet Dolfit*) Fajin e ke ti.

DOLFI — (*Duke qarë*) Pse e kam fajin unë? Ai më shan gjithnjë!

RREMA — Të shan ai, shaje edhe ti. Ai të thotë llapush, ti i thuaj brekëgrisur.

DOLFI — Ai më rrëh.

RREMA — Po ti ku i ke duart? Bjeri edhe ti...

ZENULLAI — Po ti je goxha djalë, more Dolfi, mirë thotë babai, bjeri edhe ti... Bjeri fort, mu nië kokë, kështu e duan ata, kokës. Të mos e ngrenë kurrë atë kokë... (*Rremës*) Po është i vogël ai, o Rremë, s'e merr vesh këtë që themi ne... (*Kalon patrulla gjermane*)

RREMA — S'po e marrim vesh edhe punën e tyre, ç'kanë në mend të bëjnë. Pse nuk i godasin fort? Kokës, more, kokës... T'u shtypin atë kokë, si gjarpërit... (*Duke i rënë gjoksit me grusht*) Ah, plas moj zemër, plas! Ua thamë, sa herë ua thamë, na tanë...

ZAIMI — (*Duke hyrë bashkë me Ballistin e tretë dhe një tjetër. Është i veshur dhe i armatosur, gati për t'u nisur, i flet Ballistikit të tretë*) I thuaj të më sjellë një dopio konjak.

ZENULLAI — Nipçe, mirë mëngjezi!

ZAIMI — Ah, nuk ju pashë! Mirë mëngjezi!

ZENULLAI — Ulu, ulu këtu me ne, rri pak.

ZAIMI — (*Ulet*) Nuk kam kohë, vetëm pesë minuta (*Shikon orën*)

ZENULLAI — Po ç'ka ndonjë të re?

ZAIMI — Luftë, tani do të shohim ç'është lufta. Tym dhe flakë... Sa të dridhet edhe fëmija në bark të nënës.

RREMA — Në qytet e gjetën edhe këta të bëjnë luftë, mor zoti Zaim? I hëngri dreqi edhe ato dyqane dhe ato shtëpi, që ky shpirt e di (*i bie gjoksit*) si i kemi ngritur.

ZAIMI — Kokën, zoti Rremë, të shpëtoni kokën, pa dyqanet dhe shtëpitë vihen në vend përsëri.

ZENULLAI — Mirë thotë.

RREMA — (*Zenullait*) Flet kaluar zotrote, s'ke dyqane, ke toka ti. Ato nuk digjen edhe po t'u vesh benzinën.

ZENULLAI — (*Rremës*) Sa kanë mbetur edhe ato të shkreta. I ndërrojmë po deshe... (*Zaimit, avash*) Po ata englezët edhe amerikanët ç'thonë, pse s'ndihen?...

ZAIMI — Fjalë, fjalë boshe... Të paktën deri tani...

RREMA — Na plasën, e di ç'do të thotë na plasën?...

ZENULLAI — Duro, duro. Kështu e kanë ata, durojnë shumë...

ZAIMI — Shumë dhe tepër... (*Sheh Vasilin, i cili ja merr tingujve të një marshi*) Vasilii është ky? (*Vasilit*) Që pa gdhirë, o Vasil, që në mëngjez!...

VASILI — Në mëngjez bëhen punët e mira. Ja edhe ti që në mëngjez qenke veshur e qenke ngjeshur... Për ku kështu? Thonë se partizanët kanë ardhur deri poshtë, te teqeja... Do të vijnë edhe këtu...

ZAIMI — Si, ke nisur të merresh me politikë edhe ti?

VASILI — Kështu më thanë, që në mëngjez, sa dola. Thashë se punët e mira bëhen në mëngjez...

ZAIMI — (*Papritur*) Cilat punë të mira?

MEDIU — (*Duke i vënë përpëra konjakun*) Lëre Vasilin, ç'ke me të?

ZAIMI — Mirë mëngjezi!

MEDIU — Për ku kështu, udhëtim i sëkëlldisur...

ZAIMI — Nga ekuptove?

MEDIU — Nga dopio konjaku... Kur ke ndonjë hall ti porosit dopio konjak!

ZAIMI — Ke shumë konjak atje brenda?

MEDIU — Kam, pse? (*Kalon patrulla gjermane*)

ZAIMI — Do na duhet... Jo mua, atyre. (*Tregon patrullën gjermane*) Nuk tē lajmëruan pér kafenenë?

MEDIU — Jo, pse?

ZAIMI — E duan ata.

MEDIU — Përse?

ZAIMI — Që tē kenë një vend ku tē lagin grykën... (*Duke parë nga Vasili*) Edhe Vasili ka nevojë, besoj...

MEDIU — (*Prerë*) Vetëm pér këtë?

ZAIMI — Më tepër nuk di unë...

MEDIU — (*Prerë*) Folë, pérse e duan?

ZAIMI — Ti gjithmonë mendon se unë di çdo gjë aë bëinë ata.

MEDIU — Nuk do ta thuash...

LECI — (*Duke hyrë*) Lustra, hajde lustra!..

ZAIMI — (*Pér t'u shpëtuar pyetjeve tē Mediu*) Lustra, hajde këtu! (*Mediu largohet*) Do m'i bësh mirë!

LECI — (*Ulet dhe bëhet gati t'i bëjë këpucët me bojë*) Pasqyrë fare. Unë jam lustraxhiu më i mirë në qytet... Kështu më tha njëherë edhe një oficer gjerman kur i bëra çizmet me bojë. Bile kur e pyeta: «Kush éشتë lustraxhiu më i mirë në Berlin?» ai më tha: «Ti ja kalon edhe atij». Dhe me gjithë mend, jo vetëm i bëj tē shkëlqejnë si pasqyrë, por, pér t'u çuditur, i bëj edhe tē lehta. Hiç nuk i ndjen se i ke në këmbë... E t'i kesh sot këmbët tē lehta éshtë gjë e madhe... Eh, sikur tē më paguanin edhe pér këtë, do tē isha bërë milioner...»

ZAIMI — (*Që nuk e kish mendjen shumë*) Eh?!

ZENULLAI — Mos ja vërë veshin, more nipçe,..

Ka shumë llafe ky shejtan. (*Lecit*) Pusho, more kopil!

LECI — Unë zotëri nuk jam kopil, sepse ngjas shumë me babanë...

ZAIMI — Mjaft tani, mjaft se s'ta kam ngenë...

LECI — Punët e mira bëhen ngadalë, zotëri.

«Piano, piano, va lontano,» thoshte italianni. Këta (*bën me kokë pér gjermanët*) nuk e di si i thonë, mbasë e di zoti Rremë.

REMA — He, ç'na gjeti belaja me këtë djall!

LECI — (*Zaimit*) Unë, zotëri, dua t'ju kënaq që çizmet jo vetëm t'ju shkëlqejnë, por edhe të mos i ndjeni fare kur të egni ose të vraponi... Ja, do ta shikoni, këtu nuk jam lustraxhiu më i mirë i qytetit, më i mirë edhe se ai në Berlin.

ZAIMI — (*Gjithmonë pak i hutuar*). Në Berlin, çfarë në Berlin?

LECI — Fola pér lustrën, zotëri, e kam zanat.

ZAIMI — E ku e ke mësuar?

RREMA — Ja ka lënë trashëgim i ati... (*Qesh*)

LECI — Jo, im atë është karrocier, por edhe ai është karrocieri më i mirë i qytetit. Kur del ai me karrocë, të gjitha karrocat e tjera i shkojnë prapa. Babai im është karrocier i bashkisë, karrocier, që çon të vdekurit. (*Rremës*) Po të keni ndonjë nevojë pér karrocën e babait tim, më thoni mua... (*Zaimit*) Tjetrën.

ZAIMI — Çfarë?

LECI — Këmbën tjetër.

ZAIMI — Shiko, po llape më, do të hash një kështu (*i tregon shqelmin*) ose do të të shtyp si një krimb. (*Papritur shikon orën*) Djall, se më vonave... (*Del shpejt*)

LECI — Po paret, zotëri, paret... (*Ngrihet dhe afrohet pranë Vasilit*)

ZENULLAI — (*Rremës*) E vure re?

RREMA — Çfarë?

ZENULLAI — Nuk e kish mendjen fare, pothuaj fare... Si duket, punët janë keq.

RREMA — E vura re... Pse, nipçë e ke ti atë?

ZENULLAI — Jo bash nipçë, aty afër, por nipçë i them.

RREMA — S'na la edhe ai kopil të bënim dy llafe. (*Hyn Agimi, i cili afrohet te tavolina e Vasilit*)

AGIMI — (*Vasilit*) Mund të ulem?

VASILI — Ju lutem shumë... Për njerëz të mirë ka vend gjithmonë. Çfarë do pini?

AGIMI — (Duke qeshur) Nga e dini se jam njeri i mirë?

VASILI — (E shikon me vëmendje) Nga sytë. Dhëmbët tregojnë moshën e kafshës, sytë zemrën e njeriut. Ti ke një shikim të ëmbël, edhe zemrën e ke të mirë. (Ul zërin) Se mos na dëgjon njeri: shiko gjermanët, të egër i kanë sytë, të egër e kanë edhe zemrën. Ose shikoji ata atje, (tregon Rremën dhe Zenu-llain) sytë i kanë të vegjël, të vegjël i kanë edhe shpirrat... (Qesh fort) Ha... ha... ha!...

RREMA — (Zenullait) Ja filloj Vasili...

VASILI — (Rremës) Po flitnim për sytë... Po i thosha se edhe budallenjtë edhe të poshtërit nga sytë njihen...

RREMA — Rri, more ti, mjافت grive atje!

VASILI — Pse, ju thashë gjë juve, ju thashë gjë?... Megjithëse edhe mund t'ju kisha thënë... (Agimit) Çfarë do të pini? (Hyn Mediu) Usta, nga një konjak!

RREMA — (Mediut) Mos i jep tjetër dreqit, nuk di çfarë flet... (Mediu shikon pak rreth e rrrotull, ka filluar të shqetësohet)

VASILI — (Agimit) Mirë bëre që erdhe, kisha filluar të mërzitesha. Megjithëse thonë, ju lutem shumë... se vetëmia është shoku më i mirë... Shikon atje përtëj? (Bën me dorë)

AGIMI — Ku? (Mediu u sjell konjakun, shikon përsëri rreth e rrrotull, i shqetësuar)

VASILI — Ja, ja atje, në mes të sheshit. (Pi konjakun) Kanë hapur një gropë, kanë disa ditë... Për-se vallë?...

AGIMI — Që të fusin kokën, me sa duket...

VASILI — Shshsh! Mos të dëgjojnë ata. (Tregon Rremën dhe Zenullanë) Mirë e the... Për kokën kujdesen të gjithë tanë. Kokët janë bërë me shumë rëndësi, ke parë si u venë kokëve helmeta?... Ju lutem

shumë... Pse e kam kokën kaq të rëndë? Po ti pse nuk mban helmetë?

AGIMI — Po ti pse nuk mban?

VASILI — Unë mbaj, nuk e shikon?

AGIMI — Prandaj të rëndon kaq?

VASILI — Pesëdhjetë kile... Më falni, ju lutem shumë... sa ta çlodh pak... (*Mbështet kokën mbi tavolinë*)

DOLFI — Baba, hajde të ikim, u mërzita...

ZENULLAI — Zoti Rremë, po mendohesha, mba-se është më mirë të ikim gjëkundi... U pa kjo punë... Si thua, s'është keq të bashkoheshim disa familje dhe të largoheshim, në fillim nga qyteti... pastaj shohim dhe bëjmë...

RREMA — E di që nuk e ke keq ti, Zenulla...

DOLFI — U mërzita unë, hajde të ikim!

LECI — (*Agimit*) Ç'na u bënë ferrë edhe këta të dy, (*tregon Rremën e Zenullanë*) kanë që në mëngjerez...

AGIMI — I njeh?

LECI — Prit, se ua tregoj unë. (*Thërret*) Llapush, u mërzite?

RREMA — Prapë ti?!. Pusho, more rrugaç!

VASILI — (*Duke u zgjuar*) Kush tha rrugaç?

RREMA — Nuk të thashë gjë ty, nuk e pata me ty.

VASILI — Po e kam unë me ty... Ti më the rrugaç, po unë si të të them? Ballist, ja, të mjafton? Ju njoh mirë unë, kujtoni se nuk ju njoh...

RREMA — (*Ngrihet dhe bën të afrohet nga Vasili*) Me kë flet kështu, more?...

AGIMI — (*Ngrihet edhe ai*) Ulu, more aty, ulu po të them!...

RREMA — (*Duke treguar Vasilin*) Nuk e dëgjon?

AGIMI — Po ti nuk e shikon? Me këtë do të zihesh?!

ZENULLAI — (*Rremës*) Lëre, ç'ja zgjat akoma... Ikim më mirë...

RREMA — (*Zenullait dhe Dolfit*) Të ikim!... Ngreu të ikim!... (*Hedh disa para mbi tavolinë dhe dalin*) Karroca, hajde karroca!...

VASILI — (Agimit) Shiko, shiko si t'u ndryshuan sytë! .. Sa të egër t'u bënë!.. Çudi!.. Unë jam nga Pogradeci. Ne atje kemi një liqen, eshtë shumë i burkur, ai ndryshon ngjyrë disa herë në ditë, tanë e shikon të qetë dhe me ngjyrë blu të hapët, pas pak fillojnë dallgët dhe bëhet i murmë. C'pate? Kaq i urren ti ata? (Kalon patrulla gjermane) Shshsh... po kalojnë ata me helmeta në kokë... (Pas pak, Agimi ngrihet dhe shikon me vëmendje andej nga bunkeri)

LECI — (I afrohet) Gjermanët po zenë të gjitha godinat kryesore. Kamionët sjellin ushtarë, armë dhe disa arka...

AGIMI — Minat, nga njëra anë, artileria në kordonat përreth, nga ana tjetër, dy të këqia bashkë. Plani eshtë vërtet djallëzor... Po atje te bunkeri, c'bëhet?

LECI — Nuk afrohesh dot.

AGIMI — Provo edhe një herë! (Leci bën të dalë)

VASILI — (Lecit) Mos humb, eja prapë!.. (Leci del. Agimi kthehet pranë Vasilit)

AGIMI — (Vasilit) Shko në shtëpi tanë, pse nuk shkon në shtëpi?

VASILI — Nuk kam shtëpi unë, i zoti i shtëpisë më nxori jashtë «s'ke paguar qiranë, më tha, dil përjashta!..»

AGIMI — Ku punon?

VASILI — Asgjékundi, pa punë. Jam nga ata njëzet pa fat unë... Punoja në një sipërmarrje, por më pushuan. Kam qenë edhe në bandën e bashkisë, (kappingujt e një marshi) nuk pranova t'i bie himnit fashist dhe më nxorën jashtë, më mbajtën edhe gjashtë muaj në burg...

AGIMI — Po tanë ç'bën?

VASILI — Ja, si më shikon... Kam ca miq... (Duke parë nga Mediu) Burrë i mirë ky Mediu, shpirt njëriu... (Hyn Qytetari i parë, i cili ulet në një tavolinë dhe, pas tij, Qytetari i dytë, i cili qëndron në këmbë, duke lexuar gazeten)

QYTETARI I PARË — Usta! (Vjen Mediu) Një kafe, të lutem.

QYTETARI I DYTË — (Pa i hequr sytë nga gazeta) Edhe mua. (Mediu shkon te tavolina ku ishin Rrema dhe Zenullai, merr paratë dhe pastron vendin)

QYTETARI I PARË — (Mediut) Edhe një «Diamant» (Mediu hyn brenda. Ndërkaq qytetari i dytë ulet te tavolina që pastroi Mediu dhe vazhdon të lexojë gazetën)

VASILI — (Qytetarit të dytë) Gazetën lexon a?!

QYTETARI I DYTË — (Duke vazhduar leximin) Po, gazetën.

QYTETARI I PARË — Ç'ka ndonjë të re?

QYTETARI I DYTË — Rrëmujë, e di ç'do të thotë rrëmujë?..

QYTETARI I PARË — Thonë se sot në mëngjez partizanët filluan mësymjen përmarrjen e qytetit...

QYTETARI I DYTË — Edhe kjo duhet...

QYTETARI I PARË — Të jetë e vërtetë?

VASILI — (Papritur) E vërtetë...

QYTETARI I PARË — Nga e dini ju?

VASILI — Deri sa thonë... (Agimit) S'është këshfu?

AGIMI — Po, e vërtetë...

VASILI — Tani morën fund.

QYTETARI I PARË — Kush?

VASILI — Ushtarët me helmeta... (Kalon patru-lla gjermane)

QYTETARI I PARË — (Qytetarit të dytë) Nuk na the, ç'ka ndonjë të re?

QYTETARI I DYTË — (Pas pak) Ja... (Lexon me zë të lartë) «Durimi i fuqive të armatosura gjermane mori fund...»

VASILI — Kush u tha të vinin...

QYTETARI I DYTË — (Për të parën herë ngre kokën dhe i drejtoret Vasilit) Shkruan këtu. (Tregon gazeten. Përsërit) «Durimi i fuqive të armatosura gjermane mori fund... (Vazhdon të lexojë me zë të lartë) «Natën, duke u gdhirë 21 tetor 1944, në një nga rrugët kryesore të qytetit u bë atentat i shëmtuar kundra një automjeti gjerman, viktimat e të cilit qenë oficerë dhe ushtarë gjermanë. (Duke i zgjatur fja-

lët) Sulme të tilla kanë ndodhur edhe herë të tjera. Është derdhur gjak gjerman...»

MEDIU — (*Duke hyrë, i jep kafenë dhe paqetën e cigareve Qytetarit të parë*) Urdhëroni. (*Pastaj i vë përpara kafenë Qytetarit të dytë*)

QYTETARI I DYTË — (*Vazhdon të lexojë me zë të lartë*) «Prandaj, si masa ndëshkimi, urdhëroj (*Mediu qëndron dhe afrohet të dëgjojë*) për sa vijon: 1) Lagja rrëth e përqark vendit të ngjarjes të shembet. 2) Njëqind të burgosur komunistë prej qytetit, që i përkasin rangut intelektual dhe që ndodhen në fushën e përqëndrimit të Prishtinës, të pushkatohen menjëherë për hakmarrje. (*Të gjithë dëgjojnë me vëmendje*) 3) Tetëdhjetë pjesëtarë të njohur të nacionalçlirimtares nga qyteti do të mbahen peng dhe, në rast të përsëritjes së atentateve kundër pjesëtarëve të fuqive të armatosura gjermane, do të varen publikisht. (*Hyn Qytetari i tretë, i cili duket sikur kërkon njeri, sheh Qytetarin e dytë, e njeh, i tërheq vëmendjen leximi dhe afrohet*) Shqiptarë! Fuqitë e armatosura gjermane kanë vendosur të marrin masa të çdo lloji kundër terrorit, duke u përgjegjur me kundërterror. Ndihmoni veten tuaj kundër terrorist, duke mos u dhënë çetave asnje strehim dhe duke lajmëruar me kohë preqatitjen e atentateve. Ai që nuk bën këtë, bëhet bashkëfajtor. Ai nuk mund të presë asnje mëshirë.»

QYTETARI I TRETË — Kush flet për mëshirë? .. (*E zë kolla, dhe i drejtobet Mediut*) Një caj, të lutëm.

QYTETARI I DYTË — Flitet këtu, në komunikatën e komandës gjermane. Është tekstuallisht kështu, ja, shikoje... (*Ja tregon*)

QYTETARI I TRETË — E kam të qartë... .

QYTETARI I PARË — Çfarë?

QYTETARI I TRETË — Përse mendojnë ata kur flasin për mëshirë... (*Duke shikuar nga Qytetari i dytë*) dhe përse disa njerëz përhapin psikozën e frikës?

QYTETARI I PARË — (*Qytetarit të dytë*) E sot me është?

QYTETARI I DYTË — (*Duke shfletuar një gazetë tjetër që ka në dorë*) Ja, kam këtu edhe të sotmen...

AGIMI — (*Duke ndërhyrë*) Dhe ashtu ndodhi me të vërtetë, njëqind veta u pushkatuan atje në kampin e Prishtinës.

QYTETARI I DYTË — (*Duke u kthyer nga Agimi*) Pra éshtë e vërtetë?!

AGIMI — Dhe pesëdhjetë të tjerë u pushkatuan mbrëmë këtu në qytet.

QYTETARI I DYTË — (*Lexon me zë të lartë në gazeten tjetër*) «Natën e 28-29 tetorit u sulmuani përsëri automjetet që transportonin të plagosur në qytet dhe u vranë dy ushtarë gjermanë, kurse dy të tjerë u plagosën. Për këtë iu vu zjarri një pjese tjetër të qytetit dhe u pushkatuan 50 veta që mbaheshin peng. Kjo masë u muar për haknarrje...» E firmos: «Komandanti i garnizonit të qytetit...»

MEDIU — Kriminel!..

QYTETARI I TRETË — (*Në fjalët e tij ka shumë nentekst në drejtim të Qytetarit të dytë*) Megjithëse flasin për mëshirë...

QYTETARI I PARË — Gjithë natën, mbrëmë, kanë rënë pushkë.

QYTETARI I DYTË — He, ç'do të shuhemi të gjithë!..

QYTETARI I PARË — Se mos e kemi në dorë që ta ndalojmë.

QYTETARI I DYTË — E pse të sulmojnë?! Ata për të ikur se për të ikur kanë... .

QYTETARI I TRETË — Derri do plumb, gjersatë ngordhë... .

QYTETARI I DYTË — Ashtu éshtë, ashtu... Po éshtë një kohë kjo, kur duhet menduar çdo hap. Kam hallin e qytetit... Thonë se kanë vënë mina në të katër anët dhe në kodrat përreth kanë vendosur artileri... Kështu që nuk shpëtojmë dot, në mos nga minat, nga artileria do ta pësojmë... .

QYTETARI I TRETË — Qyteti shpëton vetëm

me luftë... Duke ikur, me siguri ata do të përpinqen ta hedhin në erë. Kështu kanë bërë kudo...

QYTETARI I PARË — Veç po të kenë luajtur nga mendtë!..

QYTETARI I TRETË — Janë kriminelë, prandaj...

AGIMI — Ka një urdhër të Hitlerit: «Vetëm gërmadha të lini nga pas», kështu thotë urdhëri... Dhe këtë po bëjnë...

QYTETARI I TRETË — Prandaj nuk duhet ndejnur me duar lidhur.

QYTETARI I DYTË — Marrëzira...

QYTETARI I TRETË — Të mbrosh qytetin tënd, ti e quan këtë marrëzi?!

QYTETARI I DYTË — Për mua vetë lufta është një marrëzi.

AGIMI — Cila luftë?

QYTETARI I DYTË — Lufta në përgjithësi... Cilado luftë...

AGIMI — E pra, nuk ka luftë në përgjithësi...

QYTETARI I PARË — Kot sa lodheni... Ajo që është nisur, do të bëhet... (*Duke u shkëputur nga të tjerët, drejtohet nga spektatorët*) Na pyeti njeri ne, kur më 7 prill, atë të premte të zezë të 1939-s ushtri-të fashiste kaluan Adriatikun dhe shkelën tokën tonë? Apo më vonë, në shtatorin e 1943-së, kur vendin e italianëve e zunë gjermanët? Jo. Atëherë?! Njerëzit janë të pafuqishëm, si ndaj të keqes, ashtu edhe ndaj të mirës. Në mëngjez lind, në mbrëmje perëndon... Pas jetës, vjen vdekja... Ja, kështu... Duam, s'duam ne, kështu ndodh...

QYTETARI I DYTË — (*Duke bërë disa hapa përpara, drejtohet nga spektatorët*) Unë them: ç'duhen atentatet këto ditë? Po e paguajmë shtrenjtë: një me dhjetë, me njëzet, me pesëdhjetë. Në qoftë se fillon lufta, si thonë, ky do të jetë fundi. Ata do të zemërohen... një të shkelur sustën dhe çdo gjë mbaroi... Ç'është nevoja?... Ata për të ikur se për të ikur kanë... Llogaria është krejt e thjeshtë: dy e dy bëjnë

katër. Kjo botë është ndërtuar mbi llogarinë, mate dy, pesë, shtatë herë, pastaj prite. Shiko përpara, majtas e djathtas dhe shko nga të bie më mirë. Nuk them një gjë të re, njerëzit me mend kështu kanë bërrë gjithnjë, dhe bëjnë... Dhe mirë bëjnë...

QYTETARI I TRETE — (*Duke u drejtar edhe ai nga spektatorët*) Në të gjitha rastet, me armikun ka vetëm një gjuhë: atë të luftës. Mos prit që ai të bëhet zemërgjerë... Kot gënjen veten dhe të tjerët. (*Duke treguar Qytetarin e dytë*) Sepse ka edhe të tillë... (*Bërtet*) Përralla, të gjitha janë përralla! Në luftë nuk ka mëshirë. Përkundrazi, po të kuptoi se je i dobët, më keq akoma. Kot nuk i ka vënë minat dhe artillerinë atje në kodrat, ai ka vendosur ta shkatërrojë qytetin. Prandaj ka vetëm një rrugë: atë të luftës. Vëtëm me luftë, s'ka rrugë tjetër... (*Mediut*) S'është kështu?

MEDIU — Si, kështu?

QYTETARI I TRETE — (*Agimit*) Ti si thua?

AGIMI — Kur je ballë për ballë me armikun ndodh njëra nga të dyja: o ja heq kokën, o ta heq.

VASILI — (*Papritur*) E drejtë, shumë e drejtë!... Ja, sa të egër t'u bënë sytë përsëri... (*Ngrihet dhe i afrohet Qytetarit të dytë*) Nuk është ashtu si thua ti... Të më pyesësh pse, nuk di ta them... Nuk ta them dot, por nuk është ashtu si thua ti... Nuk është, dhe mbaroi. (*Largohet nga ai dhe bën të dalë*)

MEDIU — Dale, prit! Ku shkon?

VASILI — Po dal. Pse, nuk bën?.. Ah po, do paret... Do t'i sjell, do t'i sjell... Ashtu si edhe t'i kam sjellë...

MEDIU — E kisha për ty. Nuk bën të dalësh rrugëve kështu...

VASILI — Kam nië mik, do të vete tek ai... (*Qytetarit të dytë*) Vëre këtu në kokë, (*vë gishtin në kokë*) nuk është ashtu si thua ti... (*Agimit*) Prapë t'u bënë të egër sytë, pse? (*Duke i shtrirë dorën*) Mirëupafshim, djalçsh, mirëupafshim në qytetin e lirë!...

QYTETARI I PARË — Si tha: në qytetin e lirë?!

QYTETARI I TRETË — Mirë e tha, në qytetin e lirë dhe në Shqipërinë e lirë.

QYTETARI I DYTË — E lirë!... E pastaj?

QYTETARI I TRETË — Si pastaj?!...

QYTETARI I DYTË — Po ja: ç'do të ndodhë pastaj?

MEDIU — Vërtet, ç'do të ndodhë? Ç'do të bëhet pastaj? Kjo është një pyetje që e bën sot cilido...

QYTETARI I PARË — E thjeshtë. Ishte Zogu, erdhën italianët. Ikën edhe këta, erdhën gjermanët. Tani po u vjen fundi edhe këtyre, mbase do të vijë përsëri Zogu.

QYTETARI I TRETË — Zogu?!. Në asnje mënyrë.

QYTETARI I PARË — (Qytetarit të dytë) Ti si thua?

QYTETARI I DYTË — Kështu mbase jo... Zogu si zor të vijë përsëri.

QYTETARI I TRETË — As Zogu, as soji i tij.

QYTETARI I DYTË — Diçka, pra, do të ndryshojë. Çështja është: çfarë, sa dhe qysh. Veç, të them të drejtën, unë i trembem anarkisë, ku s'e merr vesh deni të zotin.

QYTETARI I TRETË — Ti u trembe shumë gjë-rave... Sidoqoftë, kësaj here nuk është fjala as për Zogun, as për disa ndryshime...

QYTETARI I DYTË — E përse atëhere?

QYTETARI I TRETË — Për një përblysje... E di ç'do të thotë përblysje? Do të thotë: ato që janë lart bien poshtë dhe ato që janë poshtë ngrihen lart. Me një fjalë këtij i thonë...

AGIMI — Revolucion.

QYTETARI I TRETË — Po, revolucion. E dini ç'do të thotë revolucion?..

QYTETARI I PARË — E kam dëgjuar: pa qeveri dhe pa mbret...

QYTETARI I DYTË — Revolucionet mbyten në gjak, prandaj larg këtyre fjalëve. Sa më larg... Në përgjithësi unë jam kundër dhunës...

AGIMI — Dhuna me dhunë mundet. Historia kë-të ka provuar...

QYTETARI I DYTË — Historia e luftrave... E thashë edhe një herë: lufta është e keqe...

AGIMI — Jo në të gjitha rastet.

QYTETARI I DYTË — Ju arësyeton i nё një mënyrë të çuditshme!

AGIMI — (*Shpërthen*) Sepse nuk arësyetohet kështu: lufta është e keqe, të vrasësh është keq. Duhet parë kush lufton dhe përsë vret...

QYTETARI I DYTË — Për mua ai që vret është fajtor.

AGIMI — Për mua nuk ka fajtore nё përgjithësi, ka fajtor konkret. (*Dëgjohet zhurmë, vijnë ushtarë dhe oficerë gjermanë. Ndërsa oficerët hyjnë brenda dhe, pas pak, mbi një tavolinë hapin një hartë, dy ushtarë dhe SS-i u afrohen qytetarëve, Mediut dhe Agimit*)

SS-i — Leternjoftimet! (*Pasi shikon me radhë leternjoftimet e Qytetarit të parë, të Qytetarit të tretë dhe të Qytetarit të dytë, drejtohet nga Mediut*) Ti!

MEDIU — Jam kafexhiu.

SS-i — (*Mediut*) Jo ti, tjetri... (*Agimit*) Po, ti, ty po të them!..

AGIMI — Unë jam i biri. (*Mediu habitet nga përgjegjja e tij, por e mbledh veten*)

SS-i — (*Mediut*) Është yt bir?...

MEDIU — Po, zoti oficer.

SS-i — (*Bërtet*) Të gjithë të tjerët të largohen. (*Mediut*) Ti, dhe (*Agimit*) ti, qëndroni. Do të kemi nevojë. Gjithë të tjerët të largohen. (*Mediut dhe Agimit*) Pritni pak këtu përjashta. (*Të tjerët largohen. SS-i hyn brenda dhe bashkohet me të tjerët. Mediut dhe Agimi kanë mbetur nё një qoshe, ndërsa dy ushtarë gjermanë patullojnë, duke hyrë dhe duke dalë herë majtas, herë djathtas*)

MEDIU — (*Pasi është larguar patrulla*) Cili je ti pse the se je im bir?

AGIMI — Ta them më vonë.

MEDIU — Një djalë që kisha, ai m'u vra.

AGIMI — E di. (*Kalon patrulla dhe ata heshtin pak*)

MEDIU — Doli partizan dhe atje u vra. Nuk më pyeti fare kur iku... Pér këtë më erdhi keq... (SS-i atje brenda, shkëputet nga të tjerët dhe bën të hapë portën përballë, por e gjen të mbyllur. Del jashtë dhe i drejtohet Mediut)

SS-i — Hej ti, më jep pak çelësin e asaj dhomës përballë.

MEDIU — (Duke i dhënë çelësin) Më falni, por unë nuk jam i zoti i kafenesë. Pronari i saj nuk ndodhet këtu...

SS-i — (Bërtet) Të pakta fjalët!...

NJË USHTAR — (Duke hyrë, ka në duar tela dhe telefona, i drejtohet SS-it) Erdhëm ne, zoti toger, ku t'i vendosim?

SS-i — Ku janë të tjerët?

USHTARI — Po vijnë pas...

SS-i — (Ushtarëve) Hyni brenda! (Pas tyre hyn edhe SS-i. Mediu dhe Agimi kanë mbetur te porta. Patrulla shkon e vjen. Ndërkohë vijnë ushtarë të tjerë gjermanë, të cilët sjellin tela me gjemba dhe kalojnë nëpër skenë)

MEDIU — Ç'kanë në mend të bëjnë këtu?

AGIMI — Dale të shohim.

MEDIU — Po kafenenë pse ta duan?

AGIMI — Si duket, pér të humbur gjurmët. (Kalon patrulla. Ata heshtin pak)

MEDIU — Përgjegju, pse the se je im bir?

AGIMI — Po si të thosha ndryshe? .. Nuk kisha letërnjoftim.

MEDIU — Si nuk kishe?

AGIMI — Ja që nuk kisha.

MEDIU — Nuk e di ti se është e rrezikshme të qarkullosh pa letërnjoftim?!... Sidomos sot... Apo nuk janë të egër këta djaj. Të pushkatojnë në vend. Nuk e di ti këtë? (Kalon patrulla. Ata heshtin pak)

AGIMI — E di.

MEDIU — Po ç'do t'u tregoje?

AGIMI — Këtë. (Nxjerr revolen)

MEDIU — (Shqetësohet) Po sikur unë të thosha:
«Jo, nuk është im bir?»

AGIMI — Pse nuk e thatë?

MEDIU — As unë nuk e di...

AGIMI — Ju nuk mund ta bënë këtë... (*Kalon patrulla. Ata heshtin pak*)

MEDIU — Pse nuk mund ta bëja, nga frika?

AGIMI — Jo, unë ju njoh juve, prandaj...

MEDIU — Unë nuk ju njoh, nuk ju kam parë ndonjëherë.

AGIMI — Kjo nuk ka ndonjë rëndësi. (*Vijnë disa ushtarë të tjerë gjermanë, janë xhenierë, ata sjellin ca aparatura dhe hyjnë brenda. Kalon patrulla*)

MEDIU — Merr gjë vesh ti?

AGIMI — Diçka po filloj të marr vesh.

MEDIU — Sigurisht kjo ka lidhje me luftën, që filloj sot në mëngjbez.

AGIMI — Me luftën dhe me qytetin. Ata (*tregon ushtarët që hynë brenda*) ishin xhenierë.

MEDIU — E pastaj?

AGIMI — Dhe ato që mbanin në duar ishin apane për plasjen e minave. Pra këtu... (*Kalon patrulla*)

MEDIU — Nuk më the akoma, kush je ti?

AGIMI — (*Papritur*) Një partizan.

MEDIU — Një partizan?!...

AGIMI — Po.

MEDIU — E ç'do këtu, more djalë? Nuk e shikon se kam boll telashe edhe pa ty?

AGIMI — E shikoj.

MEDIU — Ik, të lutem!... Do të marrësh në qafë veten dhe mua...

AGIMI — Tani ka shumë arësy që nuk duhet të ikë.

MEDIU — (*Kalon patrulla*) Djalosh, e di çfarë flet? Kio lodër është plot rrreziqe.

AGIMI — Për mua kjo nuk është aspak një lodër.

MEDIU — Sidoqoftë, është plot rrreziqe.

AGIMI — Unë një luftëtar jam: atje në front cse këtu në prapavijë, për mua është njëlloj.

MEDIU — Për ty mbapse është njëlloj...

AGIMI — Harrova, pér ju nuk éshtë.. .

MEDIU — (Prerë) Nuk desha të them këtë. (Rrep-të) Je i ri dhe nxitohe. Nuk më pëlqeijnë gjérat pa mend... .

AGIMI — (Papritur) E keni të lehtë, u thoni se nuk jam djali juaj dhe... (Kalon patrulla)

MEDIU — Po të mos ishte kjo patrulla, do të bija me shputë.

AGIMI — Pse?

MEDIU — Jeni pak të sjellshëm ju.

AGIMI — Nga e nxirrni këtë?

MEDIU — Nga ti dhe nga ai që u vra atje, partizan. Kështu ishte edhe ai.

SS-i — (Duke dalë te porta) Hej, ju! Ejani brenda tani! (Kthehet te të tjerët)

MEDIU — Na thërresin.

AGIMI — Shkoni dhe u thoni se nuk jam djali juaj.

MEDIU — E meriton me të vërtetë një shputë. Unë thashë «na thërresin». (Duke hapur portën) Futu! (Hynë brenda)

SS-i — (Mediut) Dëgjo këtu ti, xhaxho: përveç këtij çelësi, pér këtë dhomën këtu ke çelës tjetër?

MEDIU — Jo, zoti oficer.

SS-i — Kjo dhomë do të na duhet neve, (duke ngritur zérin) e more vesh??!

MEDIU — Mbështet ju duhet gjithë kafeneja?..

SS-i — Jo... ose më mirë po, na duhet. Por ajo nuk do të mbyllët as ditë as natë. Edhe njerëzve do t'u shërbeshet njëlloj, sidomos këtu jashtë. Kjo gjendje do të vazhdojë deri sa neve të na duket e arësyeshme.

MEDIU — Por, zoti oficer, po të jeni ju këtu, të tjerët nuk do të vijnë, ju e kuptioni edhe vetë... .

SS-i — Në mos ardhshin, do t'i sjellim ne... Kafeneja duhet të qëndrojë hapur dhe ju duhet të qëndroni këtu. Mund të dilni prej këtej vetëm me lejen tonë. U kuptuan tani?... Edhe një porosi: sa më pak

fjalë. Për dyshimin më të vogël, e shikoni atë shtyllë atje? (*Tregon me dorë një shtyllë telefonit në rrugë*)

— Bie perdja —

DITA E PESTË

(*Ditë*)

Kur hapan dritat, brenda janë Mediu dhe Agimi, i pari te banaku, i dyti shikon me vëmendje përjashta dhe është i menduar.

OFICERI — (*Duke hyrë, i pasuar nga SS-i*) Të pushkatohen, të pushkatohen të gjithë!... Çdo oficer ka dorë të lirë pér këtë, bile edhe çdo ushtar... (*Është afruar te banaku dhe i drejtohet Mediut*) Një konjak. (*Mediu i mbush një konjak*)

SS-i — Dilni pak nëpër qytet, zoti kapiten, do të mjaftonin vetëm dhjetë minuta pér t'u bindur...

OFICERI — Isha dhe pashë... Prandaj po flas kështu. Toger, të them të drejtën, mbeta i pakënaqur...

SS-i — Në qoftë se ju kuptova, zoti kapiten, ju mendoni...

OFICERI — Unë nuk mendoj, unë urdhëroj... Ju thashë edhe një herë: keni dorë të lirë.

SS-i — Kaq desha edhe unë... Ju falemnderit.

OFICERI — (*Pasi pi gotën me konjak*) Edhe një tjetër.

MEDIU — (*Duke i mbushur gotën*) Flitet se do të hidhet në erë gjithë qytetin, është e vërtetë?!

OFICERI — Gërmadhë do të bëhet, e di ç'do të thotë gërmadhë? Në qoftë se partizanët do të vazhdojnë kështu si e kanë nisur...

MEDIU — Ç'faj ka qyteti, zoti oficer?..

OFICERI — Atë mos ma thoni mua. (*Jashtë, di-ku larg dëgjohet luftë*) Shkoni e u thoni atyre. (*Bën me dorë për partizanët*)

MEDIU — Ne jemi këtu dhe ata janë atje... .

OFICERI — Kur nuk mendojnë ata për qytetin e tyre, pse duhet të mendojmë ne?! (*Papritur*) Ky djaslosh se si më duket me këtë heshtjen e tij. (*I afrohet Agimit*) I patë ata të pushkatuarit në qytet?

AGIMI — Jo.

OFICERI — Ju këshilloj t'i shikoni.

AGIMI — Vetë na keni ndaluar të lëvizim që këtej...

OFICERI — Po atë shtyllën atje e shikon? (*Shikojnë në drejtim të shtyllës, që është përjashta, në rrugë*)

AGIMI — Atë e kam të qartë.

OFICERI — Dhe mos kujto se fola ashtu kot! ..
(*E shikon përsëri nga kreu deri te këmbët*)

MEDIU — Nuk doni një kafe, zoti oficer?

OFICERI — (Duke u kthyer nga ai) Nuk thua keq.

MEDIU — Si e doni, ekspres apo nga ato të vendit.

OFICERI — Ju shqiptarët e pini shumë kafen, s'është kështu?...

MEDIU — Kështu thonë... .

SS-i — Dhe e pinë të fortë.

OFICERI — Si të fortë?... Ç'do të thotë kafe e fortë?

AGIMI — I shtiem shumë kafe dhe pak sheqer.

OFICERI — Po ajo është e hidhur!

MEDIU — Si e doni, zoti oficer, të hidhur?

OFICERI — Jo, e dua ekspres, sheqerin ja shtie vetë.

SS-i — Unë e dua të hidhur, si shqiptarët... .

OFICERI — Jeni mësuar, duket... . Keni kohë në Shqipëri?

SS-i — Që ato ditë kur kapitulloi ish-aleatja jonë. Kam qenë edhe më parë, disa herë, nga 1936 deri më 1938, si turist...

OFICERI — Në Rusi keni qenë?

SS-i — Po, kam qënë.

AGIMI — Në Stalingrad?

SS-i — (*Duke u përbajtur*) Jo, në dyert e Moskës... Atje u plagosa. Kam qenë edhe në Poloni, në luftë me partizanët...

MEDIU — (*Duke u vënë përpara filxhanet me kafe, i drejtohet Agimit*) Jepu ujë zotérinjve oficerë... (*Ai bën t'u sjellë dy gota ujë me tabaka, por pengohet dhe gotat bien përtokë me zhurmë*)

SS-i — (*Duke nxjerrë revolen*) C'djall je ti? Djalë kafexhiu dhe nuk di të sjellësh dy gota me ujë. (*Jashtë, diku larg, dëgjohen të shtëna me artileri*)

MEDIU — (*Ngatérrohet pak*) Puna në kafene nuk i ka pëlqyer kurrë. Më parë nuk ka punuar ndonjëherë, prandaj...

SS-i — Duket... (*Bie telefoni në dhomën përballë. Shkon SS-i, i cili, pas pak, del te porta dhe i drejtohet kapitenit*) Zoti kapiten, ju kërkojnë në telefon!

OFICERI — Erdha. Një minutë... (*Pi kafenë shpejt dhe del. SS-i gjithashtu e pi kafenë shpejt dhe bën të dalë*)

MEDIU — Si ju duk kafeja, zoti toger? Nuk më thatë!..

SS-i — (*Qëndron pak, e shikon në sy*) Ç'ka... (*Del*)

MEDIU — Të falemnderit. (*Nga pas*) Zeher t'u bëftë. (*Agimit*) Dhe ty, djalosh, nuk të duhen gjë londrat. E more vesh?

AGIMI — Do ta kem parasysh...

MEDIU — E bëre me qëllim, e pashë unë... Në qoftë se nuk përbahesh dot, të ikim më mirë...

AGIMI — Jo!

MEDIU — Atëhere mos bën marrëzira.

AGIMI — Do të përpinqem.

MEDIU — Edhe ti kokën e atij ke, një kokë keni... Të gjithë kemi qenë të rinj, por jo kështu si ju.

AGIMI — Pse, si jemi ne?

MEDIU — Jeni fare, s'doni t'ja dini pér asgjë. (*Shpërthen*) Çani e ikni malit dhe as që pyesni pér prindërit... Tani e kuption? (*Hyn Vjollca*)

VJOLLCA — Baba, u bëmë merak, prandaj erdha... (*Sheh Agimin* dhe e përshëndet me kokë. Këtë e vë re Mediu)

MEDIU — (*Vjollcës*) Ti e njeh?... (*Ajo nuk përgjigjet*) Folë, e njeh?! Folë, po të them, e njeh?!

AGIMI — (*Duke ndërhyrë*) Kam harruar t'ju them: me djalin tuaj, Skënderin, kemi qenë shokë.

MEDIU — (*Vjollcës*) E kam me ty, po të pyes: e njeh?...

VJOLLCA — Ashtu është: me Skënderin kanë qenë shokë...

MEDIU — (*Agimit*) Në shkollë?... Në një klasë?..

AGIMI — Jo, unë nuk kam qenë në shkollë. (*Vjollca i jep një letër Agimit*)

MEDIU — (*E sheh, por përbahet*) E mora vesh. (*Vjollcës me inat*) Ti pse erdhe këtu? Pse?... Kush të lajmëroi?... (*I kthehet Agimit*) Kurse ti, shko tani, shko! (*Agimi bën të flasë*) Shko po të them, shko në punën tënde!

VJOLLCA — (*Duke dalë përparrë Agimit*) Baba, të lutem, mos...

MEDIU — Mos, çfarë... Të mos e tregoj tek ata? (*Bën me dorë pér gjermanët*) Atë jo, nuk e bëj... (*Agimit*) Mos u bën merak... (*Shpërthen*) Por këtu s'ke se ç'bën më... Unë vura në rrezik çdo gjë... Dhe jam gati përsëri... Por atë (*tregon Vjollcën*) jo, atë jo!... (*Jashtë dëgjohen gjithmonë të shtënat me artilleri dhe luftë, të cilat vazhdojnë me ndërprerje. Hyn SS-i dhe Mediu e hedh fjalën gjetkë*) Sa herë të kam thënë! Ke parë ti kështu?

SS-i — Ç'është gjithë kjo zhurmë?

MEDIU — Qërtova... djalin...

SS-i — Ah!... Babai qërton djalin e pabindur...
(*Shikon Vjollcën*) Po kjo kush éshtë?

MEDIU — Éshtë ime bijë, zoti toger... Për pak do të shkojë.

SS-i — Interesant! (*E shikon me vëmendje*) Po, kjo me të vërtetë ju ngjet... kurse djali jo, hiç fare...

MEDIU — Thonë se vajzat ngjasin më shumë nga babai, ndërsa djemtë shtien nga nënë.

SS-i — Ashtu?! S'e kisha dëgjuar këtë... (*Papritur*) Përse e qërtuat djalin?

MEDIU — Punë familiare.

SS-i — Kurrë nuk më kanë pëlqyer skenat dramatike familjare. Bile edhe Ibseni nuk më ka pëlqyer, pikërisht pér këtë. (*Papritur*) Po pse ka ardhur vajza? Ti e thirre?

MEDIU — Jo! Por u bënë kaq ditë sot, prandaj...

SS-i — Çfarë prandaj?... (*I afrohet Vjollcës*) Hape! (*Tregon çantën, që ajo mban në dorë, e kontrollon*)

MEDIU — U bënë merak dhe erdhi të më shikojë...

SS-i — (*Afrohet te Mediu*) Shiko ti, xhaxho, shkarat nuk i kam qejf, aq më pak gënjeshtrat...

MEDIU — (*Duke shikuar nga Agimi*) Edhe unë, zoti toger...

SS-i — (*E shikon gjatë në sy, pastaj qetësohet*) Më thoni atëhere, veç këtyre keni tjetër: djalë, vajzë, vëlla, motër?... Ta marr vesh një herë e mirë: keni tjetër?... (*Jashtë dëgjohet zhurmë. Ushtarët kanë sjellë disa qytetarë dhe, duke i shtyrë, i mbledhin përpjara kafenesë. Hyn një ushtar*)

USHTARI — (*Pasi paraqitet*) Erdhëm, zoti toger!

SS-i — Mirë. (*Duke shikuar jashtë*) Si pak më duken.

USHTARI — Po vijnë edhe të tjerë. Janë pas.

SS-i — Pritni pak aty. (*Shikon te dhoma përballë, Ushtari del jashtë*)

MEDIU — (*Duke shikuar njerëzit jashtë, u drejt tohet Agimit e Vjollcës*) E shikoni ç'bëhet?... I shikoni ata atje? (*Tregon njerëzit jashtë*) I shikoni?... (*Jashtë në mes të të tjerëve, janë edhe Qytetari i parë dhe Qytetari i dytë*)

VJOLLCA — (*Agimit*) Pse t'i kenë mbledhur?

AGIMI — Dale, ta marrim vesh. (*Sjellin edhe të tjerë, me të cilët edhe Qytetarin e tretë*)

QYTETARI ME PARDESY — Ç'duan të na bëjnë?

QYTETARI ME KASKETË — Të shohim...

QYTETARI ME PARDESY — Mos do të na internojnë...

QYTETARI I PARË — (*Qytetarit të dytë*) Ty ku të gjetën?

QYTETARI I DYTË — Në rrugë... Sa dola nga shtëpia... Vajta për ta parë... Kisha dy ditë në bo-drum, aty pranë. Një vend i sigurt... Shumë i sigurt...

QYETARI I PARË — Po ç't'u desh që dole andej?

QYTETARI I DYTË — Mirë thua, ç'm'u desh. «Dale të vete të shikoj një herë, thashë, ç'bëhet andej nga shtëpia!...»

QYTETARI I PARË — Në djall, more, shtëpia... Na, tani! Na!

QYTETARI I DYTË — Vetëm të mos na pushkatojnë.

QYTETARI ME PARDESY — Amani, ju lutem, mos na ndillni të keqen...

QYTETARI ME KASKETË — Nuk e besoj, të paktën hëpërë... Si e shikoni, në atë kanalin, që por-sa ka filluar, midis bunkerit dhe kafenesë këtu ku jemi ne, kanë nevojë për punën tonë.

QYTETARI ME PARDESY — More, mos duan të na internojnë...

QYTETARI I PARË — Thonë se do ta hedhin në erë të gjithë qytetin...

QYTETARI I TRETË — Po t'i lësh, edhe atë e bëjnë.

QYTETARI I DYTË — Unë them se po i ngave, edhe atë e bëjnë!

QYTETARI ME PARDESY — Mirë thotë... Të mos i ngasin, t'i lenë të ikin vetë...

QYTETARI ME KASKETË — Vetë nuk ikin ata dhe, po i lamë të bëjnë si të duan, iku qyteti.

QYTETARI I DYTË — Si në kohën e Neronit.

QYTETARI I TRETE — (*Qytetarit të dytë*) Ne-përË!... E ke atë gjuhë si të nepërËs... Ç'do të thuash me këtë? Neroni e dogji vetë qytetin.

QYTETARI I DYTË — Pse, ne nuk po e djegim vetë?!

NJË USHTAR GJERMAN — Kush e ngre zërin atje? I është mërziturjeta ndonjërit? (*Afrohet, i shikon me radhë dhe largohet përsëri*)

QYTETARI I TRETE — (*Qytetarit të dytë*) I poshtër!...

QYTETARI ME PARDESY — (*Me zë të ulët*) Pushoni, se na morët në qafë, do të na internojnë të gjithëve.

QYTETARI I DYTË — Vetë, vetë po e kërkojmë...

QYTETARI ME KASKETË — Qenke me të vërtetë i poshtër ti!

QYTETARI ME PARDESY — U pa puna jonë, mori fund, do të na internojnë.

QYTETARI ME KASKETË — Pusho, more frikacak!

QYTETARI I PARË — Është e pamundur të gjesh në botë dy njerëz me të njëjtën dëshirë. Ky (*tregon Qytetarin me pardesy*) ka frikë mos të vdesë në internim, në kampet, si qifutët. Ti (*i drejtohet Qytetarit të tretë*) do të vdesësh në barrikadë si komunarët, (*Qytetarit me kasketë*) edhe ti po kështu...

QYTETARI ME PARDESY — E pse të vdes në internim...

QYTETARI I TRETE — Po ku atëhere?

QYTETARI ME PARDESY — Ku?! Të vdes, ore, në shtëpi, kur të më vijë për të vdekur, jo tanë...

QYTETARI I PARË — Kur të jetë shkruar, do të thuash?

QYTETARI ME PARDESY — Po, kur tē jetë e shkruar...

QYTETARI I TRETEË — Nga kush?

QYTETARI ME PARDESY — Ti nuk beson, më duket, prandaj flet kështu...

QYTETARI ME KASKETË — (*Qytetarit me pardesy*) Për zotin e ke fjalën? Vërtet, punë që ka pasur edhe ai në këtë luftë! Kush e di sa shkresa ka shkruar dhe vazhdon tē shkruajë. Në këtë çast mbas po firmos edhe shkresat tonë...

QYTETARI I DYTË — Unë nuk dua tē vdes.

QYTETARI I PARË — Kush është ai që do tē vdesë?

QYTETARI I DYTË — Po tē mos kishte filluar lufta, as nuk do tē ishim këtu.

QYTETARI ME KASKETË — Këta na vrash, ti bën fajtorë tē tjerët.

QYTETARI I TRETEË — (*Qytetarit tē dytë*) Do ta mbyllësh atë gojë ti, apo... (*I afrohet*)

USHTARI — Hej, ju atje!

QYTETARI I DYTË — Urdhëroni, zoti ushtar...

USHTARI — Kjo është e dyta dhe e fundit herë që po ju them: fjalë nuk dua unë.

QYTETARI ME PARDESY — (*Qytetarit tē tretë me zë tē ulët*) E dëgjon?

QYTETARI I TRETEË — Po atë (*tregon Qytetarin e dytë*) e dëgjove?... (*Nga turma shkëputet njëri nga qytetarët dhe vrapon për tē ikur, por një nga ushtarët gjermanë e qëllon me një breshëri automatiku dhe e vret. Nga dhoma dalin me tē shpejtë oficeri dhe SS-i*)

OFICERI — (*Mediut*) Ç'është kështu? (*Shikon jashët dhe bashkë me SS-in del*) Ç'ka ndodhur?

USHTARI — Deshi tē ikte, zoti kapiten.

OFICERI — Ashtu?... (*Duke shikuar tē tjerët me radhë*) Kush e njihte nga ju? Pranë kujt po rrinte?... Flisni, kush e njihte? (*Qytetarit tē parë*) Ti e njihje?

QYTETARI I PARË — Jo, zoti oficer.

OFICERI — (*Bërtet*) Gënjen! (*E godet me dorezën e revoles dhe ai bie përtokë*) Do tē flisni, apo do-

ni t'ju hap trutë të gjithëve? (Qëndron te Qytetari me kasketë dhe e shikon thellë në sy)

QYTETARI ME PARDESY — Ai nuk ishte pranë meje, ai ishte andej nga fundi.

OFICERI — Ti (Qytetarit me pardesy) edhe ti (Qytetarit me kasketë) dilni kätej.

QYTETARI ME PARDESY — Pse, zoti oficer, pse?...

OFICERI — (Ushtarit) Merrini! (Ushtarët nxjerrin jashtë Qytetarin me pardesy, i cili është hutuar, bëjnë të nxjerrin edhe Qytetarin me kasketë)

QYTETARI ME KASKETË — Prit! Shkoj vetë. (Del trimërisht. Heshtje. Pas pak dëgjohet zëri i tij) Vdekje fashizmit! (Një breshëri automatiku, që vazhdon, pastaj heshtje)

OFICERI — Të gjithë kështu do ta pësoni po të tentoni për ndonjë gjë. (SS-it) E dinë pse janë këtu?

SS-i — Në mos e dinë, po ua them. (U drejtohet të gjithëve) Do të hapni një kanal prej këtu deri te bunkeri atje. E qartë? Edhe një gjë: e patë atë që ndodhi me ata? Kjo mund të ndodhë me cilindo dhe me të gjithë...

OFICERI — Kështu.

MEDIU — (I cili nga brenda ka ndjekur këtë skenë) Kriminelë!

AGIMI — (Me zor përbahet) Është pak.

MEDIU — Ç'mund të thuash tjetër?...

VJOLLCA — Fashistë... (Mediu shikon të bijën dhe habitet)

USHTARI — (Jashtë u drejtohet të tjerëve) Tani, në punë. (I shtyn dhe të gjithë dalin, ndërsa oficeri dhe SS-i i shikojnë)

OFICERI — Tani, po, më pëlqen. Me siguri do të bëni karrierë, toger.

SS-i — Ju falem nderit, zoti kapiten, për fjalët e mira.

OFICERI — (Duke hyrë bashkë me SS-in, afrohet te banaku dhe i drejtohet Mediut) Konjak. (Mediu, u mbush gotat, por është i hutuar) Ç'ke kështu?

MEDIU — (*Vjen në vete*) Asgjë, asgjë...

OFICERI — (*Shikon jashtë, nga ata që shkuan të punojnë*) Ka ndonjë gjë që nuk shkon?

SS-i — Se ç'ka ky sot! Më ra në sy edhe pak përpara.

OFICERI — Mbase nga ajo që pa atje përjashta.

MEDIU — Jo, zoti oficer, u mësuan edhe këta syste tanë...

OFICERI — (*Duke pirë konjakun, i drejtohet togerit*) Kështu është, në luftë duhet të jesh i pamëshirshëm. As vetes, as kolegut nuk mund t'i lejosh asnë lëkundje... Një oficer i rajhut të tretë nuk mund dhe nuk duhet të jetë human... Kjo fjalë s'ka asnë kuptim për atë... Nuk egziston...

SS-i — (*Duke ngritur gotën e tij*) Plotësisht e drejtë, zoti kapiten, plotësisht e drejtë... (*Mediut i bie shishja përtokë, thyhet dhe bën zhurmë*) SS-i shpejt nxjerr revolen dhe drejtohet nga Mediu) Të marrtë dreqi, të marrtë!... (*Mediu shpejt mbledh veten dhe merr një shishe tjetër nga rafti*)

OFICERI — (*Qesh fort*) Ha-ha-ha!... Toger, kanë nisur të dobësohen nervat!... (*Mediut, rreptë*) Po ti ç'pate?

MEDIU — Fjalë të ashpra ato që thatë, zoti oficer, nuk i kisha dëgjuar deri më sot.

SS-i — (*Rreptë*) Tani që i dëgjove, bën mirë t'i mbash mend... (*I ve tytën e revoles në tëmtja*) Në qoftë se kjo kokë do të qëndrojë akoma mbi këto shpatulla...

MEDIU — (*I qetë*) Do të përpinqem... «Në luftë duhet të jesh i pamëshirshëm... As vetes, as kolegut nuk mund t'i lejosh asnë lëkundje»... (*Oficerit*) Kështu më duket e thatë?... Pra «Një oficer i rajhut të tretë nuk mund dhe nuk duhet të jetë human». (*Togerit*) Dhe human do të thotë... po, po... më kujtohet: njerëzor.

OFICERI — (*E pi konjakun deri në fund, pastaj i drejtohet Mediut*) Mirë thotë togeri, nguli në kokë dhe mos i harro... (*Agimit, të cilit i afrohet dhe e shi-*

kon gjatë në sy) Edhe ti, djalosh... (SS-it) Kjo është e bija? (Vjollcës) Edhe ti... (SS-it) Dalim pak, toger. Ç'bëhet atje përjashta? (Del)

SS-i — (Pasi fut revolen, pi edhe ai konjakun e tij dhe i drejtohet Mediut) Pra, u morëm vesh... (U drejtohet edhe të tjerëve) Ky është paralajmërimi, mbasë i fundit, për të gjithë... (Del jashtë andej nga doli dhe oficeri)

MEDIU — (Duke shikuar andej nga dolën ata) Po, do të përpinqem, do të përpinqem të mos i harroj... Kriminelë!...

AGIMI — Nuk do t'i harrojmë, jo...

MEDIU — (Pa lëvizur nga vendi, i drejtohet Vjollcës) Si the ti pak përpara, fashistë?... (Bërtet) Bisha!

AGIMI — (Pa lëvizur nga vendi) Jo, fashistë!... (Mediu shikon nga Agimi i habitur)

VJOLLCA — (Përsërit) Fashistë!...

MEDIU — (Vjollcës) Shko tani, shko dhe mos të vish më!

AGIMI — (Mediut, papritur) Të kam pyetur edhe një herë, po nuk më je përgjegjur: ke çelës tjetër pér këtë portë? (Tregon portën pérballë)

MEDIU — Ke luajtur nga mendtë!

AGIMI — Ky është rasti më i mirë. Duhet shfrytëzuar ky rast...

MEDIU — Po hyri ndonjeri nga ata, të vrau në vend...

AGIMI — Më jep çelësin!

MEDIU — Ç'kërkon në atë dhomë?

AGIMI — Një hartë mbi të cilën janë shënuar vendet ku janë vënë minat nëpër qytet.

MEDIU — Nuk besoj ta kenë atje...

AGIMI — Mua më duhet ajo...

MEDIU — Ty mund të të duhen shumë gjëra...

AGIMI — Dua të di ç'bëhet në atë dhomë. Unë pér këtë kam qëndruar këtu dhe po bëj atë punë që bëj.

MEDIU — Ti kujton se nuk e kam marrë vesh... Apo kujton se nuk dua të ta jap çelësin... (E nxjerr

atë nga një vend i fshehur) Na, merre! Por hap sytë...

AGIMI — (Merr çelësin) Shikoni mos vijë njeri (Afrohet te porta përballë, e hap dhe hyn brenda. Mediu dhe Vjollca përgjojnë. Diku larg dëgjohen gjëmi me të topave. Krejt papritur, te porta tjetër duket Vasili, i cili hyn brenda. Mediu dhe Vjollca shtangin në vend)

MEDIU — Ti?!...

VASILI — Unë i téri, pse? Nuk ka njeri tjetër këtu?

MEDIU — Jo, nuk ka.

VASILI — Mezi arrita, thashë të vete t'i shoh këta miq. I gënjeva. U thashë se do të shkoja të bleja dy shishe raki (nxjerr paret) Jo pér vete, pér ho-xhë efendiu. Ah po, harrova t'ju tregoj: miku im nuk kishte vend pér vete dhe vajta e u futa te xhamia e pazarit. E ku të shkoja? Hoxhë Qamili desh më nxori jashtë; por unë nuk dola... (Papritur) Vajza jo-te éshtë kjo? (Mediu dhe Vjollca shikojnë me vëmendje jashtë dhe nga porta përballë) Dëgjova se këtu tek ju rrinë gjermanët. (Duke treguar portën përballë) Atje rrinë ata?... Ku e kisha fjalën... Hë, nuk dola... E sa pér të fjetur, më shtroi një hasër mbi atë shtratin prej dërrase, ku lajnë të vdekurit. E po çka, thashë. Ti e di që unë nuk bëj naze. (Shikon jashtë) Do të bjerë shi, prite kur të fillojë. Po ju, si shkoni? (Hyn SS-i. Heshtje e plotë)

SS-i — (Shikon Vasilin) Po ky ç'bën këtu?

MEDIU — Klient, erdhi të blejë raki.

VASILI — Jo pér vete, pér hoxhë efendiu. Ja, shikoni, më ka dhënë edhe paratë. (I tregon paratë)

SS-i — Rri këtu dhe mos luaj sa të marr mushamatë... (Drejtohet nga porta përballë. Mediu dhe Vjollca kanë ngrirë. Te varësja pranë portës merr mushamatë pér vete dhe pér oficerin dhe afrohet te Vasili) Tani, hajde me mua!

VASILI — Ku?

SS-i — Atje, të punosh me ata të tjerët.

VASILI — Falemnderit shumë, por mua më presin.

SS-i — (*E shtyn përjashta*) Hajde, marsh, se nuk kam kohë. E shikon që nuk kam kohë? (*Dalin. Heshtje e gjatë*)

MEDIU — (*I shqetësuar*) Po ai ç'dreqin bën akoma atje brenda?

VJOLLCA — Hë, pra... (*Thërret te porta*) Agim, Agim!... (*Agimi del*)

MEDIU — (*Merr frymë thellë*) Pse u vonove kaq shumë? E dëgjove atë kur erdhi?

AGIMI — Po, e dëgjova.

MEDIU — C'bëje?

AGIMI — Po i qëndroja gati, prapa portës...

MEDIU — Mirë që nuk u fut brenda.

VJOLLCA — Na ngriu gjaku...

MEDIU — Hartën, e gjete?...

AGIMI — Jo, nuk e gjeta.

MEDIU — Atëhere, pse u vonove?... (*Ulen nga-dalë dritat, deri sa shuhën*)

— Bie perdia —

DITA E NËNTË

(*Natë*)

Brenda janë qytetarët, të cilët flenë si mundin. Ndriçon vetëm një dritë e vogël. Praktikisht kafeneja është kthyer në një kamp. Jashtë shkrepëtin dhe bie shi. Larg dëgjohet luftë. Një ushtar gjerman bën roje atje thellë mbi një vend pak më të ngritur. Poshtë kallon patrulla.

ROJA — (*Patrullës*) E dini sa është ora?

PATRULLA E PARË — Pse, u mërzite ti atje? Apo pse je në strehë! I ndërrojmë vendet?...

ROJA — E di si dukeni atje poshtë me ato mu-shamatë?

PATRULLA E DYTË — Si?

ROJA — Si Horati me Marcellin në Elsinor. Mun-gon edhe Hamleti.

PATRULLA E PARË — Kurse ti atje lart du-kesh si fantazma e mbretit Hamlet.

PATRULLA E DYTË — Edhe vetë qelli me këto shkrepëtima të kujton këtë tragjedi. Kohë shumë e keqë!

PATRULLA E PARË — Shi i madh!

ROJA — Shi i madh!

PATRULLA E DYTË — Na ka hyrë deri në palcë... S'ndezim dot as një cigare.

ROJA — Është e ndaluar.

PATRULLA E DYTË — E di, thashë ashtu kot.

ROJA — Officerët flenë?

PATRULLA E PARË — Po, po flenë.

ROJA — Po ata atje brenda ç'bëjnë?

PATRULLA E PARË — Dreqi e di.

ROJA — Nuk më thatë, sa është ora?

PATRULLA E DYTË — Pse, në sa të ndërrojnë?

ROJA — Në pesë.

PATRULLA E DYTË — Ke kohë atëhere, ke ko-hë... Hap sytë mos të të zërë gjumi.

PATRULLA E PARË — Mirupafshim, mbret Hamlet!

ROJA — Mirupafshim, princ Hamlet! (*Vazhdojnë shkrepëtima. Patrulla largohet*)

VASILI — (*Brenda ngrihet pak*) Mirë e kish ho-xhë efendiu. Këto janë ditët e kiametit.

QYTETARI I DYTË — Po ti pse nuk fle?

VASILI — Nuk më flihet.

QYTETARI I DYTË — As mua nuk më flihet.

VASILI — Kur nuk e ke ndërgjegjen të pastër, nuk të zë gjumi... Kështu thonë..

QYTETARI I DYTË — Folë për vete ti, shiko punën tënde.

VASILI — Pashë një ëndërr, prandaj u ngrita...

QYTETARI I DYTË — Lëri èndrrat tani, fillove edhe me èndrrat...

VASILI — Thonë se do të hedhin në erë gjithë qytetin, èshtë e vërtetë?

QYTETARI I DYTË — Nuk e di atë, unë kam hallin tim.

VASILI — Ja, këtë pashë në èndërr...

QYTETARI I DYTË — (Bërtet pak) Do pushosh ti, apo...

VASILI — Shshsh... Flenë të tjerët... Pse bërtet, ç'dreqin ke?

QYTETARI I DYTË — Kam, si të mos kem? Ç'dua unë këtu?! Po kujt t'ja them?

VASILI — Ec e thuaja atij, e shikon atje? (*Tregon rojen përjashta*) Duket si fantazmë... Ke parë fantazmë me automatik?... Unë jo...

QYTETARI I DYTË — Mirë thua: «duket si fantazmë»

VASILI — (Me zë të ulët) Dëgjo të të them një fjalë. Po afrohu pak, afrohu!...

QYTETARI I DYTË — (Duke u afruar) Hë, çfarë do të më thuash?

VASILI — (Duke shikuar nga të tjerë) Po këta na dëgjojnë?

QYTETARI I DYTË — Flenë, nuk i sheh?

VASILI — Lum si ata, kanë ndërgjegjen të pastër, jo si ne.

QYTETARI I DYTË — Do të flasësh, apo jo?...

VASILI — Prit!... E gënjeva hoxhën, por nuk kam faj... E para herë që gënjej një hoxhë. Për ata nuk èshtë e vështirë të gënjejnë, por që të gënjen... Po, ku e kisha fjalën?...

QYTETARI I DYTË — Deshe të më thuash një fjalë.

VASILI — Hë, po... (*Hetonjës*) Dëgjo këtu, ti the se ke hallin tënd, kështu? E mirë, edhe mua nuk më bëhet vonë pér të tjerët. Këtë desha të them... Po afrohu, afrohu edhe pak. Ne të dy besoj se do të merremi vesh, nuk e di pse, por kështu më duket...

QYTETARI I DYTË — Të merremi vesh, përse?
VASILI — (*Gjithmonë hetonjës*) Që të ikim....

Në këtë natë të errët nuk është edhe aq e vështirë...
QYTETARI I DYTË — Je në vete?! Ti nuk ishe
këtu kur e grinë njërin pse deshi të ikte... Pas tij edhe
dy të tjerë...

VASILI — (*Papritur e pështyn*) Phu, kolonë e
pestë... (*Atë çast, roja përjashta shtie me automatik.*
Ngrihen edhe të tjerët. Nga porta përballë hyjnë ofi-
ceri dhe SS-i, Mediu ndez dritën)

OFICERI — Ç'bëhet kështu? (Askush nuk për-
gjigjet)

SS-i — (*Del përjashta*) Roje, kush shtiu?

ROJA — Unë. Se çfarë lëvizzi atje.

SS-i — Çfarë? (*Vijnë ushtarë të tjerë*)

PATRULLA E PARË — Asgjë, asgjë... Më du-
ket një qen.

SS-i — E vrau?

PATRULLA E PARË — Jo, më duket.

SS-i — Mbase nuk ishte qen. (*Bërtet*) Kontrollo-
ni mirë nga të gjitha anët! (*Hyn brenda dhe iu drejto-
het qytetarëve*) Uluni të gjithë! (*I drejtohet Mediut*)
Djalin, ku e ke djalin?

AGIMI — (*Duke u ngritur nga prapa banakut*) Kë-
tu jam edhe unë.

SS-i — Po vajzën?

MEDIU — Ajo shkon në mbrëmje dhe vjen në
mëngjez, ju e dini këtë, zoti toger.

OFICERI — Pse, si është puna? Ç'ka ngjarë?

SS-i — Rojet thonë se është parë një qen, po
dreqi e di...

OFICERI — (*Nuk do ta zgjatë këtë çështje*) Të
ngrihen tani, (*tregon qytetarët*) nxirri jashtë, po afron
ora për punë. (*Del nga porta përballë*)

SS-i — (*Qytetarëve*) Në këmbë të gjithë! (*Ata
ngrihen*) Të gjithë përjashta! (*Ata dalin jashtë me ra-
dhë. Ushtarit*) Çojini në punë! (*Qytetarët dalin. Edhe*
SS-i del nga porta përballë. Mediut rregullon brenda,
kurse Agimi del përjashta. Tani është ditë. Oficeri

dhe SS-i hyjnë nga porta përballë me disa harta dhe zënë vend te një tavolinë atje në qoshe. Ata diskutojnë për planet. Jashtë, duket Leci me arkën e lustrës)

LECI — (Agimit) Nuk paska njerëz fare sot. Si është puna? (Duke shikuar majtas dhe djathtas) Shokët më dërguan urgjent. «Ta takosh me doemos, më thanë...» (Kalon patrulla, prandaj flet me zë të lartë) Të qenkan bërë këpucët për ibret. T'u jap një lustër?...

AGIMI — Mirë, jepu një lustër, derisa nuk ka ardhur njeri. (Ushtarët e patrullës i shikojnë dhe kalojnë tutje. Pas pak Agimi i drejtohet Lecit me zë të ulët) Folë, pse të dërguan? Ç'ka ndonjë të re?

LECI — Sonte fillon.

AGIMI — Çfarë fillon?

LECI — Sulmi... (Heshtje) Shokët më porositën të kesh kujdes.

AGIMI — Sonte the, kështu?...

LECI — Po, sonte. «Qyteti të çlirohet me çdo kusht». Ky është urdhëri «Dhe të shpëtohet më çdo kusht...»

AGIMI — Mirë, ik tani, e kam të qartë...

LECI — Kafeneja këtu do të sulmohet nesër mbrëma.

AGIMI — Mirë. Unë këtu do t'i pres.

LECI — Jo, shokët më thanë: gjeje mënyrën dhe ik tani, ik...

AGIMI — Po atje, te kodrat, ç'bëhet?... Ka ndonjë lajm?

LECI — Asgjë... Akoma asgjë...

AGIMI — Mirë, shko tani.

LECI — Ç'do të bësh?... Unë për këtë erdha.

AGIMI — Të shoh...

LECI — Jo të shohësh, por kështu...

AGIMI — Mirë, mirë... Kam edhe pak punë...

LECI — (Papritur) Nuk shkoj as unë, do të qëndroj këtu më ty.

AGIMI — (Preket) Partizanët zbatojnë urdhërin

kurdoherë. (*Leci bën të dalë, duket Vjollca*) Ti pse erdhe?

VJOLLCA — Leci ta tha? Për atë erdha edhe unë.

AGIMI — Ti e di si eshtë puna.

VJOLLCA — Atëhere pse pyet?

AGIMI — Jo, sot të mos kiske ardhur... (*Duket patrulla. Vjollca hyn brenda. Agimi i afrohet Lecit dhe i flet me të butë*) Ik tani, shko; si duket, nuk ka klientë sot. (*Leci del kokulur. Del edhe patrulla. Pas pak, del edhe Agimi*)

VJOLLCA — (*Hyn brenda, afrohet te banaku, vë ato që kishte në dorë dhe i flet Mediu*) Mirëmëngjez, baba, të solla bukën. (*Shikon oficerët*)

MEDIU — Mirëmëngjez! (*Me zë të ulët*) Mund të mos vije sot, pse erdhe? Rri pak dhe shko.

VJOLLCA — (*Me zë të lartë*) Ku eshtë kova?

MEDIU — Ç'e do?

VJOLLCA — (*Me zë të ulët*) Duhet të merrem me diçka... (*Vete merr kovën*)

SS-i — (*Duke u shkëputur nga oficeri, që shikon me vëmendje hartën, i afrohet Vjollcës*) Mirëmëngjez zonjushe! (*Ajo nuk përgjigjet*) E di që më pëlqen rregulli. Ti vjen në orën e caktuar, kryen ato punë që duhen kryer dhe shkon përsëri në orën e caktuar... Një rregull i plotë...

VJOLLCA — Mund të bëj ndryshe?

MEDIU — (*Duke ndérhyrë*) Zoti toger, nuk de-shët një çaj?

SS-i — (*Pas pak*). Jo, një kafe... të fortë... me pak... (*Afrohet te banaku*)

MEDIU — Ju keni marrë disa zakone si tonat.

SS-i — Ashtu?...

MEDIU — Po ja... Pini kafe të fortë... Pa she-quer, ose me pak...

SS-i — Ka diçka të përbashkët, prandaj...

MEDIU — Në ç'kuptim?

SS-i — Në kuptimin... (*Papritur bërtet*) Se mua nuk më pëlqeijnë fjalët e shumta.

MEDIU — Më falni, mbase fola shumë...

SS-i — (Bërtet) Edhe tepër... (Drejtohet nga oficeri) Më falni.

OFICERI — C'pate?

SS-i — Asgjë, asgjë... Më falni. (Oficeri vazhdon punën. Ai i drejtohet Vjollcës) U trembe? (Bën të afrohet)

MEDIU — Gati kafenë... (Vë kafenë në banak, por SS-i afrohet te Vjollca që po lan pllakat dhe, me shqelm, i derdh kovën me ujë... Oficeri shikon nga ai. Mediu me zor përbahet te banaku)

SS-i — (Cinik) Padashur... Më falni, zonjushe... (Vjollca ngrihet. Oficeri vazhdon punën. Përjashta duket Agimi, i cili mban në duar një arkë të rëndë. Vjollca dhe Mediu ngrijnë në vend, janë të shqetësuar. SS-i i drejtohet Mediut) Hë, po vjen bandilli. (Afrohet te banaku për të pirë kafenë)

MEDIU — Si thatë, zoti toger?

SS-i — Bandilli, thashë... Nuk i thonë kështu?...

MEDIU — Në ç'kuptim?

SS-i — Në kuptimin që ka kjo fjalë në shqip.

MEDIU — Ai është im bir...

SS-i — (Hetonjës) Se mos thashë unë jo...

MEDIU — Sot jeni nervoz, zoti toger, jeni ngritur më krah të majtë, themi ne...

SS-i — Kurse unë them se nuk jeni aq naiv, sa kërkoni të shiteni. (Duke treguar Vjollcën) E shikon si ka ngrirë në vend, as frymë nuk merr!

MEDIU — Ata nuk kanë bërë kurrë atë punë që bëjnë tani, prandaj e kanë të vështirë... Ju vetë kenë ndaluar që të punojnë të tjerë këtu... (Hyn Agimi. Pasi i shikon të gjithë me radhë, e kuption gjendjen dhe, pa e dhënë veten, drejtohet në një qoshe afër dhomës përballë, ku janë edhe ca arka të tjera, për të lënë arkën që mban në duar)

SS-i — E rëndë, eh?... (E mban për krahu)

AGIMI — Jo edhe aq...

SS-i — Konjak?..

AGIMI — (Duke mbledhur gjithë forcat, se i rë-

ndon shumë arka) Babë, s'kish tjetër, solla përsëri konjak... (Bën të largohet, por SS-i e mban për krahу. Mediu dhe Vjollca ngrijnë në vend. SS-i i shikon ato me radhë, pastaj nxjerr një shishe nga arka)

SS-i — (Lexon etiketën) Konjak... (E vë shishen në arkë) Ke qenë sportist?

AGIMI — Po.

SS-i — Ngritës peshash?...

AGIMI — (Duke bërë përpjekjet e fundit) Jo, boksier... (Largohet dhe e vë arkën në një qoshe afër dhomës përballë)

MEDIU — (Agimit, në mënyrë që të dëgjojë edhe SS-i) Ç'i deshe, more bir, mos t'i kishe marrë fare... Zotërinjtë oficerë kanë hequr dorë nga konjaku...

AGIMI — Le të rrinë aty, nuk i dihet. (Del për të sjellë arkat e tjera)

SS-i — (Mediut) Vetëm këtë djalë ke?

MEDIU — Vetëm këtë. (Bie telefoni dhe oficeri hyn në dhomën përballë)

SS-i — Dhe çupë, gjithashtu...

MEDIU — Gjithashtu... (Papritur) Po ju ftohet kafeja.

OFICERI — (Del, mbështjell hartat, i fut në dhomën përballë, del përsëri dhe i drejtohet SS-it) Majori Lebel më kërkon atje te bunkerit. Ti qëndro. Po të ketë nevojë, çoj e të thérres. (Del)

SS-i — (Mediut pas pak) Një konjak!

MEDIU — Pse nuk ju pëlqeu kafeja, zoti toger? Pra qe e fortë, me pak sheqer.

SS-i — (Rreptë) Thashë, një konjak! Dhe me gotë të madhe. (Mediu i mbush një gotë të madhe me konjak. Agimi sjell një arkë tjetër, e vendos tek e para dhe bën të dalë, por SS-i e ndal) The se ke qenë boksier... (E shikon me vërejtje) Nuk dukesh, pra!

AGIMI — Nga e kuptioni këtë?

SS-i — Nga hunda...

AGIMI — Po harrova... Ju duhet të jeni specialist për këtë.

SS-i — Specialist përse?

AGIMI — Për hundët... Çifutët nga i njihni, nga hunda...

MEDIU — Në të gjithë Shqipërinë kanë qenë a s'kanë qenë tri familje çifute...

SS-i — (*Agimit*) Po komunistët nga thua ti i njohim?

MEDIU — Mbështetjanë të kuq edhe në fytyrë...

SS-i — (*Bërtet*) Jo, nga sytë. (*I afrohet Agimit dhe e shikon thellë në sy. Heshtje. Të gjithë kanë ngrirë në vend, Pa i hequr sytë nga Agimi, i drejtohet Mediut*) Mbështetja edhe një gotë. Të madhe. E mbushe?

MEDIU — (*Pasi mbush gotën*) E mbusha.

SS-i — (*Agimit, duke i vënë gotën përparrë*) Nuk të kam parë të pish. megjithëse djalë kafexhiu!...

MEDIU — Po ai nuk pi, zoti toger, nuç ka pirë kurrë...

SS-i — Djalë kafexhiu dhe nuk ka pirë kurrë konjak?!. Nuk duket pak si e çuditshme?!

AGIMI — (*Kupton qëllimin dhe nuk do ta zgjatë, prandaj merr në dorë gotën dhe e pi deri në jund*) Kështu? (*Lë gotën mbi banak dhe bën të dalë, por SS-i e mban për krahu*)

SS-i — Vërtet nuk ka pirë kurrë? (*Nuk merr përgjegje, prandaj i drejtohet Mediut*) Edhe një tjetër. (*Pi dhe ai, por fare pak. Mediut ngurron të mbushë gotën e Agimit*)

AGIMI — (*Mediut*) Mbështetja!

SS-i — (*Mediut*) E dëgjon, mbështetja! (*Mediut mbush gotën*)

Agimi — (*Merr gotën dhe e mban në dorë, i drejtohet SS-it*) Unë piva, tani e ke radhën ti.

SS-i — Edhe unë piva.

AGIMI — Ti sa e vure në buzë.

SS-i — (*Bërtet*) Pije, po të them!

AGIMI — Jo. (*E lë gotën mbi banak*)

MEDIU — E zuri, zoti toger. Konjaku të bie në kokë menjëherë. Më dëgjoni mua...

SS-i — (*Mediut*) Përse shqetësohesh ti?! Përse ke frikë?

MEDIU — I dehuri është i dehur, zoti toger, atij edhe i marri i lëshon rrugë.

SS-i — (*Mediut*) Kërkoi njeri mend nga ti?
Jo... (*Mediu bën të flasë*) Pusho! (*Jashtë ka zhurmë, janë ata që punojnë në kanal*)

NJË USHTAR — (*Duke hyrë në kafene, i drejtohet SS-it*) Më lejoni, zoti toger! (*Mediut*) U jepni pak ujë, kanë fare pak kohë, fare pak...

MEDIU — (*Duke i dhënë një gjym me ujë dhe një kupë Agimit*) Jepu pak ujë.

SS-i — (*Duke mbajtur Agimin, i drejtohet Mediut*) Ne po pimë, nuk e shikon? Vëre këtu (*tregon banakun*) të gjithë shishen e konjakut.

AGIMI — Një minutë. (*I afrohet Vjollcës për t'i dhënë gjymin dhe kupën e ujit*)

MEDIU — Nuk është kohë për të pirë kjo, më duket, zoti toger, nuk është...

AGIMI — (*Vjollcës*) Ik, e more vesh? Ik!...

VJOLLCA — Po atje?! (*Tregon dhomën përballë*

AGIMI — (*Prerë*) Ik, ik po të them! (*Vjollca del. Agimi kthehet te banaku*)

SS-i — (*Mediut*) Pse nuk është koha, sipas teje?

MEDIU — Nuk e di, por them... (*Jashtë Vjollca ua jep gjymin dhe kupën e ujit të tjerëve dhe largohet*)

SS-i — (*Papritur, pi me fund gotën e tij dhe i drejtohet Agimit*) Pije tanë! (*Agimi vë re se Vjollca nuk është më*)

MEDIU — E lini tanë, mjافت.

SS-i — (*Duke mbushur përsëri gotën e tij*) Ke frikë mos dehet?! Pse ke kaq frikë?!... (*Jashtë duket Zaimi dhe disa ballistë. Ata ecin duke shtyrë qytetarët, të cilët janë ulur dhe vazhdojnë të hanë. Bëhet zhurmë dhe SS-i largohet pak nga banaku për të parë ç'po ndodh*)

AGIMI — (Mediut) Unë vazhdoj të shtirem i dehur.

ZAIMI — (Duke hyrë brenda, ndërsa ballistët e tjerë mbeten jashtë, i drejtohet SS-it) Zoti toger, paraqitem: Komandant Zaimi, i forcave nacionaliste të Ballit Kombëtar:

SS-i — Sa jeni? — (I merren pak këmbët, ku filuar ta zërë konjaku)

ZAIMI — Duhet të ishim një batalion... Saktësisht kemi mbetur një kompani, jo më shumë. Ashtu ndodhi...

SS-i — (Nervoz) Çfarë ju ndodhi?... Gjithnjë kjo histori: kështu na ndodhi, ashtu na ndodhi...

ZAIMI — Ju lutem, zoti toger...

SS-i — Në djall të veni me gjithë lutjet tuaja!... Shpjegohu atëhere!... Veç mos e vra mendjen shumë për të gjetur ndonjë gënjeshtër të trashë, si ndodh zakonisht me të gjithë ju...

AGIMI — Me ju ballistët... (Zaimit) E thashë mirë?...

ZAIMI — Këtu ka të huaj, zoti toger... (Duke treguar Mediun) Këtë e njoh, ai është... ose më mirë, unë jam... si të them: është kafexhiu... (Duke shikuar nga Agimi) Kurse këtë nuk e njoh.

SS-i — (Me interesim dhe provokonjës) Është i biri... (Shikon nga Medi) Kështu?!.

ZAIMI — Një djalë që kishte, iu vra në luftë, kështu e di unë...

SS-i — (Bërtet) Po ky ç'është atëherë?!

AGIMI — (Qesh fort) Ha-ha-ha!... Unë jam ai që u vra!...

MEDIU — (Zaimit) Mua nuk më është vrarë asnjë djalë në luftë. Ti ke kohë që nuk e ke parë, prandaj edhe nuk po e njeh.

SS-i — (Mediut, të cilin e shikon thellë në sy) U vra, apo nuk u vra? (Fillon një qitje e rreptë artillerie. Disa predha bien aty pranë. Heshtje. Të gjithë

dëgjojnë me vëmendje. Pas pak bërtet) Folë, u vra apo nuk u vra?

MEDIU — (I vendosur) Nuk u vra.

ZAIMI — Unë e di se u vra...

AGIMI — Unë këtë nuk e dija, që të më kenë vrarë njëherë!...

MEDIU — (Prerë) Nuk u vra... (Një ushtar duket te porta; ka hyrë me vrap)

USHTARI — Zoti toger, ju kërkojnë urgjent te bunkeri.

SS-i — (Duke iu drejtuar Mediut, i merren këmbët) Përgjigju është yt bir?!

MEDIU — Po, zoti toger, është im bir.

USHTARI — (Përsërit) Zoti toger, ju kërkojnë te bunkeri, urgjent.

SS-i — (Duket që është dehur) Kapiteni është atje, pse më duan edhe mua?!

USHTARI — Vetë kapiteni më dërgoi, është edhe majori Lebel... Të vish shpejt, më thanë, urgjent...

SS-i — (Zaimit mospërfillës) Jo, mor hajvan, ai është i biri... (Del bashkë me ushtarin me vrap)

ZAIMI — (Nga pas) Zoti oficer, zoti oficer!... (Nuk merr përgjegje dhe kthehet) S'po marr vesh se ç'bëhet!... As dreqi s'po e merr vesh më... E kanë humbur, si duket, edhe këta... Në djall të vejë kjo punë... (Mediut) Ku është Vjollca?

AGIMI — (Qesh, shtiret i dehur) Ha-ha-ha... Vjollca nuk mund të ketë punë me një komandant ballist...

ZAIMI — (Mediut) Po ju pyes juve: ku është Vjollca?

MEDIU — Më thuaj më parë: pse ke ardhur?

ZAIMI — Të marr Vjollcën.

MEDIU — Ta marrësh?! Për ku ta marrësh?

ZAIMI — Boll kemi ndenjur të fejuar, do të martohemi...

MEDIU — Tani?!

ZAIMI — Do iki bashkë me të dhe do të martohemi...

AGIMI — Ha-ha-ha!... E gjeti kohën për tu marta
tar edhe ky komandanti juaj ballist.

ZAIMI — (Mediut) Thuaji të heshtë, përndryshe
ja hodha trutë në erë...

AGIMI — U ndot shumë ajri këtu brenda... Ha-
ha-ha!...

ZAIMI — (Mediut) Po deshe, eja edhe ti me ne...
(Agimi bën të dalë jashtë, por ballistët duan ta mbajnë)

AGIMI — (Duke shtyrë një ballist) Hap rrugë të
thashë.

BALLISTI — Mbaji, more, fjalët, kujt i bërtet
ashtu?

AGIMI — Shtyhu, po të them, hap rrugë! (I shtyn)

ZAIMI — Për fjalë të nderit... Veçse je i pirë, pa
e di unë ç'të bëja...

AGIMI — Pse, ka nder një ballist?

ZAIMI — (Nxjerr revolen) Ta tregoj unë, po the
akoma edhe një fjalë, një fjalë të vetme... (Jashtë
bien ca bomba, bëhet rrëmujë)

QYTETARI I DYTE — (Duke hyrë, i drejtohet
Agimit) Ç'do ti që i ndez gjakrat kot së koti.

MEDIU — Lëreni atë! (Qytetarit të dytë) Dhe ti
mos fut hundët kudo!

AGIMI — (Qytetarit të dytë) Ti the se unë ndez
gjakrat kot së koti.

ZAIMI — (Bërtet) Pushoni të gjithë!

QYTETARI I TRETE — (Zaimit) Mos bërtit, q'ke
që bërtet?

ZAIMI — (Duke u kthyer nga ai) Si the?

QYTETARI I TRETE — Atë që thashë...

ZAIMI — Përsërite edhe një herë. (Mban në do-
rë revolen. Diku, aty pranë bien disa predha. Bëhet
rrëmujë)

QYTETARI I DYTE — (Në një anë, drejtohet
nga spektatorët) E thashë unë, as djalli nuk e merr
vesh këtë punë. Po unë, unë ç'dua këtu?

QYTERARI I PARË — (Drejtohet, gjithashtu, nga
spektatorët) E shikoni këtë? (Tregon Qytetarin e dytë)

Ja, kështu grindet ai. Vetëm ai di. Vetëm ai thotë si duhet të bëhet. Mjaft që ai atje (*tregon ushtarin gjerman*) të mos zemërohet. (*Shpërthen*) C'djall njeri është ky, akoma s'po e marr vesh!...

QYTETARI I TRETE — (*Drejtohet, edhe ai, nga spektatorët*) Jo që të mos zemërohet, por që t'i pëlqejë, ta ketë mirë me të. Sahanlëpirës, ja ç'është. Në të gjitha kohërat ka pasur dhe përsëri do të ketë shërbëtorë të tillë. Sot quhen kolona e pestë, nesër dreqi e di ç'emër do të marrin. (*Duke u drejtuar nga Qytetari i dytë*) I poshtër, dy herë i poshtër...

QYTETARI I DYTË — (*Po nga spektatorët*) Nuk i bihet murit me kokë, këtë e di edhe fëmija. Përgjithësisht nuk më pëlqeijnë gjërat e ashpra, por këta njerëz janë çmendur, me të vërtetë janë çmendur. Hanne arësyte këta njerëz?!. Po logjikë kanë?!. Kështu, vërtet nuk më ka ndodhur ndonjëherë... (*Bien predha të tjera më afër, bëhet rrëmujë përsëri. Zaimi del jashtë për të parë ç'po ndodh, i pasuar nga njerëzit e tij*)

AGIMI — (*Mediut*) Më duket filloi...

MEDIU — Kush?

AGIMI — Artileria, atje te kodrat... (*Dëgjon me vëmendje*) Jo, janë tanët...

QYTETARI I TRETE — (*Shikon përjashta dhe u flet të tjeterëve*) Kaq e pat kjo punë, u erdhi fundi, më dëgjoni mua, u erdhi fundi...

QYTETARI I PARË — (*Duke u afruar për të parë jashtë*) Veç të marrë fund...

QYTETARI I DYTË — Fundi i tyre është edhe fundi ynë.

QYTETARI I TRETE — (*Qytetarit të dytë*) Prapë ti?!. Mbylle, mor, gojën!...

QYTETARI I DYTË — Ç'do nga unë?!. Pse më je qepur pas? Pse ta mbyll gojën?

VASILI — Se e ke të qelbur, prandaj...

QYTETARI I DYTË — (*Vasilit*) Ik, more ti, nuk kam punë me ty.

QYTETARI I TRETE — (*Duke mbajtur Vasilin*

për krahu, i drejtohet Qytetarit të dytë) Po e kemi ne me ty... (I hidhet ta zërë për gryke Bëhet zhurmë) USHTARI GJERMAN — Hej, ju atje, ç'dreqin keni ashtu?

QYTETARI I DYTË — (Duke u shkëputur nga të tjerët) Deshi të më mbysë... (Fërkon fytin)

USHTARI GJERMAN — (Bërtet) Nëpër vende! (U drejton automatikun, por Agimi, më i shpejtë, e vret atë. Heshtje)

AGIMI — (U drejtohet qytetarëve të hutuar) Tani ikni, ikni edhe ju!... Shpejt, shpejt!... (Shikon jashtë mos po vjen njeri, pastaj kthehet përsëri nga qytetarët) Shpejt, shpejt!... (Të gjithë ikin në drejtime të ndryshme. Ka mbetur, përvèç Mediut, edhe Qytetari i tretë) Po ti ç'pret, pse nuk ikën?!

QYTETARI I TRETE — (Duke shikuar nga Mediu) Unë e kam njohur djalin e kafexhiut...

AGIMI — Nuk kemi kohë tani për këtë çështje...

MEDIU — (Duke e mbajtur pér krahu Agimin) Të hedhim në erë të gjithë kafenënë, të shkatërrojmë edhe atë... (Tregon dhomën përballë. Agimi nuk përgjigjet tërheq Medium dhe Qytetarin e tretë. Dalin. Errësohen dritat, deri sa shuhen fare)

— Bie perdja —

DITA E DHJETË

(Natë)

Kur hapet perdja brenda, te banaku janë oficeri dhe SS-i. Mbi tavolinë janë hapur disa harta.

USHTARI GJERMAN — (Duke hyrë) I ra të fikët, zoti kapiten.

OFICERI — Tha gjë?

USHTARI GJERMAN — Jo.

OFICERI — I hidhni një kovë me ujë dhe vazhdoni (*SS-it*) Mbrëmë e zutë?

SS-i — Po, mbrëmë. Në kohën e sulmit, e zumë të plagosur.

OFICERI — (*Duke pirë konjak*) As djalli nuk e merr vesh atë që po ndodh në këtë vend të mallëkuar. Sikur ata të Berlinit të ishin pak më praktikë, t'i kishin ndjekur ngjarjet hap pas hapi, do të kishin gjykuar ndryshe...

SS-i — E ç'mund të bënин?

OFICERI — Mirë thua, ç'mund të bënин?

SS-i Për mua është një vend i çuditshëm.

NJË USHTAR GJERMAN — (*Duke hyrë me vrap, i rraskapitur, pëershëndet dhe i zgjat një letër oficerit*) Zoti kapiten, nga komanda e garnizonit. (*Përshtet përsëri dhe del*)

OFICERI — (*Hap letrën dhe lexon me zë*) «Partizanët, që mbrëmë janë hedhur në sulm të përgjithshëm. Lufta vazhdon e ashpër në të gjitha frontet. Prandaj të jeni gati. Në çastin e fundit, në çdo rrethanë, minat duhet të pëlcasin. Sinjalin do ta japë artileria, e cila nga kodrat përreth, do të fillojë bombardimin e qytetit». (*Pas pak*) Për të tretën herë na porositin për të njëjtën gjë... Kjo s'ka ndodhur ndonjëherë... (*Duke mbyllur letrën*) Do të pëlcasin, mos u bëni merak, do të pëlcasin...

SS-i — Ky është qytet i mistereve, zoti kapiten, prandaj...

OFICERI — I kontrasteve, jam dakord, kjo bie në sy kudo, po i mistereve pse?

SS-i — Desha të thosha i të papriturave.

OFICERI — Nuk ngul këmbë. (*Jashtë dëgjohen predhat e mortajave*) Evropjanët në të vërtetë nuk dinë shumë për këtë vend.

SS-i — Mbështetë ashtu si thoni ju... Por mua nuk ma merr mendja që shqiptarët të jenë komunistë. Gjykoni pak: këtu nuk ka asnjë industri, nuk ka aspunëtorë në kuptimin tonë...

USHTARI GJERMAN — (Duke hyrë) E kotë, zoti kapiten, nuk nxori asnje fjalë, vdiq.

OFICERI — (Nervozi) Janë të çmendur! (Bashkë me SS-in afrohet dhe shikon nga partizani, që vdiq në tortura) Me të vërtetë janë të çmendur... (SS-it) E shikon? Se si të duket...

SS-i — E vura re edhe dje, zoti kapiten, me ata të vrarët atje përjashta, fytyrat e shqiptarëve të vdekur janë të freskëta.

OFICERI — Çdo të thuash me këtë?

SS-i — U vjen vonë fizionomia e të vdekurit.

OFICERI — Nuk ju kuptoj, toger...

SS-i — Po përforcoj fjalët tuaja, zoti kapiten, vend i mallëkuar.

OFICERI — (Ushtarit gjerman) Ata që zutë mbrëmë të gjithë civilë janë?

USHTARI — Civilë.

OFICERI — Të pushkatohen.

USHTARI — Të gjithë?

OFICERI — Të gjithë, Pse, sa janë?

USHTARI — Kjo s'ka rëndësi, zoti kapiten, të gjithë njësoj janë.

OFICERI — Të pushkatohen! (Ushtari gjerman del. Heshtje. I drejtobet SS-it) Ju folët për të papritura...

SS-i — Po.

OFICERI — Të kemi mendjen atëhere. Befasitë kanë bërë të dështojnë shumë plane, sado të studjuara që janë dukur në kartë...

SS-i — Sido që të ndodhë, minat do të plasin.

OFICERI — Do të pëlcasin! Plani është i thjeshtë dhe i tmerrshëm... gjithë qyteti do të marrë flakë. Bukur! Bukur! Minat këtu brenda, artileria nga kordat dhe qyteti bëhet gërmadhë, Bukur! Bukur!... (Hyn një ushtar gjerman, duke vrapuar, i tmerruar, ndërsa jashtë dëgjohen plasje mortajash dhe luftime)

USHTARI — (Me zor mban frymën) Zoti kapiten, më lejoni të raporto...

OFICERI — (*Duke kuptuar gjendjen, përpigjet të tregohet gjakftohtë*) Qetësohuni një herë!... (*I hedh shishen e konjakut*) Pini konjak! (*Ushtari pi konjakun*) Tani flitni. Tregoni gjendjen, ashtu siç është. Nuk dua asnë zbukurim.

USHTARI — Pozicionet e fortifikuara të Hoteli i madh, ato në krye të bulevardit dhe ato...

OFICERI — (*Nervozi*)... në rrugën e pazarit u zënë nga partizanët, kështu?..

USHTARI — (*Habitet*) Atëhere ju e dini, zoti kapiten!..

OFICERI — Jo, por e mora me mend, porsa vutë këmbë te porta...

USHTARI — Më falni... (*Heshtje*) Si janë punët, zoti kapiten?

OFICERI — Rrethi po ngushtohet. Presim përforcime...

USHTARI — Nga, zoti kapiten?

OFICERI — (*Bërtet*) Gatit! (*Ushtari gjerman merr qëndrim gatit*) Që kur ushtari i Raihut të tretë i lejon vetes pyetje të tilla?

USHTARI — Më falni, zoti kapiten, mbasë nuk u shpjegova, nuk kisha në mend atë që me të drejtë ju zemëroi.

OFICERI — Folë, atëhere, ç'kishe në mend?

USHTARI — Ç'presim akoma, zoti kapiten, pse nuk hakmerremi, pa asnë ngurrim, pa na u dridhur dora...

OFICERI — (*SS-it*) E dëgjoni, toger?!... (*Ushtarit*) Të lumtë! Shko tani. (*Ushtari del*) Ja pse ne kemi qenë ushtria më e fortë në botë...

SS-i — Thatë: kemi qenë, zoti kapiten?...

OFICERI — Dimri në Rusi, Stalingradi... Partizanët në shpinë të frontit, edhe këtu në Ballkan... Afrika dhe bombardimet mbi Gjermani do të kishin lo-dhur çdo ushtri tjetër... (*Papritur*) Por ne jo!... (*Duke treguar andej nga doli ushtari*) E dëgjove?

SS-i — Atë që tha për hakmarrjen?

OFICERI — Atëhere të jeni gati, toger... Gati...

SS-i — Urdhërin, zoti kapiten, presim vetëm urdhërin...

OFICERI — (*Dëgjohet zhurmë aeroplanësh, dëgjon me vëmendje, pas pak*) Janë anglezë. Në kalim... Gjurmojnë më thellë. Nuk i hëngri meraku për këtu ata.

SS-i — Nuk i dihet. Kanë edhe ata interesat e tyre.

OFICERI — Thuhet se anglezët e zenë lepurin me qerre.

SS-i — Jo gjithmonë...

OFICERI — Atë them edhe unë. Politikë e ndyrë... (*Kthehet te hartat e hapura mbi tavolinë*)

SS-i — (*Merr një shishe tjetër konjak, dy gopta dhe afrohet te tavolina, ku është oficeri*) Doni, zoti kapiten?

OFICERI — Çfarë?

SS-i — Konjak. (*I tregon shishen*)

OFICERI — Kot mundoheni të qetësoni veten toger... (*Heshtje*) Konjaku nuk e ka atë fuqi.

SS-i — Keni të drejtë... (*Lë shishen e konjakut dhe gotat mbi tavolinë*)

OFICERI — Kemi pasur ndonjëherë miq në këtë vend, toger?

SS-i — Kemi pasur, të pakët, por kemi pasur...

OFICERI — Ku janë? Mbështetja politika nuk i shkon shumë një ushtari, por e kam thënë edhe një herë, duhet të kishim punuar më mirë me ta.

SS-i — U përpinqëm, si kudo. Por, si duket, këtu qe ndryshe.

OFICERI — Ç'u bë me atë komandantin ballist? Sikur të mori përsipër të gjente kafexhiun me të birin.

SS-i — Kam një farë shprese... Kur japid fjalën këta, e bëjnë atë që thonë. (*Jashtë bien shumë predha, më afër se herë të tjera*) Duket po i vjen fundi... (*Bien predha të tjera*)

OFICERI — Artileria nga kodrat nuk po dëgjohet

akoma. (Në trotuar vijnë një grup familjarësh ballistë e kuislingë, ndër ta edhe Rrema dhe Zenullai me valixhe e plaçka në duar, që presin maqinat për të ikur) Ç'janë këta?

SS-i — Ah, po, janë nga ata që bashkëpunuan me ne. Presin maqinat. Këto ditë kemi pasur edhe një urdhër nga komanda e garnizonit për t'i ndihmuar.

OFICERI — Nuk kemi hallin e tyre tanë. (Afrohet te hartat. Brenda errësohen)

GRUAJA E PARË — Për pak mbaruam.

DOLFI — Mama, mama, ulu këtu!

GRUAJA E DYTË — Kostikë, lëri valixhet në tokë!

BURRI I PARË — Mbulohu me batanie se fryn.

PLAKA — O zot, c'gjynahe po lajmë?!...

ZENULLAI — Për pak na bënë copë.

RREMA — Thua të vijnë maqinat?

ZENULLAI — Unë këshfu e lashë fjalën, por dreqi e di.

GRUAJA E DYTË — Pse nuk do të vijnë maqinat?

BURRI I PARË — Do të vijnë, moj zonjë, patjetër do të vijnë...

DOLFI — Baba, këtu do të vijnë maqinat?

PLAKA — O zot, c'gjynahe po lajmë?!...

GRUAJA E DYTË — Kostikë, i more të gjitha?

LECI — (Duke hyrë, i drejtoshet Kostës) Zotëri, ti lustroj këpucët? Si duket, keni për të bërë rrugë të gjatë... (Dolfit) Llapush, për ku je nisur këshfu?

DOLFI — Pse, do të vish edhe ti? Nuk të marrim, jo...

RREMA — (Lecit) Ik, more ti, te këpucët e pas-kemi mendjen ne tanë!... Thyej qafën, lëre rehat edhe Dolfin!

BURRI I PARË — Mirë thua, ku na bie në mend për këpucët neve tanë!...

LECI — Nuk e di si e thoni këtë!... E, pra, në kësi rastesh te këpucët të shkon mendja, në radhë të parë... «Këmbët e lehta dhe faqja e bardhë», këshfu

thonë... Megjithëse më mirë i shkon «faqja e zezë...»
(Dëgjohet një zhurmë maqine)

GRUAJA E PARË — (Bërtet) Maqinat! (Të gjithë bëhen gati dhe fillojnë të lëvizin në një kohë. Zhurmë)

LECI — (Qeshet fort) Ha-ha-ha!... S'ka maqinë as karro që e mban këtë pleh!... Vetëm karroca e babait tim, ajo po, është tamam për këta... (Vëzhegjon edhe nië herë rrëth e rrrotull dhe del)

ZENULLAI — Nuk u ndal, ishte maqinë ushtarakë...

PLAKA — O zot, ç'gjynahe po lajmë?!...

DOLFI — Baba, kur do të vijë maqina jonë?

RREMA — (Dolfit) Mos bërtit!

GRUAJA E PARË — Kujtuam se erdhi, më në fund... Por jo...

PLAKA — O zot, ç'gjynahe po lajmë?!...

GRUAJA E DYTË — Se do t'ja arrinim kësaj ditë, vec për këtë nuk na pat shkuar mendja ndonjë herë.

RREMA — Na pat shkuar mendja, zonjë, na pat shkuar, por u mbajtëm me shpresë.

ZENULLAI — Atë thuaj...

GRUAJA E DYTË — Kostikë, lëre në tokë valixhen. është e rëndë, prandaj...

DOLFI — Baba, po shtëpinë tonë kush do ta ruajë?

RREMA — I kemi mbyllur dyert me çelës.

DOLFI — Po ata hyjnë nga dritaret.

RREMA — I kemi mbyllur edhe dritaret, me gozhdë bile.

DOLFI — Po ata do t'i thyejnë.

RREMA — (Nervoz) Le t'i thyejnë, akoma nuk u ka dalë flaka?... Nuk kemi atë hall tani.

ZENULLAI — (Plakës) Mos u mërzit se prapë. prapë do të kthehem...

GRUAJA E PARË — Vec të ikim, pa nuk do të më zërë malli...

GRUAJA E DYTË — (*Papritur*) Korba unë!...

KOSTA — C'pate?!

GRUAJA E DYTË — Takëmet, ku i kam takëmet?!

KOSTA — Cilat takëme, moj e zezë?

GRUAJA E DYTË — Takëmet me unaza, me byzlykë e me relike. Të gjitha i harrova...

KOSTA — Ku, moj, i harrove?

GRUAJA E DYTË — Nën jastëk, te dhoma e gjumit... Do t'i kenë marrë?... Korba unë, na panë kur ikëm?...

KOSTA — Pika ty! Po sa herë të thashë, moj e shastisur, sa herë të porosita.

GRUAJA E DYTË — Po ne ikëm si të marrët, more Kostikë, si të marrët... .

GRUAJA E PARË — (*Rremës*) Po ti i more ato që kishe atje në kopsht, te fundi i dardhës?

RREMA — I mora, i mora...

DOLFI — Baba, çfarë kishe fshehur ti atje në kopsht?

RREMA — Pusho, more llapush!...

GRUAJA E DYTË — (*Kostës, që le valixhen dhe del me vrap*) Na, more Kostikë, ku shkon?

KOSTA — Po shkoj t'i marr.

GRUAJA E DYTË — Dale, more Kostikë, do të humbim edhe maqinat... Apo do të hash edhe ndonjë plumb kokës?...

GRUAJA E PARË — Po ç'u bënë edhe këto maqinat?... (*Rremës*) Sa keni porositur, një apo dy?

RREMA — Dy. (*Shikon jashtë*) Tani duhet të vijnë...

BURRI I PARË — Po sikur të mos vijnë?

RREMA — Nuk është e mundur, kemi paguar gjysmën e parave... (*Dëgjohen plasje mortajash. Tmerrohen të gjithë*)

PLAKA — O zot, ç'gjynahe po lajmë?...

ZENULLAI — Ka kaq ditë, e sidomos këto dy ditët e dy netët e fundit, që s'na dëgjojnë gjë tjetër veshët veç bum-bum...

RREMA — More, të ikim pa dëgjuar atë bumin e madh... Këta nuk ikin jo, pa e hedhur në erë gjithë qytetin...

ZENULLAI — Mirë thua ti. Dje më erdhi në shtëpi edhe ai nipçja, ishte bërë si lugat. «Akoma nuk keni ikur? — më tha. — Ikni sa më parë, se u pa kjo punë». «Po ti?» — i thashë. «Edhe unë do të iki, më tha, por kam edhe pak punë.»

RREMA — Po ai sikur kishte shpresë...

ZENULLAI — Kishte... Kishte...

GRUAJA E PARË — (Gruas së dytë) E keni larg shtëpinë, zonjë?

GRUAJA E DYTË — Jo edhe aq... Korba unë, ç'bëra, ç'bëra!...

GRUAJA E PARË — Kishe gjëra të çmueshme shumë?

GRUAJA E DYTË — Kisha, zonjë, shumë kisha...

PLAKA — O zot, ç'gjynahe po lajmë?! (Duket Kosta, i cili vrapon si i marrë, rrëzohet dhe bën të ngrihet, me zor merr frymë)

GRUAJA E DYTË — (Duke iu afruar) Ngreu, more Kostika, ngreu...

KOSTA — Erdhën maqinat, mos shkuan?

GRUAJA E DYTË — Jo, nuk erdhën...

KOSTA — Po sikur kaluan disa maqina?...

GRUAJA E DYTË — Jo, nuk pamë gjë... I gjete?

KOSTA — Nuk arrita dot. Në lagjen tonë kishin hyrë partizanët... (Të gjithë tmerrohen)

GRUAJA E DYTË — Po tani?...

KOSTA — Të shpëtojmë kokën një herë... Koken...

BURRI I PARË — (Bërtet) Maqinat! Po vijnë maqinat!... (Përsëri lëvizje. Dalin me vrap. Brenda hapen dritat. Oficeri dhe SS-i punojnë mbi harta)

OFICERI — (Pasi bën disa shenja mbi hartë me laps) Rrethi sa vjen dhe ngushtohet. Toger, po vjen koha ta thuash fjalën.

SS-i — Çdo gjë është gati, presim vetëm sinjalin: qitjet e para të artilerisë nga kodrat dhe...

OFICERI — (*Papritur*) Po sikur?...

SS-i — (*Shpejt*) Çfarë, zoti kapiten?! Mbase nuk ju dëgjova mirë...

OFICERI — (*Qetësohet*) Asgjë, asgjë... (*Jashtë bien predha dhe thellë dëgjohet luftë*) Si duket, kjo do të jetë nata e fundit... (*Duke shikuar përjashta*) Ky qytet mban mend shumë gjëra... Por ata që do të mbeten, nuk do ta harrojnë sa të jenë gjallë këte natë...

SS-i — Pse, ju mendoni që me doemos sonte?..

OFICERI — Nuk e di edhe unë pse mendoj përsonte. Nesër, mbase, do të jetë vonë... (*Bien predha të tjera*)

SS-i — Artilleria te kodrat nuk po dëgjohet akoma...

OFICERI — (*Papritur*) Po sikur të mos dëgjohet?...

SS-i — Është e dyta herë që e përsëritni, zoti kapiten, çfarë ju shqetëson?...

OFICERI — (*Nervoz*) O perëndi, s'ka në mend të erret sonte!... (*Bien predha të tjera. Papritur dëgjohet luftë, jo shumë larg. Hutim. Një ushtar hyn shpejt*) Ç'është kështu?

USHTARI — Nuk e di, zoti kapiten, nuk u muar vesh nga dolën, sikur mbinë nga dheu, veç kur na ranë...

OFICERI — (*Bërtet*) Toger!

SS-i — (*Duke marrë qëndrim gatitu*) Urdhëroni, zoti kapiten.

OFICERI — Bëhuni gati!

SS-i — Gati përsë?

OFICERI — Gati për minat.

SS-i — T'i plasim, zoti kapiten?!

OFICERI — Më duket erdhi koha.

SS-i — Po sinjali?.. Akoma nuk është dhënë sinjali...

OFICERI — Kush e di ç'u ka ndodhur, mbase...

SS-i — C'doni të thoni me këtë, zoti kapiten, nuk është e mundur!

OFICERI — I kërkonë në telefon një herë, flisni me ta...

SS-i — (*Shkon në dhomën përballë, atje ku është telefoni dhe pas pak del i shqetësuar*) Telefoni nuk punon, zoti kapiten!..

OFICERI — (*Bërtet*) C'do të thotë: «nuk punon»??

SS-i — Mbështetës ndonjë bombë...

OFICERI — (*Prerë*) Ose ndonjë gjë tjetër...

SS-i — E pamundur...

OFICERI — (*Hidhur*) Është vendi i të papriturave, vetë e thatë, toger.

SS-i — (*Duke marrë qëndrim gatitu*) Jepni urdhërat, zoti kapiten, jam gati.

OFICERI — (*Jep komandë*) Të plasen minat, toger!

SS-i — Si urdhëron, të plasen minat. (*Hyn në dhomën përballë. Heshtje, pas pak del i tmerruar*) Minat nuk plasen, zoti kapiten... Gjithë sistemi i plasjes nuk vepron!...

OFICERI — (*Bërtet*) C'thoni kështu, toger?... E kuptoni atë që thoni?! Është e pamundur!... (*Nervoz*) C'më rrini ashtu me gojë hapur?... Përdorni rezervën... Lëvizni de... C'prisni, pse më shikoni ashtu, sikur s'më keni parë...

SS-i — E provova, zoti kapiten, nuk veproi edhe ajo!... (*Fare pranë dëgjohen të shtëna pushke*)

OFICERI — (*Bërtet*) Nëpër vende! (*Shpejt zënë vend kipateni, togeri dhe ushtorët. Bie një bombë. Edhe një tjetër. Dëgjohet automatiku. Togeri mbetet i vrarë te porta përballë. Kapiteni bie mbi tavolinë pa frysë. Bie Edhe një ushtar më tutje. Te porta duket Agimi i vesur partizan, si dhe disa partizanë të tjera*)

AGIMI — (*Afrohet, shtyn me këmbë togerin, hap portën përballë dhe hyn brenda bashkë me një tjetër, pas pak del dhe afrohet te arkat që pat lënë në një*

qoshe afër dhomës përballë) Në rregull, çdo gjë në rregull.

NJË PARTIZAN — Pata frikë mos i kapte ndonjë plumb dhe shpërthenin...

AGIMI — Unë pata frikë për atje brenda, mos qenë kujtar dhe e kishin rregulluar... (*Bien, aty pranë, dy predha artilerie*) Filloi!..

PARTIZANI — Çfarë?!

AGIMI — Artileria, atje te kodrat... (*Vë vesh mos bien predha të tjera. Heshtje*) Jo, nuk është ajo. Se ç'presin akoma!..

PARTIZANI — Çfarë mund të presin?

AGIMI — Nuk e di... Kot nuk ka heshtur ëri tani... Dhe derisa ajo të jetë atje, qyteti është në rrëzak... (*Partizanëve fort*) Të pastrohet vendi!... (*Një partizan ka parë atje në një qoshe partizanin e torturuar që vdiq*)

PARTIZANI — (*Agimit*) Shoku komisar! (*Tregon partizanin e vdekur. Afrohen të gjithë. Heshtje. Ata përshëndetin me grusht*)

— Bie perdja —

DITA E DYMBËDHJETË

(*Mbrëmje*)

Kur hapet perdja, jashtë ka lëvizje: partizanë e qytetarë bartin trarë, voza e materiale të tjera për ndërtimin e barrikadave. Në mes të tyre është edhe Agimi. Brenda janë anëtarët e shtabit të një batalioni, të cilët punojnë mbi një hartë.

AGIMI — (*Jashtë, u drejtohet dy partizanëve*) Shpejt, shpejt, shokël!..

PARTIZANI I PARË — Do të kemi dasmë sot, shoku komisar... E çfarë dasme!..

PARTIZANI I DYTË — Thonë se atje te Qafa e

Dushkut po bëhet kërdia me atë kolonën gjermane, s'do të mbetet gjë për ne.

AGIMI — Do të mbetet, do të mbetet... Pastaj gjermanët janë akoma në qytet...

PARTIZANI I PARË — Dhe artileria atje te kodrat...

AGIMI — Këtë desha të them: qyteti është akoma në rrezik.

NJË QYTETAR — Qytetit i marrin të keqen.

AGIMI — Armiku është i egër dhe dinak. Derisa nuk ka hedhur armët, është gjithmonë i rrezikshëm, prandaj... (*Ndihmon një partizan, që mbante diçka të rendë dhe të dy bashkë dalin*)

QYTETARI I TRETË — (*Duke hyrë, drejtohet nga spektatorët*) Fashistët nuk do ta harrojnë kurrë atë që pësuan këto ditë. Qyteti ynë u bë varri i mbeturinave të ushtrisë hitleriane në Shqipëri.

QYTETARI I PARË — (*Duke u drejtuar edhe ai nga spektatorët*) U dukën të fortë, u treguan edhe më të egër, dhe ja ku përfunduan!.. Ngado që hedh sytë, gjermanë të vrarë, tanke dhe maqina të shkatërruara, kuaj e karroca... Rrugët e sheshet janë mbushur plot, nuk ke nga të kalosh.

QYTETARI I TRETË — Me urë në dorë i vunë flakën Evropës... E shpallën veten mbrojtës të qytetimit. Uluritën për një rend të ri.

QYTETARI I PARË — Gjak dhe shkatërrime, ja rendi i tyre i ri...

QYTETARI I TRETË — Kudo që shkeli këmba e tyre, këto lanë nga pas.

QYTETARI I PARË — Thonë se qyteti është përsëri në rrezik.

QYTETARI I TRETË — Artileria atje te kodrat, minat nëpër qytet dhe tani ajo kolonë e madhe gjermane që po vjen nga jugu, si tri fantazma vërtiten rrëth qytetit tonë, duan ta shkatërrojnë.

QYTETARI I PARË — Unë po mendoj për qytetin. Do të shpëtojë?..

QYTETARI I TRETE — Unë mendoj edhe për qytetin, edhe si do të zhduket kjo kolerë që kaloi në-për vendin tonë.

QYTETARI I PARË — (*Qytetarit të tretë*). Si thatë?

QYTETARI I TRETE — Kjo kolerë...

QYTETARI I PARË — (*Duke shikuar nga Qytetari i tretë, përsërit fjalët e tij*) Fantazma... kolerë... Mirë thotë...

QYTETARI I TRETE — (*Rreptë*) Bashkë me pjellën e tyre, tradhëtinë.

QYTETARI I PARË — (*Duke shikuar nga Qytetari i tretë pak i habitur*) Bashkë me ata që i ndihmuani, me ndërgjegje, ose jo...

QYTETARI I TRETE — (*Prerë*) Unë fola për tradhëtarët, ata nuk ndahen në të ndërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm... As në të afërt e të largët... (*Dalin ata dhe gjithë partizanët e qytetarët e tjerë. Errësos het jashtë. Brenda, bashkë me shtabin, është edhe Agimi*)

KOMANDANTI I BATALIONIT — (*Agimit, i cili mendohet*) Çfarë mendon?

AGIMI — Për artilerinë atje te kodrat.

KOMANDANTI I BATALIONIT — C'mund të bëhet?

AGIMI — Nuk e di akoma... (*Heshtje*)

KOMANDANTI I BATALIONIT — Minat u hoqën

AGIMI — Sistemi i shpërthimit të tyre u shkataerrua, por minat janë atje ku ishin.

NJË ANËTAR I SHTABIT — Kemi kërkuar të vijnë specialistë, vetë nuk i heqin dot...

KOMANDANTI I BATALIONIT — Vazhdojmë: shokë, duhet të veprojmë. Gjendjen e kemi të qartë: që dje luftimet morën një drejtim tjetër. (*Duke treguar në hartë*) Kolona gjermane, që u nis nga jugu në drejtim të qytetit tonë, e përforuar me tanke, topa e shumë mjete të tjera, arriti dje te Qafa e Dushkut. Atje mori goditjen e parë nga forcat tona, por pas dhjetë

orë lufte të ashpër ato u têrroqën pak më thellë. Siç e shikoni, epigendra e luftimeve kalon tani nga qyteti, jashtë tij. Çdo gjë varet tani nga këto luftime...

AGIMI — Edhe fati i qytetit...

KOMANDANTI I BATALIONIT — Edhe i qytetit, edhe i forcave tona këtu në qytet.

AGIMI — (*Papritur*) Armiku mendon t'u bjerë prapa shpine forcave tona, kështu?

KOMANDANTI I BATALIONIT — Kështu. Të futet në qytet, të bashkohet me mbeturinat e garnizonit të rrethuar dhe të têrhiqet për në veri.

AGIMI — (*Duke vazhduar mendimin e tij*) Atëhere, dhe jo më parë, do të hyjë në veprim dhe artilleria nga kodrat, kështu?

NJË ANËTAR I SHTABIT — E drejtë, shumë e drejtë... Artilleria nuk ka asnjë arësyte të qëllojë më përparrë.

AGIMI — E qartë: kjo është arësyjeja që edhe ka heshtur deri tani. (*Hyn një partizan*)

PARTIZANI — (*Duke i dhënë një letër komandanit të batalionit*) Nga shtabi i brigadës. (*Komandanti i batalioni hap letrën dhe lexon pa zë. Ndërkokë partizani përshtendet dhe del*)

KOMANDANTI I BATALIONIT — (*Duke mbajtur në dorë letrën*) Shtabi i brigadës njofton se në këto kushte ndryshon edhe taktika jonë. Parulla «Qyteti të shpëtohet dhe të çlirohet me çdo kusht» zëvendësohet me parullën «Rezistencë, me çdo kusht, në qytet dhe të asgjesohet, me çdo kusht, kolona që vjen nga jugu». (*Duke treguar në hartë*) Konkretisht: forcat që janë në qytet, duhet t'u rezistojnë, me çdo kusht, ku ndërsulmeve të armikut dhe forcat që janë jashtë qytetit të asgjësojnë, me çdo kusht, kolonën që vjen nga jugu. (*Një grup prej tre partizanësh hyn nga porta përballe, duke kaluar pranë tavolinës, ku është Agimi me të tjerët; njëri prej tyre raporton duke përshtendet me grusht*)

PARTIZANI — Çdo gjë në rregull. Mund të shkojmë tani?

AGIMI — (Partizanëve) Shkoni. (Partizanët dalin)

KOMANDANTI I BATALIONIT — (Agimit e të tjerëve) E qartë?..

DISA PREJ TYRE — E qartë... E qartë.

KOMANDANTI I BATALIONIT — Atëherë secili në vendin e vet. (Përshëndeten dhe fillojnë të shpërndahen. Disa dalin. Bëhet gati për të dalë edhe Agimi. Hyn Leci dhe, pas tij, Mediu, Agimi, porsa e sheh Medium, i del përpëra)

AGIMI — Shumë mirë që erdhe pikërisht tani. Po të kërkoj nga të gjitha anët...

MEDIU — Porsa më lajmëruan, erdha me një frysë. «Nuk më ka harruar» thashë me vete dhe, të them të drejtën, m'u bë qejfi.

AGIMI — Si mund t'ju harroj unë?! Po si jeni? Si është Vjollca? Te shtëpia të gjithë mirë?...

MEDIU — Mirë, të gjithë mirë... Vjollca është veshur partizane... Nuk e ke takuar?!

LECI — E takova unë, me një automatik... (Agimit) Edhe unë dua automatik...

NJËRI NGA ANËTARËT E SHTABIT — (Duke dalë, i drejtohet Agimit) Shoku komisar, unë po shkoj përpëra.

MEDIU — (Përsërit) «Shoku komisar!...» (Agimit) Atëherë ti nuk ishe një partizan kushdo!

LECI — Në qoftë se sot, deri në mbrëmje, nuk më gjen automatikun që më ke premtuar, nuk e di ç'do të bëj...

AGIMI — Ku e ke lustrën?...

LECI — Lëre lustrën, dua automatikun unë.

AGIMI — Mirë, nesër.

LECI — Jo, sot. Ku ta di unë ç'ndodh nesër?

MEDIU — (Agimit) Si duken punët?

AGIMI — Një kolonë gjermane po vjen nga jugu...

MEDIU — Pse më thirre?

AGIMI — Ke të drejtë, humbëm me fjalë... Të thirra, e para, desha të takohesha pas gjithë atyre që hoqëm; e dyta, të të dorëzoj kafenenë, prandaj... (*Papritur*) Do të më falësh. Më presin... Po do të piqemi përsëri... (*Duke i zgjatur dorën*) Mirupafshim... (*Përqafohet dhe bën të dalë*)

MEDIU — (*Duke u kujtuar për diçka*) Hë!... (*Agimi qëndron*) Rrugës, kur po vija këtu, pashë gjermanë robër; ndër ta edhe shqiptarë, sigurisht ballistë... Ku i çonin?

AGIMI — (*Habitet*) Nuk e di. Pse?

MEDIU — Ashtu kot... Se si m'u kujtua kur ata vritnin rrugëve njerëzit tanë...

AGIMI — (*Dyshon për diçka dhe afrohet*) Ti mendon për Zaimin!...

LECI — (*Bën sikur shtie me automatik*) Gërr, gërr, gërr... Kështu do të doja ta grij!... Por dreqi e di, mbapse ka ikur. E di ç'më tha Vjollca? «Po e zura, do ta vras me dorën time». Dhe e vret ajo... (*Jashtë, jo shumë larg, bien dy predha artillerie. Heshtje*)

MEDIU — Po këto?

AGIMI — (*Afrohet te dritarja, i shqetësuar*) Nga kodrat, na kujtojnë herë pas here. (*Larg dëgjohet luftë*) Ndërsa në shumë pika të qytetit luftohet akoma.

MEDIU — Kush lufton?

AGIMI — Gjermanët... Edhe ndonjë tradhëtar, si Zami... Për atë e kishe fjalën?

MEDIU — (*Pendohet që e hapi këtë çështje*) A e di çfarë? E lëmë më mirë këtë çështje... Kot e hapa edhe unë. Kam boll plagë, s'mbeti ajo për ta prekur sot...

AGIMI — Derisa ti e quan plagë, mbapse është më mirë ta prekim. Në asnje mënyrë nuk duhet lënë të majiset...

MEDIU — (*Prerë*) Kush të tha se ka rezik të majiset? Në asnje mënyrë, mos u bën merak...

AGIMI — (*E shikon gjatë në sy*) Në raste të tilla operacioni duhet bërë shpejt. Sëmundje të tilla janë të rrezikshme...

MEDIU — (*Pasi mendohet pak*) Nuk ka ndonjë sëmundje të tillë tek unë, jo... Rri i qetë për atë...

AGIMI — Mirë... Dua të jetë kështu... (*Duke i shtrirë dorën edhe një herë*) Mirë u pafshim, edhe një herë!... (*I shtrëngon dorën fort dhe bën të dalë. Lecit*) Do të vish të marrësh automatikun?

LECI — Menjëherë. (*Dalin të dy bashkë*)

MEDIU — (*Duke shikuar andej nga doli Agimi*) Ku dreqin më dolën përpëra ata shejtanë... Dreqi më shtyri edhe mua ta hap këtë bisedë me të... Apo nuk ja njoha kokën?... (*Fillon të vëjë rregull në kafene. Jashtë duket Qytetari i parë, i cili pas pak hyn brenda*)

QYTETARI I PARË — (*Duke shikuar nga të kater anët në kafene*) Unë kujtova se qe shkatërruar fare, me ç'dëgjova...

MEDIU — Pse, çfarë dëgjove?

QYTETARI I PARË — Si më thanë, pa kush pa gjë! Këtu, valla, gjermanët kishin qendrën, prej nga mund të plasnin të gjitha minat, të gjitha apo një pjesë, nuk e di mirë... Dhe do t'i kishin plasur, sikur të mos kishin sulmuar partizanët dhe të mos ishte kryer çdo gjë në pak sekonda, sa hap e mbyll sytë... Kështu është?...

MEDIU — Edhe unë nuk isha, por kështu më treguan...

QYTETARI I PARË — Pra qenka e vërtetië... (*Hyn Qytetari i tretë, i cili është i egërsuar, dikë kërkon*) Mirë dita!

QYTETARI I TRETË — Mirë dita!...

QYTETARI I PARË — Kë kërkon kështu?.. Eja të pimë një kafe...

QYTETARI I TRETË — Jo, jo, nuk kam kohë...

Po kërkoj njërin... Kujtova mos është këtu.

QYTETARI I PARË — Cilin kërkon?

QYTETARI I TRETË — Një mikun tim... edhe tëndin. Po do ta gjej, do ta gjej se s'bën... (*Duke lëvizur nga vendi*) Nuk ka se ku të shkojë... (*Del*)

QYTETARI I PARË — (*Mediut*) Për kë e kish fjalën, cilin kërkonte ashtu?

MEDIU — Nuk e mora vesh... Qe egërsuar, xi-xa nxirrte nga sytë. E vure re?...

QYTETARI I PARË — E pashë... Në fillim mezi e njoha... (*Pas pak*) Po ku e kishim fjalën?... Hë, domethënë këtu e kishin qendrën nga do të plasnin minat?!

MEDIU — Po, këtu.

QYTETARI I PARË — Ku, në atë dhomën atje? (*Tregon dhomën përballë*)

MEDIU — Po, atje.

QYTETARI I PARË — Dhe këtu rrnim ne. Vinin edhe njerëz të tjerë. Si në kafene... Nuk kanë qenë aq budallenj, jo... Nejse, veç kur u dukën partizanët te porta... Si më thanë, po kush i pa... Gërrrr bëri automatiku dhe si kosa i griu, duke rrëzuar përtokë të gjithë sa qenë këtu brenda... (*Ka hyrë Qytetari i dytë*)

QYTETARI I DYTË — Dhe kosa vazhdon të bëjë punën e saj, çdo ditë dhe çdo orë.

QYTETARI I PARË — (*Duke u kthyer nga ai*) Ah, ti qenke?! Si the?

QYTETARI I DYTË — Thashë kosa po bën kërdinë...

QYTETARI I PARË — Mirë bëjnë, asnjë mëshirë për armiqtë, ashtu si edhe ata nuk patën për ne...

QYTETARI I DYTË — Sikur të ishte kjo vetëm për të huajt, edhe shpjegohet...

QYTETARI I PARË — Unë thashë për armiqtë: të huaj ose të vendit qofshin.

QYTETARI I DYTË — Shqiptari po vret shqipatarin, këtu ta kam fjalën unë...

QYTETARI I PARË — Ata që kanë tradhëtarë nuk janë më shqiptarë...

MEDIU — (*Qytetari të dytë*) Pse, si është puna?

QYTETARI I DYTË — Atje në një hendek, bashkë me gjermanë dhe kafshë të ngordhura, më zuri syri edhe disa shqiptarë të vrarë...

QYTETARI I PARË — Thuaj disa tradhëtarë.

(Jashtë kalojnë partizanë, të cilët këndojnë një këngë kundër armiqve e tradhëtarëve)

MEDIU — Kush i kishte vrarë?

QYTETARI I DYTË — Partizanët, kush tjetër?...

MEDIU — Nuk e besoj...

QYTETARI I DYTË — Edhe unë nuk desha ta besoja...

QYTETARI I PARË — (*Rreptë*) Gënjen!

QYTETARI I DYTË — Përse gënjej, për atë që i pashë të vrarë?.

QYTETARI I PARË — Jo, për atë që gjoja nuk deshe ta besoje.

QYTETARI I DYTË — Mbrëmë vranë 13 veta, disa prej tyre patriotë të njohur. Këtë e dinë të gjithë...

MEDIU — Si i vranë, në luftë?

QYTETARI I DYTË — Jo, i pushkatuan.

MEDIU — Sigurisht, u bënë gjyq.

QYTETARI I DYTË — Jo, pa gjyq

MEDIU — Nuk e besoj.

QYTETARI I DYTË — Ata i morën nga shtëpitë e tyre dhe, e beson s'e beson ti, i vranë.

QYTETARI I PARË — (*Bërtet*) Përsëri gënjen.

MEDIU — Lëre të flasë!

QYTETARI I DYTË — Unë nuk gënjej, po them të vërtetë.

QYTETARI I PARË — (*Mediut*) Gënjen, usta, gënjen! (*Qytetarit të dytë*) Atëherë të themi të gjithë të vërtetë: deri dje, kur vrisin gjermanët... që të tre ne i kemi parë me sytë tonë, ja këtu dhe atje te cepi i rrugës, ti nuk e ngrite zërin, përkundrazi...

QYTETARI I DYTË — (*I zënë keq*) Si, përkundrazi?:.. Pastaj, ç'ke që bërtet? Unë po them atë që pashë... Po them, në fund të fundit, një të vërtetë...

QYTETARI I PARË — Varet kë quan të vërtetë.

QYETARI I DYTË — Atë që quajnë të gjithë.

QYTETARI I PARË — Edhe e vërteta është relative. Njerëzit nuk mbajnë të njëjtin qëndrim ndaj saj.

QYTETARI I DYTË — Unë nuk kam ndonjë interes në këtë mes: më ra në sy dhe e thashë...

QYTETARI I PARË — E rëndësishme është si dhe pse e the; në dobi të kujt është ajo që the. (*Jastë kalon një grup robërish gjermanë dhe ballistësh. Mediu dhe të tjerët, nga brenda, shikojnë në drejtëm të tyre*)

QYTETARI I TRETË — (*Duke u dale përpara, i mban pak dhe i shikon me radhë*) Nuk është. Phu, farë e keqe!

NJË PARTIZAN — Çfarë kërkon, more shok?

QYTETARI I TRETË — Një djall, nga këta djajtë. (*Tregon ballistët, pastaj i drejtohet një gjermani*) Ah, ti ishe roje këtu, të njoha, ti i vrave ata, ti...

PARTIZANI — Nuk po të marr vesh, një nga këta, (*tregon ballistët*) apo nga këta, (*tregon gjermanët*) kërkon ti?

QYTETARI I TRETË — Pse, kanë ndonjë ndryshim?! Njëloj janë... (*Duke treguar gjermanin me gisht*) Kijeni kujdes këtë. Ka vrarë ky, ka vrarë... (*Tregon ballistët*) Edhe këta kanë vrarë... Prandaj në litar... atje e kanë vendin... të japid llogari për të gjitha... për të gjitha... (*Qytetari i tretë del. Hyn Vasili, i cili sheh Zenullain*)

VASILI — U, Zenullai! Ku ma ke nipçen, Zenulla bej?... Të zunë, eh, nuk ike dot... Po Rremë efendiu iku, apo është futur në ndonjë vrimë?...

ZENULLAI — Ti më njeh, o Vasil, folë, të lutem, u thuaj se nuk kam bërë gjë... Kam shikuar punën time unë, nuk jam marrë me politikë.

VASILI — Kjo është e vërtetë...

ZENULLAI — (*Partizanit*) He, ju thashë se e keni gabim... Më ngatërroni me ndonjë tjetër...

VASILI — Është e vërtetë, politikë nuk di shumë ti, por për të vrarë di... Ai nipçja ty të ka ngjarë... Ku është Zaimi, ku është?...

ZENULLAI — Ik, more i pirë, nuk e kam nip unë atë. Nuk di ç'flet!

VASILI — Jo, sot nuk jam i pirë... Kam vendo-

sur të mos pi më... të mos pi... (*Partizanit*) Ka një nipoçë ky, komandant ballist, një kriminel i vërtetë... Duhet ta dijë ku është.

ZENULLAI — Nuk di gjë jo, nuk di...

VASILI — E di, e di...

PARTIZANI — (*Duke e shtyrë Zenullain*) Hajt, përpara, pa do ta shohim edhe atë: e di apo nuk e di... (*Grupi i robërve gjermanë dhe ballistë bëjnë të dalin*)

VASILI — (*Bërtet*) Kaput gjermanët!... Kriminelët në litar!... (*Ata dalin. Vasili bën të hyjë në kafene, por përbahet*) Jo, kam vendosur... Nuk do të pi... (*Largohet, del. Dalin të gjithë gjermanët e të tjerët*)

MEDIU — Vasili paska marrë zjarr!... (*Bën të dalë për ta thirrur*)

QYTETARI I DYTË — (*Duke mbajtur Medium*) More, lëre Vasilin. Këta, këta të tjerët, i patë ata... (*Tregon andej nga dolën ballistët bashkë me robërit gjermanë*)

MEDIU — I pamë!..

QYTETARI I DYTË — Pyetni, pyetni ku i çojnë.

QYTETARI I PARË — Të lajnë krimet që kanë bërë.

QYTETARI I DYTË — Atëhere unë nuk flas më... Është e kotë.

MEDIU — Çfarë është e kotë?

QYTETARI I DYTË — Lufta zbulon te njerëzit instiktet e kafshës, prandaj...

QYTETARI I PARË — Zbulon edhe fytyrën e vërtetë të disa njerëzve, hedh poshtë maskat...

QYTETARI I DYTË — Nuk po të njoh! Që kur ti kështu?... S'ka veçse pak ditë që nuk të bënte përshtypje asgjë... Ti ishe kaq indiferent për këto gjëra.

QYTETARI I PARË — Isha dhe tani nuk jam më.

QYTETARI I DYTË — Të them të drejtën, nuk po të njoh: ç'ka ngjarë, si ndodhi ky ndryshim?!

QYTETARI I PARË — Të njoha ty, prandaj...

QYTETARI I DYTE — Të lutem!...

QYTETARI I PARË — (Reptë) Përse?

QYTETARI I DYTE — (Ndërron ton) Desha të them: më keni keqkuptuar dhe vazhdoni të më keqkuptoni...

QYTETARI I PARË — (Bërtet) Përkundrazi, të kam kuptuar fort mirë: ti je më i keq se ata, ballistët...

QYTETARI I DYTE — (Duke u têrhequr) Më fal, po me të vërtetë nuk po të marr vesh... Sot nuk po të marr vesh...

QYTETARI I PARË — I poshtër!

MEDIU — (I hutuar) Si the?

QYTETARI I PARË — I poshtër, thashë. Derdh helm nga të katër anët dhe, kur nuk të ngjit, thua «më keqkuptuat». Si të nepërkës e ke atë gjuhë. Je më i keq se ballistët ti, ja ku po ta them, më i rrezikshëm...

AGIMI — (Duke hyrë, u drejtohet disa partizanëve jashtë skenës) Shokë, bëni pak pushim tani, se pas dy orëve duhet të shkoni për të ndërruar të tjerët në barrikada. Nuk i dihet, çdo gjë mund të ndodhë... (Agimi me Vjollcën dhe një partizan tjetër hyjnë brenda)

MEDIU — Hajde, mirë se të vini.

VJOLLCA — (I afrohet Mediut) Baba!

MEDIU — (Pasi e përqafon) Dale, dale të shoh! (Largo het pak) Ta shoh edhe automatikun. (Bien disa predha. Heshtje)

AGIMI — Usta, mund të më jepni një çaj?

MEDIU — Posi, menjëherë. (Duke mbushur gotën e çajit, i drejtohet Vjollcës) Do edhe ti?

VJOLLCA — Unë e marr vetë. (Afrohet te banaku)

MEDIU — (Agimit) Do gjë edhe për të ngrënë, që kur nuk ke ngrënë? (Bien predha të tjera, më të forta)

AGIMI — (Ngrihet dhe shikon jashtë nga xhamet) Jo, është shpejt akoma... (Kthehet përsëri te banaku dhe pi çajin)

NJË PARTIZAN — (*Duke hyrë, i drejtohet Agimit*) Shoku komisar, jashtë kanë sjellë një grup tjetër robërish: gjermanë e ballistë. Ç'të bëjmë me ta?

AGIMI — I çoni atje te të tjerët. Tradhëtarët do t'i kalojnë gjyqit... (*Shikon nga Mediu. Shikimet e tyre kryqëzohen*)

PARTIZANI — (*Duke përvendetur me grusht*) Vdekje fashizmit! (*Del*)

AGIMI — Liri popullit!

QYTETARI I DYTË — Ç'do të bëhet me ta?

AGIMI — Do të jepin llogari për tradhëtinë e tyre, qoftë edhe me kokë... (*I jep fund çajit dhe bën të dalë*)

QYTETARI I DYTË — (*Duke u drejtuar nga spektatorët*) Sa të ashpra dhe sa me lehtësi i tha këto fjalë...

VJOLLCA — (*Duke u drejtuar nga Qytetari i dytë*) Unë them: sa drejt.

QYTETARI I DYTË — (*Mediut*) Edhe ju thoni kështu? (*Agimi ka qëndruar te porta dhe dëgjon*)

MEDIU — (*I vendosur*) Po, kështu them edhe unë.

QYTETARI I DYTË — Pse, pak gjak u derdh?... Gjak shqiptari... Sa jemi ne? Një milion, jo më shumë...

AGIMI — (*Prerë*) Një milion pa tradhëtarët.

QYTETARI I DYTË — (*Me hipokrizi*) Më falni, por këtë gjuhë unë nuk e marr vesh.

AGIMI — (*Kthehet dhe i drejtohet Qytetarit të dytë*) Flitni më qartë: c'doni të thoni?

QYTETARI I DYTË — Jo kaq të ashpër, këtë desha të thosha. Duhet përbajtur... E di, gjakrat janë ndezur, arësyeja ka kaluar në plan të dytë, pasionet në plan të parë, por...

AGIMI — (*Prerë*) Por?...

QYTETARI I DYTË — Pasionet janë pasione, arësyeja duhet të sundojë...

AGIMI — (*Bërtet*) Po ata si u sollën me ne? Edhe pasionet edhe arësyeja i çuan ata në krimë dhe në terror...

QYTETARI — E di... E kuptoj... Dua ta kuptoj
Por ata janë ata, dhe ju jeni ju... Unë nuk po flas me
ata... Po flas me ju... Ata ishin egërsira, këtë e kemi
thënë të gjithë... (*Ndërkokë kanë hyrë edhe 2-3 qytetarë të tjerë, të cilët dëgjojnë këtë diskutim, që shpërtheu papritur*)

VJOLLCA — (*Qytetarit të dytë*) Bjeri shkurt:
ku do të dalësh?

QYTETARI I DYTË — (*Duke u justifikuar*) Thashë një mendim, asgjë më shumë... A thonë se do të
ketë demokraci? E, mirë pra, demokraci do të thotë,
në radhë të parë, liri fjale.

VJOLLCA — Në radhë të parë duhet vënë kufiri
i qartë: liri përse dhe për cilët?

QYTETARI I DYTË — Unë e di se po flas me
njëz që marrin vesh, që kanë arësy, këtyre u them
njëz unë, përndryshtës të hesht më mirë...

AGIMI — (*Duke përbajtur Vjollcën, që bën të flasë*) Pra ne jemi njëz, kështu? Dhe në qoftë se ju
kuptova drejt, duhet të sillemi si njëz: të tregohemi
të arësyeshëm, kështu?

QYTETARI I DYTË — Pak a shumë kështu...

AGIMI — Të mos jemi pra të ashpër... Shqip
kjo do të thotë të jemi të butë... Të jemi zemërgjerë.
Ata na vranë, ne të mos i vrasim, kështu?... (*Bërtet*)
E përse?! Përse duhet kjo... Që të mos na quajnë të
ashpër... Të tregohemi njëz!... (*Shpërthen*) Përralla!...

NJË PARTIZAN — (*Duke hyrë*) Shoku komisar,
ju kërkojnë...

AGIMI — (*Partizanit*) Tani, vetëm dy minuta. (*Partizani del, i drejtohet Qytetarit të dytë*) Është një përrallë e vjetër kjo. Ne komunistëve shpeshherë na e
kanë bërë këtë akuzë: na kanë quajtur të ashpër, të
egër... na kanë akuzuar...

QYTETARI I DYTË — Më falni, por unë...

AGIMI — Po, po... Shpesh dhe nga shumë anë
na kanë drejtuar thirrjen: «jo kaq të ashpër... më të
përbajtur... më njëzorë... më paqësorë...»

MEDIU — Kjo éshtë e vërtetë, kush e di sa herë e kam dëgjuar edhe këtu, në kafene...

AGIMI — (*Prerë*) E, pra, këta njerëz, këta kë-shilltarë hipokritë, asnjëherë nuk e ngritën zërin kur armiku na vriste dhe bënte terror kundër nesh... I kam njojur këta njerëz: dje bekonin egërsinë e armiq-ve, sot ankohen për ashpërsinë tonë.

QYTETARI I DYTË — (*I zënë keq*) Nuk dua të më keqkuptoni... Unë një fjalë thashë... Një fjalë...

AGIMI — (*Bërtet*) Jo, ti nuk the një fjalë... «Të mos jemi të ashpër me armiqtë», nuk éshtë një fja-lë... «Të sillemi me ta si njerëz», edhe kjo nuk éshtë një fjalë!... «Të jemi të arësyeshëm dhe zemër-gjerë me ata që na vranë» as kjo nuk éshtë një fja-lë!... E di si i thonë kësaj?

QYTETARI I DYTË — Jo. Unë, të paktën, nuk pata në mend asgjë...

AGIMI — Kësaj i thonë të futësh lagëشتirën në themelet e revolucionit... t'i bësh varrin atij.

QYTETARI I DYTË — (*Duke u justifikuar*) «Jo kaq të ashpër», kaq thashë unë, mos i ngatërroni gjë-rat, ju lutem...

AGIMI — Unë nuk ngatërroj asgjë, por më pël-qen që gjérat t'i quaj me emrin e tyre të vërtetë!... Ashpërsinë, ashpërsi...

QYTETARI I DYTË — ... dhe humanizmin, hu-manizëm, janë dy gjëra...

AGIMI — (*Prerë*) Kurse unë them se humanizmi ynë qëndron pikërisht edhe në ashpërsinë tonë me armiqtë.

QYTETARI I DYTË — (*Plot hipokrizi*) Më falni, këtë e di gjithë bota, por humanizmi dhe egërsia nuk kanë asgjë të përbashkët...

AGIMI — (*Prerë*) Kanë, jo kurdoherë, por ka-në... (*Duke u afruar te porta përballë*) Gjermanët, po, po... gjermanët, këtu ishin ata, (*tregon portën përballë*) bënë çdo gjë gati, për ta hedhur në erë qytetin. Në emër të kujt?... Ata vranë me mijëra në vendin tonë dhe me miliona në të gjithë botën. Në emër të

kujt?... Në emër të «rendit të ri» fashist, në emër të «qytetërimit kristian». Në këtë rast, sigurisht, humanizmi dhe egërsia, kështu e the ti, nuk kanë asgjë të përbashkët.

QYTETARI I DYTË — (*Sikur bie dakord*) Sigurisht, nuk kanë asnje lidhje.

QYTETARI I PARË — (*Rreptë*) Nuk kanë, jo... Nuk kanë... (*Bien disa predha artilerie*)

AGIMI — Mos edhe këta që shtien nga kodrat me artileri dhe duan ta kthejnë në gërmadhë qytetin e bëjnë këtë në emër të humanizmit?...

QYTETARI I DYTË — Unë nuk thashë këtë...

AGIMI — Jo, jo, ti këtë the. Por nuk je as i pari, as i fundit... Ne nuk i lamë të hedhin në erë qytetin dhe ti e quan këtë ashpërsi! Luftohet atje te kodrat, që artileria të mos e shkatërrojë qytetin dhe ti, përsëri, e quan këtë ashpërsi. Luftohet edhe atje në të dalë të qytetit që kolona gjermane të shkatërrohen para se të futet në qytet dhe ti e quan edhe këtë ashpërsi!... (*Qytetarit të dytë, i cili kërkon të justifikohet*) Po, kështu the ti...

QYTETARI I PARË — (*Rreptë Qytetarit të dytë*) Po, kështu the, kështu...

AGIMI — Kurse ne themi ndryshe: Revolucioni ngre në luftë të shtypurit dhe vepron drejt; kërkon sakrifica, dhe ka të drejtë; likuidon armiqtë, dhe përsëri ka të drejtë. Kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e revolucionit. Këtu po, ashpërsia dhe humanizmi kanë lidhje midis tyre... (*Hyn Qytetari i tretë, i cili, sa e sheh Qytetarin e dytë, zë portën që të mos i ikë*)

QYTETARI I TRETE — Të gjeta, më në fund!... (*Bën t'i hidhet në grykë, por e mbajnë. Partizanëve*) Kapeni, shokë!... Arrestojeni!...

AGIMI — (*Duke ndërhyrë*) Dale, dale ta marrim vesh një herë... (*Qytetarit të tretë*) Si është puna?... Ç'ka bërë?

QYTETARI I TRETE — Ka vrarë... Jo me do-rën e tij, po me gjuhën e tij; një lloj është, ka vrarë...

AGIMI — (*Duke u përbajtur me zor*) Tjetër, kush di tjetër përsa thotë ky? (*Tregon Qytetarin e tretë*)

QYTETARI I PARË — (*Agimit*) Ç'do të thotë kjo?... E çfarë kérkon, dëshmitarë?! Ne, pra, jemi dëshmitarë. A nuk ju mjafton kjo?... Ai (*tregon Qytetarin e dytë*) është sahanlëpirës i gjermanëve, më i keq se ballistët...

MEDIU — (*Agimit*) E dinë mirë ata, e dinë mirë... E di edhe unë... Kanë punuar këta në kanal. Duhet ta kesh parë edhe ti, nuk e mban mend?!...

QYTETARI I TRETË — Nuk e marr vesh: ç'presim akoma, sa do ta zgjatim ne me ta?...

QYTETARI I DYTË — (*Kërcënënjës*) Kush ne?

AGIMI — (*Bërtet*) Ne!... Pse, si të dukemi ne?! (*Partizanëve*) Arrestojeni! (*Partizanët e arrestojnë. Errësohet deri sa fiken dritat*)

— Bie perdja —

DITA E FUNDIT

(*Mëngjez*)

*Kur hapet perdja, jashtë, diku larg, bëhet luftë.
Brenda janë Mediu dhe Qytetari i parë.*

MEDIU — Sot e njëzeta ditë dhe lufta vazhdon. Armiku nuk ka hequr dorë nga plani i tij, do të hakmerret.

QYTETARI I PARË — (*Ngrihet dhe shikon përjashta*) Mitralozi atje te ura nuk po dëgjohet më.

MEDIU — Kurse këtej (*tregon anën tjetër*) luftohen akoma... (*Jashtë kalon një grup partizanësh, duke kënduar një këngë partizane. Mediu dhe Qytetari i parë afrohen te xhamet dhe i ndjekin me sy deri sa largohen. Tani nuk dëgjohet më luftë, por ndonjë krismë e rrallë. Jashtë duken edhe njerëz të tjerë, ka lëvizje*)

QYTETARI I PARË — Di gjë si duken punët?

MEDIU — Unë mirë them... (*Kthehet te bana-ku. Afrohet edhe Qytetari i parë*) Po ti ç'dole kaq shpejt sot?

QYTETARI I PARË — Nuk më rrighet në shtëpi. Më del gjumi që me natë.

MEDIU — Edhe unë, këtu e kalova natën, u zgjova pa zbardhur akoma.

QYTETARI I PARË — (*Duke shikuar jashtë*) Po zbardh!...

MEDIU — (*Shikon jashtë edhe ai*) Po zbardh!...

QYTETARI I PARË — Nuk na rrighet në shtëpi, po nuk na rrighet në asnje vend. (*Drejtohet nga porta për të dalë*)

MEDIU — Dale, ku shkon?

QYTETARI I PARË — Po dal një herë, mos marr vesh ndonjë gjë...

MEDIU — Është shpejt akoma, prit edhe pak.

QYTETARI I PARË — Jo, jo, po dal... Do të vij përsëri. (*Del*)

MEDIU — (*Duke shikuar diku larg*) Trima, luf-tuan si trimat në qytet, jashtë qytetit, dhe atje te ko-drat. Vetëm kështu mund të shpëtojë qyteti... (*Fillon të rregullojë tavolinat. Hyn Zaimi, i cili ka ndrruar krejt veshjen dhe vëren me kujdes brenda e jashtë*) Ç'urdhëroni, zotëri?

ZAIMI — Asgjë. (*Heq kapelen dhe Mediu e njeh*)

MEDIU — Ti?!... Nuk paske ikur ti?!...

ZAIMI — Të ikë?! E pse të ikë?!

MEDIU — Që të shpëtoje kokën, pa të tjerat i ke humbur me kohë.

ZAIMI — Kaq shpejt?!

MEDIU — Si, si the? Fundi i tyre është edhe fu-ni juaj. Akoma nuk e ke marrë vesh këtë?!

ZAIMI — Ku është Vjollca?

MEDIU — Shko gjeje, po deshe.

ZAIMI — E pashë, ishte veshur partizane.

MEDIU — Automatikun ja pe?

ZAIMI — Ja pashë...

MEDIU — I fole?

ZAIMI — Jo.

MEDIU — Pse nuk i fole?

ZAIMI — Sidoqoftë ajo është e fejuara ime... Në bazë të të gjitha rregullave dhe zakoneve.

MEDIU — (*Bërtet*) Nuk e ke marrë vesh ti, o kriminel, se ajo punë ka marrë fund me kohë, që atëhere kur u bëre ballist? Nuk e kuption se nuk ka mbetur më asgjë?

ZAIMI — Më ka mbetur vjehrri. Pse, nuk je ti vjehrri im?

MEDIU — Jo, nuk jam, dhe nuk kam qenë kurë... Unë nuk dua të ta shoh surratin.

ZAIMI — Megjithatë nuk po më tregon tek ata. (*Bën shenjë për partizanët*)

MEDIU — (*I vendosur*) Po, ajo do bërë...

ZAIMI — (*I zë portën*) Bëje, bëje. Do të thonë: «të lumtë, shoku Medi, e ke kuptuar drejt fjalën e partisë...» Po njerëzit, njerëzit ç'do të thonë? «E tregoi nga frika...» Frika, frika deri në palcë ju ka zënë të gjithëve... Ja, këtë deshën ata. Ja arritën kësaj, tanë bëjnë si të duan... (*Shpërthen*) Por jo, nuk do të bëjnë si të duan! Është shpejt akoma...

MEDIU — (*Duke e shikuar thellë*) Ç'do të thuash me këtë? Gjermanët po thyejnë qafën, ky është fundi edhe i ju të gjithëve...

ZAIMI — (*Qesh me zor*) Paske mësuar të flasësh si ata... (*Cinik*) Gjermanët i lanë vetë të futen brenda në qytet, tanë po i rrëthojnë dhe do t'i zënë si miun në çark... Një kolonë e madhe gjermane është nisur dhe nga çasti në çast do të jetë këtu... (*Dëgjohen aeroplanë në fluturim*)

MEDIU — A-ha! Ajo mori fund, qenke prapa botës ti!...

ZAIMI — (*Për aeroplanët*) I dëgjon?

MEDIU — I dëgjoj.

ZAIMI — Janë anglezë.

MEDIU — I kam dëgjuar edhe herë të tjera.
Shkojnë tutje ata, nuk kanë punë këtu...

ZAIMI — Ti thua.

MEDIU — (Bërtet) Thashë ata nuk kanë punë këtu.

ZAIMI — Nuk i dihet...

MEDIU — Shpresat e ngordhura, ashtu si me gjermanët...

ZAIMI — Gjermanët janë akoma këtu... Si kujton ti, ikin ata pa i venë zjarrin qytetit?...

MEDIU — (Bërtet) Deshën, por nuk ja dolën dot... (*Jashtë dëgjohet zëri i Lecit*)

LECI — Komunikatë e fundit!... Rezistenca e gjermanëve në qytet mori fund. Këndoni komunikatën e fundit. (*Hyn brenda*) Usta Medi!... Qyteti u çlirua, ja edhe komunikata e fundit. (*I jep një komunikatë, një tjetër ja jep Zaimit, të cilin nuk e njeh*) Lexoje, lexoje!... (*Del me vrap, duke bërtitur*) Rezistenca gjermane mori fund... Qyteti u çlirua...

MEDIU — (Zaimit, fort) Lexoje, lexoje, mori fund!... Muart fund edhe ju...

ZAIMI — Jo, akoma nuk ka marrë fund...

MEDIU — (Entuziast) Njerëzit për pak do të dalin të gëzojnë fitoren, ti thua akoma...

ZAIMI — (Bërtet) Thashë është akoma shpejt!... (*Tregon portën përballë*) Aty janë ata?

MEDIU — Kush ata?

ZAIMI — Instalimi i minave... Më pat thënë vetë togeri gjerman.

MEDIU — Ç'ke në mend të bësh?

ZAIMI — Atë që nuk bënë dot ata... (*Afrohet te porta përballë*) Dhe dëgjo këtu: mos lëviz nga vendi... (*Nxjerr revolen dhe ja drejton Mediut*)

MEDIU — Ti do të bësh atë që nuk bënë ata?!

ZAIMI — Do ta bëj dhe pa m'u dridhur dora... Mos lëviz!...

MEDIU — Shtjerë! Shtjerë, o kriminel!... Po aty nuk ka më asgjë, more tradhëtar!... (*Zaimi huto-*

het. Mediu e tërheq dhe zë portën përballë) Megjithatë, ti atje mund të shkosh vetëm mbi trupin tim. (*Hyjnë njerëz me zhurmë; një pjesë qëndrojnë jashtë dhe një grup me Qytetarin e parë hyjnë brenda. Kanë në dorë komunikatën e fundit*)

QYTETARI I PARË — (*Duke hyrë*) Usta Medi, ja ç'të reja na solli kjo ditë! Dëgjo, dëgjo këtu!... (*Lexon me zë të lartë*) «Qyteti u çlirua nga brigadat heroike të Ushtrisë Nacional-çlirimtare, të ndihmuara nga populli i qytetit... (*Zaimi zë një qoshe, pasi porta është e zënë. Medium e rrëmbe gjëzimi i përgjithshëm dhe e harron për një minutë Zaimin*)

NJË PARTIZANE — (*Jashtë, lexon me zë të lartë pjesën tjetër të komunikatës*) «Në luftën e përgjithshme rrugë më rrugë e shtëpi më shtëpi kundër një armiku të vendosur e të egër, të armatosur me mjete moderne, vullneti i hekurt i ushtrisë sonë dhe i popullit triumfoi...»

QYTETARI I TRETË — (*Mban një pushkë në krah. Nga një cep tjetër, lexon me zë të lartë pjesën e fundit të komunikatës*) «Gjaku i bijve të popullit, që ranë në këtë betejë për çlirimin e qytetit, shkroi një nga faqet më të shkëlqyera të luftës sonë ngadhënjimtare». Nënshkruan Enver Hoxha. (*Shprehje gjëzimi nga të gjithë*)

QYTETARI I PARË — (*Mediut*) Usta, na sill diçka për të pirë, të festojmë fitoren! (*Hyn një patrullë partizane. Zaimi ë ndjen veten ngushtë dhe afrohet te banaku*)

PARTIZANI I PATRULLËS — (*Mediut*) Ti je i zoti i kafenesë?

MEDIU — Po.

PARTIZANI — Dhe këta të gjithë janë klientë?

ZAIMI — (*Shpejtohet*) Po, klientë.

PARTIZANI — (*Zaimit*) Ti çfarë je këtu?

ZAIMI — (*I zënë ngushtë*) Si çfarë jam?

PARTIZANI — U përgjegje në vend të këtij (*tre-gon Medium*) prandaj. (*Mediu vëren me kujdes*)

ZAIMI — (*Duke e mbledhur veten*) Ke të drejtë...
(*Shpejt*) Jam i biri. (*Patrulla bën të dalë*)

MEDIU — (*Shpejt*) Partizanë, qëndroni! (*Atë çast hyn Leci*) Ky nuk është im bir!... (*Duke treguar me dorë Zaimin*) Ai nuk është asgjë për mua... Është një tradhëtar, një kriminel... (*Zaimi nxjerr revolen për të qëlluar Medium, por Leci, më i shpejtë, shtie me automatik dhe Zaimi bie mbi banak i vdekur*)

AGIMI — (*Duke hyrë me Vjollcën dhe dy partizanë të tjera*) Ç'bëhet këtu?

VJOLLCA — (*Vrapon dhe i bie në gjoks Mediut*) Baba!

MEDIU — (*Lecit*) Falemnderit, çamarrok!

VJOLLCA — (*Mediut*) Mos isha unë shkaku?...
Mos erdhi këtu të hakmerrej për mua?...

MEDIU — Erdhi për të bërë atë që nuk bënë dot gjermanët...

AGIMI — (*Mediut*) Ai dhe miqtë e tij nuk mund ta falin atë që bëre ti për dështimin e planit të tyre... (*Të gjithëve*) Por nuk është vetëm kjo... Armiku mbetet armik deri në fund. Ju e patë: edhe në çastin e fundit ai e përdori armën.

QYTETARI I PARË — Kjo është e vërtetë... Por u erdhi fundi. Mbaruan... Ky është fundi i tyre...

QYTETARI I TRETË — Fundi i të gjithëve: i pushtuesve dhe i tradhëtarëve.

MEDIU — S'ka veçse pak ditë, po në këtë vend u bë kjo bisedë: nuk do të ndryshojë asgjë, do të bëhet diçka, apo do të ketë një përbysje... (*Qytetarit të parë*) E mban mend?

QYTETARI I PARË — Tamam, tamam... Këtu e biseduam...

QYTETARI I TRETË — Dhe ja ku u përbysën...

AGIMI — Një luftë e madhe nuk mund të sjellë veçse një përbysje të madhe... Por me një kusht, me kusht që t'i shkojmë deri në fund kësaj rruge të nisur...

VJOLLCA — ...dhe në qoftë se e çojmë deri në fund luftën kundër tradhëtisë...

AGIMI — Le të na quajnë të ashpër, le të cirren sa të duan. Ky është dhe do të jetë revolucioni ynë deri në fund. Ne e themi këtë me zë të lartë: revolucioni ynë është dhe do të jetë i ashpër me armiqtë e revolucionit.

Fund

Tiranë, 1969

H Y R J E

Pesë njerëz pa ndërgjegje (politikë) fitojnë ndërgjegje nëpërmjet aksionit. Kjo është idea e dramës «Lagjja e varfër». Janë pesë punëtorë sezonalë nga anë të ndryshme të vendit, që punojnë diku, jashtë qytetit, në ndërtimin e një rruge. Jemi në muajët e parë të vitit 1942, pak kohë pas themelimit të Partisë Komuniste Shqiptare. Lagjja e varfër duket e qetë, kasollja ku banojnë pesë punëtorët tonë duket, gjithashtu, sikur ka rënë në gjumë. Por një natë bien ca pushkë, një vajzë hyn në kasollen ku banojnë pesë punëtorët dhejeta e tyre merr një rrugë tjetër. Revolucioni hyri edhe në këtë kasolle dhe çdo gjë ndryshoi. Në fillim për një rastësi të thjeshtë, pastaj nga një veprim jo shumë i vetëdijshëm, më vonë sepse të pesë punëtorët hidhen nga aksioni në aksion dhe rriten, zbulohen tek ata energji të mëdha, zbulojnë edhe vetveten. Kështu në procesin e luftës, të udhëhequr nga idetë që sjell komunistja Besa, ata transformohen. Në këtë kuptim drama «Lagjja e varfër» i bën jehonë të sotmes, edukimit revolucionar nëpërmjet aksionit, duke i kërkuar rrënjet e luftës së partisë për edukimin revolucionar të masave që në fillimet e revolucionit.

Dy mendime të tjera që më udhëhoqën kur iu vura punës për këtë dramë:

E para, Migjeni pat shkrojtur, në kohën e vet, një vjershë me titullin «Lagjja e vorfën», të cilën e fillon kështu:

«Krahët e zez të një nate pa fund
e varrosën lagjen pranë,
dritë, jetë, gjallsi-askund,
vetëm errsinë e skam»..

Nga pozitat e realizmit kritik kështu mund t'i shihte dhe t'i trajtonte jetën e njerëzit e lagjes së varfër Migjeni në kohën e vet.

Nga pozitat e realizmit socialist është krejt ndryshe, lagjja e varfër do zgjohet, zëri kryengritës i Besës ngre në këmbë njerëzit e lagjes së varfër në kohën e partisë.

E dyta, vura në qendër të dramës njerëzit e thjeshtë, dhe, duke i vënë ata para ngjarjeve të mëdha, desha të tregoj se ata janë plotësisht në gjendje të kuptojnë e të bëjnë të tyre ide të mëdha, të bëhen edhe bartës edhe transmetues të tyre. Në këtë kuptim bashkë me dy dramat e tjera «Rrugëve të pashkelura» dhe «Ngjarje në fabrikë» ajo bën pjesë në përpjekjet për të sjellë në skenë njerëzit e thjeshtë dhe të tregojë se ata mund të jenë bartës të ideve të mëdha.

Personat veprues:

BESA	komuniste, 19 vjeće
FATMIRI	
ADNANI	punëtorë sezonalë
SAZANI	
BIMI	
TELATI	
LAMJA	xhandar, 38 vjeç
OFICERË, XHANDARE, CIVILË.	

PJESA E PARË

Një dhomë e varfër. Muret janë të tymosura dhe vendë-vende u ka rënë suvaja. Tavan nuk ka, por duken disa trarë dhe çatia. Dhoma ndriçohet nga llambë me vajguri. Në qoshe ka disa rroba, që shërbejnë si shtroje kur flenë. Përballë është një vend i ngritur. Porta është djathtas. Nga e djathta duket edhe rruga, e cila zë një pjesë të skenës, ku herë pas here gjatë gjithë shfaqjes, kalojnë njerëz të ndryshëm. Është natë. Në dhomë janë Fatmiri, Adnani, Sazani, Bimi dhe Telati, të cilët porsa kanë mbaruar darkën.

ADNANI — (Duke u ulur në një qoshe) Këto ditë, ka filluar të shtrëngojë keq vapa. Aty nga dreka të djeg dielli si saç.

◀ BIMI — Sot më duket se na e zgjati përsëri kohën e punës: afër një gjysmë ore në pushimin e drekës, po aq edhe në mbrëmje.

FATMIRI — Është një zagar ai konduktori... spiun i italianëve, ç'do më shumë. Si ka surratin ka edhe shpirtin. (Ndërkaq të gjithë janë ulur dhe me diçka merren: dikush ndreq këpucën, një tjetër diçka qep, e kështu me radhë)

TELATI — Ta zë në ndonjë qoshe, pa po s'ja bëra shpinën më të butë se barkun...

ADNANI — E pastaj?... Do të vënë një tjetër, më të keq akoma... Apo s'kanë dalë shumë plehra që kur erdhi kjo Italia...

SAZANI — (Adnani) Ky (tregon Telatin) duhet mbajtur, se do të na bëjë ndonjë të pabërë. Sherrin e ka qejf, bile e kërkon...

ADNANI — (Prerë) Telati nuk do të bëjë asgjë. (Telatit) Kështu?

TELATI — Pa e marë vesh njeri dhe pa lënë asnjë gjurmë, për fjälë të nderit... Kini besim, ma lini mua...

FATMIRI — (Duke qeshur fort) Si the, si?!. Për nder ty s'të ka kush. E zëmë bashkë...

ADNANI — (Rreptë) As bashkë, as vec! (Të dyve) U muarëm vesh? (Ata heshtin) Me ju po flas!

BIMI — Dhjetë orë në pisk të diellit, duke thyer gurë, ose pranë kazanit të ziftit... (kollitet) të del shpirti.

FATMIRI — I kemi shitur krahët, jo dhe shpirtin. (Bimi vazhdon të kollitet)

ADNANI — (Bimit) Kohët e fundit sikur të ka shtrënguar më shumë kjo kolla...

BIMI — Nuk më lë rehat, ditë — natë. Krahët më janë prerë... me zor qëndroj në këmbë...

SAZANI — Ke shkuar te mjeku? Shko një herë...

TELATI — Mjeku të çon pastaj te barnatori... Kush të zhvatë më shumë... Phu, farë e drejt! Të gjithë një-lloj janë: një stan me ujqër.

FATMIRI — Nuk e di, kështu ka qenë bota gjithnjë?

ADNANI — Mua më duket ka ardhur duke u pri-shur, sot është më e keqe se njëzet vjet më parë. Këtë ta siguroj unë.

SAZANI — Thonë se, sa më shumë afrohet fundi, aq më të këqinj bëhen njerëzit.

BIMI — Hoxha i fshatit tonë këtë e kishte në më të gjuhës... E si të thoshte?... Edhe në fshatin tonë shtoheshin për ditë ata që rronin keq...

FATMIRI — Mua s'më mbushet mendja që njerëzit të kenë qenë gjithmonë të këqinj.

ADNANI — Thonë se, që kur doli paraja, njerëzit filluan të prishen. (Duke u ngritur) Paraja është nëna e të gjitha të zezave. (Shkon në një qoshe, merr shtamën

e ujit, pi dhe e lë përsëri) Prandaj, deri sa të ketë para, bota kështu do të jetë. (*Afrohet te Fatmiri dhe i zë flokët me përkëdheli*) Nuk ja ka gjetur njeri kësaj bote: pse disa lindin të pasur dhe disa lindin të varfër, pse të varfërit punojnë e rraskapiten dhe të pasurit, megjithëse nuk punojnë, rrojnë mirë, kush ka lindur më parë, të pasurit apo të varfërit? (*Duke u ulur atje ku ishte*) Është si ajo puna e vezës dhe e pulës: e bëri pula vezën, apo veza pulën? Dreqi e di këtë punë... Mbështetje po flas gabim. Po bota kështu është ndarë: në të varfër dhe të pasur...

TELATI — Po zoti, baca Adnan, me cilët është, me të pasurit apo me të varfërit?

ADNANI — Rri, more djallë, mos na fut në gjynah.

FATMIRI — Unë them me të pasurit.

* BIMI — Hoxha dhe prifti thonë me të varfërit.
FATMIRI — Gjenjejnë.

ADNANI — (*I drejtobet Bimit*) More gjë vesh si t'u bë djali, që e kishe të sëmurë atje në fshat?

* BIMI — Jo, u bënë dy muaj që nuk kam marrë asnjë lajm.

ADNANI — Do të jetë shëruar, përndryshe do të kishte ardhur ndonjë...

* BIMI — Nuk e di... (*Kollitet përsëri. Heshtje*)
SAZANI — Dje takova një bashkëfshatar. Ai më tha se kjo thatësira e sivjetme i dogji krejt misrat. Jo vetëm pa bukë, por mbetën edhe pa farë... (*Jashtë, dëgjohen të shtëna me pushkë*)

TELATI — Pushkë!

ADNANI — Prit! (*Heshtje*) Pushuan.

TELATI — Shpesh dëgjohen pushkë natën. (*Fatmirit*) A ke shtënë ndonjëherë me pushkë?

FATMIRI — Pse, vetëm një herë?!

SAZANI — (*Telatit*) Ka qenë ushtar, e harrove?
(*Përsëri dëgjohen pushkë*)

TELATI — Po pse bien këto pushkë natën?

SAZANI — E kanë keq me komunistët, po u nxjerrin shumë telashe.

TELATI — Ç'deshi, ore, kjo Italia që erdhi këtu në vendin tonë? U mbushën plot tre vjet, më duket, nuk kisha parë ndonjëherë aq shumë aeroplanë mbi fshatin tonë sa atë ditë.

FATMIRI — Po, prill qe edhe atëhere, si tani... Kur u mbushën tre vjet!.. Isha ushtar në atë kohë. Na futën në kazermë dhe nuk na lanë të dilnim. Nuk morëm vesh ç'po ndodhje. Me një fjalë, na tradhëtuan. Vëtë e sollën, prandaj...

ATNANI — E sollën bejlerët dhe tregëtarët, se mos kanë atdhe ata. Paraja është mbi çdo gjë, për disa. S'e di ti këtë?

✗ **BIMI** — Atëhere mirë ua bëjnë këta komunistët, mirë ua bëjnë.

TELATI — Unë nuk kam parë asnijëherë ndonjë komunist. Si janë ata? (*Përsëri dëgjohen pushkë, por tani më afër*)

ADNANI — Thonë se janë trima, kaq di unë. Kësh-tu thonë...

TELATI — Trim është edhe Fatmiri, atëhere pse s'është komunist edhe ai?

✗ **BIMI** — Mbase edhe është, ku e di ti.

TELATI — Ti po tallesh. Pse, kështu si ne janë komunistët?

SAZANI — Si i kujton ti ata?... Unë kam njojur njëherë një komunist, jo tani, shumë kohë më parë... Ishte një djalë i mirë, xhevahir djalë... Një natë i vajtën xhandarët në shtëpi, e arrestuan dhe e futën në burg.

TELATI — Po pse?

SAZANI — Si pse? Ishte kundër qeverisë, për këtë e arrestuan. Ishte Zogu atëhere...

✗ **BIMI** — Kohët e fundit flitet shumë për komunistët dhe për luftën me italianët, e keni vënë re?..

TELATI — (*Fatmirit*) Vërtet, komunist je ti?

FATMIRI — Tallet Bimi, tallet... (*Pas pak*) Jo. nuk jam...

TELATI — Po një ditë mund të bëhesh, po deshe, kështu?

FATMIRI — Edhe mund të bëhem, pse?

TELATI — Po u bëre ti, u bëra edhe unë.

SAZANI — Veç kur të të fusin në burg edhe ty, si atë djalin që të thashë unë, e pastaj?...

ADNANI — (*Telatit*) Je akoma i vogël ti për atë punë... Shiko, mor djall, hallin tënd...

TELATI — Ashtu? Po Fatmiri që është edhe më i vogël?...

ADNANI — (*Prerë*) Lëre, more Fatmirin, ç'do që e përmend atë? Ai ta tha: Bimi u tall, bëri shaka.

SAZANI — (*Telatit*) Po ç'di ti për komunistët, qoftë ti (*shikon nga Fatmiri*) qoftë Fatmiri?

FATMIRI — Se janë të varfër, këtë e di, dhe kjo më mjafton; se luftojnë kundër italianëve, që kanë ardhur e na kanë pushtuar vendin, edhe këtë e di, dhe kjo është boll. Janë edhe kundër bejlerëve e tregëtarëve, dhe kjo i vë kapakun... (*Jashtë në rrugë*, duket Besa. Ajo është e plagosur dhe ecën me zor. Gjen hapur portën e shtëpisë, ku janë Adnani e të tjerët dhe hyn brenda. Porsa hyn, mbyll portën nga pas, humbet ndjenjat dhe bie përtokë. Të gjithë ngrijnë në vend. Telati i afrohet)

TELATI — Është e plagosur.

ADNANI — Ato pushkë që ranë... duket mbi të shtinin. (*Telati me shpejtësi i vë shulin portës*) Mos e mbyll! (*Heshtje*) Prit!...

FATMIRI — Çfarë të presë?!

ADNANI — Karabinierët... po të vijnë, do të kujtojnë se e kemi fshehur ne... Me ta s'merremi dot vesh... (*Bimi është afruar dhe vëren në merr frysë*)

* B I M I — Ka humbur ndjenjat...

SAZANI — Mirë thotë Adnani, mos e mbyll portën... Punë me zarar këto. Ç'na duhet ne...

ADNANI — (*Bërtet*) Sazan!...

SAZANI — (*Adnanit*) Me qeverinë nuk i dilet, kjo
është më se e drejtë...

ADNANI — (*Nervoz*) Jo. Unë nuk desha tē them
atë.

SAZANI — Atëhere po e them unë: karabinierët
po tē vijnë, do tē kujtojnë se deshëm ta fshehim. Sa më
larg punëve tē qeverisë, aq më mirë. Nuk thonë kot:
«Zot, më ruaj nga zjarri, nga uji dhe nga qeveria, nga
tē tjerat ruhem vet». (*Bimit*) S'është kështu?

BIMI — S'e di. (*I vë diçka nën kokë Besës*)

SAZANI — (*Telatit*) Hape portën! (*Telati jo vetëm*
që nuk e hap, por qëndron te porta dhe ruan tē mos e
hapë njeri. Heshtje) Pas pak do tē jetë vonë! Telat,
ka rreziqe në këtë punë! (*Kthehet nga Fatmiri*) Fatmir!...
(*Pastaj nga Adnani*) Adnan!... (*Të gjithëve*) Pse nuk doni
ta kuptoni?...

ADNANI — (*Në një anë, i ndriçuar nga një pistoletë*)
Ashtu është: pas pak do tē jetë vonë... S'mbetet veçse pak
kohë... Duhet vendosur... Në qoftë se s'gaboj, po flitet për
t'uad dorëzuar karabinierëve... Jo, jo, askush nuk e tha kë-
të. Unë jo... As Sazani nuk e tha... Aq më pak Bimi. Po
pse tē mos e mbyllte portën?!... Ose, pse ta hapë?!. Unë
i hashë diçka... Nuk më kujtohet... S'ka rëndësi... Fatmiri
e kuptoi keq... Ai gjithnjë ngutet... Është i ri. Por unë
duhet tē mendoj për tē gjithë. Jam më plaku, prandaj...

FATMIRI — (*Telatit*) Hape portën!

ADNANI — (*Papritur*) Çfarë? Ta hapë portën?! E
përse?!

FATMIRI — (*Bën tē hapë portën*) Kush tē dojë,
le tē dalë. (*Heshtje*)

ADNANI — Do tē thuash: kush ka frikë?... (*Duke*
e penguar që tē hapë portën) Trimëri do tē na shesësh
këtu!...
TELATI — Ndoshët s'vijnë. S'u vete mendja tē
kërkojnë këtu tek ne.

SAZANI — (*Shpërthen*) Oj ky, s'u vete mendja!...

BIMI — (*Ul kokën dhe vë veshin në tokë*) Po vij-

në! (*Jashtë duken një oficer, dy karabinierë dhe një xhandar*)

ADNANI — Tani s'mbetet të mendojmë më për asgjë. (*Fatmirit, duke treguar Besën*) Zëre! (*Të dy e zë-në Besën dhe e fshehin prapa vendit të ngritur përbalë*)

XHANDARI — (*Jashtë*) Nuk duhet të ketë shkuar larg. (*Duke treguar shtëpinë ku janë Adnani dhe të tjerët*) Të shohim këtu një herë.

OFICERI — Është e kotë, do të vonohemi.

XHANDARI — (*I bie portës*) Hapeni! (*Brenda të gjithë ngrijnë. Fatmiri hedh edhe disa rroba në vendin ku fshehën Besën*)

ADNANI — (*Të gjithëve*) Uluni dhe asnjë fjalë. U morëm vesh?

TELATI — Asnjë fjalë. (*Jashtë, afrohet te porta edhe oficeri*)

ADNANI — (*Sazanit*) E more vesh, Sazan?

SAZANI — Pse më drejtohe vetëm mua?!...

OFICERI — (*Duke i rënë portës më fort*) Hapeni! Hapeni!

ADNANI — Atëhere edhe një herë të gjithëve: asnjë fjalë. (*Telatit*) Tani hape portën. (*Telati hap portën. Hyn oficeri, kurse dy karabinierët dhe xhandari porsa duken*)

OFICERI — Hajvanër, pse s'e hapni portën?

ADNANI — Ju porsa i ratë, zoti oficer. Ne ishin zhveshur.

OFICERI — Shkojmë, s'ka gjë këtu. (*Largo hen me rrëmbim. Të gjithë kanë ngrirë. Heshtje e gjatë. Telati myll portën*)

FATMIRI — Shkuan.

ADNANI — Po, shkuan.

BIMI — Shpëtuam.

SAZANI — Çfarë?...

TELATI — Si tha: hajvanër?! (*Duke u drejtuar nga porta*) Phu, farë e dreqt! (*Fillojnë e qeshin pa luajtur nga vendi*)

SAZANI — Po tani?

TELATI — Çfarë tani?

SAZANI — Ç'do të bëjmë? (Adnani dhe Fatmiri nxjerrin Besën nga ku e kishin fshehur dhe e vënë nē vendin e ngritur. Adnani i shikon plagën)

FATMIRI — (Adnanit) Plumbin e ka brenda, apo i ka dalë?

ADNANI — Atë po shikoj. (Heshtje) Më duket se i ka dalë. Sazan! Më ke thënë njéherë se, kur ke qenë ushtar, ke shérbyer pér disa muaj nē spital.

SAZANI — Po, por s'kam pasur punë me të plagosur.

ADNANI — (Duke e shikuar me inat) Më sill atë këmishën që lava dje. (Nervoz) Luaj, more, nga vendi! (Sazani i sjell këmishën, të cilën Adnani e gris dhe lekkat ja jep Sazanit) Mbaji dhe afroju këtu të më ndihmosh. (Fillon t'i lidhë plagën Besës) Kam parë një herë nē fshat si lidhen plagët... (Vazhdon të lidhë plagën)

FATMIRI — (Në një anë, i ndriçuar nga një pistoletë) Si tha? «S'kam pasur punë me të plagosur!...» Me një fjalë: «as dua të kem punë me ta...» Mirë, po unë ju dola borxhit: kush s'do, rrugën e ka të hapur... (Shikon nga Adnani dhe Sazani, të cilët po i lidhin plagën Besës) Ç'them edhe unë!.. Ata tani po i lidhin plagën... Por mba-se duhet gjetur një mjek. Po ku ta gjej?.. (Papritur) Sidoqoftë, unë duhet t'ju them përsëri: kush s'do të qëndrojë, rrugën e ka të hapur... Prit, këtë mund t'ua them edhe nesër... Por mjekun, mjekun ku ta gjej? Ai duhet me doemos, sa më parë...

ADNANI — Fatmir, më jep një këmishë tjetër! Ke ndonjë të larë? (Fatmiri merr një këmishë të tijën dhe ja jep Adnanit. Sazani largohet pak)

BIMI — Si duket?

SAZANI — Të shohim...

BIMI — Mos të na vdesë këtu.

SAZANI — Të gjitha duhen menduar, të gjitha. Po të vdesë këtu, atëhere do ta kemi keq nga të dy anët: edhe me qeverinë, karabinierët qenë këtu dhe ne e fshe-

hëm, edhe me komunistët, ata do të na e hedhin fajin ne, që e lamë të vdiste.

TELATI — Pse, komuniste është ajo? Nga e di ti që është komuniste?

SAZANI — E ç'mund të jetë tjetër... Ato dalin natën. Italianët me ata e kanë. Ç'qenë ata që e kërkonin?

TELATI — Atëhere nuk vdes, me siguri nuk vdes...

SAZANI — Nga e more këtë siguri ti? Mbylle, mor, të shkretën, më mirë.

BIMI — Vërtet, po sikur?!

TELATI — S'ka sikur këtu. Nuk vdes dhe mbaroi kjo punë... Ja, këtu jemi.

ADNANI — (Bërtet) Mjaft, i lini përrallat. Nuk gjendet gjë me sikur... As duke shtierë fall si plakat. (*Ka mbaruar me lidhjen e plagës dhe, duke u ngritur, i drejtohet Sazanit*) Nga e di ti se ajo është komuniste?

SAZANI — Thashë, sepse ato dalin natën. E di unë: hedhin komunikata, bëjnë mbledhje, djegin depo dhe vrasin njerëzit e qeverisë.

FATMIRI — Po këtë nga e di?

SAZANI — E di... Pse më shikon ashtu? Më ka tre-guar Lamja.

TELATI — E kam kaq inat atë Lamen... Nuk e di pse, por s'e shoh dot. Më duket si shejtan, kur e shoh.

FATMIRI — Xhandar! A ka xhandar të mirë?

TELATI — Fjalë me vend: a ka xhandar të mirë?

ADNANI — (Duke u ulur) Plaga s'është e lehtë... Sigurisht, me sa marr vesh unë.

SAZANI — Prandaj, diçka duhet bërë.

FATMIRI — (Papritur) E çfarë të bëjmë: t'uad dorëzojmë karabinierëve — këtë të bëjmë?

SAZANI — (Bërtet) Unë nuk thashë t'uad dorëzojmë karabinierëve. Merri për vete ato fjalë. Ç'dreqin ke që çdo fjalë timen e merr ters?!

TELATI — Ashtu the!

ADNANI — (Bërtet) Telat! (Heshtje) Sazani nuk tha atë. (Fatmirit) Në qoftë se ti e kuptove ashtu atë që tha Sazani, atëhere mos iu drejto vetëm atij, m'u

drejto edhe mua. Unë fola i pari... Unë i thashë Telatit, që të mos e mbyllte portën... Unë e pashë, ti i more keq fjalët e mia...

TELATI — (Adnanit) Jo, bace, nuk është njëloj...
Ti nuk the ta nxjerrim jashtë.

ADNANI — Atë nuk e tha as Sazani... Dhe asnje nga ne nuk mund ta thoshte...

FATMIRI — Si shqiptarë?..

ADNANI — Po, si shqiptarë... .

FATMIRI — (Bërtet) Shqiptar është edhe Lamja.
Jo! Kaq nuk mjafton. Këtu më duket ka edhe diçka tjetër...

* BIMI — Çfarë?

FATMIRI — Nuk e di, por e ndjej se duhet akoma edhe diçka tjetër.

SAZANI — Kur nuk e di, pse akuzon të tjerët?

TELATI — Sepse aty e hodhe fjalën, prandaj...

SAZANI — Unë nuk jam më pak shqiptar se ti.

FATMIRI — Unë për vete pranoj se jam më pak shqiptar se ajo. (*Tregon Besën*)

SAZANI — Unë nuk e pranoj, dhe as se ti... (Adnanit) Filloi sherri, atëherë le të fillojë si duhet...

* BIMI — Ule zërin, mos bërtit.

ADNANI — Mirë thotë Bimi, mos bërtit.

SAZANI — Nuk e dëgjon? (*Tregon Telatin*) Të bën të xhindoshesh, të bërtasësh është pak. (*Telatit*) Folë de, si e kuptove ti atë që thashë?

TELATI — Ashtu si e the...

* BIMI — (Në një anë, i ndriçuar nga një pistoletë) Ne nuk jemi grindur ndonjëherë, me gjithë varfërinë tonë. Thonë se varfëria sjell grindje... Kështu thonë. Sa është e vërtetë, këtë nuk e di. Ne nuk kishim gjë për të ndarë në mes tonë, prandaj s'kishim as pse të grindeshim. Por ne tani po grindemi... Po pse filluam të grindemi?... E pse të grindemi?! Sepse erdhi ajo?!. Mbasse unë nuk i kuptoj mirë këto gjëra... Mbasse kot e vrás mendjen... Po ajo si erdhi, edhe do të shkojë. Prandaj pse të grindemi?... (U drejtohet të tjerëve) Megjithatë,

diçka duhet bërë... Unë nuk e di çfarë, por Sazani nuk thotë keq: ajo këtu nuk mund të rrijë... Ka nevojë edhe për mjekë... (*Pas pak*) Fatmir, më dëgjon?

FATMIRI — Të dëgjoj.

BIMI — Atë që kishim në dorë e bëmë: e strehuam, e fshehëm nga karabinierët, plagën ja lidhëm... nuk di ç'mund të bëjmë tjetër. Po tani?... (*Të tjerët vazhdojnë të heshtin*) Flisni, pse s'flisni! Baca Adnan, folëti, pse e mbylle gojën?

ADNANI — E ç'të them?! Kur s'di çfarë të thuash, më mirë hesht. (*Pas pak*) Mbase ka pér të thënë gjë Fatmiri.

FATMIRI — Jo, s'kam. (*Heshtje*)

BIMI — (*Nuk duron dot*) Ju të gjithë e kyçët gojën. Bluan, secili bluan... Po thoni një fjalë... Ç'të bëjmë? Të lajmërojmë atëhere komunistët, t'u themi se ajo është këtu... T'u themi të sjellin një mjek, të vijnë ta marrin, ne s'mund të bëjmë më asgjë pér atë... Ne s'kemi c'ti bëjmë as votës...

TELATI — Ku t'i gjejmë, pa shkoj unë. (*Të gjithë-ve*) Më thoni, pa vete dhe i gjej unë. (*Bimit*) Njeh ti ndonjë komunist?

BIMI — Unë?!... Jo.

BESA — (*Flet në kllapi*) Shokë, jemi të rrethuar... Këtej, këtej, nga kjo anë... Ik ti përpara, shpejt, shpejt... (*Bërtet*) Kujdes! Shiko, ai karabiniéri atje po kapërcen murin... Mirë ja bëre. Ik tani. Pér mua mos u bën merrak, do të kaloj këtej, nga fqinjët... (*Heshtje*)

ADNANI — E ka nga plaga.

BESA — Karabinierë e xhandarë gjithandej, plot... Po tani?... Më duket të gjithë shpëtuan, shumë mirë... Po tani? (*Merr frymë thellë*) Edhe pak... edhe pak... Po shtien... Le të shtien... shokët shpëtuan. Ja, e zura qoshen e rrugës... Oh! Ç'është kjo?... Si një hell i skuqur... Tamam si një hell i skuqur... Gjak!.. (*Merr frymë me shpejtësi*) Po shtien akoma... Jo, më bëjnë veshët... Kam vapë... M'u dogj koka... Zjarr... (*Heshtje*)

ADNANI — Digjet... (*Fatmirit*) Merr ca ujë të ftoh-

të dhe një leckë... vërja në ballë... Ngreu, q'më shikon ashtu, sikur nuk më ke parë ndonjëherë! (*Fatmiri ngrihet, merr ca lecka, një legen me ujë dhe fillon nga puna*)

SAZANI — (*Ngrihet, afrohet pak dhe i thotë Fatmirit*) Ma lërë mua.

FATMIRI — Mirë jam.

SAZANI — (*Me ton urdhëronjës*) Ma lërë mua, të thashë!

ADNANI — (*Fatmirit*) Ngreu, lërja. (*Fatmiri ngrihet*)

SAZANI — (*Duke rregulluar leckat në ballin e Besës*) Nuk e dëgjove ti se, kur kam qenë ushtar, kam shërbyer për disa muaj në spital? Vërtet atje s'kishte të plagosur, se atëhere nuk bëhej luftë, që të kishte të plagosur, por kishte të sëmure. *

BIMI — Me një fjalë je gjysminfermieri.

SAZANI — Aty afër.

TELATI — (*Bimit*) Po baca Adnan ç'duhet të jetë sipas teje?

* BIMI — Gjysmëmjeku, ose shkuar edhe mjekut, pse jo...

ADNANI — Mjek nga e keqja. Në jetë më ka ndodhur të bëj shumë gjëra nga e keqja. Ja edhe këtu, tani, më duhet të jem në vend të plakut të shtëpisë, nga e keqja.

SAZANI — (*Fatmirit*) Je gjaknxehtë, merr zjarr shpejt, si benzina. Telati edhe më shumë.

ADNANI — (*Shpejt*) E lëmë tani këtë bisedë. Sa vajti ora?... (*Shikon orën*) Paska vajtur goxha...

FATMIRI — Flini ju. Unë po ruaj.

TELATI — Edhe unë nuk fle. Po sikur të vijnë përsëri karabinierët?

ADNANI — Nuk vijnë, jo. (*Bëhen gati të flenë*)

SAZANI — (*Në një anë, i ndriçuar nga një pistoletë*) Për Fatmirin dhe Telatin është e lehtë, ata nuk kanë as fëmijë, as detyrime. Ata nuk mendojnë gjatë. I riu si veriu, kështu kanë thënë gjithmonë. Kur nuk

mendon gjatë je edhe trim, ndërsa, kur mendon përfëmijët... për këtë dhe për atë, është ndryshe. Por këtu s'është çështje trimërie ose frike. Kemi boll hallet tonë, kjo është e tëra. Ata që i kanë dalë zot le ta nxjerrin në krye vetë. Unë nuk thashë që t'uad dorëzojmë karabinierëve, si tha Fatmiri. Shumë e durova... Sa i durueshëm bëhet njeriu nganjëherë!... Fatmiri është krejt i padurueshëm, u hodh sikur ta kish kafshuar gjarpëri. Mbase e teprona edhe unë, por fjalët që më tha nuk janë të pakta. Sa i durueshëm ky baca Adnani!.. Mirë që ishte ai, përndryshe nuk e di si do të ishim ndarë. Frikë nuk kam unë dhe nuk e pata nga frika... (*Papritur i drejtohet Fatmirit*) Dëgjo këtu ti, Fatmir, unë nuk kam frikë dhe atë që bëra nuk e bëra nga frika. Këtë e them që ta dish.

ADNANI — (*Duke e ndërprerë*) Mjaft tanë, mjaft. Asnjë fjalë më shumë. (*Fatmirit*) Ti vazhdo me ato leckat. (*Të tjerëve*) Të gjithë të tjerët të marrin një sy gjumë, se në mëngjez duhet të dalim në punë... (*Shikon Telatin*) Po, po, edhe ti. Në mëngjez mendohemi edhe një herë se ç'duhet të bëjmë. (*Ndërsa ai dhe të tjerët shtrihen, i drejtohet Fatmirit*) Po të ketë gjë, na zgjo, megjithëse edhe ne me një sy do të flemë, me tjetrin do të jemi zgjuar.

FATMIRI — (*Në një anë, i ndriçuar nga një pistoletë*) Shumë gjëra u ngatërruan sonte... U ngatërruan apo u shkatërruan, këtë nuk di ta them akoma. Njëqind e një... Jo, njëmijë e një gjëra... Ne kemi afër një vit bashkë, por asnjëherë... është e vërtetë: asnjëherë nuk e kemi vrarë mendjen si sonte. Dhe nuk jemi grindur... (*Duke shikuar nga Besa*) E, pra, ne nuk dimë asgjë përtë: cila është? Si e quajnë? Pse e kanë plagosur? Ç'duhan nga ajo karabinierët? Sazani tha një fjalë: «është komunistë». Mirë. Po ç'lidhje ka kjo më të gjitha ato që u thanë këtu sonte?! Ose, më mirë, që ngritet krye!..

BESA — Uf!... (*Merr frymë thellë, rënkon*) Plasa! (*Fatmiri afrohet dhe fillon t'i verë lecka me ujë të ftohtë në ballë. Ajo jep shenja se po vjen në vete*) Ku jam këtu?

FATMIRI — Mos u bën merak: në mes miqshi.
BESA — Miq apo shokë?

FATMIRI — Pse, nuk është njëlloj?
BESA — Jo, jo plotësisht e njëjta.

FATMIRI — Quaje si të duash: ne jemi pesë punëtorë, që banomjmë në këtë kasolle. Punojmë atje në të dalë të qytetit, në rrugën e re.

BESA — Atëhere, në mës shokësh. (*Bimi kollitet*)
Kush kollitet kështu?

FATMIRI — Njëri nga shokët e mi. Kështu e ka zakon.

BESA — Po të tjerët ku janë?

FATMIRI — Këtu janë edhe ata, flenë.

BESA — Po ti pse nuk fle?

FATMIRI — Nuk më flihet. (*I ndërron pecen me ujë të ftohtë në ballë*)

BESA — Të falemnderit. (*Heshtje*) Karabinierët nuk erdhën këtu?

FATMIRI — Erdhën dhe shkuan. Ne të fshehëm dhe ata nuk të panë.

BESA — Ju falemnderit të gjithëve. (*Bimi kollitet përsëri*) Kollë e thatë... Në rrugë punon edhe ai?!... Me atë kollë?!... Uf!..

FATMIRI — Ç'pate? Mos lëviz...

BESA — Bën shumë të nxehët... Plasa! (*Merr frymë thelli, rënkon*) Uf!... Plasa!

FATMIRI — Duro, s'ke ç'bën. Edhe pak dhe do të zbardhë... Do të vete të gjej një mjek... (*Besa nuk përgjigjet*) Më dëgjon? (*E vëren me kujdes*) I ra të fikët përsëri... (*Vazhdon t'i vërë lecka me ujë të ftohtë në ballë*. Ngadalë shuhën dritat. Kur, pas pak, ndizen përsëri, Adnani dhe të tjerët po bëhen gati të shkojnë në punë)

ADNANI — (*Fatmirit*) Atëhere ti do të rrish, nuk do të dalësh në punë sot. Do të themi se je i sëmurë. Sidoqoftë, diçka duhet të bësh. Po erdhi në vete përsëri, pyete mirë: ka njerëz të sajtë? Sigurisht duhet të ketë...

FATMIRI — Natën u qetësua pak, tani më duket se fle. Patjetër do ta pyes dhe deri në mbrëmje, kur të vini ju, diçka do të bëj.

ADNANI — Veç me kujdes. Këtu në lagjen tonë ka njerëz të mirë, të varfër si ne, kot nuk e quajnë lagjja e varfër, por a ka pyll pa derra?... Prandaj edhe një herë kujdes. Kujdesi është i mirë gjithmonë... (*Telatit, i cili do të thotë diçka*) Jo, ti nuk do të rrish, do të vish në punë. Po të mungojnë dy, mund të bier në sy. (*Të gjithëve*) Gati? Dilni tani me radhë, si gjithnjë. (*Dalin. Heshtje. Fatmiri diçka rregullon nëpër dhomë dhe pastaj qëndron pranë Besës. Pas pak ajo hap sytë*)

BESA — (Duke lëvizur, ndjen dhimbje) Oh! (*Shikon Fatmirin dhe hesht*)

FATMIRI — Mirëmëngjezi!

BESA — Kush je ti? Si erdha unë këtu?

FATMIRI — Mbrëmë natën... Karabinierët po të ndiqnin... të plagosën dhe ti u fute tek ne.

BESA — Ah, po!... Diçka mbaj mend... Jeni pesë punëtorë, më duket... njëri kollitej natën... Ku janë të tjerët?

FATMIRI — Shkuan në punë.

BESA — Po ti?

FATMIRI — Ndenja me ty... Prita deri sa të zgjo-hesh. Shokët më thanë: «Rri dhe kujdesu për të, nuk mund ta lemë vetëm...» Si ndjehesh tani?

BESA — Diçka më mirë. Natën kisha shumë zjarr.

FATMIRI — Ke nevojë për mijek, njeh ti ndonjë, që të vete ta thérres? Mos duhet të lajmëroj prindërit. Ku e ke shtëpinë?

BESA — Nuk ke frikë?

FATMIRI — Nga se?

BESA — Karabinierët me siguri më kërkojnë akoma. E di pse më kërkojnë?

FATMIRI — Diçka e marr me mend. Por nuk kam frikë.

BESA — Atëhere dëgjo këtu: do të shkosh në rrugën e Pishës, e di? Do të gjejsh shtëpinë Nr. 38. Bje-

ri portës. Mund të dalë një grua ose një burrë. U thuaj se kërkon shokun Gaqo. E kam kushëri... Po, kushëri. E mban mend emrin, shokun Gaqo? I thuaj, se jam këtu. I trego për plagën dhe i thuaj që të vijnë e të më marrin. Kur edhe si, të vendosin vetë. Bisedoni edhe për mjekun.

FATMIRI — (*Ngrihet dhe bën të dalë, por kthehet*) Më dërgoi... kush? Si t'i them? Mua më quajnë Fatmir, po ty?

BESA — Harrova fare. Më dërgoi Besa, i thuaj.

FATMIRI — Unë po e mbyll portën. Po i ra kush, ti mos u përgjegj. Shokët e mi nuk vijnë tani, ata kthehen në mbrëmje. Edhe po të kthehet ndonjëri, ata dinë si ta hapin portën vetë, futin dorën këtu (*tre-gon një vend te porta*) dhe porta hapet. Por këtë e dijmë vetëm ne të pesë njerëzit e shtëpisë. Tani e di edhe ti, ti pra je e gjashta. Mos u mërzit, do të vij shpejt. (Del. Heshtje)

BESA — (*Shikon dhomën, pastaj ndriçohet nga një pistoletë*) Ç'varféri! Varféri dhe guxim, të duket sikur ato plotësojnë njëra-tjetrën... Ndoshta për këtë unë u besova menjëherë! Si ndodhi, s'e di, por ndodhi... Unë e dërgova atë te shokët. Për Gaqon i thashë e kam kushëri... Më mirë kështu... Sigurisht më mirë... Me-gjithëse... Jo, jo... Cili është ai? E di vetëm se ai banon këtu, (*duke shikuar nëpër dhomë*) më këtë varféri... Në lagjen e varfër. Di edhe këtë: ai dhe shokët e tij më fshehën nga karabinierët. Këtë ma tha vetë... Tjetër s'di. (*Papritur*) Po ata e dinin cila isha unë?! Jo. Atëhere?... (Heshtje. Hyn Bimi. Besa kujton se është Fatmiri) Pse u ktheve? (*Nuk merr përgjigje, bën të lë-vizë, por ndjen dhimbje*) Po ti kush je?

* BIMI — Mos u tremb. Edhe unë banoj këtu. Jam një nga pesë shokët, ne punojmë së bashku. Fatmiri ku qenka? Do të vijë mjeku?

BESA — Cili mjek?

* BIMI — Fatmiri nuk vajti për të marrë mjekun?

BESA — Të shohim, mund të vijë. (*Bimi kollitet*) Je i sëmurë?

* BIMI — Nuk më lë rehat kjo kollë dhe jam i kapitur, nuk më mbajnë gjunjët, krahët me zor i lëviz. Nganiöhërë digiem. Po ti ke zjarr? Mbrëmë flitje përcart. Fatmiri gjithë natës të vuri lecka me ujë të ftohte, deri në mengjez. Ai të fshehu edhe kur erdhën kårabinierët. Oh, kur e kujtoj atë çast!...

BESA — Pse e bëri ai këtë?

* BIMI — Si ta shpjegoj?! Ma merr mendja se edhe ai vetë, po ta pyesësh, nuk di ta thotë. Besoj se do të vijnë të të marrin sot. Si thua ti?

BESA — Kush?

* BIMI — Njerëzit e tu. Ke shtëpi ti, baba, nënë, vëllezër?... (*Heshtje*) Komuniste je ti? (*Heshtje*) Mos të bën keq të flasësh? Më mirë të mos flasim...

BESA — Jo, jo, të flasim. Ç'di ti për komunistët?

* BIMI — Vetëm se janë trima, tjetër s'di. Konduktori, atje ku punojmë ne, foli një ditë shumë keq për ata, por Fatmiri më tha rrugës se, derisa i shante ai, duhej të jetë e kundërtë.

BESA — Kaq di edhe Fatmiri, edhe të tjerët, që banojnë këtu me ju, kaq dinë?

* BIMI — Kaq... Jemi njerëz të punës ne, nuk kemi kohë për të tjerat. Fatmiri, ai është pak më i ditur. Një ditë tha se komunistët janë të varfër, janë kundër bejlerëve e tregëtarëve, luftojnë edhe kundër italianëve. «Kaç është boll për mua» tha ai, por, se c'deshi të thoshte me këto fjälë, nuk e mora vesh. Thashë, jemi njerëz të punës ne, nuk kemi kohë për të tjerat. Nuk të lënë hallet të ngresh krye. Punon gjithë ditën, e përsë? Për një kafshatë bukë. Është e keqe varfëria... E di ti ç'është varfëria?

BESA — E di.

* BIMI — Si e di, e ke parë, apo e ke hequr vetë?

BESA — Ka varfëri dhe varfëri... Mbështetë jo kaq sa shoh këtu, por e njoh, e kam hequr edhe vetë... (*Në rrugë duket Fatmiri*)

* BIMI — (*Vë kokën në tokë dhe dëgjon hapat*) Po vjen.

BESA — Kush?

BIMI — Fatmiri. E njoh nga tē ecurit.

FATMIRI — (Duke hyrë) U vonova. (Bimit) Paske ardhur, sa mirë. (Besës) Shtëpinë e gjeta pa ndonjë zor. Takova edhe atë kushërin tēnd... shokun Gago, kështu e quanin?... Më dha këto fasha (*i nxjerr nga gjirri*) dhe këto ilaçe. (*I nxjerr nga xhepet*) Bisedova me te, ja thashë tē gjitha, por sot nuk tē tērheqin dot prej këtej, as doktori nuk vjen dot se lagjja eshtë e rrethuar dhe akoma kërkijnë shtëpi pér shtëpi. Ka shumë roje rrugëve. Sa do tē zgjatë rrethimi nuk dihet, ndoshta deri nesër, ndoshta deri në darkë, nuk dihet... (*Jashtë, në rrugë, duken roje, që kalojnë si patrullë...* Bimi i dëgjon dhe u bën me shenjë tē tjerëve që tē heshtin derisa ato largohen)

BIMI — (Duke u kollitur) Unë kujtova se do tē vin-te mjeku. Ka disa ditë që ma mori shpirtin kjo kollë e djallit... Unë pér këtë erdha...

BESA — (Bimit) Mos u bën merak, do tē vijë, në mos sot, nesër. Edhe po nuk erdhi, do tē shkojmë ne tek ai, sa tē hiqet rrethimi shkojmë bashkë. Mos u bën merak. (Fatmirit) Tjetër q'të tha shoku Gago?

FATMIRI — Pyeti ku je plagosur dhe si e ndjen veten. Aty ishte dhe një tjetër. Ai më tregoi si duhet tē ta lidh plagën. E lamë që tē takohemi nesër përsëri. Do t'i vete në shtëpi. Por përpëra duhet tē sigurohemë në eshtë hequr rrethimi i lagjes. (Bimit) Më sill një legen me ujë tē pastër. (Bimi i sjell ujin, kurse Fatmiri bën gati fashot dhe ilaçet)

BESA — Infermier je?

FATMIRI — Jo, por eshtë një punë që duhet bërë. (Fillon t'i ndërrojë plagën) Të dhëmb?

BESA — (Duke e mbajtur veten) Jo shumë.

FATMIRI — Gënjen.

BESA — (E prekur) Si thatë?

FATMIRI — Nuk thua tē vërtetën, desha tē them. Ja edhe pak dhe mbarova. (Besa humbet ndjenjat) E di-

ja që gënjente. (*Hedh leckat e vjetra në legen dhe i flet Bimit*) Hiqi tani.

* BIMI — Pse nuk erdhën ta marrin?

FATMIRI — Si të vinin? Ti e pe sa roje kishte në të gjitha anët. Unë vetë u thashë ta linin deri nesër... do të bëjmë si të bëjmë. (*Duke nxjerrë nga xhepi një revole*) Më dhanë edhe këtë. «Ta kesh, më thanë, mund të të hyjë në punë».

* BIMI — (*Shqetësohet*) Atëhere ta besuan ty? (*He-shtje*) E kuption ç'do të thotë kjo?

FATMIRI — E kuptoj.

* BIMI — Barrë e rëndë. E ke menduar?

FATMIRI — Të ishe ti në vendin tim, ç'do të bëje?

* BIMI — S'e di... Por të tjerët ç'do të thonë?

FATMIRI — Do të bisedoj, porsa të kthehen. (*Rreptë*) Në fund të fundit, kush nuk është dakord, le të largohet, qoftë edhe përkohësisht.

* BIMI — (*Zemërohet*) Me ty nuk flitet... (*Papritur*) Mbrëmë arrestuan dhjetë njerëz në lagjen tonë.

FATMIRI — Pse?!

* BIMI — Kërkojnë atë. (*Tregon Besën*) Nuk di si të them, por edhe kjo se si më duket: shpëton një dhe sakrifikohen dhjetë. Sikur s'është e drejtë: fajtorët fshihen, të pafajshmit e pësojnë...

FATMIRI — (*Nervoz*) Atëhere ec e iu thuaj!

* BIMI — (*Rreptë*) Unë po flas me ty. Po ti si mendon, është e drejtë?

FATMIRI — Ç'do të thuash, folë më qartë!

* BIMI — Atë që thashë: folë, ti je dakord?! (*Hesh-tje*) Rrugës, më dukej sikur të gjithë sa kalonin më shikonin mua dhe më thoshin: «për fajin tuaj arrestuam mbrëmë dhjetë veta. Ata janë krejt të pafaj... a keni menduar pér këtë?» Pashë nëna që qanin...

FATMIRI — I pashë edhe unë.

* BIMI — Atëhere?...

FATMIRI (*Nervoz*) Çfarë atëhere?

* BIMI — S'është, pra, e drejtë, s'është as njerëzo-re.

BESA — (*E cila ka dëgjuar një pjesë të bisedës së tyre*) Njerëzit janë ngatërruar shumë herë në atë se çfarë është e drejtë dhe çfarë duhet të quhet njerëzore. Nganjëherë i kanë ngatërruar të tjerët... prifti dhe hoxha u thonë të shtypurve t'i mëshirojnë shtypësit e tyre. Herë të tjetra janë ngatërruar vetë, pse s'e kanë vrarë mendjen shumë dhe kanë marrë përsipër fajet e të tjerëve. Fajtorë për atë që ka ndodhur mbrëmë në lagjen tonë, për arrestimin e atyre që the ti, janë po ata që më plagosën mua, janë po ata që ju kanë hedhur juve në këtë varfëri. Po në këtë vepër të tyre nuk ka asgjë të drejtë, asgjë njerëzore; kurse lufta kundër tyre është e drejtë, krejt njerëzore. Nuk flas kështu pse dua të mbroj veten... Thashë vetëm një mendim... Tani bëni si të doni, mua aq më bën...

FATMIRI — Çfarë të bëjmë?... Bimi nuk tha asgjë...

~~BIMI — Po tregoja vetëm çfarë ndodhi mbrëmë në lagjen tonë dhe ç'na panë sytë sot në mëngjez, por nuk kisha në mend atë që the tani së fundi. Shumë nga ato që the nuk i marr vesh, megjithatë, ç'është e mirë dhe ç'është e keqe di ta ndajë edhe unë... (Jashtë duken Adnani, Sazani dhe Telati)~~

~~Po vijnë edhe të tjerët...~~

FATMIRI — (*Besës*) E ka fjalën për shokët e tjerë. Harrova të them. Bimi ka veshë të çuditshëm, dëgjon shumë dhe njeh hapat e secilit nga ne.

~~x BIMI — Racë qeni, kështu më thoshin kur isha ushtar. (Hynjë Adnani, Sazani dhe Telati)~~

~~ADNANI — Mirëmbërëma! (Pëershëndetin edhe të tjerët, por, kur shikojnë se Besa është akoma aty, disa prej tyre nuk e fshehin pakënaqësinë)~~

~~FATMIRI — Mirëmbërëma. U lodhët?~~

~~ADNANI — Nga pak.~~

~~SAZANI — (Fatmirit) Nuk vajte gjëkundi?~~

~~FATMIRI — Vajta, por nuk qe e mundur ta merrnin sot. E patë edhe vetë si janë mbushur rrugët plot me karabinierë e xhandarë. (Jashtë, në rrugë, duken roje që kalojnë si patrullë. Bimi i dëgjon, e kupton se po kalojnë dhe nuk u thotë gjë të tjerëve)~~

SAZANI — Mund të vijnë edhe këtu. Po kontro-llonin shtëpi për shtëpi. (*Rojet largohen*).

ADNANI — (*Bërtet*) Sazan!

TELATI — Nuk vijnë, jo. Erdhën një herë mbrë-më.

SAZANI — Nuk i dihet...

FATMIRI — (*i papërmabjatur*) Prandaj, kush nuk do të qëndrojë, rrugën e ka të hapur, mund të shkojë dhe të këthehet kur të largohet rreziku. Koha po ngrohet, nga e keqja mund të flihet edhe jashtë.

ADNANI — (*Bërtet*) Fatmir!

FATMIRI — (*Shpërthen*) E po si duhet të them atëhere?

ADNANI — Folë, po mos fyej të tjerët.

TELATI — Sazani foli keq i pari.

BESA — (*Fatmirit*) Ti the se të gjithë më fshehët... Unë e kuptova se edhe të tjerët qenë dakord.

ADNANI — (*Papritur*) Mirë të ka thënë, ne të gjithë jemi një.

BESA — Më falni, por m'u duk se po bisedonit për mua...

ADNANI — Si e ndjen veten tanë? Ke dhëmbje? (*I shikon plagën*) Kush ta lidhi kaq mirë plagën?

* BIMI — Fatmiri.

ADNANI — (*Me shaka*) Më mirë se unë. (*Sazanit*) Shikoje, shikoje sa mirë. Edhe ti që e heq veten si gjysminfermieri nuk do ta lidhje kështu.

SAZANI — (*Duke u afruar*) Me garzë, s'do mend. (*Fatmirit*) Ku i more? Ke akoma? Nesër do t'ja lidh unë.

BESA — (*Sazanit*) Me të vërtetë je infermier?

SAZANI — Jo, bëjnë shaka. (*I shikon temperatu-rën*) Ka zbritur edhe të nxehtit. Shumë mirë.

TELATI — (*Me shaka*) Për zotin, tamam si mjek flet ti, Sazan, duket që ke punuar në spital.

ADNANI — Po pér darkë ç'na keni bërë?

TELATI — Kam një uri prej sharrëxhlu.

* BIMI — (*Duke u shfajësuar*) U hutuam fare, nuk na ra në mend pér asgjë. Po bukë a sollët?

ADNANI — Unë duhet të kujdesem gjithnjë për ju. (*Nga një çantë që mbante në krah nxjerr bukë dhe gjizë*) Qe bukën, qe edhe pak gjizë.

TELATI — Kot nuk të kemi të parin tonë.

ADNANI — Vetëm pér këtë punë, pa pér të tjerat as pyetni fare, bëni me kokën tuaj. Më duket se kishim edhe pak qepë, diku duhet të jetë. (*Kujtohet*) Po mikut ç'do t'i japim?

TELATI — Cilit mik?

SAZANI — (*Besës, duke u tallur me Telatin*) Mos ja vini re, harron shumë.

TELATI — (*I singertë*) Pér zotin harrova fare.

BESA — Ndoshta ai tani më quan si të shtëpisë. (*Adnanit*) Pér mua mos u bëni merak. Vërtet nuk më hahet.

SAZANI — (*Besës*) Si të quajnë?

FATMIRI — Besa.

SAZANI — Mua më quajnë Sazan. Këtë e thërrësim baca Adnan, kurse këtë Telat. Këtyre të tjerëve me siguri ua di emrat: njërit ja thonë Fatmir dhe tjetrit Bimi.

FATMIRI — (*Me shaka*) Sazani është ndër ne më i shëtituri. Kurse Telati është hamësi më i madh. (*Duke u ulur atje ku Adnani po ndan bukën dhe qepët*) Nuk kam ngrënë që mbrëmë, më preu uria. (*Bëjnë të afrohen edhe të tjerët*)

* BIMI — (*Dëgjohen hapa në rrugë, Jashtë duket Lamja*) Pritni! Dikush po vjen. (*Bie porta. Heshtje, Fatmiri menjëherë rregullon vendin pér të fshehur Bësen dhe i hedh një mbulesë përsipër*) Qëndron pranë saj. Telati zë vend te porta)

LAMJA + (*Duke i rënë portës*) Hapeni, jam unë, Lamja! Sazan! O Sazan! A je në shtëpi, më dëgjon apo jo?

SAZANI — Ç'do, or Lame, kaq vonë, kemi rënë pér të fjetur.

LAMJA + Kaq shpejt! Po hape, hape pak... (*Të gjithë shikojnë në sy njëri — tjetrin*)

FATMIRI — (Telatit) Hapja!

ADNANI — Luajte nga mendtë!

FATMIRI — (I vendosur) Hapja po tē them!

✗ BIMI — Fatmir, hap sytë! (Tē tjerëve) Ai ka nē xhep revole. (Telati ndërkaq ka hapur portën dhe hyn Lamja)

LAMJA + Ç'jeni mbyllur kështu dhe nuk e hapi ni portën? (Vë re që po hanë darkë) Kalova këtej dhe thashë: dale t'i shoh këta miq si rrojnë, si i kanë punët. (Heshtje) Po hani darkë! Hani, hani... Kot, fare kot er-dha...

ADNANI — A po merr një kafshatë edhe ti?

LAMJA + Jo, kam ngrënë.

✗ BIMI — Pse, nuk ishe roje edhe ti?!

LAMJA + Unë jo, ishin tē tjerë... Kanë dy net që kërkojnë një vajzë, një komuniste tē rrezikshme...

ADNANI — E gjetën?

LAMJA + Jo, akoma... Por do ta gjejmë, se s'bënn. Dhe do ta varin, nē mes tē qytetit, pa çka se është vajzë, që tē marrë vesh ky popull se tē gjithë komunistët kjo i pret: litari.

TELATI — A janë shumë këta komunistët, o Lame? Si shumë telashe po keni me ta...

LAMJA + Nuk janë shumë, jo... Por janë si ai grami i keq, mbijnë kudo.

TELATI — Po për një vajzë jeni çuar peshë gjithë këta burra? Nuk më ka parë syri ndonjëherë kaq xhandarë e karabinierë si sot këtu më lagjen tonë.

LAMJA + Vajzat komuniste janë më tē idhëta se burrat, nuk i njeh ti ato. Pastaj ajo nuk është një dosido...

ADNANI — Ju e kërkoni nëpër lagjen tonë, o Lame, kurse ajo kushedi ku ka vajtur dhe tallet me ju tanë.

LAMJA + Jo, këtu është... Diku është fshehur, po ku?

TELATI + Hë, ku?...

LAMJA + Aty është puna: ku? Këtë tē zbuloj unë dhe u bëra marshall menjëherë, përveç një shpër-

blimi tē majmë, sa tē them: aq sa tē gjithë ju fitoni pér tre vjet.

x BIMI — (*Fishkëllon*) Kaq shumë?!

SAZANI — Po atyre që e kanë fshehirur ç'u bëjnë?

LAMJA + Kuptohet, njëlloj... (*Papritur i shkujnë sytë te këpucët e Besës, tē cilat ishin harruar në një qoshe, por nuk e bën veten. Fatmiri e vë re këtë. E vë re dhe Telati*) Mirë the ti, Adnan, ajo kush e di ku ka vajtur... .

FATMIRI — (*Provokonjës*) Mirëpo ti ke vendosur tē bëhesh marshall!...

LAMJA + Unë marshall!... Ha — ha — ha! Fola ashtu kot...

FATMIRI — Jo, ti nuk fole kot, dhe dole ta kërkosh kështu!...

LAMJA + (*Ngatërrrohet*) Jo... as më duhet gjë mua ajo punë. Kalova krejt rastësishët dhe thashë: pa dale t'i shoh një herë këta miq...

SAZANI — (*Duke kuptuar gjendjen*) Po ç'kemi andej nga fshati, o Lame, ke marrë gjë vesh, si i kemi ata fëmijë?...

LAMJA + Nuk kam dalë fare, s'kam takuar njeri. Po hani bukë, hani... ju lashë pa ngrënë... Më falni, o vëllezër. Unë po shkoj tani, boll ndenja.

ADNANI — Kaq shpejt?! Ja, mbaruam edhe ne. Djem, pastrojeni vendin.

LAMJA + Më falni që ju ndërpresa... E po, natën e mirë... (*Bën tē dalë*)

FATMIRI — (*Bërtet*) Prit! (*Ndërkohë Telati e zë nga prapa dhe e përplas përtokë. Lamja bën tē nxjerrë revolen, por Fatmiri i kërcen përsipër dhe nxjerr revolen e vet*)

x BIMI — (*Bërtet*) Mos! (*Por është vonë, dëgjohet një krismë e mytur. Lames i bie revolja e tij nga dora. Të gjithë kanë ngrirë në vend. Fatmiri ngrihet, duke mbajtur në dorë revolen e vet. Heshtje. Të gjithë shikojnë herë atë, herë Lamen tē vdekur. Heshtje*)

ADNANI — Vdiq? (*Besa heq mbulesën dhe shikon*)

TELATI — (*Afrohet, i lëviz njérën dorë*) Vdiq.

ADNANI — Po sikur ta kenë dëgjuar krismën jashtë? (*Telati del jashtë, vëren me kujdes dhe kthehet*)

* BIMI — Hë?

TELATI — Qetësi. Krisma nuk u dëgjua shumë: ishte në rroba dhe në mish.

ADNANI — Duket nuk u shqetësua njeri. Sot krismat e pushkëve janë më të zakonshme se britmat e kalamajve në rrugë.

* BIMI — Thuaj nuk kishte ndonjë patrullë këtu pranë... Këtë thuaj... (*Ul kokën në tokë dhe dëgjon*) Nuk dëgjohet asgjë... Qetësi e plotë.

ADNANI — Në lagjen tonë zakanisht njerëzit fletë shpejt, dërmohen gjithë ditën në punë, prandaj...

SAZANI — Kjo s'ndryshon asgjë.

ADNANI — Por është me rëndësi.

SAZANI — (*Ngrihet, shikon Lamen të vdekur, pastaj i drejtohet Fatmirit*) Ç'bëre kështu?

FATMIRI — Atë që deshi të bënte ai me ne.

ADNANI — (*Duke i shikuar revolen Fatmirit*) Mirë thotë: ç'bëre kështu? Ku e more atë?

* BIMI — Harrova t'ju them më parë...

ADNANI — (*Bërtet*) Ku e more? (*Nuk merr përgjegje: i drejtohet Bimit*) Ku e mori?

* BIMI — Le ta thotë vetë. (*Heshtje*)

ADNANI — (*I afrohet*) E di ç'bëre?

SAZANI — Vrau, ja ç'bëri...

FATMIRI — Vrava një xhandar...

SAZANI — Njësoj është...

FATMIRI — (*Bërtet*) Jo, është dy soj! (*Heshtje*) Dhe tani të bëhet ajo që thashë në fillim: kush të dojë është i lirë të shkojë. Bile sa më parë, aq më mirë. (*Shpërthen*) Ç'prisni akoma, pse nuk shkon?!?

ADNANI — (*Bërtet*) Pusho! (*Fatmiri bën të flasë*) Pusho po të them! (*Heshtje*) «Shkoni!...», «Ç'prisni akoma?...» Fjalë sa të duash... Po ku të shkojmë? Ku?...: Ne

ishim këtu, të gjithë bashkë. Ti e vrave, mund të mos e vrisje, por ne ishim këtu bashkë me ty.

SAZANI — Ai bëri me kokë të vet, se mos na pyeti... se mos u muar vesh me ne... Në fund të fundit, përsë?..

BESA — Për sherrin tim.

SAZANI — (Bërtet) Po, për sherrin tënd... Për ty arrestuan gjithë ata njerëz mbrëmë, për ty ai (*tregon Fatmirin*) vrau, për ty do ta pësojmë të gjithë një ditë... Kush je ti? Ç'deshe që erdhe? U fute këtu për të shpëtuar lëkurën tënde dhe aq të bën për të tjerët.

BESA — (Prerë) Po të ishte puna për të ruajtur lëkurën time, e kisha të lehtë: rrija në shtëpi edhe unë, si bëjnë akoma shumë të tjerë dhe të tjera të moshës sime... Po nuk është puna për të ruajtur ose për të shpëtuar lëkurën time, nuk është puna aty....

SAZANI — Ku ta di unë si e ke hallin ti...

BESA — E, pra, duhet ta dish. Kjo (*tregon plagën e saj*) nuk të thotë gjë, kjo, ty? Mbrëmë mora vetëm këtë, nesër mund të ndodhë edhe ajo, të le lëkurën këtu ose në ndonjë vend tjetër... Edhe kjo mund të ndodhë. Unë i kam marrë parasysh të gjitha... Pra nuk është puna si the ti... E more vesh?!

SAZANI — Unë di këtë: ai u vra për sherrin tënd...

BESA — Po ti pse nuk pyet, përsë e bëj unë këtë, përsë?!

SAZANI — Nuk më duhet gjë që ta di...

BESA — (Bërtet) Jo, duhet ta dish.

SAZANI — (Bërtet) Mos bërtit! Unë duhet të bërtas, apo ti?!

ADNANI — (Rreptë) Sazan!... Pusho!... Mbylle po të them!...

SAZANI — (I papërbajtur) Sazan, Sazan... Nuk e dëgjon si flet? (*Tregon Besën*)

FATMIRI — Pas atyre që the, mirë t'u përgjegj... Nuk ta ka frikën njeri, jo...

SAZANI — (Fatmirit) Po ti, more, ku na dole kaq trim... Në qoftë se ta mban, dil atje në rrugë të madhe

dhe bën ç'të duash. Por atje, jo kätu. Eshtë e lehtë kështu: ai një, ju dy.

ADNANI — Jo, pesë.

SAZANI — Mirë, tre.

BIMI — Pesë.

BESA — Gjashtë.

SAZANI — Ti mos folë! Nuk kam punë me ty.

BESA — Tani kam unë punë me ty.

SAZANI — (*Lëviz nga vendi*) Ke parë kështu?...
Mirë thonë...

BESA — (*Prerë*) Çfarë thonë?

SAZANI — Do ta them: se me ju komunistët nuk e nxjerr në krye as dreqi.

BESA — (*Reptë*) Kush e thotë këtë: ky kätu. (*Tregon Lamen e vrarë*)

SAZANI — Jo vetëm ai... Ohu!...

BESA — (*Prerë*) Qëndro aty!.. Dhe ulu... (*E vendsur*) Ulu po të them!

SAZANI — (*Duke u përbajtur*) Shiko, shiko, fillove të japësh edhe urdhëra!..

BESA — Urdhëra mbase jo, por ti nuk bën mirë që ndahesh nga shokët.

SAZANI — Atë e di unë dhe nuk do të marr mend nga ti...

BESA — Jo nga unë, po nga të gjithë sa jemi këtu! Fatmiri e vau atë, (*tregon Lamen të vrarë*) kjo eshtë e vërtetë, po ne ishim të gjithë kätu, pra të gjashtë e vramë dhe me të drejtë, s'kish rrugë tjetër... Në fund të fundit, një zagar vramë... një tradhëtar... Fatmiri dhe ne të gjithë e vramë.

SAZANI — Mirë, ju katër dhe ajo pesë. Kështu heq trimëri kushdo. (*Tallës*) Ha-ha-ha! .. Trimëri e madhe!

FATMIRI — (*Sazanit shumë serioz*) Ke më? Folë, ke më?

SAZANI — Pse, ç'do të bëje?

FATMIRI — Zbrazu po të them, thuaji të gjitha...

ADNANI — (*Bërtet*) Në shesh të gjithë! (*Bën me duar të ulen. Bimi dhe Telati ulen ngadalë. I drejtohet*

Sazanit) Në shesh po të them! (*Sazani bën të flasë*) Asnjë fjalë! Ulu në shesh!

SAZANI — Të ulet ai i pari.

ADNANI — (*Fatmirit*) Ulu! (*Fatmiri ulet. I drejtohet Sazanit*) Ulu tani. (*Ulet edhe Sazani. Heshtje. I drejtotohet Bimit*) Folë ti i pari.

X BIMI — Kjo nuk duhet të ndodhte... Mund të mos ndodhete...

SAZANI — Të mos i biem rrrotull... Të përgjigjet pse e vran.

ADNANI — Prit, do të flasësh kur të vijë radha.

SAZANI — (*Nervoz*) Oh, sa me gjakftohtësi që flet!

ADNANI — Prit, të thashë!... (*Besës*) Të dëgjojmë edhe të tjerët, kështu? (*I drejtohet Fatmirit*) Folë, ke gjë pér të thënë?

FATMIRI — (*I menduar*) Pse e vrava?... Ju e patë vetë... Ju ishit këtu... S'kish rrugë tjetër... Ai pse erdhi? Si mendoni, pse erdhi?

SAZANI — S'ishte e para herë që vinte, ai kish ardhur edhe herë të tjera... ti e di mirë... (*Të tjerëve*) Ju të gjithë e dini....

FATMIRI — (*I qetë*) Ta zëmë se erdhi ashtu kot, si herët tjera... Unë them jo, por ta zëmë... Mirëpo ju e patë si ndodhi, nga këpucët ai kuptoi çdo gjë... E patë se si kërkoi të tërhiqej... të shkonte...

TELATI — Porsa pa këpucët, shpejtoi të dilte... Unë e vura re...

FATMIRI — Dhe ku do të shkonte? Ku kujtoni se do të shkonte? Ç'do të bënte? Do të heshtte?!... Jo, aspak... Ai do të tregonte, patjetër do të tregonte. Zagar ishte ai, zagari ku ha, atje leh...

SAZANI — Atëhere pse e fute brenda? Ti i the Telatit ta hapte portën. Ti e dije se kjo (*tregon Besën*) ishte këtu, pse e fute brenda?

FATMIRI — S'mund të bënim ndryshe: po të mos i hapnim portën, ai do ta merrte me mend dhe njëlljo do të lajmëronte.

SAZANI — Atëhere ti e fute brenda pikërisht pér ta vrarë, thuaje hapur, pse nuk e thua?!

FATMIRI — Jo, atë çast nuk mendova pér ta vrarë... Thashë se do të hidhte një sy, si xhandar që ishte, dhe do të shkonte.

SAZANI — Gënjen!

FATMIRI — Unë nuk gënjej.

SAZANI — Gënjeshtra s'ka brirë... (*Fatmiri ngrihet me rrëmbim*)

ADNANI — Fatmir! (*Eshtë ngritur edhe Sazani*) Në shesh po ju them! Uluni të dy! Keni luajtur mendsh të dy! (*Heshtje. Bërtet*) Uluni! (*Ulen të gjithë. Heshtje e gjatë*)

✗ BIMI — Po tani, ç'do të bëjmë me të? (*Tregon kufomën e Lames*) Ky nuk mund të rrijë këtu.

SAZANI — Kurse kjo (*Tregon Besën*) qëndroi dhe mund të qëndrojë akoma!...

BIMI — Nuk mund të rrijë këtu pse qelbet, më kupton ç'dua të them?!

SAZANI — Drejtoju atij, (*tregon Fatmirin*) jo mua.

✗ BIMI — Mirë, po mos bërtit. Në fund të fundit, nuk e pate vëlla. Ç'ke që bërtet?

SAZANI — Ç'kam që bërtas?!... Asgjë... Kot... Fare kot... (*Nervoz*) Jo, pér mua s'është kot. E para, e kisha bashkfshatar, njiheshim prej kohësh, e kisha mik. E dyta, kur ta marrin vesh të vëllezërit atje në fshat, do drejtohen tek unë, se mua më njojin, nga unë, edhe të mitë atje në fshat, do ta kërkojnë, derisa u gjend i vrarë këtu, ku banoj unë... Më duket nuk janë pak të gjitha këto... (*Heshtje*)

ADNANI — (*Në një anë i ndriçuar nga një pistoletë*) Lëmshi sa vjen dhe po ngatërrrohet... «Kjo mund të mos ndodhete» — tha Bimi — Nuk e di!... Por shumë keq që ndodhi. Ngutet, është i rrëmbyer ky djalë... Por si të bënte?... Të mos e vriste?... Por ai ç'do të bënte... (*Nervoz*) Por, por.. Më duket se po ngatërrrohem edhe unë. Këtu nuk është fjala se bëri mirë apo keq... Çështja është: ç'duhet bërë tani?

FATMIRI — (*Në një anë, i ndriçuar nga një pistoletë*)

toletë) Unë e di, jo vetëm Sazani, por edhe të tjerët. Bimi këtë e tha hapur, e kanë të vështirë ta pranojnë se s'mund të bëja ndryshe. (*Duke u shpejtar*) Atëherë desha dhe e vrava... Apo e vrava pse duhej ta vrisja pér të shpëtuar (*shikon nga Besa*) atë... gjithë të tjerët... vreten? S'kam qenë ndonjëherë në luftë... por thonë se atje kështu ndodh: armikun o e vret, ose të vret ai ty... E vrava përpara se të na vriste — ja pérse e vrava... Në fund të fundit, një xhandar vrava. (*Duke shikuar nga Sazani*) Pse, ai nuk e kupton këtë? Si t'ja shpjegoj? Si të bëj që të më kuptojë?...

SAZANI — (*Në një anë i ndriçuar nga një pistoletë*) Djalli, vetë djalli e solli sonte. Ja kisha thënë kaq herë: ç'tu desh që u bëre xhandar? Hiq dorë!» Po ku merrte vesh ai! Ja tanë... Ta zëmë se erdhı ashtu kot, ashtu si herë të tjera... Por ai kuptoj çdo gjë... Ai deshi të bëhej marshall, e tha vetë. Prandaj nuk mund të mos vinte në dyshime Fatmirin. Por pse ta vriste?... Pse?... Edhe unë s'di si të them... (*Nervoz*) Djall o punë, si ngatërohen gjérat nganjëherë... .

BESA — (*Papritur i drejtoshet Sazanit*) Ti the se kur të marrin vesh atje në fshatin tënd, do të drejtohen tek ti... Po pse ta marrin vesh? Aspak. Askush nuk do të marrë vesh asgjë... (*Heshtje*)

SAZANI — (*Besës*) Për ty është e lehtë. Nesër ti ikën prej këtej dhe askush s'do të marrë vesh se ti ishe këtu, se pér shkak tënd u vra ai... Pasnesër ky (*tregon kufomën e Lames*) qelbet këtu dhe atëhere... .

BESA — Thashë, se askush nuk do të marrë vesh asgjë... Nuk më dëgjove?

x BIMI — Si?

BESA — Mjaft që asnjë nga ne të mos flasë, të mos tradhëtojë.

SAZANI — (*Tallës*) Ja, asnjëri nga ne nuk tradhëtoka, ja edhe pasnesër ne të gjithë do ta braktisim këtë kasolle...

BESA — E pse ta braktisim? Aspak...

SAZANI — Aspak kjo, aspak ajo... Pusho se na i qite mendtë!

ADNANI — (Bërtet) Ç'dreqin ke, pse bërtet?

SAZANI — Nuk do të marrim mendtë e saj, ja ç'kam.

BESA — Jo, nuk do të pushoj. (*Sazanit*) Ti the se të gjitha këto ndodhën për sherrin tim. Pra gjithë sa ndodhi ka lidhje drejt për së drejti me mua. (*Bën të flasë Fatmiri*) Prit! (*Sazanit*) Unë tani jam pjesëtare e kësaj shtëpie. Ishit pesë, u bëmë gjashtë. Prandaj do të flas si të gjithë ju, do të flas... Dhe kam për të thënë këtë: të hidhet atje në përrua, sonte ose nesër mbrëma, porsa të jetë hequr rrëthimi i lagjes...

TELATI — (Gjallërohet) E marr unë përsipër. (*Bën të dalë*)

ADNANI — Ku shkon?

TELATI — Do të shikoj se ka apo s'ka roje akoma. Po të jenë pakësuar, e hedhim që sonte dhe merr fund kjo punë. (*Del*)

ADNANI — (Bimit) Ti si thua?

✗ BIMI — Ç'të them?! Tani për tani kjo është rru-gëdalje. Për më tutje, shohim e bëjmë.

SAZANI — Dihet si u nis, por s'dihet si do mba-rojë. Ja, këtu jemi.

✗ BIMI — Ç'të bëjmë, sipas teje?

SAZANI — S'duhej nisur kjo valle. E keqja filloj mbrëmë... Tani vijnë varg, njëra pas tjetrës.

ADNANI — E dëgjuam një herë. (*Nervoz*) Të dëgjuam dhjetë herë, tani mjaft... Mjaft de!... Oj ky!..

TELATI — (Duke hyrë) Çdo gjë në rregull. Roje s'ka më. S'dukan.

FATMIRI — (*Adnanit, duke i shtrirë dorën*) Sidooqoftë, ma jep revolen. (*Adnani heziton pak, por ja jep*) Tjetrën jepja Telatit (*Adnani i jep revolen tjetër Telatit. Merr në shpinë kufomën e Lames dhe i drejtotohet Telatit*) Prij ti përpara. (*Dalin të dy*)

✗ BIMI — (Është ulur dhe dëgjon, duke vënë ve-

shin n̄ë tokë) Po ecin... U ndalën pak... Po ecin përsëri... Tani nuk dëgjohen më... (Ngrihet)

SAZANI — Kështu ndodh, e thashë edhe njëherë: dihet si fillon, por nuk dihet si mbaron. (*Dëgjohen pushkë. Sazani shpërthen*) Ja edhe fundi. I dëgjoni?... Pushkë...

ADNANI — Prit! (*Dëgjon me vëmendje. Dëgjohen përsëri pushkë, por duket se janë larg*) Janë shumë larg. Pastaj nuk ka përgjegje... (*Dëgjojnë me vëmendje... Heshtje*) Jo, s'kanë lidhje më ta.

SAZANI — S'ka asnë dyshim se një ditë kështu do të mbarojë kjo punë.

✗ **BIMI** — (*Nervoz*) Na plase, të marrtë dreqi, të marrtë: jo kështu, jo ashtu.

ADNANI — (*I tërheq vërejtjen*) Bimi! Fillove edhe ti?

SAZANI — (*Bimit*) Pusho, more ti! Kush të pyet ty këtu? (*Adnanit*) S'e kuptoj: ç'doni nga unë, të myll gojën? Jo, nuk e myll!... Nuk kam si ta myll. Iku burri i botës si qeni në vreshtë dhe ju më thoni të hesht. E përsë?...

✗ **BIMI** — (*Papritur*) T'i biem shkurt! O rri si eshtë për të ndenjur ose bën ashtu si të tha Fatmiri: (*duke hapur portën*) rrugën e ke të hapur, shko!

FATMIRI — (*Duke hyrë*) Pse, si eshtë puna?

ADNANI — Asgjë... asgjë.

TELATI — Çdo gjë vajti në irregull! (*Sazanit*) Askush nuk do ta marrë vesh. Veç kur ta gjejnë nesër në përrua.

BESA — (*Fatmirit që eshtë afruar pranë saj*) Të falemnderit!

FATMIRI — Si e ndjen veten tani?

TELATI — Kushedi ç'menduat kur dëgjuat ato pushkët që ranë pak përpara. Binin nga ana tjetër. Natën gjithnjë bien pushkë, herë nga një anë, herë nga ana tjetër. Kohë lufte!... Çudi! Dikur vetëm flitej për lutfët, më vonë ajo filloj me të vërtetë. Shumë shpejt erdhì ajo në lagjen tonë, tani sikur ka hyrë edhe në këtë

kasolle. Nuk më thoni pse luftojnë njerëzit në mes të tyre, tamam si ujqërit?

BESA — Ti si thua: pse luftojnë?

TELATI — Unë pyeta i pari.

SAZANI — Pse njerëzit janë më të këqinj se ujqërit.

BESA — Kjo nuk mund të thuhet për të gjitha rastet.

SAZANI — (Besës) Fillove avazin ti? Do të ta them shqip: mos na ngatërron me politikë, ne kemi hallet tona.

BESA — Më duket se kjo, tanimë, është e pamundur.

ADNANI — Në ç'kuptim?

BESA — Pas atyre që ndodhën mbrëmë dhe sonte, thashë është e pamundur.

SAZANI — (Të tjerëve) Kaq deshi, sa të hidhte grepin...

ADNANI — (Reptë) Për të fundit herë po të them: pusho!

SAZANI — Dhe kjo (tregon Besën) të mos na flasë për politikë këtu. Ne jemi njerëz hallexhinj, boll kemi hallet tona. Ç'na duhen punët e saj? Politika s'është për ne.

TELATI — Pse s'qenka për ne?

SAZANI — Sepse është e rrezikshme, për ne hallexhijtë sidomos. Për të pasurit mbështetje një luks, kurse për ne është ndryshe...

FATMIRI — Të pasurit shumë gjëra i mbajnë për vete, kurse ne na i ndalojnë. Nuk janë budallenj ata, jo, më të mirat i mbajnë për vete. Edhe ai konduktori ynë, atje në kantier, u thoshte një ditë punëtorëve: «shikoni punën tuaj për të fituar ndonjë lek më shumë, nuk ju duhet gjë politika juve».

TELATI — E di ku e kishte hallin ai: te partizanët. Ju ka hyrë lepuri në bark.

SAZANI — Rri, more Telat, kush na pyet ne për këto punë. Sa na pyeti njeri kur e thirrën Italinë, aq do të na pyesin edhe kur të ikë.

BESA — Vetë nuk ikën jo, duhet ta përzëmë.

SAZANI — Le ta përzënë ata që i kanë dalë zot kësaj pune... (*Heshtje*) Unë kaq di, kaq them. Për vete e kam mendjen top: dua të siguroj bukën e kalamanëve. Kush e ka siguruar atë, të merret edhe me politikë, e me se të dojë.

~~BIMI — Po kjo (*tregon Besën*) e pasur është? Si e di ti?~~

TELATI — (*I afrohet Besës dhe e shikon nga ko-ka deri në këmbë*) Nuk më duket.

SAZANI — Nga e more vesh ti?

TELATI — E nuhata dhe nuk më duket.

FATMIRI — Pse, si i di ti komunistët, të pasur?

SAZANI — (*I zënë ngushtë*) Unë po flas për politikën: është apo nuk është e rrezikshme? Pse ma çoni llafin gjetkë?

FATMIRI — Që është e rrezikshme, këtë e shoh: vetë plaga e saj na tregon qartë. Por, është e mirë apo e keqe, këtë më thuaj ti... Dhe pse nuk qenka ajo për ne hallexhinxjtë?

SAZANI — (*I zënë ngushtë, përsëri bëhet nervoz*) Baca Adnan, si do të vejë ky halli ynë? Kemi dy ditë që s'bëjmë tjetër veç jo kështu, jo ashtu...

ADNANI — Vetë e hape këtë bisedë, bëni ballë tani. (*Të tjerëve*) Mirë, djema, e lëmë politikën në vendin e vet. Edhe unë them se ajo s'është për ne.

TELATI — (*Duke rregulluar vendin e tij për të fjetur*) Hë! Hajvani!... Deshi të bëhej marshall... Bukur fort: u bë nëntoger fare, me një yll.

SAZANI — Fillove ti përsëri? Lëre dreqin.

TELATI — Mirë, e lëmë. Po përse të bisedojmë?

FATMIRI — (*Pas pak*) Ç'kish ndonjë të re sot an-dej nga kantieri?

TELATI — Përsëri deshi të na e zgjaste kohën e punës ai turispinaqi, konduktori, por i doli huq...

ADNANI — Mirë ma kujtove: ç'deshe të bëje ash-tu? Pse or djall, e kërkon sherrin? (*Fatmirit*) Për pak na u zu me të. (*Sazani lëviz nga vendi*)

TELATI — (*Duke shikuar nga Sazani*) Pse e shke-la përsëri?! Tani po flasim për punën atje në kantier. Ç'hyn këtu politika?... (*Bimin e zë kolla, e cila i zgjat për disa sekonda*)

ADNANI — Si do të bësh nesër, do të dalësh në punë?

* BIMI — Duhet të dal doemos, ndryshe më presin rrogën.

SAZANI — Mund të të nxjerrin edhe nga puna... (*Besa bën buzën në gaz. Sazani e sheh*) Nuk e kuptoj, ç'ka këtu për të qeshur.

BESA — Hic, ashtu kot... Po ju dëgjoj dhe se ç'm'u kujtua. (*Pas pak*) S'doni të flisni për politikë dhe s'bëni tjetër veçse për 'të flisni... Prandaj më qeshet.

SAZANI — (*Zemërohet*) Fillove edhe të tallesh tani?... Po pse të mos tallesh?!

ADNANI — Ne po flasim për hallet tonë, për shëndetin e Bimit, Telati tregoi për atje në kantier...

BESA — Sigurisht këto halle s'janë të vogla...

TELATI — Po ju komunistët çfarë hallesh keni.

BESA — Si të them: ja, çfarë qe Lamja? Një zagar i fashizmit. Përse deshi ta zgjatte ditën e punës ai konduktori? Që t'ju grabiste juve dhe të fitonin më shumë padronët e tij. Po për shëndetin e Bimit kush përgjigjet? Ata që, si shushunjat, thithin gjakun dhe djersën e punëtorit e të fshatarit. Ja, pra, që të mos ketë më zagarë e tradhëtarë, të mos ketë më shushunja, që të mos ketë, në radhë të parë, fashistë në vendin tonë — ja përse luftojmë ne komunistët.

TELATI — Po më këtë jemi dakord edhe ne.

SAZANI — (*Telatit*) Folë për vete!... Kush të vuri ty të flasësh edhe për të tjerët?... (*Adnanit*) Kemi në mend të dalim në punë nesër, apo s'kemi më nevojë të punojmë, dhe sot e tutje, në vend të bukës, do të hamë fjälë?...

ADNANI — Mjaft tani, vajti vonë, duhet të flemë. (*Ule dritën e llambës me vajguri*) Shtrihuni, pra, (*Seci-*

li shtrihet në vendin e vet) Natënemirë. (Bimi kollitet. Pas pak ka qetësi)

TELATI — (Lëviz pak dhe afrohet te Besa) Pëfleti?

BESA — Jo, çfarë më deshe?

TELATI — Nuk më thua, si do të jetë atëhere kur të mos ketë më xhandarë, shushunja dhe të pasur, kur të thyejnë qafën edhe këta fashistët e djallit?

BESA — Do ta marrin fuqinë punëtorët edhe shteti do të jetë i tyre.

TELATI — Po ku dinë ata të qeverisin?

BESA — Do të mësojnë, askush nuk ka lindur i ditur...

TELATI — (Në një anë, i ndriçuar nga pistoleta) Mirë thotë: «askush nuk ka lindur i ditur». Në fshatin tonë nuk ka pasur shkollë... Vetëm djali i beut shkon te në shkollë, atje në qytet... Apo nuk kapardisej kur vinte në fshat... Sa inat që e kisha! (Qesh pak) Po mirë ja bëra... Një natë i dola në rrugë, ja këputa më hu, ashtu vence dhe e lashë palmuç mbi tokë. Ishte errësirë dhe nuk më njuhu. Kështu nuk u muar vesh kush ja bëri këtë. Të nesërmen erdhën xhandarët dhe kryetari i komunes... Ah, ai kryetari i komunes!... «Ligji këshfu, ligji ashtu...» vetëm këtë kishte në gojë... Ja tregojë unë ligjin atij... (Afrohet te Besa) Po ligje, do të ketë ligje atëhere?

BESA — Do të ketë, por ato do t'i bëjmë ne.

TELATI — Kush ne?

BESA — Ne: ti, unë, (tregon të tjerët) këta të gjithë...

ADNANI — (Telatit) Fli, or djall, do të flesh apo të nxorra jashtë.

TELATI — Mirë, mirë... Po s'më flihet. (Shkon në vendin e vet. Heshtje e gjatë)

* BIMI — (Pas pak) Telat!... Telat! (Pasi nuk merr përgjegje, i afrohet Besës) Po për të sëmurët do të interesohet njeri atëhere?

BESA — Sigurisht që do interesohet. Shteti në radhë të parë.

BIMI — Pak si e çuditshme më duket: shteti është vetëm për të grabitur, për të marrë taksa dhe për të futur në burg.

BESA — Kur të ikin fashistët, shteti do të jetë yni. Atëhere do të jetë ndryshe. Shteti i të pasurve grabit edhe fut në burg të varfërët, të pasurit jo, kurse shteti i të varfërve do të bëjë të kundërtën.

ADNANI — (*Duke u ngritur pak*) He, ç'më gjeti me ju sonte! Flini, more djaj, flini. (*Bimi largohet në vendin e tij. Heshtje përséri. Adnani ndez një cigare dhe fillon të nxjerrë tym. Pas pak i afrohet Besës*) Këta janë të rinx, moj çupë e babait, nuk marrin vesh ngajeta. Pa më thuaj mua plakut: si do të jetë ky shteti i të varfërve nesër?... (*Atë qist njihen të gjithë të tjerët, të cilët po përgjonin dhe nuk po flinin*)

TELATI — «Më thuaj mua plakut»... Sa mirë ditke se! (*Të gjithë qeshin*)

ADNANI — Ngreuni, djaj! Për pak zbardhet, nuk ka më kohë për të fjetur. Afrohuni të gjithë. (*Të gjithë afrohen pranë Besës, përvëç Sazanit, i cili dëgjon gjithashtu. Fiken dritat. Errësirë. Kur ndizen dritat, të gjithë po bëhen gati për të shkuar në punë*)

TELATI — Sigurisht tanë do ta kenë gjetur atë në përrua. Kushedi ç'bëjnë tanë fashistët! Do të jenë xhindosur fare. Ka rrezik ta rrethojnë lagjen përsëri, dreqi e di, dhe të fillojnë përsëri nga kontrolllet. (*Fatmirit*) Po deshe, rri edhe unë me ty.

ADNANI — (*Fatmirit*) Sidoqoftë, sot duhet (*triangle Besën*) të largohet këtej. (*Telatit*) Dreqi e di, mbasse do bëjnë atë që thua ti, mbasse bëjnë edhe të kundërtën, e mbyllin pa bërë shumë zhurmë, nga frika, jo për tjetër, prandaj s'ka nevojë të qëndrosh edhe ti, eja me ne në punë. (*Fatmirit*) U morëm vesh? (*Fatmiri nuk përgjigjet*) Medoemos. (*Dalin Adnani, Sazani, Bimi dhe Telati*)

FATMIRI — (*Pas pak i drejtohet Besës*) Atëhere unë po shkoj.

BESA — Ku?

FATMIRI — Të takoj atë shokun. Të shahim ç'mund të bëjmë sot. Po nuk pati roje, do të bëjmë diçka, qoftë edhe aty nga mbrëmja. Edhe unë nuk besoj ta rrrethojnë lagjen përsëri.

BESA — (*Papritur*) Sidoqoftë, unë nuk shkoj gjëkundi.

FATMIRI — (*Habitet*) Nuk të kuptoj!

BESA — Tani nuk mund të iki që këtej.

FATMIRI — Pse?

BESA — Si pse? Ajo që ndodhi mbrëmë ka lidhje të drejtpërdrejtë me mua, kështu? Atëhere, si do ta quani po të shpëtoj unë dhe ta pësoni ju?... Prandaj unë nuk iki. Edhe ti e kupton fort mirë, veç në qoftë se nuk do ta thuash. Bile unë po prisja që ndonjëri nga ata që shkuan, të ma thoshte hapur, të ma përplaste në fëtyrë. Dhe kishte plot të drejtë...

FATMIRI — Po plaga? Ti duhet të mjekohesh, ke nevojë për mjek, për ilaçe... Këtu nuk ka kush të bën shërbim....

BESA — E ndjej veten mirë.

FATMIRI — Pastaj... kur ka mundësi të shpëtosh, do të ishte budallallëk... E kupton? Budallallëk...

BESA — (*Shpërthen*) Po ju?

FATMIRI — Ne... është ndryshe për ne... bëjmë si bëjmë ne, kush pyet për ne në bëjmë apo s'bëjmë hije mbi tokë.

BESA — Jo, nuk është e vërtetë!..

FATMIRI — (*I afrohet me rrëmbim*) Duhet të shkosh! Me doemos duhet të shkosh! Bile sa më parë. Tani duhet ta kenë gjetur atë atje në përrua. Kush e di si janë mbledhur kokë më kokë të gjithë ujqërit. Natën do të fillojnë të kérkojnë përsëri shtëpi më shtëpi. E kupton? Ata kanë plot arësyte të mendojnë se ti je akoma diku këtej, nëpër lagje... dhe se nuk je vetëm. Do të bëhen përsëri kontrollë... do të vijnë edhe këtu... E kupton tani? Më dëgjo mua, nesër do të jetë vonë. Dy herë e kaluam rrezikun, të tretën... nuk e di, prandaj...

BESA — (*E vendosur*) Eshtë e kotë, nuk shkoj.
(*Heshtje*)

FATMIRI — (*Papritur*) Atëhere më duhet ta them troç: nuk e kupton se kështu na rrezikon të gjithëve?! Nuk të nxorëm jashtë dhe të mbrojtëm, duke vënë kokën tonë në rrezik... Për ty vramë mbrëmë atë që holdhëm në përrua, vërtet një xhandar, por e vramë. Për shkakun tënd u zumë dhe u grindëm me njëri-tjetrin. Tani ç'do tjetër? Do të vijnë e të të gjejnë këtu brenدا? Apo aq të bën ty se ç'do të ndodhë me ne? Ti e ke të humbur veten qoftë këtu, qoftë atje ku do të shkosh, vetë e ke thënë këtë, por ne, ne përsë? Përsë? Folë, përsë? E kupton tani pse duhet të shkosh?

BESA — (*E prekur, por e vendosur*) Jo, nuk e kupto... Dhe nuk shkoj.

FATMIRI — (*Nervoz*) Po ne mund edhe të nxjerrim përjashta... mund të vemi të tregojmë se je këtu... mund edhe të vrasim dhe të hedhim atje në përrua. Ne nuk do të vrasim veten me duart tona për hattrin tënd. Në fund të fundit, cila je ti? Ç'na lidh ne me ty? Ç'na lidh ne me komunistët? Ne kemi hallet tona, luftojmë për copën e bukës... Nuk na lidh, pra, asgjë. Asgjë. Prandaj.. prandaj mos e zgjat, jepi fund kësaj lodre! E kupton tani? E kupton?

BESA — (*Me zor përbahet*) Jo, nuk e kuptoij.

FATMIRI — (*Shpërthen*) Do të kuptosh se s'bën! (*Afrohet dhe e zë për duarsh. Besës i lëndohet plaga dhe kthen kokën nga ana tjetër për të mos shfaqur dhëmbjen. Fatmiri e kupton se është e kotë të vazhdojë më si e filloj dhe menjëherë zbutet*) Më fal! Nuk desha të të lën-doj. Padashur... Unë e kam për ty...

BESA — E di... Unë e kuptova këtë që në fillim, që kur nise të bërtasësh... Ti nuk e ke hallin se do të rreziko-heni ju, ti ke hallin tim. Unë e kuptova këtë... e kuptova fort mirë...

FATMIRI — Besa, bëhu e arësyeshme. Duhet të shkosh... plaga nuk shërohet vetë... Ti the se nuk mund të ikësh dhe të na lësh neve, nuk mund të shpëtosh ve-

të dhe ta pësojmë ne... Kush të tha se do të pësojmë gjë ne? Aspak! Këtu nuk vjen njeri... Askujt nuk do t'i shkojë në mend të vijë këtu, në këtë kasolle... Kështu ne nuk na gjen gjë dhe ti do të shërohesh shpejt. Prandaj... Kështu është më mirë... e kuption? Është më mirë. Pastaj ti mund të vish përsëri, sa herë të duash dhe kur të duash. Apo do të na harrosh?

BESA — Jo, nuk shkoj. (*Fatmiri, i pakënaqur që nuk arriti ta bindte, hesht dhe bën të largohet. Besa e zë për dore*) Shko tani, me siguri shoku Gaqo të pret. I thuaj të mos bëhet merak. Tregoji për atë që ndodhi mbrëmë. Bëja të qartë edhe pse unë vendosa të qëndroj këtu.

FATMIRI — Nuk e di si mund të sqaroj atë tjetrin për një gjë që nuk jam i qartë vetë.

BESA — Ai do të më kuptojë. (*Heshtje*) Pse je kaq i ashpër? (*Shikohen gjatë në sy*) Kam një porosi: të lutem, përveç fashove dhe çdo gjëje që duhet për plagen, mos harro të më sjellësh edhe disa komunikata.

FATMIRI — Çfarë komunikatash? Përse duhen ato?

BESA — Ta them kur të kthehesh. Veç kujdes rru-gës...

FATMIRI — Tjetër ke?

BESA — U zemërove?

FAMIRI — (*Shikohen gjatë në sy*) Jo. (*Bën të dallë, por kthehet*) Po të bjerë porta, mos bën zë, e more vesh? (*Del duke myllur portën*)

(*Bie perdja*)

PJESA E DYTË

I njëjti dekor. Hyjnë Adnani, Sazani, Bimi dhe Tëlati. Ata shikojnë Besën që fle dhe nuk e zgjojnë.

SAZANI — (Duke iu afruar Besës) E pra, sot do të shkonte! (Adnanit) Kështu qe edhe porosia jote, medoomos.

* BIMI — Sot ishte më keq se dje. Nuk e pe? Rojet genë dyfishuar.

SAZANI — Nesër do të trefishohen, e pastaj?

TELATI — Le të qindfishohen! Të shohim kush do të mërzitet. (Hyn Fatmiri)

FATMIRI — Mirëmbrëma.

TË GJITHË — Mirëmbrëma, mirëmbrëma.

ADNANI — Si u bë puna?... (Fatmiri bën me shenjë se mos dëgjojë Besa) Ajo fle?

FATMIRI — Si e sheh...

* BIMI — Sot, sigurisht nuk mund të bëhej asgjë.

FATMIRI — Sigurisht, por edhe sikur të kishte mundësi, ajo nuk do të shkojë.

SAZANI — Si? Si the?!

FATMIRI — Thashë nuk do, ose, më mirë, nuk pranon të shkojë... .

SAZANI — E bukur edhe kjo. Vjen pa e ftuar, për sherrin e saj ne vrashim një njeri, nga çasti në çast mund ta pimë edhe ne dhe, pa çarë kokën për asgjë, thotë: «nuk dua të shkoj». Kësaj i thonë: babë, e kapa hajdutin. Bjere këtu! Nuk vjen. Atëherë lëshoje, mor bir! Nuk më lëshon.

ADNANI — (*Sazanit*) Prit ta marrim vesh një herë, mos u ngut! (*Fatmirit*) Nuk pranon të shkojë, po përse??

FATMIRI — Për atë që ndodhi mbrëmë: «Unë isha këtu me ju dhe do të qëndroj me ju deri në fund».

TELATI — Shumë e drejtë, fjalë burrash.

SAZANI — Shejtanllëqe grash...

BESA — (*Zgjohet*) Për mua po flitni?

ADNANI — (*I afrohet*) Po, dhe nuk po dimë si të flasim me ty.

BESA — Ju rëndojoj për një copë bukë?

ADNANI — S'është aty puna. As që na shkon në mend. Por çdo të bësh ti këtu me ne? Ç'patëm në dorë, e bëmë, tani ç'do tjetër? I lëmë të gjitha: ta zëmë se nuk do të vijnë për të kontrolluar, se nuk ka asnje irrezik, as për ne as për ty, se plaga që ke do të shërohet vetë... Por çdo të bësh me ne, me se do të merrresh?

BESA — Kur unë jam dokord...

SAZANI — Por s'jemi dakord ne!

ADNANI (*Duke larguar pak Sazanin*) Dua të përsërit edhe një herë: shko, moj vajzë, në punën tënde dhe ne mbetemi në punën tonë. Kështu është më mirë: secili në punë të vet. Ç'të lidh ty me ne?

BESA — Shumë.

ADNANI — Unë nuk po flas për atë që ndodhi me Lamen ose për atë që të fshehëm nga karabinierët.

BESA — Unë flas edhe për ato, edhe për të tjerat.

BIMI — Më duket se kot bisedojmë për një gjë që nuk e ka në dorë as ajo as ne. Sot, edhe po të donte, nuk shkonte dot. (*Heshtje. Sikur pranohet kjo ide. Secili zë nga një vend dhe me diçka merret*)

ADNANI — (*Në një anë i ndriçuar nga një pistoletë*) Një mendje më thotë të ikë, bile sa më parë... veç rrreziqe sjell ajo në këtë kasolle... Një mendje tjetër më thotë ndryshe: të rrijë. Arësyja që vë, edhe në mos qoftë e vëtmja, ka një kuptim... Nuk thonë kot: kur të vjen e keqja, hapi portën... (*Papritur*) Po ku djallin u ndodh e hapur ajo portë? Ne s'e linim hapur asnijëherë...

Aq më pak natën!... (*I qetë*) Por ja që ndodhi një herë... dhe ajo herë solli gjithë ato që solli... Sa ditë e net, sa muaj, më se një vit ka kaluar në këtë kasolle pa u ndjerrë fare... pa u marrë vesh... pa sjellë asgjë, as për të mirë, as për të keq?!. (*Nervoz*) Po ku djallin u ndodh e hapur ajo portë?!... Po Lamen? Vetë djalli e solli edhe atë shejtan! Kishte kohë që s'kishte ardhur. Apo erdhi me qëllim?.. Nuk thonë kot: kur të vjen e kedja, hapi portën... (*Të tjerëve, papritur*) E keni myllur portën?!

TELATI — Po. (*Heshtje*) Pse?

ADNANI — Kot, kot... (*Lëviz nga vendi, edhe të tjerët lëvizin*)

BESA — (*Fatmirit*) M'i solle ato që të porosita?

FATMIRI — Po, harrova fare... (*Nga torba nxjerr një pako me trakte dhe ja jep. Besa i hap dhe fillon t'i shikojë*)

TELATI — (*I afrohet ngadalë*) C'janë ato?

BESA — Di të lexosh?

TELATI — Jo. Por di të lexojë Fatmiri. Edhe Sazani di pak. Përse shkruhet?

BESA — Për ty. (*Të gjithë shikojnë me vëmendje*)

TELATI — Ti po tallesh. Kujt i bie në mend se ka një Telat në botë!

BESA — Do ta lexoj? Dëgjo: «Armiku egërsohet përditë. Ai vë shpallje nëpër rrugë dhe kërcenon se, kush strehon komunistët, do të pushkatohet në vend, por populli i strehon dhe i mbron bijtë dhe bijat e tij. Armiqtë zbuluan një bazë të luftës në qytet, rrethuan një lagje të tërë dhe kontrolluan çdo shtëpi... Kërkonin një vajzë, por në vend të saj, sot gjetën në përrua kufo-mën e një xhandari...»

TELATI — Lamen!... Po, për zotin, për atë flet.

SAZANI — (*Besës*) S'ka asnë dyshim: po të gjetën këtu, ne të gjithë pushkatoheri në vend.

TELATI — Unë në radhë të parë.

SAZANI — Ti i ke dalë zot vetë kësaj pune. Por ne hyjmë kot, fare kot në këto belara. (*Pas pak*) Të

gjitha ato, (*tregon komunikatat*) për këtë flasin? Ç'i do të gjitha ato?

BESA — (*Duke lexuar*) Këtu, në fund, shkruan: «Lexoje, shpërnda dje armikut mos ja dorëzo».

SAZANI — (*Shpérthen*) Mos do tani që edhe t'i shpërndajmë, të merremi edhe me këtë punë?

BESA — Po. (*Të gjithë ngrijnë në vend*)

SAZANI — (*Bërtet*) Ne?! Ne t'i shpërndajmë ato? Edhe kjo ka mbetur! Ha-ha-ha! E thua me gjithë mend?! (*Papritur*) Ç'ke në mend të na bësh neve, komunistë? (*Serioz*) Shiko, çupë e mirë, dhëntë zoti e s'vjen njeri sonte, sepse keq për ty dje keq për ne. Por nesër, sa të pakësohen rojet, ti në punën tënde dje ne në hallet tonë. U morëm vesh?

FATMIRI — Secili flet për vete, vetë e ke thënë këtë një herë. Unë nuk dua që të tjerët të flasin në emrin tim.

TELATI — As unë. (*Heshtje*)

SAZANI — (*Adnanit*) Ti s'po flet! Pra, po hesht! Kjo do të thotë....

ADNANI — S'do të thotë asgjë!..

SAZANI — Nuk ju kuptoj, me të vërtetë nu~~k~~ ju kuptoj! Në fillim na zuri belaja dje s'kishim nga t'ja mbanim. Por më duket se tanë po e kërkojmë vetë me këmbët tonë. Po të vazhdojmë kështu, kam frikë se një ditë do ta kthejmë këtë kasolle në një depo armësh. Bëni si të doni. Unë heq dorë. (*Shkon në një qoshe dhe shtrihet për të fjetur. Heshtje*)

ADNANI — Hani bukë një herë, pastaj flini. (*Heshtje. Sazanit*) Ngreu, me ty po flas!

SAZANI — Nuk më hahet.

ADNANI — (*Të tjerëve*) Ngreuni ju të tjerët.

* BIMI — Po ti?

ADNANI — S'kam uri.

* BIMI — As unë. (*Shtrihet për të fjetur. Adnani, menduar, thith fort cigaren. Fatmiri dhe Telati heshtin. Pas pak shtrihen edhe ata. Errësohet. Kur hapen dritat*)

është ditë. Në dhomë është vetëm Besa. Ajo tanë është më mirë, është ngritur dhe fillon të rregullojë diçka nëpër dhomë, por me zor qëndron. Pas pak hyn Bimi)

BESA — Pse u ktheve?

* BIMI — Isha te mjeku, harrove?... Vetë më dërgove dhe harrove...

BESA — Hë, ç'të tha?

* BIMI — Më dha ca ilaçë dhe më tha: «Të vish përsëri». Po para pse nuk më mori mua ai?

BESA — Janë shokët tonë edhe ata, prandaj...

* BIMI — Pse, kemi shokë edhe nga mjekët ne?

BESA — Kemi, posa, edhe të tjerë kemi... Atëherë, do të shkosh përsëri?

* BIMI — Do të shkoj. (*Duke prekur një mbulesë që Besa ka vënë mbi do plaçka*) Po këto ku i more?

BESA — I solli Fatmiri. Më ndihmo të vëmë pak rregull. (*Pasi rregullojnë pak*) Pse, nuk është më mirë kështu?

* BIMI — Sigurisht, por ne mund të rrojmë edhe pa to...

BESA — Dhe pa marrë vesh se ç'ndodh jashtë kësaj dhoma!..

* BIMI — Nuk desha të them këtë.

BESA — Ndoshta ashtu qe më mirë?!. (Me zor qëndron, prandaj Bimi e ndihmon të ulet)

* BIMI — A do të them të vërtetë? Edhe ashtu nuk rrohet. Bota është diçka më e madhe se kasollja jonë. (*Hynë Adnani, Sazani dhe Fatmiri*)

ADNANI — Ho-ho, qenkan bërë ndryshime në këtë kasollen tonë! (*Sazanit*) Nuk është më mirë kështu? Sesi më duket tanë kjo kasolle! Edhe frymë tanë merr më lirisht!

* BIMI — Ky është vetëm fillimi.

FATMIRI — (*Besës*) Çdo gjë në rregull.

ADNANI — (*Fatmirit*) Shpërndarja e trakteve edhe sot shkoi në rregull, këtë po i thua? (*Besës*) Edhe atje, në kantierin tonë, nuk ka më qetësi.

* BIMI — Telati nuk erdhi me ju?

ADNANI — Nuk e di ku mbeti. E kërkova, por bën se ka ardhur, nuk besoj të vonohet.

SAZANI — E kërkova edhe unë... Unë kam thënë dhe e them: Telati do përmabajtur...

ADNANI — Përse të shkon mendja? Gjithnjë veç pér të keq mendon. Hiq dorë nga mendimet e këqia. (*I shqetësuar*) Unë them se ai është duke ardhur tani...

SAZANI — Pra as ti nuk je i qetë deri sa të vijë. Në kasollen tonë kanë hyrë dreqërit dhe nuk dimë më se ç'ndodh. Dikur çdo gjë ishte më e thjeshtë... Nuk e kemi më veten në dorë. Unë flas seriozisht.

ADNANI — Ti me të vërtetë të shtie dreqërit me këto dyshimet e tua. (*Jashtë, diku larg, dëgjohen pushkë. Heshtje*)

BESA — Sigurisht, ndonjë aksion... Në ndonjë depo...

ADNANI — Nga e kupton ti këtë?

BESA — Janë pushkë alarmi.

* BIMI — Në qoftë se nuk ngatërron gjë era, pushkët bien andej nga kantieri ynë.

SAZANI — (*Papritur*) Telati!... Unë e pashë atë t'i sillej rrrotull depos. Prandaj edhe dyshova... Prandaj të thashë edhe rrugës: ku është Telati? Ja ku është, atje te depua...

ADNANI — (*Bërtet*) Mos folë marrëzira. (*Sazani bën të flasë*) Pusho të thashë!

BIMI — Sazani ka thënë dhe thotë shumë marrëzira... Por kësaj here ka të drejtë. Telati më foli këto ditë pér punën e depos...

ADNANI — Po ti pse s'na fole ne të tjerëve? Apo ishe dakord edhe ti? Po të jetë kështu, atëherë ka të drejtë Sazani. (*Fatmirit*) Ti di gjë? Më thuaj të drejtën.

FATMIRI — Jo, s'di asgjë.

TELATI — (*Hyn me shpejtësi, myll portën dhe qëndron i mbështetur tek ajo*) U dogj!

ADNANI — (*I afrohet*) Çfarë u dogj?

TELATI — Depua. (*Adnani me zor përbahet*)

FATMIRI — Të lumtë!

SAZANI — (*Duke treguar Fatmirin*) Ja kush do ta marrë në qafë, dhe jo vetëm atë. Unë jam i bindur që ti e ke ditur, në mos e paç shtyrë...

FATMIRI — (*Duke u përbajtur*) Unë thashë se nuk kam ditur gjë. Dhe ja ku po të them: po ta kisha ditur, nuk do ta kisha lënë vetëm, do të kisha vajturi bashkë me të. Po, po, mos dysho aspak.

ADNANI — (*Besës*) As ti nuk ke ditur gjë?

BESA — Jo.

ADNANI — (*Telatit*) Herë tjetër nuk do të bësh asgjë pa pyetur. (*Largohet pak dhe rri i menduar*)

SAZANI — (*Çuditet*) Me të vërtetë nuk kuptoj më asgjë! Sipas kësaj që the, e keqja është vetëm pse nuk pyeti... Në qoftë se nesër ai do të pyesë ti pra, do të jesh dakord??!

TELATI — (*Besës*) Tani do të më japësh edhe mua trakte?

SAZANI — (*Me ironi*) Pas kësaj prove që dhe... e meriton. Mund të ketë besim të plotë...

BESA — (*Duke u përbajtur*) Ka kohë që dua të pyes: çfarë ke ti me mua?

SAZANI — Na fute dreqin në shtëpi, ja ç'kam.

TELATI — Mjaft edhe ti, gjithmonë ty do të dë-gjojmë? Na lodhe, e more vesh? Na lodhe.

ADNANI — Telat!

TELATI — Sa do durojmë? (*I drejtohet Sazanit*) Për të fundit herë po të themi: ja ku e ke portën.

SAZANI — Ashtu?!... Mirë...

TELATI — Veç mos harro: po të doli nga goja, qoftë edhe një fjalë...

SAZANI — (*Shpërthen*) Në qoftë se ti do të nxjerrësh tani qoftë edhe një fjalë të vetme, unë do të vras! *Rrëmben një dru dhe njihet një kënbë. Njihen edhe të tjerët*)

ADNANI — Uluni! (*Bërtet*) Në shesh po ju them. (*Telatit*) C'deshe të thuash me atë potere fjalësh? (*Telati bën të flasë*) Mbylle, asnjë fjalë më tepër. As ti, (*i drejtohet Sazanit*) as ti. Hidhe poshtë, atë dru! (*Bërtet*)

tet) Dëgjon apo jo? Hidhe poshtë atë dru! (*Sazani e hedh*) Uluni dhe flitni si njerëz.

SAZANI — (*Duke u ulur*) Fjalët janë të tepërtatani.

BESA — Më shumë se unë askush nuk ka arësye të zemërohet. Dhe megjithatë nuk po zemërohem.

SAZANI — Pse të zemërohesh ti? Këta të gjithë bëjnë si do ti.

BESA — (*Duke u përbajtur*) Përsëri nuk do të zemërohem.

FATMIRI — (*Shpërthen*) Por edhe durimi ka një kufi.

SAZANI — Kufiri u kalua...

BESA — Ç'do të thuash?

SAZANI — Asgjë. (*Duke zënë një qoshe, shtrihet për të fjetur*) Natën e mirë! (*Pas pak shtrihen edhe të tjerët për të fjetur. Errësohet. Pas pak Sazani ngrihet pak, i ndriçuar nga një pistoletë*) Deri këtu, më tutje asnje hap. Unë pyes: ku vemi kështu? Dhe kam të drejtë: çdo ditë sjell diçka... Filloi si një gjë e vogël, kurse po na del e madhe. Me një fjalë: nuk shoh qartë... Mirëpo unë dua të shoh qartë... (*Nervoz*) Djall o punë, këtu nuk është puna: unë, apo ata! (*Qetësohet*) Atëhere?... Ku të na çojë vala?! Kokën në thes dhe shty përpara!... Në radhë të parë duhet të bëhet e qartë: c'valë është kjo? Ne nuk dimë asgjë... Unë, të paktën, nuk di asgjë... (*Nervoz*) Djall o punë, përsëri unë! Po ata? (*Qetësohet*) Atëhere?... Unë ua thashë, disa herë ua thashë... nuk di si t'ua them ndryshe. Po pse ata nuk e shohin?... Pse nuk duan ta shohin fundin drejt të cilit ne po vrapijmë si të çmendur?... Apo e shohin dhe thonë: na zuri, tanë s'kemi ç'të bëjmë. Kjo ndodh shpesh me ne të varfërit: fatkeqësitë vijnë njëra pas tjetrës dhe ne themi: «ky pas ka genë fati ynë», «na zuri, s'kemi ç'të bëjmë», (*Nervoz*) Po pse të gjitha të këqiat përplasen tek ne? Mjaft! Unë nuk dua më... Kam boll... Boll! Pra asnje hap.. asnje hap më tutje. Për mua këtu merr fund... (*Errë-*

sohet. Kur ndizen dritat, në dhomë janë Besa dhe Fatmiri, i cili porsa është kthyer dhe nga xhepet nxjerr disa komunikata, bomba dore, paketa me dinamit dhe dy revole nga brezi)

FATMIRI — Në komunikatë flitet edhe për aksionin që bëri Telati. Kurse këto (*tregon bombat etj.*) janë për një aksion tjetër, që duhet bërë sonte, në mbrëmje.

BESA — Kush do të vijë me ty?

FATMIRI — Përveç Telatit, duhet të paktën edhe një tjetër.

BESA — Do të vij unë.

FATMIRI — Jo, ti jo...

BESA — Pse jo unë?!

FATMIRI — Nuk bën... Edhe shokët më kanë porositur disa herë...

BESA — Nuk jam dakord me shokët.

FATMIRI — Atë shko thuaja atyre.

BESA — Është me rëndësi?

FATMIRI — Çka!

BESA — I vështirë?

FATMIRI — Edhe i lehtë jo. Pse?

BESA — (*Duke mbledhur veten*) The se duhet edhe një tjetër, të paktën...

FATMIRI — Do të provoj ta bisedoj edhe më të tjerët, porsa të vijnë.

BESA — Edhe me Sazanin?

FATMIRI — (*I menduar*) Të shoh. (*Heshtje*) Shokët të bëjnë të fala.

BESA — Ç'ka ndonjë të re?

FATMIRI — Ata më thanë se ka ardhur koha që ti të largohesh prej këtej.

BESA — Ndoshta... Këtu tani ka një bazë që nuk ka më nevojë për mua. Dhe gjithë kjo të detyrohet ty. Unë për këtë ju kam shkrojtur edhe shokëve...

FATMIRI — Ma thanë. (*Heshtje*) Sot mora pjesë edhe në një mbledhje.

BESA — Unë e shikoj, tani ti mund të ecësh vetë. Prandaj ata e kanë menduar drejt. (*Heshtje*)

FATMIRI — (*Papritmas*) Të mos flasim më pér këtë.

BESA — Si të duash. (*Heshtje*) Atëhere pérse të flasim?

FATMIRI — Pérse të duash.

BESA — Pér aksionin që do të bësh nesër.

FATMIRI — As pér këtë.

BESA — Atëhere më thuaj diçka pér veten tënde, pér jetën tënde.

FATMIRI — S'ka asgjë interesante.

BESA — Njëherë të kam thënë: «Pse jë kaq i ashpér?» E mban mend? Atëhere nuk m'u përgjegje.

FATMIRI — Nuk e di, porjeta ka qenë e ashpér me mua. Që kur isha i vogël... Në shtëpinë tonë ishim gjashtë fémijë, unë isha i katërti. Babai më vdiq kur unë isha pesë vjeç. Nuk kishim as tokë, asgjë. Që shtatë vjeç u bëra çoban, në fillim më dhi, pastaj me lopë...

BESA — E pastaj?...

FATMIRI — U rritëm vetëm me kujdesin e nënës. Ishte një grua trime. E mbaj mend një natë, kur po rrnim pranë zjarrit, ndërsa jashtë frynte e binte shi me dëborë bashkë, pasi na kish treguar përralla të frikshme me xhinde dhe të vdekur, më dërgoi mua, vetëm, te dajat pér të marrë diçka, nuk më kujtohet çfarë... Shtëpia e dajallarëve ishte në lagjen tjeter dhe pér të shkuar atje duhej të kaloja pranë varreza-vë të fshatit. Nuk i kisha mbushur akoma tetë vjeçtë. U nisa. Të them të drejtën, dridhesha nga frika. Por nuk mund të bëja ndryshe. Ajo ishte grua e ashpér. U nisa, pra. Kalova nga njëra anë e fshatit në tjetrën, kalova pranë varreve, kapërxeva përrenj, ndërsa shiu binte me furi, vetëtinte e bubullinte. Kur u ktheva në shtëpi, ajo më tha: «Pse vravove kur kalove pranë varreve?» Unë u habita nga e mori vesh ajo. Motra më tregoi më vonë se ajo më kishte ndjekur nga pas dhe se të gjithë këtë e kishte bërë pér të më hequr frikën...

BESA — Bimi më ka treguar se ke shtënë edhe me pushkë, edhe me revole, që kur ishte tetë ose nën-të vjeç.

FATMIRI — Ashtu pat ndodhur. Isha me dhi në mal. Andej në malet tonë kishte disa njerëz që cuhe-shin kaçakë. Unë i kisha parë ata disa herë. Një ditë njëri, i pari i tyre, më tha: «A do të shtiesh me pushkë?» Dhe kështu ndodhi: shtira edhe me pushkë, edhe me revole. E mbaj mend se më dhëmbi supi kur shtira me pushkë... (*Hyjnë Adnani, Bimi dhe Telati. Janë të mërzitur*)

ADNANI DHE

TË TJERËT — Mirëmbrëma!

FATMIRI DHE BESA — Mirëmbrëma.

FATMIRI — (*Pas pak*) Po Sazani? (*Nuk merr përgjegje*) Sazani, thashë, nuk erdhi me ju? (*Nuk merr përgjegje*) Nuk po marr vesh, pse nuk përgjigjeni? Ku është Sazani?

ADNANI — Ai nuk vjen më...

FATMIRI — Pse? Këtë jua tha ai vetë?

BIMI — Jo, ai na u fsheh. E thirra, por nuk m'u përgjegj.

ADNANI — Nuk është ashtu, nuk u fsheh... Mbështetje nuk të dëgjoi kur e thirre...

TELATI — Si nuk dëgjoi? Dëgjoi fort mirë, por bëri sikur nuk dëgjoi... dhe iku.

ADNANI — Mirë, mirë... Por unë mendoj se s'ka asnjë arësyte të shqetësohem. Ne kemi ngrënë bukë bashkë... jemi mbuluar me një jorgan... ai nuk na bën gjë neve... Nuk mund të na bëjë gjë të keqe... Për vete ai s'deshi të vazhdonte... nuk qe i një mendjeje me neve... Pse? Nuk e di... është punë e tij...

TELATI — Nga frika...

ADNANI — Jo, Sazani nuk kishte frikë! Këtë unë e them si për veten time. (*Heshtje*) Ajo puna e Lames e pat turbulluar... Pastaj nuk u ngroh më. Si i thonë një fjale: buka e thyeme nuk ngjitet më.

BESA — Vetëm kjo?...

ADNANI — (*Papritur*) Mos! (*Heshtje*) Mos vazhdo. Deri tani ti ke thënë vetëm fjalë të matura. Të mos ngutemi. Më lini të flas një herë me të. Nesër ai do të vijë në punë...

FATMIRI — Po në qoftë se nesër do të jetë vonë?

ADNANI — (*Zemërohet*) Si flet kështu? Si mund të mendosh kaq keq për shokun?... Ne kemi ndarë kafshatën e gojës së bashku, kemi qarë hallet e njëritjetrit.

BESA — Të gjitha këto janë, por nuk shpjegojnë çdo gjë. Nuk prekin kryesoren: kjo është një luftë, që nuk merr parasysh asgjë... që i përmbyt të gjitha.

* BIMI — (*Adnanit*) Pse nuk na tha asgjë?... Pse kështu hajdutçel!... Nuk deshi të qëndronte, mirë... ja thamë vetë, disa herë ja thamë.

TELATI — (*Papritur*) Shumë e drejtë! (*Bën të dalë*)

BESA — Ku shkon?

TELATI — Ta gjej. Të shoh ç'ka në mend të bëjë.

BESA — (*Duke i dalë përpëra dhe duke qëndruar te porta*) Ti nuk do të shkosh askund.

TELATI — Po si, atëhere, të presim?... Çfarë të presim, që të vijnë të na zënë të gjithëve? Nesër mund të jetë vonë. Ai e di me se merremi ne tani.

BESA — (*E menduar*) Po, e di...

TELATI — Prandaj... (*Do të dalë*)

BESA — Prit! (*Heshtje*) Në qoftë se është ashtu si tha baca Adnan, ai tani mendohet, do të mendohet mbështetës deri nesër, dhe sa më shumë të mendohet aqë më mirë është. Prandaj...

TELATI — Çfarë prandaj...

BESA — Fatmir! Ti the se sonte do të bëhet një aksion tjetër? Mirë. Unë mendoj se Sazani duhet të jetë diku këtej rrötull. Puna është që ai të mos vendosë të bëjë gjë deri nesër... Aksioni, që do të kryhet sonte, do ta bëjë të mendohet akoma. Ai e di se aksionin e kemi bërë ne.

TELATI — Kjo do të jetë një arësy me tepër që të na tregojë...

BESA — Mund të ndodhë si thua ti, por mund të bëjë edhe të kundërtën...

* BIMI — Nuk thotë keq. Pastaj nuk duhet harruar se edhe ai nuk ka qenë krejt jashtë valles.

ADNANI — Do të thuash nga frika. Sazani nuk ka frikë, këtë e them me bindje të plotë.

FATMIRI — Kjo mbetet për t'u parë: ka apo nuk ka frikë.

ADNANI — Për çfarë aksioni bëhet fjalë?

FATMIRI — Në depot e mëdha.

ADNANI — Kush do ta bëjë këtë aksion?

FATMIRI — Unë... dhe Telati.

ADNANI — S'është punë për dy veta ajo.

TELATI — Mund të bëhem katër. (*Të gjithë shikojnë në sy njëri-tjetrin*)

FATMIRI — (*Nxjerr një skicë nga xhepi dhe e vendos diku. Telati, Bimi dhe Adnani afrohen me radhë dhe shikojnë. Fatmiri shpjegon. Besa ka qëndruar te porta dhe i shikon*) Sot unë u solla disa herë rrötull depos. Po të zëmë dy rojet, atëherë çdo gjë do të shkojë mirë: dy kontrollojnë rrugën dhe dy të tjerë u vënnë zjarrin depove. (*Heshtje*)

TELATI — (*Duke u drejtuar nga Besa me shaka dhe duke e nderuar me grusht*) Shoqja komisare, ki besim. cdo gjë do të vejë më së miri.

BESA — Si the?

TELATI — Shoqja komisare... Kujton ti se nuk e di unë ç'janë komisarët dhe komisaret?... Më ka treguar Fatmiri.

BESA — (*Duke iu drejtuar Telatit*) Shoku partizan! Gatitu! (*Telati qëndron gatitu. Të tjerëve*) Gatitu! (*Të gjithë qëndrojnë gatitu. Besa nderon me grusht*) Vdekje fashizmit!

TË GJITHË — Liri popullit!

BESA — Tani ju jeni një njisit i vërtetë.

ADNANI — Dhe komandant kemi Fatmirin.

FATMIRI — (*Duke marrë komandën*) A têhere bëhuni gati. (*Duke u dhënë armët, bombat etj.*) Tê dalim një nga një. Piqemi te varrezat. (*Dalin një nga një. I pari del Telati, pas tij Bimi. Bën tê dalë edhe Adnani*)

BESA — Shoku Adnan! (*Ai qëndron. Besa i afrohet ngadalë, është e prekur, i bie në gjoks dhe e shtrëngon fort. Adnani del. Bën tê dalë edhe Fatmiri*) Kujdes. Është e lehtë tê përgjigjesh vetëm pér vete, shumë më e vështirë tê përgjigjesh edhe pér tê tjerët.

FATMIRI — Do tê përpinqem. (*Del*)

BESA — (*Kthehet në vendin e saj e ndriçuar nga një pistoletë*) Me njerëzit ka vetëm një gjuhë pér t'u marrë vesh: gjuha e së vërtetës. Ajo ndoshta është e vrazhdë... mund tê kërkojë shumë... ndoshta shkakton edhe dhimbje, por ka fuqi... është e kuptueshme... (*Heshtje*) C'ditë është sot? (*E kënaqur*) Sot është dita e formimit të njësitit... Dita që njësiti vajti tê bëjë inaugurimin e tij... (*Shikon orën që ka në dorë*) Pér pak arrijnë... Pér pak njësiti do tê flasë... Pér pak zërin e tij do ta dëgjojnë tê gjithë... Do tê flasë me gjuhën e vet tê ashpér, por tê qartë... (*Shikon orën përsëri*) E vërteta nuk e ka tê lehtë... Asaj i vënë plot pengesa, por me luftë ajo fiton... Me doemos fiton. (*Shikon orën përsëri*) Tani duhet tê kenë arritur... Tani fillon... Tani ata kanë mbaruar punë me rojet... (*Heshtje, pret me padurim*) Jo, akoma, është shpejt. (*Papritur*) Pse s'po dëgjohet gjë akoma? (*Diku, larg, dëgjohen disa tê shtëna me pushkë*) Po këto? (*Heshtje*) Jo, jo, kush e di ku bien. Depot janë nga kjo anë. (*Bën me dorë*) Po pse akoma s'po dëgjohet gjë?! (*Shikon orën përsëri*) Ora vajti! Ora po kalon! (*Shpërthen*) Pse s'po dëgjohet gjë akoma?... (*Dëgjohen disa krisma tê forta në thellësi*. Ajo i numeron) Një... dy... tre... (*E kënaqur*) Aksioni i parë i njësitit... aksioni i parë... i pari... sa shumë u dëgjua... gjithë qyteti e dëgjoi. E kanë dëgjuar edhe shokët dhe me siguri thonë: bravo njësitet. Nesër duhet ta marrë edhe ko-

munikata... (*Shikon orën*) Tani ata do tē vijnë... (*Dëgjohen pushkë po në atë drejtim nga u dëgjuan krismat e mëdha*) Pushkë... (*Dëgjohen tē tjera*) Vazhdojnë. (*Heshtje*) Sigurisht japin alarmin. (*Mban vesh*) Nuk ka përgjegje. Pra ata janë larguar. Për pak ata janë këtu. (*Bën se kanë ardhur. Afrohet te një raft dhe e hap*) Po çfarë t'u jap pér tē ngrënë? (*Dëgjohen pushkë tē tjera*) Prapë?! (*Pushkët pushojnë. Ajo fillon tē presë bukën*) Po vonohen... Pérse? Pse s'po vijnë akoma? (*Hap raftin përsëri*) Po çfarë t'u jap pér tē ngrënë? S'ka asgjë. (*E myll dollapin*) Po le tē vijnë një herë. Tani do tē vijnë. (*Jashtë shikohet Telati, i cili afrohet ngadalë dhe hyn brenda*) Erdhët? Si vajti?

TELATI — Të tjerët s'kanë ardhur akoma?!

BESA — (*I afrohet*) Jo, pse?

TELATI — Kot, kot... Ë lamë tē takohemi këtu. Kam hallin e Bimit, atë nuk duhet ta kishim marrë... është i sëmurë, nuk vrapon dot. (*Jashtë duken Adnani dhe Bimi. I pari hyn Bimi*) Për ty po flitnim.

ADNANI — (*Duke hyrë*) Po Fatmiri?! Nuk erdhët bashkë!

BESA — Kush u vuri zjarrin depove?

TELATI — Fatmiri dhe unë. Kishte mbetur edhe një e vogël dhe ai më urdhëroi mua tē ikja i pari. (*I shqetësuar*) Më urdhëroi, po unë nuk desha ta lija vetëm. Ju e dini si është ai... kur thotë një gjë, do tē bëhet vetëm ashtu...

ADNANI — Kur pamë se ti po largojeshe, u larguam edhe ne... kështu e kishim bërë me fjalë: dy nga dy... ne kujtuam se u larguat tē dy bashkë.

TELATI — (*Nervoz*) Unë jua thashë si qe puna...

* BIMI — Ti nuk duhej ta lije vetëm.

TELATI — Po më urdhëroi pra, më detyroi. A nuk ishte ai komandanti i njësitet?

ADNANI — Le tē ishte komandant, ti tē mos ikje.

TELATI — Po nuk ika!... Nuk ika! (*Bën tē dalë*)

BESA — (*Bërtet*) Ku shkon? Prit! (*Telati qëndron*)

Në ushtri ka rregull, nuk bën dot me kokën tënde. Ti zbatove urdhërin... Duhej ta zbatoje. (Telati bën të dale) Prit të thashë! Zbato urdhërin! (Telati qëndron. Besa shikon orën, e qetë) Kaluan dhjetë minuta. Të presim edhe pak.

ADNANI — Ç'të presim akoma? Vete unë. Dicka duhet bërë, kështu nuk mund të rrimë.

BESA — (E vendosur) Jo! Do të presim edhe pesë minuta. askush nuk duhet të bëjë me kokë të vet.

TELATI — Po ai nuk bëri me kokë të vet kur më nisi mua?!

BESA — Adnan, bëhu gati, do të shkosh ti.

TELATI — Po unë pse të mos shkoj? Për dënim?!?

BESA — Jo, je i papërmabjatur. (Heshtje. Besa shikon orën, me zor përbahet. Jashtë duket Fatmiri)

* BIMI — (E dëgjon) Po vjen. (Mban vesh) Po, ai është.

FATMIRI — (Duke hyrë) Jeni të gjithë? Në rregull.

TELATI — (Nervoz) Po ti pse u vonove? Ç'më bëre ashtu, më nise mua dhe vetë qëndrove... Por fajin e patë vetë, pse të dëgjova.

BESA — (Ka mbështetur kokën te muri dhe ka myllur sytë. Fatmiri i afrohet) Erdhe?

FATMIRI — Erdha.

BESA — (Hap sytë) Komandant i mirë është ai që nuk ndahet nga shokët.

ADNANI — (Duke u afruar) Ishte e para herë. Kjo nuk do të ndodhë më. (Duke qeshur) Bukur planë, njëra pas tjetrës.

* BIMI — S'ke ç'i thua, dorë prej mjeshtri. (Fatmiri) Kot nuk bëhesh minator atje në kantier.

TELATI — Sa më ngriu gjakun mua!

ADNANI — (Duke qeshur) Akoma ky...

TELATI — Nuk do ta harroj sa të jem gjallë.

FATMIRI — (Telatit) Më fal!

TELATI — Nuk të fal hiç.

* BIMI — (Me shaka) Fale, fale...

TELATI — (*Besës*) Si thua ti, ta fal?

BESA — S'ke ç'bën, éshtë komandant, ka të drejtë tē japë urdhëra.

TELATI — Por tē japë urdhëra pér tē qënë.

BESA — Aty ke tē drejtë.

FATMIRI — (*Me shaka*) U krijua aleanca.

ADNANI — E patë si vajtën flakët në qiel? Ish-te puna pér t'i bërë dritë Telatit që tē shikonte nga tē ikte. (*Telati shikon me inat Adnanin*)

FATMIRI — (*Duke hyrë në mes*) Ej, ej! Nuk éshtë Lamja ky. (*Qeshin fort*)

TELATI — (*Bimit*) More, kam vënë re se më pak tē ngacmon kolla tani. Si duket, ato ilaçet që more pa para tē bënë mirë...

BIMI — Më shumë se ato, më duket se po më shërojnë këto ilaçet e Besës. (*Qeshin fort*)

FATMIRI — I lëmë shakatë tani... (*Telatit*) E ka fjalën pér traktet, pér ato e ka fjalën.

TELATI — Shaka bëra edhe unë...

* BIMI — Me gjithë mend e ndjej veten më mirë. (*Heshtje*)

ADNANI — Ku do tē jetë vallë Sazani, çfarë mendon ai tani?

BESA — Sigurisht ka dëgjuar...

TELATI — Po e takova nesër...

BESA — Nuk do t'i thuash asgjë. Bën sikur nuk ka ndodhur asgjë. Mund ti thuash vetëm se e pritëm mbrëmë deri vonë dhe se u bëmë merak pér 'të. (*Të tjerëve*) Kështu edhe tē tjerët. (*Telatit*) E more vesh?

TELATI — (*Duke nderuar me grusht, me shaka*) Si urdhëron, shoqja komisare! (*Fatmirit*) Mos kishe gjë edhe ti?

FATMIRI — Jo. Jam dakord.

TELATI — E besoj. Një kokë keni tē dy. (*Besa dhe Fatmiri shikohen gjatë në sy. Errësohet ngadalë. Kur nd'zen dritat në dhomë hyn Besa, e cila ka sjellë disa gjëra me vete dhe i vendos në dollap. Pas pak hyjnë me radhë Adnani, Telati dhe Fatmiri*)

ADNANI DHE TË TJERËT — Mirëmbërëma!

BESA — Mirëmbërëma! U lodhët?

TELATI — Në kantierin tonë dhe në gjithë qytetin nuk flitet tjetër veç për depot. Po dale, dale kur të hedhim në erë urën, atëhere c'do të jetë... (*Fatmirit*) Sonte apo nesër mbrëma?...

FATMIRI — Të shohim...

ADNANI — (Besës, e cila bëhet gati të pyesë) Bimi u ndal pak të blente bukë. Tani vjen.

BESA — E takuat? (*Heshtje*) Pyes për Sazanin, e takuat?

FATMIRI — Jo, as sot nuk doli në punë... e treta ditë. Askush nuk e ka parë.

ADNANI — Në mos pastë ikur në fshat... Ka një kokë edhe ai... nuk i lë gjë mangut këtij. (*Tregon Fatmirin*)

* BIMI — (Duke hyrë, është i shqetësuar) Ai... (*Të gjithë ngrijnë në vend*)

FATMIRI — Ku?

BIMI — Sillet këtej rrrotull. E pashë, por ai bëri sikur nuk më pa.

ADNANI — Pse nuk i fole?

* BIMI — Nuk mu dha t'i flitja. Thashë t'ju lajmëroja sa më parë.

BESA — Do të vijë.

TELATI — Këtu?! Sigurisht bashkë me karabinerët. (*Bimit*) Ku e pe? (*Tjerëve*) Ma lini mua, di unë si të bisedoj me të. (*Bën të dalë*)

BESA — Jo, nuk do të shkosh askund.

BIMI — Ai për diçka ka ardhur. Pse të bënte sikur nuk më pa? Kurse më pa fort mirë. (*Sazani duket në rrugë*)

* BIMI — (E dëgjon) Po vjen.

BESA — Vetëm?

* BIMI — Po, vetëm, hëpërhë vetëm. (*Ulet dhe vë veshin në tokë*) Dëgjoj vetëm hapat e tij.

FATMIRI — Ju qëndroni në një anë. Më lini ve-

tëm pér vetëm me të. (*Qëndron ballë pér ballë me portën. Hyn Sazani. Heshtje*)

SAZANI — Mirëmbërëma! (*Heshtje*) E shoh, nuk jam i mirëpritur si më parë.

FATMIRI — Pse ke ardhur? Vetëm je a por... Folë, pse ke ardhur? (*Bërtet*) Përgjegju po të them!

SAZANI — Erdha në shtëpinë time... Mos nuk është më kjo shtëpia ime?...

FATMIRI — (*I rrëptë*) Po të pyes: pse ke ardhur dhe a je vetëm? (*Heshtje. Sazani i shikon në sy të gjithë me radhë*)

SAZANI — Unë e di se kush i hodhi depot në erë...

FATMIRI — E merr me mend, këtë e dimë. Prandaj po të pyes: pse ke ardhur dhe ç'do?

SAZANI — (*Me zor i nxjerr fjalët*) Erdha... (*Heshtje*)

FATMIRI — (*Bërtet*) Folë, po të them! Apo do të fitosh kohë deri sa të vijnë... (*Të gjithë fillojnë t'i afrohen ngadalë dhe e vënë në mes*)

SAZANI — (*Shpërthen*) Erdha pse nuk mundem... nuk mundem, më kuptioni... Nuk qëndroj dot... Uolla andej-këtej, por... por nuk mund të qëndroj larg kësaj kasolleje, (*shikon dhomën rrëth e rrötull*) larg jush... larg atyre me të cilat filluam të merreni... larg atyre që bëni ju... që keni bërë këto ditë: aksionit të depove, aksionit tjetër...

FATMIRI — (*Bërtet*) Gënjen!

SAZANI — (*I prekur*) Si the?!... Gënjej?!... Unë gënjej?!... (*Adnanit*) Folë, ti më njeh mirë!... (*Adnani nuk flet*) Bimi! (*Edhe ky hesht*) Telat!... (*Heshtje*) E shoh, nuk besoni... nuk më besoni...

BESA — (*Papritur*) Unë i besoj. (*Të gjithë shikojnë nga ajo*)

FATMIRI — Unë nuk i besoj.

BESA — (*Bërtet*) Fatmir!

FATMIRI — Thashë: nuk i besoj.

BESA — (I afrohet. *Shikohen gjatë në sy*) C'arë-sye ke që të mos i besosh?

FATMIRI — Po ti ç'arësy ke që t'i besosh?

ADNANI — Besa ka të drejtë. Ai është njëlloj si ne. Si do të na tradhëtonte ai ne?!

FATMIRI — Pse iku atëhere?

ADNANI — Ai është yni, i varfër si ne...

* BIMI — Edhe Lamja nuk qe i pasur.

ADNANI — E para, ai nuk është xhandar... E dyta, erdhi vetë...

FATMIRI — Këtë dua të di edhe unë: pse erdhi?

ADNANI — E tha, dhe ne duhet t'i besojmë...

FATMIRI — E tha, por nuk është e qartë...

SAZANI — Mirë, po shkoj. (*Besës*) Të falemndërit dhe më fal. (*Bën të dalë*)

FATMIRI — Ku do të shkosh?

SAZANI — (*Ballë për ballë me Fatmirin*) Në punë time. Unë të thashë të vërtetë... Ti s'beson, (*nervoz*) atëhere më lërë... (*Bën të dalë*)

FATMIRI — Qëndro!

SAZANI — (*Rreptë*) Unë nuk rri me zor.

FATMIRI — (*Bërtet*) Qëndro po të them!

SAZANI — Si të qëndroj?... Si peng?...

FATMIRI — (*Papritur*) Do të vish me ne. (*Nga një qoshe nxjerr armët*)

ADNANI — Ç'ke në mend të bësh?

FATMIRI — (*I rrëmbyer*) Ti, Bimi, qëndro sonte. Në vend tënd do të vijë ky. (*Tregon Sazanin, të cilat i jep revolen dhe bomba*) Merri!

SAZANI — (*Duke i marrë*) Dakord.

ADNANI — Ku vemi?

FATMIRI — Te ura e madhe.

ADNANI — Pse, për sonte e lamë?

FATMIRI — Po, për sonte.

ADNANI — Ajo do kushedi sa dinamit. Janë marrë masat?

FATMIRI — E kam dërguar që mbrëmë dhe e kam fshehur diku, aty afér kthesës... (*Adnanit, i cili e shikon i habitur*) Ka ndonjë gjë që nuk shkon?

ADNANI — Nuk thashë gjë...
BIMI — Unë s'jam dakord. Ne s'kishim bise-duar pér sonte...

FATMIRI — Medoemos sonte.

BIMI — Atëhere do të vij unë. Ç'ke me atë?
(Tregon Sazanin)

FATMIRI — (I vendosur) Jo, ai. Medoemos ai.

SAZANI — (Bimit) Do prova, s'e kuhton këtë?

FATMIRI — Nuk do të vish?

SAZANI — (Pasi ka vënë armët dhe bombat në xhep) Unë jam gati.

FATMIRI — (Nxjerr një skicë nga xhepi dhe jep shpjegime) Këtu është ura. Ne do t'i dalim këtej nga e majta. Dinamitin do ta vendos unë. Ju do të më priti-ni te kthesa. (Sazanit) E di ku është kthesa?

SAZANI — E di.

FATMIRI — Atëhere e qartë pér të gjithë.

TELATI — E qartë, e diskutuam edhe një herë, s'ka dy ditë. (Dalin me radhë Adnani, pas pak Sazani dhe në fund Telati. Bën të dalë edhe Fatmiri)

BESA — (Duke u mbajtur) Nuk bëre mirë.

FATMIRI — Pér Sazanin e ke fjalën?!

BESA — Pér atë dhe pér aksionin. Nuk e kishe pér sonte, por ti i lidhe ngushtë të dyja.

FATMIRI — Nuk je dakord?

BESA — Tani s'mund të bëhet ndryshe. (Fatmiri bën të dalë) Ky është aksioni më i vështirë, prandaj... (Fatmiri del me rrëmbim) Shkuan.

BIMI — Shkuan.

BESA — Sa është ora?

BIMI — Akoma s'ka vajtur dhjetë.

BESA — Ka roje atje te ura?

BIMI — Duhet të ketë.

BESA — Me siguri ka. (Heshtje) Pse është kaq i vrazhdë? Nuk të duket?

BIMI — Zemrën e ka të bardhë.

BESA — Është larg ura?

BIMI — Jo edhe aq. (Heshtje) Nesër përsëri të

gjithë do të flasin për urën. Si për depot. Do të shkruajë edhe komunikata...

BESA — (*Papritur shkon te rafti dhe nxjerr andej një maqinë daktilografike dhe një shaptilograf*) Më ndihmo pak.

✗ BIMI — Ç'do të bësh?

BESA — Ti vazhdo me shaptilografin, se kanë mbetur pa u shtypur edhe nja njëqind copë. Ndërkaq unë po bëj komunikatën për aksionin e urës. Nesër ajo duhet të shpërndahet që në mëngjez. (*Dëgjohet një krismë e fortë, pas saj një tjetër*) «Edhe ura u hodh në erë! (*Fillon e shkruan në maqinë*) Mbrëmë njësiti kreu një aksion tjetër: hodhi në erë urën e madhe në të dalë të qytetit. (*Dëgjohen pushkë. Besa pushon së shkruari dhe shikohet në sy me Bimin*) Armiqve po u digjet toka nën këmbë. Dje një depo, sot një urë, nesër një spiun i vrarë... (*Përsëri dëgjohen pushkë. Heshtje. Shikohen gjatë në sy*) Asnjë minutë qetësi për armiqtë...» (*Vazhdojnë të bien pushkë*)

✗ BIMI — Shumë pushkë po bien.

BESA — (*Duke u përbajtur me zor*) Kush e di nga bien. Lëshojnë alarmin nga të gjitha anët, siç e kanë zakon. (*Duke dashur të tregohet e qetë*) Ku mbeta? (*Shikon fletën që po shkruan në maqinë*) Pra, asnjë minut qetësi për armiqtë... «Armiku duhet goditur nga të gjitha anët: në mal dhe në qytet, në çdo kohë: ditën dhe natën...»

✗ BIMI — Pushkët bien në atë drejtim, andej nga është ura...

BESA — Nga e kupton ti këtë?! Ndoshta të bëjnë veshët.

✗ BIMI — Jo. Ky është luftim: dikush shtie dhe dikush përgjigjet.

BESA — Ashtu? Je i sigurt?!

✗ BIMI — Them se po.

BESA — Sazani?!

✗ BIMI — (*Duke u tërhequr i frikësuar*) Jo... jo.

Nuk besoj. Nuk dua të besoj... Të kenë rënë në kurth?!. E pamundur.

BESA — (Bërtet) Po atëhere?!

BIMI — (Dëgjon hapë jashtë) Po vijnë! Është vë tëm një. (Ulet në tokë dhe dëgjon) Është Fatmiri.

FATMIRI — (Duke hyrë) Ngreuni! Duhet të largohemi prej këtej. Shpejt, shpejt!

BESA — Të tjerët ku janë?

FATMIRI — Ngreuni! Tani s'ka kohë...

BIMI — Folë, ç'ka ndodhur?

BESA — Sazani?!

FATMIRI — Jo. Po të mos ishte ai ne mbaruam të gjithë. Luftoi si trimat...

BESA — Luftoi the?... Pastaj?

FATMIRI — Pastaj?... S'ju themi dot asgjë të saktë. I lajmërova që të mos kthehen më këtu dhe u shpërndamë në drejtime të ndryshme. Telatin, atë nuk pata mundësi ta lajmëroj. Kam frikë për të. Ju e dini si është ai... Shpejt, shpejt!... (Dëgjohen pushkë përsëri)

BIMI — Duket ndonjëri bën pushkë akoma! Telati!

FATMIRI — Ai duhet të jetë... (Besës) Prandaj duhet të lëvizim këtej... Deri në bazën tjetër... Nuk është larg. Më pritni atje. (Bimit) Ti e di vendin: në shtëpinë e atij shokut, që punon në kantierin tonë, të Lefterit. Kujdes rrugës!

BESA — Po ti?

FATMIRI — Do t'ju ndjek nga pas deri në bazën e re, pastaj do të vete të gjej të tjerët. Mos u bën derak. Shpejt, shpejt. Nuk mbetet kohë. (Besa dhe Bimi da'in. Fatmiri shikon edhe një herë dhomën dhe del., Heshtje. Errësohet. Pas pak, jashtë, dy njerëz pyesin njëri-tjetrin)

NJËRI — Ç'ndodh kështu?

TJETRI — Kanë hedhur në erë urën e madhe.

NJËRI — Dhe për këtë e rrethuan përsëri lagjen tonë. (Ata largohen në drejtime të ndryshme. Duken oficeri, dy karabinierë dhe xhandari, si në fillim)

XHANDARI — Po të ndjekim radhën, duhet të kontrollojmë edhe në këtë kasolle. Apo e lemë, s'ka çë këtu, kot sa humbim kohë.

NJË NGA KARABINIERËT — Kot, plot, duhet. Qoftë edhe sa për të qenë në rregull.

OFICERI — Kemi kontrolluar edhe njëherë. Banojnë ata punëtorët e humbur. E mban mend atë natë, kur kërkonim atë vajzën?

XHANDARI — Dhe që nuk e gjetëm dot. (*I bie portës*) Hapeni! (*Heshtje. I bëz fort*) Hapeni! (*I bie fort portës*) Hapeni, more derra (*Heshtje. I bie portës përsëri, i drejtohet xhandarit*) Duhet shpërthyer! (*E shpërthejnë, hyjnë brenda dhe mbeten të habitur kur shikojnë maqinën daktilografike, shaptilografin, në qoshe disa armë e bomba. Njëri nga karabinierët heq nga maqina daktilografike letrën, ku po shkruante Besa dhe lexon*) «Edhe ura u hodh në erë! Mbrëmë njësiti kreu një aksion tjetër: hodhi në erë urën e madhe në të dalë të qytetit...» (*Vjen edhe një oficer i shoqëruar nga një civil*)

OFICERI I DYTË — Ç'bëhet këtu?... (*Shikon shaptilografin etj. dhe ngrin në vend*) Nuk gjetët njeri?

OFICERI I PARË — Jo. (*Njëri nga xhandarët shikon një fustan të Besës dhe e zë me dorë*)

XHANDARI — Sipas shenjave këtu u fsheh edhe ajo vajza atë natë.

NJË NGA KARABINIERËT — (*I cili ka gjetur dokumentat e Lames*) Ja këtu vranë edhe xhandarin Lame, pas dy ditësh...

OFICERI — (*Hidhur*) Dhe ne i kërkonim ata nga të katër anët...

F u n d

Tiranë, 1969

53 771

LIBRI I SHËRIM
BESIMATORE